

**UNIVERSITETI I SHKODRËS**  
**“Luigj Gurakuqi”**

**BULETIN SHKENCOR**

**Seria e shkencave shoqërore**

**Viti LXXV i botimit**

**Nr. 75**

Shkodër, 2025

## **REDAKSIA**

*Kryeredaktor : Prof. dr. Artan HAXHI*  
*Anëtarë: Prof. as. dr. Arben PRENDI,*  
*prof. as. dr. Orjeta BAJA, dr. Bendis Kraja,*  
*dr. Flora Gjoni*  
*Sekretar shkencor : Prof. as. dr. Zamira SHKRELI*

**DREJTOR I REVISTËS**  
*Prof. dr. Tonin GJURAJ*

**Korrektori dhe punoi në kompjuter: Arta Bajrami**

---

*Pronë letrare e Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”*

---

Adresa e redaksisë:      Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”  
Redaksia e revistës “*Buletin shkencor*”  
(seria e shkencave shoqërore)  
E-mail : qsa@unishk.edu.al

## PASQYRA E LËNDËS

- **Gjuhësi**

**Artan HAXHI, Tefë TOPALLI**

Terminologjia si sistem

(Fjalor i termave të gjuhësisë)

*Terminology as a sistem*

*(Dictionary of linguistic terms)*.....7

**Anisa KOSTERI - Bora LOGU**

Fjalorthi i Ri i dom Nikollë Gazullit në dimensionin e tij gjuhësor e kulturor

*The New Glossary of Dom Nikollë Gazulli in its Linguistic and Cultural*

*Dimension*..... 17

**Rovena MERA, Gerta KUPI**

Studim sociolinguistik i r dhe rr, ndryshueshmëria në të folurit urban shqiptar

(2013-2023)

*Sociolinguistic study of r and rr, variability in Albanian urban speech*

*(2013-2023)*..... 29

**Sejdi M. GASHI**

Leksiku i jurisprudencës në disa medie të Kosovës dhe të Shqipërisë

*The lexicon of jurisprudence in some media of Kosova and Albania*..... 47

**Ilda HOXHA**

Roli i studiuesve gjermanë në dokumentimin e shqipes në shek. XX-XXI

*The Role of German Scholars in Documenting the Albanian Language in the*

*20th–21st Centuries* ..... 59

- **Letërsi**

**Ermira ALIJA**

Fishta për tre poetë bashkëkohës: Ndre Mjedën, Asdrenin dhe Kolë Thaçin

*Fishta on Three Contemporary Poets: Ndre Mjeda, Asdreni, and*

*Kolë Thaçi*..... 73

**Edmond MUÇO**

Ikonografia e Onufrit

*Iconography of Onufri*..... 79

• **Gjeografi**

**Nertila HAXHIJA LJARJA, Zamira SHKRELI**

Turizmi i errët në Shqipëri (rasti i Shkodrës) dhe krahasimi me praktikat e Evropës Lindore

*Dark tourism in Albania (the case of Shkodra) and a comparison with Eastern European practices* ..... 91

• **Histori**

**Anelmo SPAHIJA, Bendis KRAJA**

Në anën tjetër të Adriatikut: lëvizja shoqërore dhe politike në Itali në mbështetje të të drejtave kombëtare të popullit shqiptar gjatë Luftës së Vlorës (qershor-gusht 1920)

*On the Other Side of the Adriatic: Social and Political Mobilization in Italy in Support of the National Rights of the Albanian People during the Vlorë War (June–August 1920)*. ..... 105

**Ilijana KACELI (DEMIRLIKA), Cavid QAZIMOV**

Vlerësime të orientalistëve rusë mbi veprën e Mustafa Koçi Beut

*Mustafa Koçi Bey work through the lens of Russian Orientalism*..... 123

**Migena SALIHI, Nertila HAXHIA LJARJA**

Prijësi i madh i qëndresës kombëtare shqiptare, Azem Galica

*The great Leader of Albanian National Resistance, Azem Galica*..... 137

## **JETA SHKENCORE**

### **I Veprimtari shkencore**

*Scientific activity*..... 153

### **II Nekrologji**

Prof. dr. Fatbardha Hoxha (Fishta) (1947 – 2025)..... 160

### **III Botime**

*Publishing*..... 161

Artan HAXHI  
Tefë TOPALLI

## TERMINOLOGJIA SI SISTEM

(Fjalor i termave të gjuhësisë)

(vijon)

### *apeks*

1. Në anatomi **apeks** (nga latinishtja *apex* – majë) është pjesa ekstreme e një organi, p.sh.: maja e gjuhës. Maja e gjuhës është pjesa më e lëvizshme e gjuhës, e cila shërben për të prodhuar tingujt apikalë.
2. *Apeks* në mbishkrimet e lashta latine është një shenjë diakritike që ngjan me theksin e mprehtë të frëngjishtes. Ajo vendoset në pjesën e sipërme të disa shkronjave dhe ka funksione të ndryshme, kryesisht për të treguar gjatësinë e zanoreve. Gjithashtu *apeksi* përdoret edhe në transkriptimin fonetik, kur i paraprin rrokjes së theksuar.

### *apelativ*

1. **Apelativ** (nga latinishtja *appellare*, që do të thotë “të adresosh”, “të drejtosh fjalën”) - thirror - quhet një rasë e veçantë e sistemit rasor indoevropian, e cila shërben për të shprehur thirrjen (thirrorin), pra, për të tërhequr vëmendjen e marrësit të mesazhit. Sistemi rasor i indoevropianishtes, me të cilin shpreheshin lidhjet sintaksore të emrit në fjali, ka qenë mjaft i zhvilluar. Ai njihte tetë rase (emëroren, **thirroren**, kallëzoren, gjinoren, dhanoren, rrjedhoren, vendoren dhe instrumentalen). Për shkak të veprimit të sinkretizmit, ky sistem rasor nuk është ruajtur me besnikëri në gjuhët e kësaj familjeje, por është riorganizuar. Kjo ka ndodhur edhe me shqipen, e cila, krahasuar me sistemin rasor të indoevropianishtes, ka bërë ndryshime të mëdha, duke e reduktuar numrin e rasave dhe zhdukur disa prej tyre (ndër të tjera edhe thirroren). *Apelativët* janë përdorur në komunikim të drejtpërdrejtë për t’iu drejtuar personit të cilit i drejtohen me emër ose duke e vënë theksin te marrëdhëniet shoqërore që ai ka me të:  
*Agron, ejani këtu!*  
*Zonjë, keni harruar të dorëzoni formularin.*  
*Burra, të gjithë në punë!*
2. Quhet *apelativ* (thirror) një funksion i veçantë gramatikor që përmbushin fjalët në komunikimin e drejtpërdrejtë. Ky komunikim midis folësit dhe bashkëfolësit në gjuhët me sistem rasor të zhvilluar realizohet nga rase thirrore.

**apikal**

Bashkëtingëllore **apikale**, term i fonetikës artikulare me të cilin përshkruhen tingujt që artikuloohen me pjesëmarrjen e apeksit ose të majës së gjuhës. Ky tingull u kundërvihet bashkëtingëlloreve laminale, që artikuloohen përmes krijimit të një pengese me tehun e gjuhës.

**apikalizuar (i/e)**

Bashkëtingëllore e **apikalizuar** quhet ajo bashkëtingëllore që realizohet nga afrimi i majës së gjuhës me dhëmbët ose alveolat.

**apodozë**

**Apodozë** (nga greqishtja e lashtë ἀπόδοσις / *apódosis* – “veprimi i dhënies, kthimi”) quhet fjalia drejtuese (fjalia kryesore), e cila së bashku me fjalinë e varur (protazën) formojnë periudhën me fjali të varur kushtore. Bie fjala:

*Nëse unë e ftoj (protaza), ajo do të vijë (apodoza).*

**apofoni**

(shih *ablaut*)

**apokopë**

**Apokopa** (nga greqishtja ἀποκοπτείν / *apokoptein* – “me zbritë”, gr. *apokopé* - *cungim, shkurtim*) - rënie, është një modifikim fonetik, ndonjëherë i përdorur edhe si figurë e stilit, që karakterizohet nga shkurtimi i fjalës së plotë, duke mbajtur vetëm tingujt ose rrokjet e para të saj, për shembull: “*auto*” për “*automobil*”, *ish* për *ishte*, *gjet* për *gjeti*, *zu* për *zuri*, *profë* për *profesor* etj.. Vërehet se apokopa është vetë procesi (p.sh.: rënia e “*-mobil*”), rezultati i saj (këtu, “*auto*”), pra, është është një shkurtim. Ky shkurtim përdoret shpesh në të folur për të verbalizuar diskursin ose edhe për qëllime stilistike. Ajo përdoret edhe për të thjeshtuar gjuhën.

Ky fenomen mund të jetë qoftë si rezultat përfundimtar i një procesi diakronik të ndryshimit të fjalës, i cili në këtë rast vërtetohet nën një formë të re të përdorimit, ku shkurtimi është i përhershëm dhe krejtësisht i pavarur nga konteksti fonologjik përreth; qoftë edhe si efekt i një kërkese eufonike, që çon në shkurtimin e pjesës fundore të fjalës për të shmangur kakofoninë në takimet ose fenomenet fonetike të fjalëve të veçanta.

Megjithëse ngjan me fenomenin e elizionit, i cili është gjithashtu me natyrë eufonike, *apokopa* dallohet nga aftësia e fjalës “*së shkurtuar*” për të ruajtur dhe për të komunikuar kuptimin e saj, edhe nëse është shqiptuar në mënyrë të izoluar, pra, në mungesë të një konteksti frazor. Dallimi në mes të dy fenomeneve ka edhe pasoja drejtshkrimore, mbasi elizioni shoqërohet gjithmonë nga apostrofi. *Apokopa* është një mekanizëm origjinal që shërben për krijimin e fjalëve të reja.

**apokrif**

**Apokrif** (nga greqishtja ἀπόκρυφα / *apókryphos* - “i fshehtë”) u përdor në fillimet e erës sonë, për të treguar ato shkrime fetare që nuk duheshin përhapur (jokanonike). Që në shekullin e tretë *apokrif* ishte pothuajse sinonim me “fals” (i rremë, i gabuar) dhe shërbeu për të treguar ato libra të Testamentit të Vjetër e atij të Ri që nuk bëjnë pjesë në listën kanonike të librave të shenjtë, pasi Kisha nuk e njihte frymëzimin e tyre hyjnor.

Filologët klasikë këtë term (**apokrif**) e përshtatën për të treguar një shkrim, dokument apo vepër arti, që i atribuohet gabimisht një autori ose një epoke të caktuar, por që në të vërtetë nuk i përkisnin atij.

**apostrof/-i**

**Apostrof/i** (nga greqishtja ἀποστρέφω - *apostréfo* – “të kthehesh diku tjetër”) është një shenjë grafike në formën e një presjeje (’), e cila vihet sipër dhe shërben për të shënuar rënieën e zanores fundore -ë të disa fjalëzave, kur pas tyre vjen një fjalë që fillon me zanore dhe pas pjesëzës mohuese *s* ose pas përemrit *ç*.

Në gjuhën shqipe apostrofi përdoret.

1. Pas trajtave të shkurtra të përemrit vetor *më* dhe *të*, të ndjekura nga trajtat e shkurtra -i, -ia, -u, -ua, -ju, -jua, si dhe pjesëza *u* e formës joveprore të foljeve:

*m’i dërgoi; t’i çoi; m’i solli librat; t’i rrih pranë mikut; m’u dha rasti; t’u bëftë nëna!* etj.;

*do t’i them; t’u bësh të fala; t’ua dërgosh në kohë; do t’jua di për nder; do t’ua kisha sjellë* etj.

2. Pas pjesëzës mohuese *s’* dhe përemrit pyetës *ç’*:

*s’e di ku shkoi; s’u bë i gjallë për shumë kohë* etj.

*ç’e mirë të solli?; ç’u bë me të?* etj.

**apostrofë/-a**

**Apostrofë/a** (nga greqishtja ἀποστροφή (*apostrofë*) – “devijim”) është një figurë stilistike që krijohet kur një personazh ose tregimtari i drejtohet me një thirrje të fuqishme një audience ideale, një personi që mungon a një sendi të personifikuar, me qëllim që ta bindë këtë të fundit.

p.sh.:

O malet e Shqipërisë! E ju o lisat e gjatë,

Fushat e gjera me lule, q’u kam nër mënt dit’ e natë...,

**apostrofim**

**Apostrofim** është veprimi sipas kuptimit të foljes apostrofoj, në kuptimin vë

apostrof, përdor apostrofin për të zëvendësuar një zanore apo një rrokje që bie.

### ***apozicion***

***Apozicioni*** (nga latinishtja *appositio* – “shtim”) është një nocion i gramatikës tradicionale që tregon një njësi sintaksore që i referohet një emri, me të cilin është në një marrëdhënie bashkëreferenciale. Në gjuhën shqipe këtij nocioni i përgjigjet *ndajshtimi*, i cili është një lloj përcaktori i shprehur me një emër të pashquar në rasën emërore, që përshtatet në numër me gjymtyrën e përcaktuar. Përshtatja jo e plotë e dallon atë si një lloj i veçantë përcaktori:

*Profesor Agroni qëndronte krah meje.*

*Apozicioni* nuk ka autonomi semantike ose sintaksore dhe normalisht shërben si një funksion atributiv, duke specifikuar kokën së cilës i referohet: për këtë arsye, heqja e tij nuk sjell ndonjë ndryshim në gramatikalitetin e një fjalie. Ai tregon një karakteristikë të emrit apo të grupit emëror që përcakton, si: profesion, detyrë, titull, marrëdhënie faresfisnore, vend, titull veprë etj.

*Teze Drita ka zë të bukur për muzikë.*

### ***apraksi***

***Apraksi*** (nga greqishtja ἀπραξία - ἀπραξία, e përbërë nga parashtesa e mohimit ἀ- dhe rrënja *praxia* - “të veprsh”, që do të thotë pamundësi për të bërë) është një çrregullim neuropsikologjik i lëvizjeve të vullnetshme, i përkufizuar si paaftësi për të kryer gjeste të koordinuara, megjithëse vullneti dhe aftësia motorike e individit mbeten të paprekura (p.sh., ndezja e një cigareje, lidhja e këpucëve etj.). Ashtu si me shumë probleme të tjera neurologjike, njerëzit me këtë çrregullim zakonisht nuk janë të vetëdijshëm për gjendjen e tyre. ***Apraksia verbale*** është një çrregullim në prodhimin e njësive themelore tingullore të gjuhës së folur për shkak të anomalive në komandimin e lëvizjes të muskujve të aparatit të të folurit. Tek të rriturit zakonisht shkaktohet nga dëmtimi i trurit (p.sh., si pasojë e goditjes në tru, traumave në kokë ose i ndërhyrjeve kirurgjikale). Pacientët me apraksi verbale janë në gjendje të lëvizin muskujt e aparatit të të folurit, por kanë vështirësi në të folur për shkak të kontrollit të reduktuar ndaj këtyre muskujve. Pacienti duket sikur ka harruar si të prodhojë tingujt e të folurit. Gabimet fonematike dhe lëvizjet e ngurta të muskujve të artikulimit janë karakteristikë e apraksisë verbale. Apraksia verbale shpesh ndodh së bashku me afazinë.

### ***aprosimant***

***Aprosimant*** (nga latinishtja e vonë *approximare* – “të afrohesh”) - përafres, quhet një bashkëtingëllore që krijohet me një pengesë fare të vogël të rrymës së ajrit në aparatit e të folurit. Disa autorë e quajnë kontinuant me fërkim të zbehtë. Tinguj të tillë në shqipen standarde janë l, ll, j. Disa autorë fusin në mesin e aprosimantëve edhe bashkëtingëlloren h. Aprosimantët nuk kanë mbyllje të rrymës së ajrit. Bëjnë pjesë ndërmjet bashkëtingëlloreve fërkimore dhe zanoreve. Termi është relativisht i ri në fonetikë dhe përdoret për klasifikimin e tingujve të të folurit sipas mënyrës së nyjetimit apo mënyrës së formimit të pengesës<sup>1</sup>.

### ***arabizëm***

***Arabizëm*** është një term që i referohet një klase të veçantë fjalësh ose shprehjesh me origjinë nga varietete të ndryshme të arabishtes që nga Mesjeta deri në ditët e sotme, shumë prej të cilave kanë zënë vend në fjalorin e shqipes, duke iu nënshtruar rregullave të kësaj gjuhe. Shumica e arabizmave lidhen me fushat semantike të kulturës materiale, të prodhimit, të fesë dhe të ushqimit dhe kanë depërtuar në leksikon tonë veçanërisht gjatë periudhës së shtrirjes dhe të vendosjes së Perandorisë Osmane.

Në gjuhën shqipe ato kanë hyrë në rrugë e mënyra të ndryshme. Një pjesë e madhe e tyre ka hyrë përmes turqishtes apo edhe gjuhëve të tjera evropiane, të cilat sidomos gjatë mesjetës kanë huazuar shumë fjalë arabe, veçanërisht nga fusha e shkencës. Nga ana tjetër, ato janë futur në gjuhën shqipe edhe si rezultat i zgjerimit kulturor dhe politik të fesë islame në Shqipëri. Gjithashtu, nuk përjashtohet mundësia që një pjesë e tyre të ketë hyrë edhe në mënyrë të drejtpërdrejtë, kryesisht nga ata që e kanë njohur arabishten.

### ***arbëresh***

***Arbëreshët*** ose shqiptarët e Italisë janë një minorancë gjuhësore dhe kulturore e vendosur historikisht kryesisht në pjesën jugore të Italisë midis shekujve XV dhe XVIII. Janë emërtuar arbëreshë, pasi në kohën kur u larguan nga Shqipëria, ajo quhej *Arbëria*. Arbëreshët nuk e kanë harruar vendin e të parëve dhe ruajnë të gjalla zakonet e tyre të pasura, si gjuhën, veshjet dhe ritet e doket që kishin në atdheun e të parëve.

Të njohur si arbëreshë janë edhe arvanitët, një grup i popullsisë me origjinë shqiptare i vendosur në Greqi gjatë fundit të mesjetës, të cilët tradicionalisht flasin një dialekt të gjuhës shqipe, arbërisht. Ato ishin

---

<sup>1</sup> Bardh Rugova, Leksikon i termave të fonetikës dhe të fonologjisë, Prishtinë, 2019, fq. 33.

element mbizotërues i popullsisë në disa rajone të Peloponezitet dhe të Atikës deri në shekullin XIX. Gjithashtu edhe arbëreshët e Zarës janë një bashkësi me prejardhje shqiptare, që flasin arbërisht (një varietet i gegërishtes). Vendbanimet e tyre të para ishin Arbanasi i Zarës dhe disa fshatra rreth Zarës.

### *arbërishte*

*Arbërishte* ose varietete gjuhe të përdorura nga arbëreshët. Në Itali, duke filluar nga viti 1999 arbërishtja njihet nga qeveria italiane si “gjuhë e pakicës etnike dhe gjuhësore”, sidomos në administratën lokale dhe në shkollë.

### *arbitraritet*

*Arbitraritet* - (nga latinishtja *arbitrarius*, nga *arbiter* - “dëshmitar, gjykatës”) - është marrëdhënia që lidh formën e jashtme të një fjale me një kuptim specifik, një marrëdhënie, natyra arbitrare e së cilës demonstron edhe nga fakti që i njëjti kuptim gjen shprehje në forma të ndryshme në varësi të gjuhës. Ky është një term i futur në gjuhësi nga Ferdinand de Saussure, i cili e përcaktonte arbitraritetin si një çështje thelbësore të shenjave gjuhësore dhe si një princip të një rëndësie të dorës së parë. Sipas tij nuk kishte ndonjë arsye natyrore që një varg tingullor t’i përkasë një koncepti. Këtë mungesë ai e quajti *arbitraritet* të shenjës.<sup>2</sup>

Në historinë e mendimit gjuhësor tema e natyrës së shenjave gjuhësore ka një traditë të gjatë, që nga Platoni, Aristoteli etj., të cilët kanë diskutuar nëse fjalët kanë kuptim të natyrshëm apo të shpikur, d.m.th., nëse ka një motiv objektiv që një shenjë merr kuptim të caktuar apo nëse kjo është fryt i një shpikjeje njerëzore.

Për Saussure, e para e këtyre tezave, ajo natyraliste, që bën fjalë për një korrespondencë objektive midis emrave dhe gjërave, është gabim: shenja nuk bashkon një emër dhe një gjë, por një fjalë dhe një kuptim, lidhja e të cilave është *arbitrare*.

Me këtë term Saussure nuk nënkupton faktin që i njëjti koncept, në gjuhë të ndryshme, shprehet me shënjes të ndryshëm; pra, faktin që, për shembull, fjala (koncepti) *qen*, korrespondon me *cane* – italisht; *chien* - në frëngjisht; *dog* - në anglisht; *hund* - në gjermanisht etj.. Kjo do të ishte tezë konvencionaliste dhe po aq e gabuar, sipas Saussure, përderisa pranon që konceptet ekzistojnë më parë në gjuhë dhe ajo (gjuha), mjaftohet vetëm me etiketimin e tyre. Në të vërtetë, për Saussure, përpara ndërhyrjes së gjuhës,

<sup>2</sup> Bardh Rugova, Leksikoni i termave të fonetikës dhe të fonologjisë, Prishtinë, 2019, fq. 33.

mendimi dhe tingulli janë masa amorfe, të pastrukturuara, që më vonë krijojnë grupe foniko-konceptuale, që janë pikërisht *shenjat gjuhësore*.

#### *e ardhme*

*E ardhmja* është një kohë foljore e mënyrës dëftore, që tregon se veprimi ose gjendja e shprehur prej saj pritet të ndodhë a të vijë pas çastit të ligjërit. Në gjuhën shqipe përdoren dy tipa të së ardhmes: tipi i parë, që është mbizotërues, *do të punoj* dhe tipi i dytë, që përdoret më rrallë, *kam për të punuar*.

Përveç të ardhmes, në gjuhën shqipe njihen edhe këto forma foljore:

*E ardhmja e përparme (do të kem punuar)*, që shërben për të treguar një veprim, që pritet të kryhet në të ardhmen para një veprimi tjetër.

*E ardhmja e së shkuarës (do të punoja dhe tipi i dytë, kisha për të punuar)*, që shërben për të treguar një veprim, që pritet të kryhet pas një çasti të caktuar të së shkuarës.

*E ardhmja e përparme e së shkuarës (do të kisha punuar)*, që shërben për të shprehur një veprim, që mund të jetë kryer para një çasti të caktuar të së shkuarës.

#### *areal*

*Areal* (nga latinishtja *area* - “shesh, fushë”) ose hapësinor, një term që i referohet hapësirës gjeografike të përhapjes së një gjuhe ose të një fenomeni gjuhësor.

*Gjuhësia areale* (gjithashtu gjeografia gjuhësore ose gjeolinguistika) është një degë e gjuhësisë që studion shpërndarjen hapësinore të fenomeneve gjuhësore. Përfaqësues i shquar i saj ishte italianin Matteo Bartoli.

*Normat areale* janë ato norma të evolucionit gjuhësor që nxirren nga vëzhgimi i fenomeneve të studiuara nga pikëpamja e shpërndarjes së tyre gjeografike.

#### *argument*

*Argumenti* (nga latinishtja *argumentum*, e prejardhur nga *arguëre* - “tregoj, shfaq”), një term i huazuar nga logjika dhe matematika, përdoret për të treguar njësitë e përfshira drejtpërdrejt në procesin e përshkruar nga folja, ndryshe elementin që merr pjesë në veprim. *Argumentet* janë të detyrueshëm në fjali. Janë quajtur ndryshe edhe “aktantë” (Tesnière).


Gjuhëtari francez Lucien Tesnière e krahasoi fjalinë me një shfaqje teatrale. Ashtu si në çdo skenar, që ka role të cilat u caktohen aktorëve të ndryshëm, edhe në fjali çdo folje ka valenca (aftësia për të marrë elementet e nevojshme për të formuar një fjali kuptimplote) që kërkojnë të

“plotësohen” nga argumente specifike. Kështu, fjalinë “*Miri shikon Arian*” mund ta ndajmë lehtësisht në dy elemente, emrat *Miri* dhe *Aria*, si dhe foljen *shikon*. Folja *shikon* kërkon dy elemente për ta shprehur plotësisht ngjarjen, një emër që vepron si kryefjalë (*Miri*) dhe një që vepron si kundrinor (*Aria*). Pra, ato janë dy argumente. Gjuhësisht mund të themi se folja *shikon* ka dy valenca dhe kërkon dy argumente (*Miri, Aria*).

Në aspektin semantik, argumentet kryejnë role semantike (të quajtura edhe role tematike), që u janë caktuar nga predikati. Kështu, në fjalinë e mësipërme predikati *shikon* merr dy argumente (*Miri, Aria*) dhe u cakton atyre dy role tematike: rolin e subjektit (kryefjalës) dhe atë të objektit (kundrinës).

### *aritenoid*

**Aritenoid** (nga greqishtja *άρυταινοειδής* - “e ngjashme me një vazo”) në anatomi është secili prej dy kërceve të zonës së pasme dhe të sipërme të laringut, që ka formë piramidale të çrregullt, në të cilat janë të vendosura kordat e sipërme vokale. Ato janë pjesë e kërceve kryesore të laringut, quajtur ndryshe edhe *molla e Adamit*. Luan një rol të rëndësishëm në procesin e artikulimit të tingujve.



**BIBLIOGRAFI**

- Akademia e Shkencave e Shqipërisë (2002), *Gramatika e gjuhës shqipe*, I, Tiranë.
- Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë (1980), *Fjalor i gjuhës së sotme shqipe*.
- Beccaria, Gian Luigi (2004), *Dizionario di linguistica e di filologia, metrica, retorica*, Piccola Biblioteca Einaudi.
- Belluscio, Giovanni & Rrokaj, Shezai (2011), *Fjalor krahasues i termave të gjuhësisë*, Arbëria, Tiranë.
- Dubois, Jean & Giacomo, Mathee & Guespin, Louis & Marcellesi, Christiane & Marcellesi, Jean-Baptiste & Mével, Jean-Pierre (2001), *Dictionnaire de linguistique*, Larousse, ISBN: 2-03-532047-X.
- Dubuc, Robert (1992), *Manuel Pratique de terminologie*. Linguatex: Brossard.
- Katz, Jerrold J., (1972) *Semantic Theory*, Harper & Row, New York; Katz, J. J. (1987) *Common Sense in Semantics*, in aa. vv., *New Directions in Semantics*, Academic Press, London.
- Leka, Ferdinand (2013), *Fjalori i termave të letërsisë*, INFBOTUES, Tiranë, ISBN 978-9928-173-11-9.
- Rugova, Bardh (2019), *Leksikoni i termave të fonetikës dhe të fonologjisë*, Prishtinë.
- Sbisa, Marina (1978), *Gli atti linguistici-Aspetti e problemi di filozofia del linguaggio*, Milano, Feltrinelli.
- Topalli, Kolec (2011), *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, Botimet albanologjike, Tiranë, fq. 12.
- Vendler, Zeno (1967), Dubuc, R. (1992), *Manuel Pratique de terminologie*, Linguatex: Brossard.
- Vendler, Zeno (1967), *Verbs and times*, in *Linguistics in Philosophy*, Ithaca (New York).

**TERMINOLOGY AS A SISTEM  
(Dictionary of linguistic terms)**

*ABSTRACT*

This article comes is a continuation of the articles with the same title which was published in the previous publications. In it, 23 language terms have been explained, which we come across in the field of literature, both in contemporary and traditional one. In our explanations, we have tried to preserve the particular characteristics that often reflect the original value they have, according to different linguistic theories or which might be revised by the Science of Albanian Language to different concepts.

Anisa KOSTERI, Bora LOGU

## FJALORTHI I RI I DOM NIKOLLË GAZULLIT NË DIMENSIONIN E TIJ GJUHËSOR E KULTUROR

Dom Nikollë Gazulli (1891-1946), rreshtohet ndër dijetarët me emër të gjysmës së parë të këtij shekulli, më së shumti si gjuhëtar. Lindi në Dajç të Zadrimës. Kreu seminarin Papnor të Shkodrës dhe studimet e larta teologjike në Istbruk (Austri). Mori pjesë në lëvizjet kryengritëse të malësorëve të Veriut e të Mirditës kundër qeverisë së A. Zogut dhe u burgos katër vite në Gjirokastrë. Shërben për shumë vite në zonën e Malësisë së Madhe (në famullinë e Shkrelit), ku gjurmoi dhe mblodhi lëndë të pasur leksikore, frazeologjike, onomastike, etnografike etj. Botoi dy vepra gjuhësore: “Fjalorth i ri” (fjalë të rralla të mblodhuna në Veri të Shqipnisë) “me mbi 5000 fjalë, që doli si vëllim XI i serisë “Visaret e Kombit” (Tiranë, 1941) dhe “Fjalori onomastik”, botuar pjesë – pjesë në “Hylli i Dritës” me 22 numra (1939-1943) nën pseudonimin Gelasius. Fjalori toponomastik u botua para pak kohësh, si vëllim anastatik nga Biblioteka Françeskane, Shkodër, me titullin “Fjalori toponomastik dhe shkrime të tjera”<sup>1</sup>. U pushkatua pa u gjykuar në vitin 1946.<sup>2</sup> Ajo që dallon këto dy vepra, shumë të vlefshme për kulturën kombëtare, është niveli i lartë shkencor, ku duket dora e një dijetari të mirëfilltë si filolog i kompletuar, metodologjia e hartimit, objektiviteti i lëndës gjuhësore dhe, sidomos shpjegimi analitik i lëndës, vë në dukje Simon Pepa.

Si leksikograf solli ndihmesë të shquar në gjuhësi. Nikollë Gazulli ishte i dhënë edhe pas folklorit dhe historisë, fusha në të cilat boton shkrime, këngë të moçme etj. Fjalori i gjuhës shqipe 1954 dhe ai i Atë Benedikt Demës, i cili u botua për herë të parë në vitin 2005, u mbështetën bindshëm në Fjalorin e ri të Gazullit. Për shumë vite emri i Gazullit nuk u përmend, madje në shumë citime, si të gjuhëtarëve të mëdhenj: Xhuvani apo Çabej, shënohej vetëm “G”, “Fjalorth i ri”, ose “Shkodër, 1941”. Fjalësi i këtij “Fjalorthi” paraqet më së miri një hapësirë të së folmes së gegërishtes veriperëndimore, përkatësisht trevës së Malësisë së Madhe (Bajzë, Bogë, Egçi i Bregut, Gruda e Madhe, Gruda e Vogël, Gruemira,

<sup>1</sup> Dom Nikollë Gazulli, Fjalori toponomastik dhe shkrime të tjera, Botime Françeskane, Shkodër, 2024.

<sup>2</sup> Shih: S. Pepa, FESH, vëllimi II, f.757-758.

Kastrati, Kelmendi, Hoti, Reçi, Rrjollli, Shkreli,(nga i cili përfshihen një shumicë fjalësh <sup>3</sup>), Shkodra, Dukagjini, Lezha, por kemi edhe fjalë nga gegërishtja verilindore, si zonat e Pukës e gegërishtja qendrore, ku përfshihet Mirdita me zonat përkatëse.

“ *U bâne hulumtime të gjata ndër fjalorë të huej për t’u gjetun kuptimi i vërtetë i fjalëve*- nënvizon autori në parathënien e “Fjalorit”-, *por shumë herë as s’kam mujtë as s’kam dashtë me i rreshtue të gjitha vështrimet, për arsye se fjalori i vogël u paraqitet të dijshëmvet shqiptarë e të huej për studim, e don me kjenë një pasqyrë, si do të studjohen djalektat e ndryshëm, për me i a mbërri një fjalori të madh të përbashkët*”<sup>4</sup>.

Fjalësi i “Fjalorit” përmban 5000 lema. Profesori i ndjerë, Simon Pepa numëron 4819 fjalë të rralla<sup>5</sup>. Sipas studiueses Ledi Shamku,<sup>6</sup>kriteri sasior nuk ngre peshë, sepse ky është një fjalor i tipit shpjegues dhe përshkrues dhe e rëndësishme është metodologjia e hartimit, gjë që Gazulli e ka pasqyruar në mënyrën më të përsosur.

Për Gazullin gjuha e folur e popullit, është ajo që duhet t’i japë shkrimtarit fondin themelor të mjeteve të shprehjes dhe se lëvruesi i gjuhës letrare duhet të depërtojë në shtresa të thella të saj, në leksikon dialektor e krahinor përkatës.

Fjalësi i tij përfshin mjaft aspekte të jetës shqiptare, historisë, gjeografisë, kulturës (kryesisht zonave të gegërishtes veriperëndimore) duke na dhënë një pasuri leksiko-frazeologjike të shqipes, duke i dhënë lemave përkatëse ngarkesa e ngjyrimë kuptimore të reja e duke zgjeruar valencat e tyre në bashkëvajtje me kategori të tjera morfologjike.

Si njohës i mirë i gjuhëve të huaja dhe me një përgatitje të lartë filologjike klasike e moderne, në shumicën prej fjalëve, ai jep edhe përgjegjëset e tyre në gjuhë të tjera, si italisht e latinisht, ose edhe gjermanisht e frëngjisht, kjo ndoshta për të treguar etimologjinë ose domethënien e asaj fjale.

Në shpjegimin e fjalëve, Gazulli i kushton rëndësi polisemisë dhe sinonimisë dialektore, të cilat luajnë një rol të shumëfishtë në pasurimin e gjuhës standard. Po i ilustruam me shembuj si më poshtë:

**kafjall-i** (PK, MR) – 1.gotë –a. 2. *nji hae bukë e lehtë, razog, zâmër, lat. Haustrus, germ. imbiss* (F.G.f.187).

<sup>3</sup> B. Beci, *E folmja e Shkrelit*, “Dialektologjia shqiptare” I, Tiranë, 1971.

<sup>4</sup> N. Gazulli, *Fjalori i Gazullit*, Parathanje, Tiranë, 2005, f.5.

<sup>5</sup> S. Pepa, *D. Nikollë Gazulli- themelues i leksikografisë krahinore dhe i asaj onomastike*, “Gjurmime kulturore”, Shkodër 2000, f.44.

<sup>6</sup> A. Haxhi – T. Topalli, *Nikollë Gazulli, (Ledi Shamku-Shkreli, Parathënie e botimit anastatik të Fjalorit të Gazullit, Tiranë, nëntor, 2005, f.5-16)*, “Leksikon, gjuhëtarë shqiptarë dhe albanologë”, Shkodër, 2012, f.42.

**sabitë** (Krz.MR) – *âsht sabitë drûja, tkurë* (PK), *kuritë* (SP), *përfiskë, përfikë, fiktue* ( F.G.f. 365).

Përveç sinonimeve të thjeshta, këtu kemi përdorimin e vargut sinonimik, që e gjejmë në mjaft shembuj:

**matshue** – *matshitë, coptue, grimcue* (G. f.251).

**mballim** – *mbarë, gjithëkah, t'i biem ballim* (G. f.252).

**mundshtim** – *brigim, qortim* (G. f.273).

**navig** – *shul, shiluer, drang* (G. f.277).

**ndërkalitë** – *përdredhë, ndërmblyë* (G. f. 283).

**ndryçë** – *shtypë, ndrydhë* (G. f.287).

**përfetue** – *diftue, kallxue* (G. f.307).

Megjithatë, standardi ka mënjanuar shumë fjalë dialektore që e ngarkojnë së tepërmi atë. Por, sa më shumë të ketë sinonime gjuha standarde, aq më i begatshëm është leksiku i saj. Duke qenë se pasuria leksikore e këtyre fjalorëve është me të vërtetë e madhe, duhet të merret në konsideratë fakti, se ka fjalë, që mund të përfshihen në standard, të cilat mund t'i quajmë fjalë me “*mundësi normative, për të cilat gjuha letrare ka nevojë që të zhvillojë më tej aftësitë a saj shprehëse, pavarësisht nga burimi i tyre.*”<sup>7</sup>

Një tjetër çështje me interes për t'u trajtuar në Fjalorin e Gazullit është fakti se, për shumë fjalë, ai ofron sinonimet përkatëse në gjuhën letrare ose në variante të tjera dialektore. Megjithatë, ka edhe raste kur ai mjaftohet vetëm me një shpjegim përmes një fjalie. Kjo na bën të kuptojmë se, në disa raste, Gazulli nuk arrinte të gjente një përgjegjëse të saktë për fjalët krahinore në gjuhën standarde apo në dialekte të tjera. Për këtë arsye, ai zgjidhte t'i shpjegonte këto fjalë përmes përdorimit të tyre në fjali, duke synuar që të përcillte kuptimin sa më qartë. Po i vërejmë duke i radhitur si më poshtë:

#### **Fjalë krahinore që i ka vënë sinonimin në gjuhën letrare / dialektore:**

**abulli-i** – *avull-i*(G.f.43).

**acar-e** – *grue acare= e dliçët, veshëacare; mot acar = i ftofët* ( G. f.43).

**aft-i** – *afti i borës bjen të ftofët; ajri, tafti* ( G. f.43).

**çafodhe-ja** – 1. *krahnoshe, krahnorçë*. 2. *çantë lëkure a tjetër sehit, valigje* (G.f.97).

**çakraman** – **e** – *shakllaban- e(tyrq); vagabond (it.)* (G.f. 97).

<sup>7</sup> A. Hidi, *Sinonimet dialektore dhe pasurimi i leksikut të gjuhës letrare shqipe,*” Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe”, III, Tiranë, 1989, f. 375.

### Fjalë krahinore që i ka shpjeguar me fjali:

**baltimë,t** – *me hangër sa me hjekë baltimën e gojës: të keqt qi merr goja prej së pa ngrânmi; të baltimët* (G.f. 53).

**capë-a** – *dhe a shtrat dheu i forcuem prej motesh si çemento, i gurzuem, peqinë (slav), harasan (tyrq)* (G. f.80).

**qesllue** – *me i dhânë frymës jashtë tue u kullë lehtë; sh. qellëxue* (G.f.92).

Këto fjalë të rralla që i vërejmë në këtë fjalor, janë fjalë që përdoren në ligjërimin popullor në zona të ndryshme të Veriut të Shqipërisë, të cilat dëshmojnë për një gurrë të çmuar leksikore të fondit shqip dhe na japin larminë e shumëkuptimësinë e përdorimit të fjalës shqipe me ngjyrimë e përftesa që vetëm një filolog si Nikollë Gazulli ka ditur t’i mbledhë e të na i pasqyrojë në këtë Fjalorth, siç e quan ai.

Tjetër element me vlerë, që nuk duhet lënë pa u përmendur, është se autori i ka kushtuar rëndësi faktit të përdorimit të një gjuhe të mesme, në mënyrë që të kuptohet nga të gjithë shqiptarët e të gjitha trevave.

“...sa për gjuhë të mjesme mârë lëjën me shkrue një oroe qi më duket me vend. Fjalën: gjuhë e mjesme: ka pasë asi Shqiptarësh qi e kanë mârë në vështrim të dheshkrojës, shka po diftoj qi asht një hutim (gabim)...”<sup>8</sup>

Po e ilustruam me shembuj: fjala *pykë* ka variante të ndryshme përdorimi sipas krahinave të ndryshme. Në Çamëri ajo del *pylkë*, në Hot e Grudë (M.M) thuhet *pyjkë*. Sipas Gazullit, fjala *pykë* nuk mund të jetë e gjuhës së mesme, sepse i takon *një zhvillimi gjuhësor në shkallën zero*<sup>9</sup>. Trajta *pylkë* gjithashtu nuk i përket gjuhës së mesme, sepse janë *âma*<sup>10</sup> e trajtavet tjera, kështu që si e mesme, i takon të jetë trajta *pyjkë*, që i përket së folmes së Malësisë së Madhe, përkatësisht nëndialektit të gegërishtes veriperëndimore.

Tjetër rast, kemi fjalën *qeshë*, ku në Pukë jep variantin *keshë*, si trajtë të mesme jep përdorimin e Bardhit *me kjeshun* ose në Malësinë e Madhe jep variantet *kelbë, kjelbë, qjelbë*, por edhe *qelbë* si përdorim në M.M e Pult të Dukagjinit, në krh. me *qelbë*, standard.

Të tillë e quajti Gazulli gegërishten, si gjuhë e mesme, që të kuptohet nga të gjithë shqiptarët e çdo treve. I këtij mendimi është edhe studiuesja L. Shamku, e cila shprehet: “...shtrahet me ngut nevoja e normimit të gegërishtes. Ky normim do kryer duke u nisur nga stadi i sotëm i përdorimit të gegërishtes, i cili sikundër rezulton, ka brenda edhe standardin, por mbetet i pandryshueshëm pikërisht në ato tipare ku kjo idiomë dallon

<sup>8</sup> N. Gazulli, “Fjalori i Gazullit”, Parathanje, Tiranë, 2005, f.8.

<sup>9</sup> N. Gazulli, “Fjalori i Gazullit”, Parathanje, Tiranë, 2005, f.8.

<sup>10</sup> N. Gazulli, “Fjalori i Gazullit”, Parathanje, Tiranë, 2005, f.8.

*qenësisht prej standardit.*<sup>11</sup>

Një aspekt tjetër me rëndësi që vlen të theksohet në Fjalorin e Gazullit është përfshirja e elementeve etnolinguistike, të cilat i japin veprës një dimension përtej përshkrimit të thjeshtë leksikor. Këta komponentë pasqyrojnë në mënyrë të ndjeshme mendësinë, psikologjinë kolektive, karakterin dhe trashëgiminë kulturore – si atë shpirtërore ashtu edhe materiale – të popullit shqiptar, me theks të veçantë mbi komunitetet që jetojnë në zonat më të skajshme veriore të vendit. Në këtë mënyrë, Fjalori i Gazullit nuk përbën vetëm një burim të çmuar për studimet gjuhësore, por edhe një dokument autentik të antropologjisë kulturore shqiptare.

Kemi fjalën “*gjâmue*” nënkupton një ritual të veçantë mortor, që konsiston në bërjen e gjâmës për të vdekurin përmes një sjelljeje të caktuar dhe të strukturuar, ku ndërthuren elementë të burrërisë, dhimbjes kolektive dhe shprehjes rituale të humbjes. Sipas përshkrimit të Gazullit, kur merret lajmi i vdekjes, burrat dhe gratë ndjekin role të përcaktuara: burrat shprehin haptazi dhimbjen përmes britmave të rregulluara (“mjeri unë për ty, miku, vëllai im!”), ndërsa gratë marrin përsipër vajin e zgjatur me zë – funksion që përmbushin “vajtoret” apo “vajtojçet”. Gratë nuk marrin pjesë në këtë formë gjëmimi, fisi i tyre dhe vëllezërit e gjakut të saj e kryejnë këtë rit për nder të të ndjerës, duke thirrur “vëllau i im!”

Ky përshkrim tregon qartë jo vetëm një ngarkesë të fortë emocionale dhe kulturore të riteve të vdekjes, por edhe mënyrën se si gjuha ndërthur retorikën, performancën dhe ndjeshmërinë kolektive në një akt të thellë shoqëror. Ky është një shembull i qartë se si Gazulli nuk kufizohet vetëm në përkthim apo sinonimi, por pasqyron me saktësi strukturën e mendësisë tradicionale shqiptare përmes gjuhës.

Po citojmë shembullin më poshtë:

**gjâmue** – *me i bâ gjâmën të vdekunit me sjellje të caktueme: bashkohen burrnimi t’a mârrmën lajmin e dekës, granija shkojnëme ‘ta; një grue do të mbajë zânin tue vajtue (vajore, vajtojçë). Burrat kundruell shpisë rreshtohen gna dy e bërtasin dy herë: mjeri ún për ty, miku, vllau i im! Etr.-mjeri ún-oo, mjeri un-ê-ê!*

*N’oborr të shpis thrrasin kështu katër herë në kambë. Britma do tëpërsëritetprej gjashtëherënë dymbëdhetë herë a njizet’ e katër herë, por përherë parë: të hymën te i vdekuni thrrasin prap dý herë, rrahin parzmat prej dhimbe e dahren njëni prej tjetrit tue rrethue vigun;mandej thrrasin prap e dý herë vetmas nëkambë; mandej bijnë në gjúj. Në Pukë ndêjnë*

<sup>11</sup>L.Shamku- Shkreli, *Fjalori i Gazullit dhe gegnishtja e papërmbushur*, “Shtatë vjet prolog”, Tiranë, 2005, f.134.

*krahun me shplakë të dorës të apme përmbi të vdekunin e sa herë lohet vigu i ndaluem i rrugës. Në Dukagjin thrrasin: kraj'i im: rrahen e gërvishten (përgjaken) në shëj dhimbe, e shumë herë shkon gjaku rrëkajë tãnzave të faqevet; kapin hundën me dorë tue lëshue një zã me shungullue toka. Grueja vetëm vajtohet, por gjinija ( gjaku i saj) e vllaznija i bãn edhe gjãmën tue thirrë përherë: vëllau i im!(f.35).*

Disa leksema të tjera, të cilat i ndeshim janë:

**bjerrun-** (i,e) (M.M)adj.bjerrë (m'u) : *me hî në jaz, m'u veshë në të zi. Jam i bjerrun; N.N është i bjerrun; germ. (im Trauer sein a traurig sein.) Në Malësi të Madhe nana vën në krye rubë të bardhë për djalë qi i ka dekë, e tjerët të zezë. (f.64).*

**razog-u** – (në Kanû të Lekës) –1. *dukagjinsit kur pajtohen prej zotnija për punë i thonë: të due kulaçin e xët me djeth, në nade tri rrojët e ditës, as zogun nuk nuk t'a fal, as nuk t'a shes! Hakun t'a due grumbull! Zogu ishte pushimi me dy orë ditë, prandej kur zotnija e harronte thirrshin: ra zogu, flutëroi zogu! 1. Pushim, sa pushon zogu. 2. haeja e kësaj kohe: zãmër – a (Kurbini): frz. Po e bãmë një zog (pushim të shkurtën, sa pushon një zog). Me hângër zogun; me hangër n'e mbasdite; shms. Razogjt ishin koniqet qi i kishte detyrë i Mirditsi Derës Gjomarkejvet, kur ndonji kësi princash dilte me këqyrë gjendjen e popullit (f. 344).*

**buzm-i** – 1. *carâni i votrës, përboçë-a, urëz-a, 2. nata e Buzmit, e kremja e të këthyemit të diellit prej vere a pranvere, lutet nër male të Veriut të Shqipnis me sjella të posaçme natën e Këshndellavet, në të cillën digjet Buzmi, qi shembëllen vjetën e shkueme, tue bâ urime për vjetë t'ardhëshme, 3. ishte si buzëm, çumrak i vogël e i keq, i pa-ândshëm, trup i palatuem(f.78).*

Këto dukuri etnolinguistike, ndonëse sot janë venitur pothuajse krejtësisht dhe kanë mbetur vetëm si jehonë e largët në kujtesën e brezave, janë shpjeguar me kujdes dhe qëllim nga autori, jo thjesht si objekte studimi gjuhësor, por si dëshmi të gjalla të një bote të hershme, në të cilën gjuha, zakonet dhe besimet popullore ndërthureshin në mënyrë organike. Ai synon të dokumentojë dhe të ruajë një trashëgimi të çmuar kulturore, duke treguar se përmes këtyre shprehjeve dhe praktikave të lashta gjuhësore, mund të kuptojmë më thellë botëkuptimin, ndjeshmërinë dhe mënyrën e të jetuarit të të parëve tanë.

Megjithëse është një fjalor krahinor, në Fjalorin e Gazullit, fjalët e përfshira kanë valencë leksikore njëlloj si fjalët e një Fjalori tjetër normativ të gjuhës shqipe, ashtu siç kemi bërë ne një përjasje me « Fjalorët e gjuhës shqipe », 1954, 2006. Bashkëlidhja leksikore e fjalëve përcaktohet nga faktorë të jashtëm gjuhësorë, ku sendi dhe objekti duhet të kenë lidhje

logjike mes tyre, psh., mund të thuhet ka *sy të shkruar*, por nuk thuhet ka *buzë të shkruara*, ose *flokë të verdhë*, por jo *sy të verdhë* etj. Kjo ka të bëjë me atë që quhet edhe ligji i valencës<sup>12</sup>, gjë që për një leksikograf nuk duhet lënë në harresë. Për t'u krijuar bashkëlidhja e fjalëve, i rëndësishëm është konteksti, sepse jashtë tij, na jepet një kuptim i papërcaktuar i fjalës. Në Fjalorin e Gazullit kemi vënë re, se të gjitha fjalët semantizohen në një kontekst a situatë të caktuar. Fjalëve përkatëse dialektore, Gazulli iu jep valencë leksikore duke i shoqëruar me fjalë përcaktore të ndryshme .  
Duke filluar me *valencën e emrit*, kemi raste si :

#### emër + emër :

**zhym-i** (Miliskau.PK) – *pluhuni, hîni qi lën duhani i djegun* : **zhym pilave, zhym cigare** ( G. f.476).

**zhokël-a** (SP)- *lëvorja qi mbulon kokrrën e groshës në bështâjë*: **zhokël groshe, zhokël kollomboqi, zhokël lejthije** ( G. f.475).

**bind-i** (S.P) - . 1. *çudi, mrekuilli*. 2. *send i çuditëshëm, i mrekuillueshëm*: *Bindi i Zotit: mirabile Dei (lat.) bindi i tokës: një mrekuilli, për bind: mrekuillisht.* (G.f.62). (**Bindi i Zotit, bindi i tokës**).

#### emër + mbiemër

**rrëshyell-elli** (Malsinat)- *rrëshejë,t: rrëshuell-olli, rrshojët (SHK)*, (G.f.354). (**rrëshyell i helmatuem, rrëshyell i egër**).

#### folje + emër :

**prës-i** (M.M) – *gajle, kujdes, kasavet*: (**mos m'e bâ pres, me vû pres, mos kij pres**) (G.f. 336).

**ngazë-a** (SP)- *të qepun t'imë*:(**m'e qepë ngazë, m'e bâ ngazë**) (G.f 288).

Tek *valenca e foljeve*, kemi raste si :

#### folje + emër

**prue** (SP)- *me plaçkitë, prëtue*:(**m'a proi shpin, m'a prove gjân**) (G. f.339).

**rrëshqitë** – *pëshqitë, shkitë (PK) rrëshitë (SP), rrëshqas, pëshqas, shkas, rrëshas...* (G.f.354).(**më rrëshqiti kamba, më rrëshqiti puna**).

**cungue** (S.P).- v. akt. 1.*me cungue lisiin, me i pré degët e trupin tue i lânë pjesën mâtë trashën*. 2. *m'e cungue njeriun: me i këputë kryet, kambë e krahët, tue mbetë*

<sup>12</sup> A. Kostallari, "Kompozitat dëshirore dhe urdhërore të shqipes", Studime filologjike 4, Tiranë, 1968.

*veçcungu i njeriut (it.torso), (G. f.87). (me cunqie lisiin, m'e cunqie njeriun).*

### **folje + ndajfolje**

**gërmue** (M.M) - 1. *me ngushtue: më gërmoi me shkue, më gërmoi gazi, po mue shka më gërmoi me i a hÿ kësaj pune: 2. pas. me hÿ ndër ngushtica; fraz. u gërmova me fjalë në mal; mos u gërmo tepri, i u gërmuen dhit, i u gërmue ushtrija e i sharruen. (G. f.147). (mos u gërmo tepri).*

Tek *valenca e mbiemrit :*

### **emër+ mbiemër**

**ndezç-i**(M.M) - *qi ndezet, qi merr zjarm: (G.f 285). (gur ndezç, uj ndezç). ardhshëm (M.M) i, e adj - *njeri i ardhshëm: qii vjen punës, arsyes: i ndigjueshëm, i shoqnueshëm; punë e ardhshme, qii vjen për doresh, njeri i ardhshëm me kuvend: qii vjen arsyes. (G. f.48). (njeri i ardhshëm, punë e ardhshme).**

Siç vërejmë, pjesët e ligjëratës që më së tepërmi formojnë valencë leksikore janë emrat, mbiemrat e foljet, dhe tek-tuk ndonjë ndajfolje. Po t'i bëjmë një përqasje me Fjalorët e gjuhës shqipe të vitit 1954, 2006, shohim se ka nga ato fjalë që i ndeshim me një kuptim të ndryshëm nga ai që na pasqyrohet tek Gazulli. Psh.: kemi raste të tilla si:

**ardhshëm** - tek Gazulli ka kuptimin për *njeri i ardhshëm, i ndigjueshëm, i shoqnueshëm, qi i vjen arsyes*, ndërsa tek Fjalori i '54 dhe ai i 2006, ka kuptimin e *diçkaje që pritet të vijë, që do të jetë a do të bëhet në të ardhmen, psh. : mjek i ardhshëm, javën e ardhshme* etj. Pra, vërejmë se kuptimi dialektor i kësaj fjale është ndryshëm nga ai i përgjithshmi.

**bjerrun-** tek Gazulli e kemi *me hÿ në jaz, m'u veshë në të zi*. Jam i bjerrun; N.N është i bjerrun; germ. Në Fjalorin e '54 **bjerr** – *humbas*, ndërsa në Fjalorin e 2006 kemi **bjerrë-** (fol.) *i shkoi fjala bjerrë*. Tek Fjalorët e '54, 2006 kuptimi është pothuajse i njëjtë edhe me nuanca të larmishme ligjërimore, ndërsa Gazulli jep kuptimin dialektor me një kuptim krejt të ndryshëm.

Një tjetër element me rëndësi, i cili ngjall interes në Fjalorthin e Gazullit, është se përmes valencës së fjalëve ai ka krijuar edhe *bashkëlidhje metaforike*<sup>13</sup> të tyre, duke i ilustruar kuptimet e fjalëve me shembuj të ndryshëm, çka bën që ky Fjalor të jetë si i pasur, ashtu edhe i arrirë nga ana gjuhësore.

<sup>13</sup> H. Shehu, *Çështje të sintagmatikës në fjalorë të shqipes*, "Leksikografia shqipe, Trashëgimi dhe perspektivë", Tiranë, 2005, f.159-160.

Sipas kësaj rregullsie kemi këto skema bashkëlidhjesh metaforike:

- **në vend të një emri frymor të një grupi tematik zë vend një emër frymor i një grupi tjetër tematik:**

*zemër qofe / njeri qofe* (G.f. 94).  
*drang mice / drang lugati* (G. f.113).  
*njeri garcel / kal garcel* (G. f.154).  
*grue katanë / mushkë katanë*(G. f.195) etj.

- **në vend të një emri jofrymor të një grupi tematik zë vend një emër jofrymor i një grupi tjetër tematik:**

*anët e barrës / ana e pëlhurës* (G. f.46).  
*angrra e mushknivet / angrra e dheut* (G.f. 47).  
*bengu i trimit / bengu i shoqnis* ( G. f.59).  
*boçë pishe / boçë kollomboqi* (G. f.65).  
*qyeja e vis / qyeja e malit* (G .f.96).  
*m'u dushkue mali / m'u dushkue landa* (G.f.117).  
*nji bangë duhan/ nji bangë tesha* (G. f.55).  
*me flakurue shpija / u flakurue buka* ( G. f.134).

- **në vend të një emri frymor zë vend një emër jofrymor :**

*njeri i ardhshëm / punë e ardhshme* (G. f. 48).  
*njeri i avitshëm / mendime të avitshme* (G.f.50).  
*me brufullue krymbat / me brufullue bari* (G. f.71).  
*njeri krekëc / dru krekëc* (G. f.216)

- **në vend të një emri jofrymor zë vend një emër frymor:**

*vend bëzdyç / njeri bëzdyç* (G. f. 61).  
*me kreckue lisiin / me kreckue krena* (G. f.216) etj, etj.

**Por sa ka gjetur pasqyrim ky fjalës në Fjalorët normativë të shqipes?**

Nga një analizë e hollësishme vërejmë se janë 254 fjalë që nuk i gjejmë të pasqyruara në fjalorët normativë të shqipes (1954,1980). Përmendim këtu fjalë si:

**azull-i** (f. 51) - *hija e muzgut të mbrâmes*.

**bahlul-e** (f.52) – *jam bâ bahlul; i marrun mendësh*.

**brrezë-a** (f.72) – *bërskot-i; njaj njeri ka ra brrezë, njeri i rrëxuem prej pleqnije, së lodhmi, smundë*.

**camrùk-u** (f.80) – 1. *camruk kështëje, kokërr kështëje e qërueme, thalb,*

*thalbok kështëje.2. fraz., m'u ba camrruk prej së ftofti, m'u ngrucë së ftofti...*

**qindrák** (f.93)- *qitrak, drejt, thik, fill.*

**dhajë-a** (f.118)- *fuqi, forcë.*

**hysë** (f.179) – *me i dishrue kuj një të keqe të madhe, me habinue.*

**kabûth-i** (f.184) – *grumbull i vogël.*

**odokët-i,-a** (f.293) – *i dobët, i pa mire, i pa-pashi.*

**ogerc-i** (f.293) – *kandërr.*

Vërejmë se nga shumësia e lemave që ndodhen në Fjalorthin e Ri të Nikollë Gazullit, të paraqitura më lart, prej tyre, mendojmë se fjalët e mëposhtme mund të gjejnë hapësirë përdorimi edhe në Fjalorët normativë të shqipes së sotme, (mbi bazën e ususit gjuhësor) si: **akulltar-e** (f.44)- *njeri qi e ka menden akull, qi i peshon fjalët.* **caktár-e** (f.79) – *që rrin në cak, që ruen cakun.* **danisë** (f.104)- *me danue, me e da menden, me vendue, me këputë.* **dae-ja**(f.104) - *të dam-t; de-ja, krh. dreja,për: droe-ja.* **lëjetar-e** (f.233) – *kush xir lëjën. etj.*

Kemi dalluar fjalë me kuptim të ndryshëm në Fjalorët e tjerë të shqipes (1954,1980). Përmendim këtu:

**bigë-a** (f.61) – *birë, vrimë.* Jepet me këtë kuptim të veçantë, pasi në Fjalorin e sotëm të shqipes 2006, ka edhe kuptimin: 1. *dru a diçka tjetër që mbaron me një degëzim më dysh; vendii degëzimit ose vetë degëzimi; furkaçe.* 2. *vinç i madh me dy krahë.* 3. *çift e drejt përpjetë.*

**brojcë-a** (f.71) – *shpend.* F.'54 e ka me një kuptim tjetër, **brojcë-a** – *enë balte a metali me një vesh, që përdoret për ujë; masë drithi (1/2 kilo),* (F.'54, f.47). F.'80, **brojcë-a** – 1. *enë balte a metali e vogël, me një vesh, që përdoret zakonisht për ujë.* 2. *masë drithi prej druri, që nxë rreth një gjysmë kilogrami* (F.'80, f.182).

**lëmesë-a** (f.234) – *mos m'u prishë në pleqni, por as m'u ndreqë krejt.* F.'54, **lëmesë-a** – *shkazmëbore* (F.'54, f.267). F.'80, 1. *vend i lagët, me baltë ose me borë, ku të rrëshqasin këmbët; rrëshqitë, shkazmë.* 2. *cipë shumë e hollë dhe e tejdukshme ndërmjet lëvoreve të disa bimëve e perimeve; cipë e hollë e diçkaje; guaskë* (F.'80, f.977).

**maçkë-a** (f.246) – *zog kuble, kubël e vogël.* F.'54, **maçkë-a** – *tokë që mezi punohet* (F.'54, f.285.)

**përgjegjë** (f.309)- *përgjakë, lëvyrë, gjaknue.* F.'54, **përgjegj** – *përgjigjem* (F.'54, f. 397). F.'80, nuk e ka.

**pruzhë-a** (f.339) – *puprra, puçrra qi mbulojnë shtatin a një pjesë të tijën.* F.'54, **pruzhë-a** - *fshesë e vogël me qime të bishtit të kalit për të fshirë thërrmijat e sofrës* (F.'54, f 436). F.'80 nuk e ka.

I sollëm këto lema nga Fjalori i Gazullit për arsyet e mëposhtme:

- Fakti që mjaft fjalë nga Fjalori i Gazullit (1941), janë pasqyruar vetëm në Fjalorin e vitit 1954 dhe jo më vonë, gjen shpjegim me afrinë në kohë të publikimit të këtyre veprave, me një dekadë ndërmjet.
- E dyta, hartuesit e Fjalorit të 1954-ës e kanë njohur dhe çmuar në mënyrë të veçantë si një prej botimeve të njohura të serisë së Visareve të Kombit.
- Mendojmë gjithashtu se gjuhëtarët leksikografë që punuan për mbledhjen dhe përzgjedhjen e fjalësit të fjalorit të parë shpjegues të shqipes (1954), kanë pasur mendimin se, në rrjedhën e natyrshme të zhvillimit të variantit të shkruar të Veriut, shumë fjalë dialektore të mbledhura nga N. Gazulli, mund të ishin përdorur sot e gjithë ditën brenda standardit të shqipes.
- Së katërti, duhet vënë në dukje se edhe Fjalori i vitit 1954 ka mjaft trajta fjalësh krahinore, të cilat në kohën tonë, jo vetëm që nuk përdoren, por edhe kalojnë në harresë.

Por, del që edhe hartuesit e Fjalorit të shqipes të vitit 1980, kanë përfshirë një numër jo të vogël letrash, vjelë prej Fjalorit të Gazullit. Për këtë mendojmë se është gjykuar i drejtë përdorimi aktiv i tyre në variantin e shkruar e të folur të Veriut, pasi shumë e shumë fjalë gjenden në gjuhën e autorëve të kohës, si, te Migjeni, Koliqi, Fishta e Mjeda etj.

Për Gazullin gjuha e folur e popullit, është ajo që duhet t'i japë shkrimtarit fondin themelor të mjeteve të shprehjes dhe se lëvruesi i gjuhës letrare duhet të depërtojë në shtresa të thella të saj, në leksikon dialektor e krahinor përkatës.

#### BIBLIOGRAFI:

- A. Kostallari, "Kompozitat dëshirore dhe urdhërore të shqipes", Studime filologjike 4, Tiranë, 1968.
- A.Haxhi – T.Topalli, Nikollë Gazulli, (Ledi Shamku-Shkreli, Parathënie e botimit anastatik të Fjalorit të Gazullit, Tiranë, nëntor, 2005, f.5-16), "Leksikon, gjuhëtarë shqiptarë dhe albanologë", Shkodër, 2012.
- Hidi, Sinonimet dialektore dhe pasurimi i leksikut të gjuhës letrare shqipe," Studime mbi leksikon dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe", III, Tiranë, 1989.
- ASHSH, Instituti i gjuhësisë dhe i letërsisë, Fjalor i gjuhës shqipe 1980.
- B.Beci, *E folmja e Shkrelit*, "Dialektologjia shqiptare" I, Tiranë, 1971.
- H. Shehu, Çështje të sintagmatikës në fjalorë të shqipes, "Leksikografia shqipe, Trashëgimi dhe perspektivë", Tiranë, 2005.
- K. Cipo, E. Çabej, M. Domi, A. Krajni, O. Myderrizi, Fjalor i gjuhës shqipe 1954.
- L.Shamku- Shkreli, Fjalori i Gazullit dhe gegnishtja e papërbushur, "Shtatë vjet prolog", Tiranë, 2005.
- N. Gazulli, "Fjalori i Gazullit", Parathanje, Tiranë, 2005.
- S. Pepa, D. Nikollë Gazulli - themelues i leksikografisë krahinore dhe i asaj onomastike, "Gjurmime kulturore", Shkodër 2000.

## THE NEW GLOSSARY OF DOM NIKOLLË GAZULLI IN ITS LINGUISTIC AND CULTURAL DIMENSION

### *ABSTRACT*

This study examines *Fjalorthi i Ri* by Dom Nikollë Gazulli as a significant linguistic and cultural monument of Albanian scholarship, focusing on its lexicographic methodology, dialectal richness, and ethnolinguistic value. Gazulli, a prominent Albanian linguist of the early 20th century, compiled this dictionary based on extensive fieldwork in Northern Albania, particularly in the Malësia e Madhe region. The work includes over 5000 lexical entries, reflecting primarily the northwestern Gheg dialect while also incorporating elements from northeastern and central Gheg varieties.

The analysis highlights the descriptive and explanatory nature of the dictionary, emphasizing its treatment of rare and dialectal words through synonymy, polysemy, and contextual usage. Gazulli's methodology reveals a deep philological awareness, as he often provides equivalents in foreign languages (Latin, Italian, German, French), thereby offering insights into etymology and semantic nuances. Furthermore, the study underlines the importance of lexical valency and contextualization in his work, demonstrating how meaning is constructed through syntagmatic relations and usage patterns.

A key dimension of the dictionary is its ethnolinguistic content, which transcends purely lexical description. Entries frequently encode cultural practices, beliefs, and social structures, particularly those related to ritual life, such as mourning customs (*gjâmue*), seasonal traditions, and customary law. These elements position the dictionary as both a linguistic resource and an anthropological document that preserves the worldview and collective memory of Albanian highland communities. The study also discusses Gazulli's concept of a "middle language," reflecting his effort to bridge dialectal diversity and contribute to the development of a shared linguistic standard. Ultimately, *Fjalorthi i Ri* emerges not only as a repository of lexical wealth but also as a crucial contribution to Albanian lexicography, dialectology, and cultural heritage, with enduring relevance for contemporary linguistic and ethnographic research.

**Keywords:** Albanian lexicography; Dom Nikollë Gazulli; *Fjalorthi i Ri*; Gheg dialect; dialectology; ethnolinguistics; lexical semantics; synonymy and polysemy; lexical valency; cultural anthropology; Albanian language history; linguistic heritage.

Rovena MERA, Gerta KUPI

## STUDIM SOCIOLINGUISTIK I R DHE RR, NDRYSHUESHMËRIA NË TË FOLURIT URBAN SHQIPTAR (2013-2023)

### Hyrje

Qëllimi i këtij punimi shkencor është të studiojë mënyrat e ndryshme të përdorimit të dy fonemave dridhëse të gjuhës shqipe, /r/ dhe /rr/, në të folurën e përditshme. Studimi shtrihet në një periudhë dhjetëvjeçare, nga viti 2013 deri në vitin 2023, duke analizuar ndryshueshmërinë fonetike dhe ndikimet sociokulturale që formojnë përdorimin e këtyre fonemave (Agalliu, Memushaj, & Reso, 1989; Hudson, 2002).

Edhe pse /r/ dhe /rr/ dallohen nga një tipar fiziologjik, numri i dridhjeve (shtypje e lartë nënglotore, SHLN), ato shpesh ndërrohen në të folurit bisedor, duke krijuar ndryshueshmëri të dukshme gjuhësore (Labov, 1966, 1972a, 1972b). Ky alternim bën të nevojshëm shqyrtimin e kontekstit sociolinguistik dhe rajonal ku ato përdoren (Gjinari, 1988, 1989).

Hulumtimi përqendrohet në përdorimin e këtyre fonemave në disa qytete të Shqipërisë së Jugut, si Korça, Berati dhe Vlora, si edhe në kryeqytet, Tiranë, ku fluksi i popullsisë dhe ndikimi i urbanizimit krijojnë kontekste të larmishme për ndryshueshmëri gjuhësore (Beci, 2016; Klosi, Hajnaj, & Çelo, 2015). Në përputhje me parimet e dialektologjisë urbane, mbledhja e të dhënave realizohet përmes intervistave me pyetësorë që përfshijnë fjalë me /rr/ në pozicione të ndryshme brenda fjalës (p.sh., birra, arrë, rrapi, Gorricë, Durrës, racë) (Hudson, 2002). Pyetësi gjithashtu përmban të dhëna demografike, si: mosha, arsimi, gjinia dhe profesioni, duke siguruar përfaqësim të balancuar të pjesëmarrësve. Përgjigjet mbahen shënim me përpikëri dhe i nënshtrohen analizës fonetike (Labov, 1984).

Analiza krahasuese mbështetet në metodologjinë e Labovit (1966, 1972a, 1972b, 1984) dhe vendoset në paralelizëm me studimet mbi bashkëtingëlloret e gjalla në dialektet italiane, të përshkruara nga Varvaro (1978). Gjetjet tregojnë se /r/ dhe /rr/ nuk funksionojnë gjithmonë si fonema të dallueshme në shqipen e folur. Alternimi i tyre shënon variacione dialektore dhe shoqërore. Në qytete jugore si Korça dhe Berati, fonema /rr/ mungon në të folurën popullore, në përputhje me klasifikimin e Gjinarit (1988), i cili i përfshin këto zona në areale të veçanta dialektore.

Ky studim kontribuon në sociolinguistikën shqiptare duke analizuar ndryshueshmërinë reale të fonemave në kontekste bisedore dhe duke diskutuar supozimet për dallimin e rreptë të tyre në shqipen standarde (Drejtshkrimi i gjuhës shqipe, 1973; Agalliu, Memushaj, & Reso, 1989). Ai plotëson boshllëqe në studimet dialektologjike dhe nënvizon marrëdhëniet dinamike midis gjuhës së gjallë, përdorimit të përditshëm dhe normave gjuhësore (Gjinari, 1988, 1989; Beci, 2016)

### Metodologjia

Metodologjia e përdorur kombinon rishikimin e literaturës dhe vëzhgimet në terren të kryera në qytetet e përzgjedhura të Shqipërisë së Jugut gjatë periudhës 2013–2023 (Hudson, 2002; Labov, 1984). Mbledhja e të dhënave u realizua përmes intervistave të strukturuar dhe anketave në hapësira publike, si tregje, ura dhe rrugë historike, të përzgjedhura strategjikisht për të siguruar ndërveprime me një kampion të larmishëm qytetarësh të rastësishëm (Labov, 1966; Varvaro, 1978).

Pikat kryesore nga instrumentet e kërkimit përfshijnë:

Pjesëmarrësit ishin qytetarë të afruar në mënyrë të rastësishme në hapësira publike, duke siguruar përfaqësim të larmishëm nga grupe të ndryshme sociale dhe moshash. Kampionimi përfshinte një përzjerje të banorëve të përhershëm dhe të të ardhurve, për të analizuar përdorimin e gjuhës dhe veçanërisht këtyre dy fonemave, në kontekste të ndryshme demografike (Klosi, Hajnaj, & Çelo, 2015; Hudson, 2002).

Pyetësi i intervistave përfshinte fjalë që kërkonin përdorimin e fonemave /r/ dhe /rr/ për të vlerësuar prirjet gjuhësore. Pyetjet u hartuan me kujdes për të nxjerrë natyrshëm këto fonema në përgjigjen e dhënë, duke përdorur fjalë të komunikimit të përditshëm si *birrë*, *arrë*, *rrugë* dhe *Durrës*. Intervistuesi shënonte shqiptimin në kolonën përkatëse si /r/ ose /rr/ dhe mblidhte të dhëna shtesë për moshën, arsimin, profesionin, origjinën dhe gjininë e pjesëmarrësve (Agalliu, Memushaj, & Reso, 1989; Labov, 1972a, 1972b).

Tregu publik në Korçë, Ura e Goricës në Berat, lulishtja Tre Racat në Vlorë, rruga e Durrësit dhe Rrapi i Treshit në Tiranë, ishin vende të zgjedhura strategjikisht që mundësonin ndërveprimin me banorët.

Studimi u krye në dy periudha të rëndësishme vëzhgimi: sondazhet fillestare në 2013 dhe studimet pasuese në 2023, duke mundësuar analizën e prirjeve gjuhësore me kalimin e kohës.

Mbledhja e të dhënave u drejtua nga parimet e dialektologjisë urbane dhe u bazua në intervista me pyetje të hapura, të cilat nxiten pjesëmarrësit

të japin shembuj konkretë me fjalë që përmbajnë fonemën /rr/ në fillim të fjalës ose pas zanores. Të dhënat u regjistruan në shënime të shkruara me dorë për analizë të mëtejshme.

U inkurajam të ndërmerrim këtë lloj kërkimi duke u bazuar në studime të autorëve të huaj, si W. Labov, i cili, përveç studimeve të shumta mbi variacionet gjuhësore në Nju Jork, kreu edhe kërkime të orientuara drejt variacioneve në shqiptimin e fonemës /r/ midis banorëve të qytetit (Labov, 1966, 1972a, 1972b).

Për të marrë të dhëna më të përshtatshme për shqiptimin e saktë të këtyre fonemave, kemi përzgjedhur intervistuesit duke pasur parasysh një shpërndarje të balancuar sipas moshës dhe gjinisë, në përputhje me praktikën e sociolinguistikës (Labov, 1984). Kështu u përcaktuan edhe mostrat për studim.

Të dhënat e marra nxorën në pah çështje që janë objekt i studimeve themelore në sociolinguistikë: fonemat /r/ dhe /rr/ nuk funksionojnë gjithmonë si dy fonema të dallueshme në gjuhën shqipe, dhe alternimi i tyre (zakonisht rr → r) mund të përbëjë një veçori identifikuese për folësit ose grupet e folësve (Gjinari, 1988; Labov, 1984).

Bashkëtingëlloret dridhëse ekzistojnë edhe në gjuhë të tjera, kryesisht si variante të së njëjtës fonemë në gjuhën e folur; në disa raste përdoren, në të tjera jo (alternimi i /r/ ~ /ɹ/ në anglisht), ndërsa diku tjetër mungon kontrasti (alternimi i /r/ ~ /rr/ në italisht) (Labov, 1966; Berruto, 1995). Synuam të përdorim metoda të orientuara nga kërkime të mëparshme, në përputhje me shembullin dhe metodat e Labovit. Labov mblodhi të dhëna faktike në vende publike dhe i analizoi ato. Për variacionet e /r/ në anglisht, ai vëzhgoi supermarkete ku mund të takonte njerëz nga sfera të ndryshme të jetës (Labov, 1966; Labov, 1972b). Duke luajtur rolin e një klienti të paorientuar, ai pyeti për vendndodhjen e pjesës së luleve; përgjigjet përfshinin fjalë si “lule–flower”, “katër–four” dhe “kat–flor” (Labov, 1966).

Sa i përket përdorimit të bashkëtingëllores rotike në gjuhën e shkruar të shqipes, ku vendoset norma, aspektet që do të diskutohen janë krejtësisht të ndryshme. Këtu fokusi është tek norma gjuhësore dhe tek vlerat stilistike që rrjedhin nga potenciali retorik i fonemave të gjalla në gjuhën shqipe (Drejtshkrimi i gjuhës shqipe, 1973).

Për të përshtatur drejtshkrimin e fonemave dridhëse në gjuhën shqipe, janë përcaktuar një sërë rregullash drejtshkrimore në tekstin akademik *Drejtshkrimi i gjuhës shqipe* (1973). Çështjet e theksuara në atë libër fokusohen edhe në alternimin e fonemave dridhëse. Fjalët që rrjedhin nga gjuhët e huaja dhe që kanë një /rr/ në origjinal duken më të pakapshme.

Meqë i referohemi gjuhës standarde shqipe, këto fonema nuk paraqiten si variante, por vendosen në një kundërvënie fonologjike e rregulluar nga norma drejtshkrimore (Drejtshkrimi i gjuhës shqipe, 1973).

Duke pasur parasysh faktin se ka dallime midis tingujve të një gjuhe të gjallë, të folur, e cila ndryshon vazhdimisht, dhe asaj të ngrirë në gjuhën standarde, variacionet e hasura do të ndahen dhe kualifikohen në mënyrë konvencionale në variacione fjalë për fjalë dhe variacione ideale (Agalliu, Memushaj, & Reso, 1989). Studime të tilla kanë qenë të pakta në gjuhën shqipe. Në këto kushte, hulumtimi ynë kontribuon në zgjidhjen e çështjeve të caktuara që lidhen me temën, e cila ka qenë një sfidë më vete. Nga ana tjetër, variacionet në shqiptimin e bashkëtingëllores rotike /r/ nuk mund të jenë objekt i një kërkimi specifik. Megjithatë, gjuhëtarët kanë nxjerrë në pah fakte të rëndësishme lidhur me këtë çështje, veçanërisht ato më të dukshmet (Hudson, 2002).

Duke parë bibliografinë gjuhësore shqiptare, gjetëm pohime që japin një kontribut të rëndësishëm në këtë drejtim. Çështja më e rëndësishme që lidhet me temën në shqyrtim janë gjetjet dhe përfundimet e dialektologëve. Në veprën e tij “Dialektologjia e shqipes”, Jorgji Gjinari shkruante se në të folurin e sotëm të rrethit të Korçës dhe të Beratit nuk ndeshet fonema /rr/ (Gjinari, 1988). I njëjti autor në veprën “Dialektet e gjuhës shqipe”, pohon se fonema /rr/ ishte e panjohur në të folurën popullore të banorëve të mëparshëm të pothuajse të gjitha qyteteve të Jugut të Shqipërisë (Gjinari, 1989).

Libri “Hyrje në Gjuhësi” shkruan: *“Në këtë drejtim, tendenca e vërejtur në të folurit e banorëve të qyteteve tona lidhur me çështjet e rënies apo kontrastit të /r - rr/, nuk mund të shpjegohet thjesht me faktin se ky aspekt i folësve fillimisht ndërgjegjësohet në përdorimin e tij praktik”* (Agalliu, Memushaj, & Reso, 1989).

Siç përmendëm më parë, vëzhgimi ynë u fokusua në disa qytete të Shqipërisë së Jugut, në harkun kohor 2013-2023. Në vijim paraqitet ajo që vumë re në vitin 2013.

E konsiderojmë të arsyeshme të ritheksojmë se intervista është realizuar me qytetarë të rastësishëm.

Ajo u zhvillua në tregun e qytetit pasi kishte më shumë mundësi për të arritur atë që synonym. Në qytetin e Korçës numri i të intervistuarve arriti në 90.

Pyetja drejtuar të intervistuarve u hartua e tillë që të kishte fjalën “birrë” si përgjigje. Gjithsej 90 personat e intervistuar u ndanë si më poshtë.

Tabela 1. Përdorimi i fonemave /r/ dhe /rr/ në qytetin e Korçës (N = 90)

Kategoria	Numri	/r/	%	/rr/	%
<b>Totali</b>	90	55	61%	35	39%
<b>Femra</b>	39	29	68%	10	32%
<b>Meshkuj</b>	51	36	60%	15	40%

Të dhënat tregojnë se në të folurin urban të Korçës, fonema /r/ përdoret më shpesh sesa /rr/, çka sugjeron një prirje të qartë drejt neutralizimit të kundërvënies fonologjike në kontekstin bisedor. Diferencat midis femrave dhe meshkujve janë minimale, gjë që tregon se përdorimi i këtyre fonemave nuk kushtëzohet nga gjinia, por përbën një tipar të përgjithshëm dialektor të komunitetit urban të Korçës.

Tabela 2. Përdorimi i /r/ dhe /rr/ sipas grupmoshave (femra)

Grupmosha	/r/ %	/rr/ %
15–22 vjeç	75%	25%
26–40 vjeç	52%	48%
41–60 vjeç	65%	35%

Analiza sipas grupmoshave tregon se përdorimi i fonemës /r/ është më i theksuar tek grupmosha më e re (15–22 vjeç), ndërsa në grupmoshën 26–40 vjeç vërehet një shpërndarje pothuajse e barabartë midis /r/ dhe /rr/, çka sugjeron një fazë tranzicioni fonologjik ku bashkëjetojnë forma tradicionale dhe forma të thjeshtuara. Në grupmoshën 41–60 vjeç, dominimi i /r/ mbetet i qëndrueshëm, duke përforcuar interpretimin e këtij variacioni si tipar dialektor dhe jo si dukuri e kufizuar nga faktorë socialë si gjinia apo mosha. Megjithatë, një analizë më e detajuar sipas gjinisë tregon se femrat, veçanërisht ato të reja, janë më të prirura për të përdorur fonemën dridhëse /r/.

Ky dallim, i theksuar kryesisht në grupmoshën 15–22 vjeç, mund të shpjegohet jo vetëm nga variacionet dialektore, por edhe nga faktorë sociolinguistikë që lidhen me etikën e të folurit dhe ndërtimin e identitetit urban. Përdorimi i /r/ nga vajzat e reja, veçanërisht ato të ardhura rishtazi në qytetin e Korçës, shërben si një mjet përshtatjeje gjuhësore, duke krijuar

përshtypjen e përputhjes me normat e të folurit vendor ose të identifikimit si banore të hershme të qytetit. Në grupmoshat më të larta, këto dallime zbehen, çka sugjeron një stabilizim të përdorimit dhe një mospërfillje relative ndaj vlerave simbolike që mbart kundërvënia /r-/rr/.

Intervistuar 46 meshkuj, nga të cilët, 30 përdorin fonemën /r/ dhe 16 përdorin fonemën /rr/. Ndarjet e grupmoshave zbulojnë sa vijon.

Tabela 3. Përdorimi i /r/ dhe /rr/ (Meshkuj)

Grupmosha	/r/ (%)	/rr/ (%)	Raporti /r/: /rr/
15–25 vjeç	80%	20%	1:04
26–40 vjeç	56%	34%	01:01.6
41–70 vjeç	57%	43%	01:01.3

Analiza e të dhënave për meshkujt tregon një tendencë të qartë sociolinguistike, ku përdorimi i fonemave /r/ dhe /rr/ ndryshon në varësi të moshës, por jo të gjinisë.

Në grupmoshën 15–25 vjeç, fonema /r/ përdoret në mënyrë dominuese (80%), ndërsa përdorimi i /rr/ mbetet dukshëm më i ulët (20%), duke krijuar një raport 1:4. Ky rezultat sugjeron një prirje drejt thjeshtimit fonetik të të rinjtë, e cila mund të lidhet me ndikime urbane, mediatike dhe sociale.

Në grupin 26–40 vjeç, raporti i përdorimit ngushtohet ndjeshëm (1:1.6), çka tregon një fazë tranzitore ku bashkëjetojnë forma më tradicionale dhe më të reja të shqiptimit.

Ndërkohë, në grupmoshën 41–70 vjeç, raporti bëhet më i balancuar (57% /r/ dhe 43% /rr/), duke reflektuar ruajtjen më të qëndrueshme të opozicionit fonemik tradicional.

Në përputhje me të dhënat e marra nga grupet e femrave, këto rezultate konfirmojnë se ndryshimi nuk është i kushtëzuar nga gjinia, por kryesisht nga faktori i moshës. Me rritjen e moshës, diferenca mes përdorimit të /r/ dhe /rr/ zvogëlohet, duke dëshmuar një model të përbashkët sociolinguistik për të dyja gjinitë.

Pas 10 vitesh, në vitin 2023, 60 persona u intervistuan në qytetin e Korçës, duke u bërë pyetje që përfshinin një përgjigje me fjalët “birrë” ose “arrë”.

Numri i përgjithshëm i të anketuarve është ndarë si më poshtë.

Tabela 4. Përdorimi i fonemave /r/ dhe /rr/ sipas gjinisë (Korçë, 2023)

Grupi	Numri total	/r/ (nr.)	/r/ (%)	/rr/ (nr.)	/rr/ (%)
Të anketuar gjithsej	60	26	43%	34	57%
Femra	20	9	45%	11	55%
Meshkuj	40	15	37%	25	63%

Tabela 5. Përdorimi i fonemave /r/ dhe /rr/ sipas grupmoshës (2023)

Grupmosha	/r/	/rr/	Vërejtje
15–25 vjeç	50%	50%	Shpërndarje e barabartë
26–40 vjeç	më pak	më shumë	Dominon /rr/
41–70 vjeç (femra)	7	7	Barazi e plotë

Të dhënat e mbledhura në vitin 2023 tregojnë një ndryshim të dukshëm në prirjet e shqiptimit krahasuar me intervistat e kryera një dekadë më parë. Në përgjithësi, përdorimi i fonemës /rr/ rezulton më i përhapur (57%) sesa përdorimi i /r/ (43%), çka sinjalizon një orientim më të fortë drejt normës standarde të shqipes.

Analiza sipas gjinisë tregon se si femrat ashtu edhe meshkujt ndjekin të njëjtin zhvillim gjuhësor, megjithëse meshkujt shfaqin një përqindje më të lartë të përdorimit të /rr/. Kjo diferencë, megjithatë, nuk është thelbësore për të argumentuar një ndarje gjinore, por më tepër përforcon idenë e një procesi të përgjithshëm standardizimi.

Nga këndvështrimi i moshës, të dhënat paraqesin një model interesant: grupmoshat ekstreme (15–25 dhe 41–70 vjeç) shfaqin një shpërndarje të barabartë midis dy fonemave, ndërsa grupmosha 26–40 vjeç përdor më shpesh fonemën /rr/. Ky grup, i ekspozuar më intensivisht ndaj arsimit formal, institucioneve dhe komunikimit publik, duket se luan rol kyç në përhapjen e shqiptimit standard.

Të dhënat e vitit 2023 tregojnë se qytetarët e Korçës janë gjithnjë e më të prirur të përdorin forma të standardizuara në fjalë si *birrë* dhe *arrë*, duke reflektuar një zhvendosje graduale fonologjike që shkon përtej faktorëve gjinorë dhe lidhet ngushtë me ndikime sociale, arsimore dhe normative. Ndryshe nga të dhënat e mëparshme, ku /r/ dominonte si tipar

dialektor, rezultatet aktuale dëshmojnë një rikonfigurim të preferencave fonetike në përputhje me normën standarde të shqipes

Në qytetin e Beratit, vëzhgimet u kryen në vendin e quajtur “ura e Goricës”. I pyesnim njerëzit: si quhet ky vend? Si quhet kjo urë e bukur? Vendndodhja e kësaj pjese të qytetit, pranë urës, na dha mundësinë të intervistonim banorë të dy lagjeve të qytetit të quajtura “Gorica” dhe “Mangalem”.

Tabela 6. Shpërndarja e përgjithshme sipas origjinës (Berat)

<b>Origjina e të intervistuarve</b>	<b>Numri</b>	<b>/r/</b>	<b>/rr/</b>
Banorë vendas	45	45	0
Të ardhur	27	8	19
<b>Gjithsej</b>	<b>72</b>	<b>53</b>	<b>19</b>

Tabela tregon qartë se përdorimi i fonemës /r/ është tipar karakteristik i banorëve vendas të qytetit të Beratit, ndërsa fonema /rr/ shfaqet pothuajse ekskluzivisht te të ardhurit. Kjo dëshmon se variacioni fonologjik nuk lidhet me faktorë socialë të brendshëm, por me origjinën gjeografike të folësve.

Tabela 7. Femrat sipas grupmoshës (Berat)

<b>Grupmosha</b>	<b>/r/ (%)</b>	<b>/rr/ (%)</b>
15–25	73%	27%
26–40	100%	0%
41–65	85%	15%

Shpërndarja sipas grupmoshës nuk tregon prirje të rregullta zhvillimore. Përdorimi i /rr/ në këtë rast shpjegohet kryesisht nga prania e femrave të ardhura në qytet dhe jo nga mosha. Mungesa totale e /rr/ në grupmoshën 26–40 vjeç përforcon rolin përcaktues të origjinës.

Tabela 8. Meshkujt (Berat)

<b>Fonema</b>	<b>Përqindja</b>
/r/	54%
/rr/	46%

Ndryshe nga femrat, meshkujt shfaqin një shpërndarje më të balancuar

midis dy fonemave. Kjo lidhet me lëvizshmërinë më të madhe sociale dhe gjeografike të meshkujve, të cilët përthithin më lehtë tipare fonologjike të shqipes standarde ose të dialekteve të tjera.

Në qytetin e Beratit nuk ka kuptim kërkimi i variacionit fonologjik sipas gjinisë apo grupmoshës. Përdorimi i fonemave /r/ dhe /rr/ varet pothuajse ekskluzivisht nga origjina e folësve, duke mbështetur plotësisht vëzhgimet e J. Gjinarit mbi konservatorizmin fonologjik të qyteteve tradicionale.

Situata në qytetin e Vlorës paraqitet si më poshtë.

Tabela 9. Shpërndarja e përgjithshme (Vlorë)

Fonema	Përqindja
/r/	16%
/rr/	84%

Të dhënat tregojnë dominim të theksuar të fonemës /rr/ në të folurin urban të Vlorës. Ndryshe nga Berati, këtu /rr/ përfaqëson normën funksionale të komunikimit të përditshëm.

Tabela 10. Femrat sipas grupmoshës (Vlorë)

Grupmosha	/r/ (%)	/rr/ (%)
15–25	39%	61%
26–40	35%	65%
41–60	50%	50%

Femrat e grupmoshave të reja dhe të mesme shfaqin prirje të qartë drejt përdorimit të /rr/, ndërsa në grupmoshën më të madhe vërehet një ekuilibër. Kjo sugjeron një ruajtje relative të formave tradicionale tek brezi më i vjetër.

Tabela 11. Meshkujt sipas grupmoshës (Vlorë)

Grupmosha	/r/ (%)	/rr/ (%)
15–25	25%	75%
26–40	29%	71%
41–70	14%	86%

Meshkujt përdorin fonemën /rr/ dukshëm më të shpeshtë se femrat në të gjitha grupmoshat. Dallimi rritet me moshën, çka tregon se /rr/ është fonemë e konsoliduar në sistemin fonologjik urban të Vlorës.

Në Vlorë, ndryshe nga Berati, fonema /rr/ përbën normën dominante, ndërsa /r/ shfaqet si variant më i kufizuar. Dallimet gjinore janë të pranishme, por variacioni është më i theksuar tek meshkujt, çka lidhet me dinamika sociale dhe komunikative më të hapura.

Në qytetin e Beratit, pas 10 vitesh u kthyem te “ura e Goricës” duke bërë pyetjen; “Si quhet ky vend”, që iu drejtua 130 personave.

Të dhënat e marra në vitin 2023 nxjerrin në pah rezultatet e mëposhtme.

Tabela 12. Përdorimi i fonemave sipas gjinisë (Berat, 2023)

Gjinia	Numri total	/r/	/r/ (%)	/rr/	/rr/ (%)
Femra	59	36	61%	23	39%
Meshkuj	71	49	69%	22	31%
<b>Gjithsej</b>	<b>130</b>	<b>95</b>	<b>73%</b>	<b>35</b>	<b>27%</b>

Përdorimi i fonemës /r/ është më i përhapur në të dyja gjinitë. Meshkujt tregojnë një përqindje më të lartë për /r/ (69%) krahasuar me femrat (61%). Kjo tregon se në qytetin e Beratit, /r/ është fonema dominuese në të folurin urban, ndërsa /rr/ përdoret më rrallë dhe nuk lidhet me gjininë.

Tabela 13. Femrat sipas grupmoshave

Grupmosha	Numri total	/r/	/r/ (%)	/rr/	/rr/ (%)
15–25	12	11	91%	1	9%
26–40	17	10	58%	7	42%
41–70	30	20	66%	10	34%

Femrat e grupmoshës më të re 15–25 vjeç përdorin në mënyrë shumë të qartë /r/ (91%). Në grupin 26–40 vjeç, përdorimi i /rr/ është më i dukshëm (42%), ndërsa në grupmoshën 41–70 vjeç, përqindjet kthehen në favor të /r/ (66%). Kjo tregon se /r/ është fonema dominuese ndër të gjitha grupmoshat femërore, me një rritje të përdorimit të /rr/ vetëm te grupi i mesëm.

Tabela 14. Meshkujt sipas grupmoshave

Grupmosha	Numri total	/r/	/r/ (%)	/rr/	/rr/ (%)
15–25	8	7	87%	1	13%
26–40	16	12	75%	4	25%
41–70	47	32	68%	15	32%

Tek meshkujt, përdorimi i /r/ mbetet dominues në të gjitha grupmoshat, por vërehet një rënie graduale me moshën (87% → 68%). Përdorimi i /rr/ rritet

proporcionalisht tek grupmosha më e madhe, duke treguar adaptimin ndaj formave standarde ose ndikimeve nga të ardhurit e rinj.

Në fund të vëzhgimeve tona vihet re se fonema /r/ është më e përdorur se /rr/ në të folurin urban të Beratit. Ky trend është i njëjtë për femrat dhe meshkujt. Në grupmoshat e reja dhe të mesme vërehet një prani e vogël e /rr/, ndërsa tek grupmosha më e madhe përdorimi i /r/ është i qëndrueshëm. Këto të dhëna tregojnë një stabilitet dialektor në përdorimin e /r/ dhe një ndikim të kufizuar të /rr/, që duket të lidhet me kontaktin me të folurit standard ose me të ardhurit në qytet.

Në qytetin e Vlorës ka një situatë krejt të ndryshme në këtë drejtim. Në këtë qytet nuk ka tendencë nga brezi i ri për të shmangur /rr/, siç ka rezultuar në qytetin e Beratit dhe Korçës. Nuk mund të thuhet se ky rezultat përputhet me normën e shqiptimit, (ka shumë devijime), megjithatë, në Vlorë ka një tendencë të kundërt; edhe kur është pranë një bashkëtingëlloje tjetër, si për shembull në fjalët *motrre*, *zembrre*, (në shqipen standarde *motra* dhe *zemra*) (sigurisht që numri i dridhjeve nuk është katër, si në fonemën /rr/ të gjuhës standarde shqipe, por ka dy deri në tre dridhje, diçka midis /r/ dhe /rr/.

Konteksti në qytetin e Vlorës pas 10 vjetësh, përshkruhet në vijim. 60 është numri total i individëve të intervistuar, nga të cilët 34 femra dhe 26 meshkuj, 44 të intervistuar janë me origjinë nga Vlora dhe 16 të tjerë janë të ardhur në qytet.

Grupimi i tyre sipas moshës solli rezultatet e mëposhtme.

Tabela 15. Përdorimi i fonemave /r/ dhe /rr/ tek femrat sipas grupmoshave (Vlorë, 2023).

Grupmosha (vjeç)	Numri i Femrave	/r/ (numër)	/r/ (%)	/rr/ (numër)	/rr/ (%)
15 – 25	10	5	50%	5	50%
26 – 40	17	4	24%	13	76%
41 – 70	7	3	50%	3	50%

Tek grupmosha 15–25 vjeç, përdorimi i /r/ dhe /rr/ është i barabartë (50%-50%), duke treguar se brezi i ri në Vlorë ka një tendencë të lehtë për të ndjekur standardin, duke shmangur dominimin e fonemës /rr/. Tek grupmosha 26–40 vjeç, përdorimi i fonemës /rr/ është dukshëm më i lartë (76%), duke treguar se të rriturit vazhdojnë të ruajnë përdorimin tradicional të /rr/. Tek grupmosha 41–70 vjeç, raporti është përsëri i barabartë, duke treguar se moshat më të vjetra nuk kanë një ndryshim të qartë midis /r/ dhe /rr/.

Tabela 16. Përdorimi i fonemave /r/ dhe /rr/ tek meshkujt sipas grupmoshave (Vlorë, 2023).

Grupmosha (vjeç)	Numri i Meshkujve	/r/ (numër)	/r/ (%)	/rr/ (numër)	/rr/ (%)
15 – 25	17	6	35%	11	65%
26 – 40	5	3	50%	3	50%
41 – 70	4	2	50%	2	50%

Tek grupmosha 15–25 vjeç, përdorimi i /rr/ është më i lartë (65%), por në krahasim me grupmoshat më të vjetra, kjo tregon një tendencë të lehtë të rinisë për të përdorur /r/ në përputhje me standardin. Tek grupmoshat 26–40 dhe 41–70 vjeç, përdorimi i /r/ dhe /rr/ është i barabartë (50%-50%), që do të thotë se mes të rriturve nuk ka preferencë të dukshme për asnjërën nga fonemat.

Në qytetin e Vlorës pas 10 vjetësh, fonema /rr/ përdoret më shpesh se /r/, megjithëse frekuenca ka rënë tek grupmosha më e re e femrave. Sjellja gjuhësore e të rejave për të shmangur /rr/ (grupi 15–25 vjeç) tregon një prirje të përshtatjes me standardin e gjuhës shqipe. Tek meshkujt, përdorimi i /rr/ mbetet i lartë tek të rinjtë dhe barazimi midis fonemave tek grupmoshat më të vjetra tregon ruajtjen e formave tradicionale.

Tirana ka një popullsi heterogjene dhe në tabelat e mëposhtme tregohet shpërndarja e përdorimit të fonemave /r/ dhe /rr/ sipas moshës dhe gjinisë së të intervistuarve.

Tabela 17. Përdorimi i fonemave /r/ dhe /rr/ tek femrat sipas grupmoshave (Tiranë, 2013).

Grupmosha (vjeç)	Numri i Femrave	/r/ (numër)	/r/ (%)	/rr/ (numër)	/rr/ (%)
15 – 25	13	9	69%	4	31%
26 – 40	11	3	27%	8	73%
41 – 65	10	3	30%	7	70%
<b>Totali</b>	<b>34</b>	<b>15</b>	<b>44%</b>	<b>19</b>	<b>56%</b>

Femrat e moshës 15–25 vjeç përdorin fonemën /r/ më shumë (69%) krahasuar me /rr/ (31%), që tregon një prirje për të ndjekur standardin e gjuhës shqipe dhe për të shmangur devijimet tradicionale të fonemës /rr/. Në grupmoshat 26–40 dhe 41–65 vjeç, fonema /rr/ është dominante (73% dhe 70%), duke reflektuar përdorimin tradicional të fonemës në të folurit e zonës. Për femrat, prirja për shmangien e /rr/ është më e dukshme tek të

rejat, gjë që sugjeron ndikim të etikes së të folurit dhe stilit të rafinuar.

Tabela 18. Përdorimi i fonemave /r/ dhe /rr/ tek meshkujt sipas grupmoshave (Tiranë, 2013).

Grupmosha (vjeç)	Numri i Meshkujve	/r/ (numër)	/r/ (%)	/rr/ (numër)	/rr/ (%)
15 – 25	11	1	9%	10	91%
26 – 40	15	3	20%	12	80%
41 – 70	24	5	21%	19	79%
<b>Totali</b>	<b>50</b>	<b>9</b>	<b>18%</b>	<b>41</b>	<b>82%</b>

Tek meshkujt, fonema /rr/ është e dominuese në të gjitha grupmoshat, përqindjet shkojnë nga 80% në 91%, duke treguar se nuk ka prirje për shmangien e /rr/. Tek të rinjtë (15–25 vjeç), përqindja e përdorimit të /rr/ është 91%, që tregon ruajtjen e formave tradicionale dhe pak ndikim nga standardi i gjuhës në foljen e meshkujve.

Në Tiranë, mosha e re e femrave është e prirur të përdorë /r/ për të respektuar standardin, ndërsa meshkujt ruajnë dominimin e /rr/ pavarësisht moshës. Përdorimi i /rr/ është më i lartë tek meshkujt sesa tek femrat, duke reflektuar një ndikim më të fuqishëm të traditës në të folurit e meshkujve. Tendanca e rinisë femërore për të shmangur /rr/ tregon përshtatje sociale dhe stilistike në folje, ndërsa tek meshkujt nuk vihet re një tendencë e tillë. U kthjem për intervista në kryeqytetin e Shqipërisë, Tiranë, te “Rruga e Durrësit” dhe vumë re se në këto 10 vjet popullsia është bërë më heterogjene dhe më e larmishme për nga origjina.

Nga 130 individë të intervistuar, 94 janë të ardhur në Tiranë dhe 36 janë të lindur dhe rritur në Tiranë.

Tabela 19. Përdorimi i fonemave /r/ dhe /rr/ tek femrat sipas grupmoshave (Tiranë, 2023).

Grupmosha (vjeç)	Numri i femrave	/r/ (numër)	/r/ (%)	/rr/ (numër)	/rr/ (%)
15 – 25	20	3	15%	17	85%
26 – 40	26	6	23%	20	77%
41 – 70	22	2	9%	20	91%
<b>Totali</b>	<b>68</b>	<b>11</b>	<b>16%</b>	<b>57</b>	<b>84%</b>

Femrat e të gjitha grupmoshave tregojnë një dominim të fonemës /rr/, me

prirje të rinisë për të përdorur pak më shpesh /r/ (15%), që mund të lidhet me ndikim të standardit në të folur.

Tabela 20. Përdorimi i fonemave /r/ dhe /rr/ tek meshkujt sipas grupmoshave (Tiranë, 2023).

Grupmosha (vjeç)	Numri i meshkujve	/r/ (numër)	/r/ (%)	/rr/ (numër)	/rr/ (%)
15 – 25	15	2	13%	13	87%
26 – 40	20	2	10%	18	90%
41 – 70	27	0	0%	27	100%
<b>Totali</b>	<b>62</b>	<b>4</b>	<b>6%</b>	<b>58</b>	<b>94%</b>

Tek meshkujt, fonema /rr/ është e dominuese për të gjitha grupmoshat, madje edhe tek të rinjtë, duke treguar se nuk ka prirje për shmangien e /rr/ në foljen e përditshme.

Analiza e këtyre të dhënave na tregon që tek femrat, përqindja e përdorimit të /rr/ është 84% në total, ndërsa tek meshkujt është edhe më e lartë, 94%. Kjo tregon se në Tiranë, folësit përdorin gjerësisht fonemën /rr/, e cila është më afër standardit të gjuhës shqipe.

Femrat e grupmoshave 15–25 vjeç përdorin /r/ më shumë (15%) krahasuar me të tjerat, që tregon një prirje të lehtë për të shmangur /rr/ sipas normave të të folurit standard. Meshkujt nuk tregojnë ndonjë ndryshim të madh midis grupeve; dominimi i /rr/ është i qëndrueshëm, duke ruajtur traditën e foljes.

Femrat kanë një përdorim më të larmishëm të /r/ dhe /rr/, ndërsa meshkujt përdorin /rr/ pothuajse ekskluzivisht. Kjo tregon se femrat janë më të ndjeshme ndaj normave sociale dhe stilit të të folurit, ndërsa meshkujt ruajnë përdorimin tradicional.

Përdorimi i /r/ tek femrat e reja (15%), mund të lidhet me ndikimin e arsimimit, standardit dhe sjelljeve sociale që kërkojnë një të folur më të rafinuar. Përdorimi i /rr/ tek meshkujt dhe femrat e moshuara tregon stabilitet të lartë të fonemës në arealin e Tiranës, pa ndryshime të mëdha nga brezi i ri.

### Diskutimi i gjetjeve

Përfshirja e qytetarëve të rastësishëm nga grupe të ndryshme sociale dhe moshë të ndryshme në intervista siguroi një bazë të gjerë dhe të

larmishme për analizimin e prirjeve gjuhësore. Përzierja e banorëve vendas me të ardhurit në qytete të ndryshme zbuloi kontraste të qarta në përdorimin e fonemave /r/ dhe /rr/, duke treguar se migrimi i brendshëm dhe urbanizimi ndikojnë në mënyrën se si artikuloohen këto tinguj.

Fonemat /r/ dhe /rr/ shfaqën dallime të dukshme rajonale dhe sipas moshës. Në qytetet më tradicionale, si Berati, përdorimi i fonemës /r/ mbizotëronte, ndërsa fonema /rr/ shfaqej kryesisht tek të ardhurit. Në qytete më urbane dhe heterogjene, si Tirana, dominonte përdorimi i fonemës /rr/ tek të gjitha grupmoshat, duke treguar një orientim më të fortë drejt standardit gjuhësor. Në qytetin e Vlorës, përkundrazi, shfaqej një tendencë të kundërt: banorët e rinj përdornin fonemën /rr/ më shumë, edhe në pozicione ku standardi sugjeron /r/, duke treguar ndikime të ndryshme të arealit dhe praktikave lokale të të folurit.

Analiza sipas gjinisë tregoi se femrat janë më të ndjeshme ndaj normave të të folurit dhe mund të shmangin përdorimin e fonemës /rr/ për të përshtatur shqiptimin me standardin, veçanërisht në grupmoshat e reja. Meshkujt, nga ana tjetër, ruajnë përdorimin tradicional të fonemës /rr/, pavarësisht moshës, duke treguar një qëndrueshmëri më të madhe të praktikave fonetike tradicionale.

Të dhënat krahasuese nga vitet 2013 dhe 2023 treguan ndryshime të dukshme me kalimin e kohës. Në qytete si Korça dhe Tirana, u vu re një rritje e përdorimit të fonemës /rr/, ndërsa në qytete si Berati, përdorimi i /r/ mbeti i dominueshëm. Këto ndryshime pasqyrojnë trende sociokulturore më të gjera, përfshirë lëvizshmërinë e popullsisë, ekspozimin ndaj dialekteve të ndryshme, urbanizimin dhe ndikimin e medias në standardizimin e gjuhës.

Përdorimi i fjalëve me kontekste natyrore, si “birrë” dhe “arrë”, në vende simbolike dhe mjedise kulturore të përditshme (tregje, ura historike, rrugë të njohura), ndihmoi në evidentimin e praktikave reale të të folurit. Kjo qasje tregoi se vendndodhja dhe konteksti social ndikojnë në mënyrë të dukshme në përdorimin e fonemave, dhe se ndërveprimet midis banorëve vendas dhe të ardhurve krijojnë modele të ndryshme artikulimi.

Në përfundim, gjetjet tregojnë se përdorimi i fonemave /r/ dhe /rr/ evoluon gradualisht nën ndikimin e moshës, gjinisë, origjinës dhe urbanizimit. Femrat e reja tregojnë një ndjeshmëri më të madhe ndaj normave të standardit, ndërsa meshkujt ruajnë praktikatat tradicionale. Ndryshimet krahasuese midis 2013 dhe 2023 pasqyrojnë adaptime sociokulturore dhe tendenca më të gjera në zhvillimin fonetik të shqipes në qytete me struktura dhe histori të ndryshme sociale.

## PËRFUNDIME

Ky studim nxjerr në pah ndërveprimin dinamik midis praktikave të të folurit të përditshëm dhe faktorëve socialë, si migrimi i brendshëm, urbanizimi dhe ndryshimi i brezave. Analiza e përdorimit të fonemave /r/ dhe /rr/ në qytete të ndryshme të Shqipërisë (Korçë, Berat, Vlorë dhe Tiranë), tregon se shqiptimi nuk është i njëtrajtshëm, por formohet nga një kombinim i ndikimeve rajonale, demografike dhe gjinore.

Rezultatet kryesore tregojnë se:

- Përdorimi i /r/ dhe /rr/ pasqyron dallime të qarta rajonale dhe sipas moshës, ku brezat e rinj dhe të ardhurit janë më të ndjeshëm ndaj normave të standardit, ndërsa banorët më të vjetër ruajnë praktikatat tradicionale.
- Migrimi i brendshëm dhe pranimi i të ardhurve kanë sjellë një diversitet gjuhësor që sfidon modelet tradicionale të shqiptimit dhe krijon variacione të reja të fonemave.
- Të dhënat krahasuese midis viteve 2013 dhe 2023 tregojnë një zhvendosje graduale drejt përdorimit më të shpeshtë të fonemës /rr/, një reflektim i lëvizshmërisë sociale, ekspozimit ndaj dialekteve të ndryshme dhe ndikimeve të medias dhe urbanizimit.
- Këto gjetje theksojnë se gjuhësia shqiptare është një sistem i gjallë, i ndikuar nga faktorë socialë dhe kulturorë, dhe ndryshimet fonetike nuk duhet të konsiderohen thjesht si devijime, por si pasqyrë e evolucionit të të folurit në kohë dhe hapësirë.

## REKOMANDIME

Bazuar në rezultatet e këtij studimi, sugjerohen disa drejtime për hulumtime të mëtejshme dhe aplikime praktike:

- Studimet e ardhshme duhet të përfshijnë qytete dhe zona të tjera, si dhe grupe të ndryshme socio-ekonomike, për të ofruar një pamje më të gjerë dhe më të thelluar të variacioneve gjuhësore në Shqipëri.
- Analiza fonetike mund të përmirësohet duke përdorur softuerë të avancuar për matje të sakta të tingullit, duke rritur besueshmërinë e të dhënave dhe duke kaluar përtej vetëm dëgjimit subjektiv.
- Studimet e mëtejshme duhet të shqyrtojnë ndikimin e medias, arsimit dhe globalizimit në standardizimin e gjuhës dhe në përdorimin e fonemave të veçanta, për të kuptuar më mirë mekanizmat e përhapjes së normave gjuhësore.
- Kryerja e hulumtimeve periodike do të lejojë gjurmimin e

ndryshimeve të vazhdueshme gjuhësore, duke ofruar njohuri të vlefshme për edukatorët, mësuesit e gjuhës shqipe dhe politikëbërësit në fushën e kulturës dhe arsimit.

## REFERENCA

- Agalliu, F., Memushaj, R., & Reso, M. (1989). *Hyrje në gjuhësi*. Tiranë.
- Berruto, G. (1995). *Fondamenti di sociolinguistica*. Bari, Laterza.
- Beci, B. (2016). *Struktura dialektore e shqipes: Një qasje e re* (Monografi). Tiranë.
- Drejtshkrimi i gjuhës shqipe. (1973). Tiranë.
- Gjinari, J. (1988). *Dialektologjia shqiptare*. Tiranë.
- Gjinari, J. (1989). *Të folmet e gjuhës shqipe*. Tiranë.
- Hudson, R. (2002). *Sociolinguistics*. Tiranë.
- Klosi, D., Hajnaj, L., & Çelo, E. (2015). *Relation of Albanian standard language to dialects, sociolects, idiolects: The linguistic situation at the University of Vlora. Academic Journal of Interdisciplinary Studies*.
- Labov, W. (1966). *The Social Stratification of English in New York City*. Washington, DC: Center for Applied Linguistics.
- Labov, W. (1972a). *The design of a sociolinguistic research project*. Report of the Sociolinguistics Workshop, Central Institute of Indian Languages.
- Labov, W. (1972b). *Language in the inner city*. Philadelphia, PA: University of Pennsylvania Press.
- Labov, W. (1984). *Field methods of the project on linguistic change and variation* (Sociolinguistic Working Paper No. 81). Southwest Educational Development Laboratory.
- Varvaro, A. (1978). *La lingua e la società*. Napoli.

## SOCIOLINGUISTIC STUDY OF R AND RR, VARIABILITY IN ALBANIAN URBAN SPEECH (2013-2023)

### *ABSTRACT*

This study examines the pronunciation and usage of the trill phonemes /r/ and /rr/ in everyday Albanian during the period 2013–2023. Although these two phonemes are distinguished by a physiological feature, high subglottal pressure, they are frequently alternated in conversational speech, giving rise to noticeable linguistic variability (Agalliu, Memushaj, & Reso, 1989; Berruto, 1995). The research focuses on their use in several urban centers, primarily in southern Albanian cities such as Korça, Berat, and Vlora, as well as in the capital city, Tirana (Gjinari, 1988, 1989; Beci, 2016).

In accordance with the principles of urban dialectology, data were collected through interviews using a questionnaire that included words containing /r/ in different word-internal positions (e.g., *birra*, *arra*, *rrapi*) (Hudson, 2002; Klosi, Hajnaj, & Çelo, 2015). The questionnaire also gathered demographic information such as age, education, gender, and profession, ensuring a balanced representation of participants. Responses were carefully recorded and subjected to phonetic analysis (Labov, 1966, 1972a, 1972b, 1984).

The comparative analysis is grounded in Labov's methodological framework (1966, 1972a, 1972b, 1984) and is placed in parallel with studies on rhotic consonants in Italian dialects as described by Varvaro (1978).

The findings indicate that /r/ and /rr/ do not always function as distinct phonemes in spoken Albanian. Substitution patterns reveal both dialectal and social variation. In particular, in southern cities such as Korça and Berat, the phoneme /rr/ is largely absent from popular speech, in line with Gjinari's (1988) classification, which identifies these areas as distinct dialectal zones.

This study contributes to Albanian sociolinguistics by analyzing real-life phonemic variation in conversational contexts and by critically discussing assumptions regarding the strict distinction between /r/ and /rr/ in Standard Albanian (Orthography of the Albanian Language, 1973).

**Keywords:** Albanian language, vibrational phonemes, sociolinguistics, dialectal variation, everyday speech.

Sejdi M. GASHI

## LEKSIKU I JURISPRUDENCËS NË DISA MEDIE TË KOSOVËS DHE TË SHQIPËRISË

### Hyrje

Gjuha e medias, apo diskursi mediatik, përfshin dy elemente thelbësore: lajmin (tekstin e folur apo të shkruar) dhe procesin për prodhimin e këtyre teksteve. Dimensioni i parë, ai i tekstit, ka qenë qëllimi parësor i studiuësve të gjuhës së medie, veçanërisht për faktin se teksti kodon vlera dhe ideologji që ndikojnë gjerësisht te njerëzit dhe i reflekton ata. Ndërsa, dimensionin e dytë, ai i procesit të prodhimit të teksteve, që përfshin normat dhe shprehjet e lajmshkruesve, ka qenë në qendër të kërkuesve shkencorë, por për këtë çështje ende nuk janë realizuar mjaftueshëm vepra studimore.

Thënë përgjithësisht, studimi *Leksiku i jurisprudencës në disa medie të Kosovës dhe të Shqipërisë* synon të analizojë gjuhën e medie, duke u fokusuar më së shumti te leksiku i jurisprudencës, pra vështruar sipas një qasjeje sociolinguistike. Hulumtimi është përqendruar kryesisht në mediet e shkruara në Kosovë dhe në Shqipëri. Këtë përzgjedhje e përligjim me faktin se për analizën dhe hulumtimin e leksikut teksteve të shkruara janë më të favorshme, po ashtu edhe për faktin se, marrë parasysh natyrën e këtij studimi, është më i saktë dhe më praktik identifikimi i termave në teksteve të shkruara. Nga mediet në Shqipëri, janë hulumtuar, analizuar, si dhe është shkëputur material gjuhësor (përkatësisht fjalë terma) prej teksteve të ndryshme, të botuara në ato gazeta që vijojnë ende të botohen edhe në variantin e shtypur, konkretisht nga gazetat: “Dita”, “Gazeta shqiptare”, “Sot”, “Telegraf”, “Fjala”, “Liberale”, “Panorama” etj. Në disa raste, materiali gjuhësor është marrë edhe nga portalet mediatike me përmbajtje më cilësore lajmesh, si “Newsbomb”, “Arberianews.net”, “Shtypi.net”, “Balkanweb”, “Shqip”, “Faxnews”, “Reporter.al” etj. Pra, qëllimshëm jemi përcaktuar për këtë përzgjedhje mediesh për të shmangur lajmet e shkruara nga medie joserioze e pa përvojë, çka do të ndikonte edhe në cilësinë e këtij vëzhgimi. Ndërkaq, mediet e Kosovës, nga të cilat kemi vjelë material, janë: “Koha.net”; “dukagjini.com”; “televizioni7.com”; “kanal10.live”; “insajderi.com”; “kallxo.com”; “zeri.info”; “gazetaexpress.com”; “telegrafi.com”; “tëvël.info”; “rtlive.com”; “botasot.info”.

Hulumtimi i fjalëve terma është realizuar nëpërmjet vjeljes së tyre të drejtpërdrejtë. Korpuset e medie të Kosovës dhe të Shqipërisë janë krijuar si korpuse rasti, me material që përfshijnë një periudhë tetëvjeçare,

përkatësisht vitet 2015-2023. Artikujt janë përzgjedhur në mënyrë të rastësishme, ku fillimisht janë nxjerrë nga konteksti fjalët terma dhe më pas është bërë klasifikimi i tyre sipas fushës përkatëse.

### Roli i gjuhës në jurisprudencë

Ligji funksionon përmes gjuhës e gjuha është fillesa e të gjitha ligjeve. Çfarëdo mesazhi që ligji supozohet t'u komunikojë qytetarëve të caktuar, duhet të tejçohet përmes gjuhës. Para së gjithash, çdo veprim që buron nga zbatimi i ligjit duhet të programohet dhe përcaktohet përmes gjuhës. Dhe duke qenë se ligjet duhet të formulohen përpara se të ndodhë një veprim, procesi i ligjbërjes shënon fillimin e të gjithave dhe gjuha qëndron në thelb të këtij aktiviteti<sup>1</sup>. Para se të kalojmë në analizën e termave juridikë, fillimisht do të shpjegojmë termat *juridik*, *e drejtë*, *ligj*, *kod*.

Në të gjithë fjalorët shpjegues kuptimet e termit *juridik* jepen kryesisht nëpërmjet këtyre shpjegimeve: “Që lidhet me normat dhe ligjet e së drejtës, që lidhet me drejtësinë dhe me të drejtën”<sup>2</sup>; “1. Që bëhet, ushtrohet në drejtësi ose përpara drejtësisë. 2. Që ka lidhje me të drejtën, që prodhon efekte që lidhen me të drejtën”. I pari sinonim që renditet në këta fjalorë dhe që, siç del nga përkufizimi, shërben si referencë kryesore për këtë përcaktor të shprehur me mbiemër, është termi “e drejtë”. *E drejta* është një sistem rregullash dhe zgjidhjesh që organizojnë shoqërinë në emër të disa vlerave shoqërore, duke synuar drejtësinë sociale ose sigurinë e shoqërisë. E drejta korrespondon me tërësinë e rregullave shoqërore që drejtojnë raportet e njerëzve ndërmjet tyre ose me pushtetin, sjelljen e burrave dhe të grave në një shoqëri, raportet shoqërore. Në kuptimin e gjerë, *një ligj* është një dispozitë normative që vendos një rregull juridike për aplikim të detyrueshëm

*Një kod* paraqitet si një tërësi dispozitash normative, të bashkuara në një vepër, të cilat paraqesin një vijimësi logjike të librave, titujve, kapitujve, seksioneve, ndonjëherë edhe nënseksioneve, paragrafëve dhe në fund neneve. Kodet përmbajnë ekskluzivisht tekste të ligjeve ose të rregulloreve që kanë një përmbajtje zyrtare. Tekstet speciale, tekstet e shfuqizuara, komentaret, bibliografitë, referencat ndaj doktrinave dhe ndaj jurisprudencës që botuesit fusin në tekst ose në vijim të neneve të kodeve, nuk kanë fuqinë e ligjit.

<sup>1</sup> F. Vogel (red), *Legal Linguistics Beyond Borders: Language and Law in a World of Media, Globalisation and Social Conflicts.: Relaunching the International Language and Law Association (ILLA)*, Duncker & Humblot GmbH, 2019, f. 255-322.

<sup>2</sup> Grup autorësh, *Fjalor i gjuhës shqipe*, AShSh, IGJL, Tiranë, 2006, f. 423.

Ligjet janë të shkruara sipas një stili të veçantë, që është specifik për këtë sferë të veprimtarisë njerëzore. Ndërmjet stileve funksionale të klasifikuara mbi bazën e kriterit të funksionit dhe të sferave të përdorimit në veprimtaritë e ndryshme njerëzore, si stili i letërsisë artistike, stili politiko-shoqëror, stili fetar, stili shkencor-teknik dhe juridik-administrativ zënë një vend të veçantë<sup>3</sup>.

Sasia mbizotëruese e leksikut dhe sasia e kufizuar e tij në përbërje të stileve mund të krijonte një kundërvënie mbi një bazë më të gjerë në gjuhë për t'i rigrupuar stilet dhe për të veçuar kështu dy pjesë përbërëse kryesore në gjuhën shqipe: a) ligjërimin e përgjithshëm, i cili ka në bazë stilin e letërsisë artistike dhe pjesërisht stilin politiko-shoqëror dhe atë fetar me pjesët me përdorim të mjeteve shprehëse me karakter ndikues (politik) dhe sugjestiv (fetar); b) ligjërimi i specializuar që bashkon dy stilet me karakter të mirëfilltë special, stilin shkencor-teknik dhe atë juridik-administrativ<sup>4</sup>. Identifikimi i një terminologjie si sistem i veçantë mund të bëhet i plotë vetëm kur shihet në rrafshin e funksionimit të termave që e përbëjnë atë si shënues të koncepteve të një fushe të veçantë të dijes. Në varësi nga një tematikë e përbashkët në një fragment ligjërimor, mund të veçohet një grup termash, të cilët në tërësinë e tyre mund të përcaktojnë vlerën stilistike të fragmentit ligjërimor në fjalë<sup>5</sup>. Studiuesi Xh. Lloshi stilin juridik e përfshin si nënstil në stilin e veprimtarisë shtetërore e administrative, ku si kategori teksti përfshihen tekstet ligjore dhe kushtetuta<sup>6</sup>.

Ligjërata shtetërore është një ligjëratë imponuese, pavetore. Funksioni stilistik i ligjërimin të këtyre teksteve është kumtues dhe parashkruar, duke e bërë të detyrueshëm zbatimin e tyre. Tekstet ligjore shkruhen duke u kujdesur më shumë që të mos keqkuptohen, sesa që të kuptohen,- thotë studiuesi Xh. Lloshi.

Sfida kryesore e gjuhëtarëve, terminologëve, si dhe specialistëve të fushës ka të bëjë pikërisht me kuptimin e një ligji, teksti i të cilit hartohet dhe u drejtohet të gjithë njerëzve të një shteti të caktuar. Qartësia gjuhësore, e sidomos ajo terminologjike, lehtëson kuptimin, prandaj funksioni imponues dhe detyrues i tij del në pah më mirë duke u njohur dhe u zbatuar në masë. Gjuha e ligjeve, nuk është aq e thjeshtë për t'u kuptuar nga të gjithë dhe vështirësia e të kuptuarit shtohet edhe më tepër kur tekstet juridike përkthehen.

<sup>3</sup> A. Duro, *Terminologjia në ligjërimin e specializuar*, Studime Filologjike, 1997, f. 72.

<sup>4</sup> Po aty.

<sup>5</sup> Po aty.

<sup>6</sup> Xh. Lloshi, *Stilistika dhe pragmatika*, Tiranë, 1999.

Le të shohim se cilat janë tiparet e leksikut të jurisprudencës në mediet e Kosovës e të Shqipërisë!

Në periudhën e pasluftës në Kosovë pati një zhvillim të hovshëm të legjislacionit. Kalimi nga njëri sistem në sistemin tjetër të qeverisjes, me ligje që hartoheshin aty për aty, me akte ligjore e rregullore, çoi në përdorimin e gabuar të shumë termave juridikë. Kjo erdhi edhe si rezultat i mungesës së seriozitetit të hartuesve të këtyre ligjeve, rregullave etj., përkthimin e gabuar apo mospërshtatjen e duhur të termit nga gjuha e huaj në shqipe etj. (kryesisht nga anglishtja në shqipe), si dhe “moszotërimi i mjaftueshëm i rregullave të terminologjisë profesionale, mosnjohja e duhur e gjuhës shqipe dhe e gjuhës angleze gjatë përkthimit të materialeve nga fushat e shumta të dijes krijojnë një varg termash juridikë të panevojshëm dhe jo përkatës për gjuhën tonë. Mungesa e normëzimit terminologjik dhe e fjalorëve profesionalë përkatës gjithëpërfshirës bënë që të krijohen anglicizma dhe neologjizma të panevojshëm në shqipe”<sup>7</sup>.

Në Kosovë, termat juridikë janë kryesisht huazime, ashtu siç janë në shumicën e gjuhëve evropiane, prandaj është i domosdoshëm një qëndrim korrekt ndaj termave. Të përkthehen a përshtaten kur shqipja i ka mjetet dhe të lihen siç vijnë nga gjuha hyrëse kur shqipja s’ka një gjegjëse të kënaqshme. Çështja e termave nga fushat e dijes apo veprimtarisë njerëzore duhet t’i lihet gjithnjë në dorë profesionistit. Megjithatë, gjatë periudhës së pasluftës në Kosovë, me gjithë përpjekjet e bëra në hartimin e fjalorëve terminologjikë për jurisprudencë nga disa autorë, që kryesisht janë bazuar në forca të veta, siç është *Fjalor i termave të drejtësisë*, i autorit Sylë Kasumaj<sup>8</sup> e ndonjë tjetër, janë bërë edhe disa përpjekje institucionale për hartimin e një glosari të legjislacionit me bashkëpunim profesionistësh të udhëhequr nga OSBE-ja (Organizata për Siguri e Bashkëpunim Evropian)<sup>9</sup>. Këto mangësi do të pasqyrohen padyshim edhe në medie.

Ashtu si terminologjia e fushave të tjera të dijes, edhe terminologjia e jurisprudencës paraqet të njëjtat probleme. Gazetarët, në shumicën e rasteve nuk i përkthejnë apo përshtatin termat edhe kur e kemi një gjegjëse në shqipe. Po ashtu, duke qenë se lajmet nëpër portalet mediatike hartohen e publikohen shumë shpejt, gazetarët nuk ia kushtojnë gjuhës kohën e mjaftueshme. Po sjellim një shembull nga portali mediatik “Bota sot”: *Ky i*

<sup>7</sup> Sh. Hoxha, A. Caka, A. Raça-Shala, *Terminologjia juridike anglisht -shqip në legjislacionin e Kosovës në periudhën 1999-2009*, f. 1-12.

<sup>8</sup> S. Kasumaj, *Fjalor i termave të drejtësisë*, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2019. (Ky fjalor terminologjik është vlerësuar si njëri ndër fjalorët më të mirë që është botuar në Kosovë gjatë viteve të fundit).

<sup>9</sup> Po aty.

*fundit, para disa ditësh, ka shkruar se Tribunali Special për Kosovën ka lëshuar aktakuzën e tij Hashim Thaçi dhe tre ish.-udhëheqës të tjerë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, por nuk ka asnjë shenjë të trafikimit të organeve të marra nga të burgosurit serbë, gjë që ishte një turp i organizuar nga shërbimet sekrete serbe dhe ruse...*

“... deklarata e z. S. Metais është e natyrës letrare, beletristike e filozofike e lansuar si një flokule voluntaristë, e cila nuk do të mund të reflektohej në rrafshin politik e juridik aktual. Së andejmi deklarata e tillë mbetet shprehje e një opinionit qëllim mirë dhe për aq mbetet një opinion publik dhe asgjë tjetër”, theksoi Smaka... (të vihet re përdorimi i fjalëve të huaja të panevojshme, si: *beletristike, e lansuar, flokule voluntaristë*) ...“Kolegjet prokuroriale e gjyqësore të specializuara janë themeluar nga Kuvendi i RK-së, me mbështetje implicite nga komponentë ndërkombëtare ndaj *abrogimi* i të cilave do të mund të bëhej në procedurë të njëjtë, e cila tejet vështirë do të mund të realizohej”, nënvizoi Smaka (“Bota sot”, 9 dhjetor 2020).

Nga shembujt e mësipërm, duket qartë se gazetari nuk i ka kushtuar aspak vëmendje gjuhës së përdorur në shkrimin e lajmit. E njëjta situatë haset edhe në mediet në Shqipëri.

Siç dihet, terminologjia na vjen në ndihmë për të shprehur qartë koncepte të caktuara. Një tipar i rëndësishëm i gjuhës së sferës juridike është mungesa e ambiguitetit (dykuptimësisë), që do të thotë se një ligj s’mund të hartohet në mënyrë të atillë që të ketë më shumë se një interpretim. Eliminimi i ambiguitetit, shpesh kërkon forma më të shtjelluara të shprehjes në krahasim me ato që përdoren rëndom në fjalimet e zakonshme ose në gjuhën e përditshme, ndërkohë që legjislacioni duhet të shprehet me një gjuhë më të përgjithësuar dhe me natyrë shumë më abstrakte. Ligjet duhet të sqarojnë sa më saktësisht dhe me një gjuhë të përgjithshme atë që është e sanksionuar, prandaj dhe terminologjia duhet të zgjidhet me kujdes që të shmangen keqkuptimet dhe interpretimet e shumëfishta. Kjo kërkon që e njëjta fjalë përgjatë gjithë tekstit juridik duhet të ketë po atë kuptim. Po ashtu, fjalët e përdorura në hartimin e ligjeve nuk mund të jenë polisemantike. Termat e kanë këtë tipar, pra, monosemantizmin. Kjo gjë e bën tekstin juridik të jetë i saktë, i zbatueshëm dhe i kuptueshëm.

Sa më i kuptueshëm të jetë ligji, aq më i saktë do të jetë interpretimi që i bëhet atij. Dhe sa më i saktë të jetë interpretimi, aq më i drejtë do të jetë vendimi kundrejt një çështjeje të caktuar. Megjithatë, jo në të gjitha rastet ndodh që tekstet juridike të jenë kaq të qarta. Më tej, edhe media si hapësira ku përpunohet e përcillet informacioni, tekstet gazetareske do t’i ketë të

tejm bushura me fjalë e terma që nuk kuptohen nga publiku i paspecializuar. Në mediet në Shqipëri hasim shpesh lajme nga fusha e drejtësisë që përmbajnë shprehje ligjore të tejzgjatura; mospërdorim i standardit të gjuhës etj. Ja një rast nga “Gazeta shqiptare” : *“Ministria e Drejtësisë u përfshi dje dhe sot në një furtunë shkarkimesh dhe arrestimesh, por vetë ministrja Etilda Gjonaj nuk ishte në detyrë. Ajo ia kishte deleguar që më parë kompetencat zëvendësministres, Teuta Vodo. Urdhri i delegimit është publikuar në Fletoren Zyrtare dhe nëpërmjet tij ministrja Gjonaj i ka deleguar Teuta Vodos të gjithë kompetencat e titullarit të kësaj ministrie, për vetëm 24 orë. Një rast i rrallë ky ku një ministre i delegon kompetencat e titullarit të ministrisë zëvendësues së tij vetëm për 1 ditë”* (“Gazeta shqiptare”, 6 shkurt 2019).

Më poshtë po paraqesim një shembull tjetër:

*“Me delegimin e kompetencave, përveç reagimeve politike mbi lëvizjen e Ramës, po diskutohet edhe pjesa procedurale, për shkak se disa konstitucionalistë gjykojnë se kryeministri “shkeli betimin Kushtetues”, pasi u betua edhe si ministër, ndërsa menjëherë ia kaloi kompetencat zëvendësministrit. I pyetur mbi “delegimin e kompetencave”, Presidenti Ilir Meta reagoi në mënyrë të përmbajtur, teksa përmendi kushtetutën dhe nga ana procedurale e kishte të pamundur të mbante qëndrim për zgjedhjen e Ramës. “Presidenti nuk ndërhyr dhe nuk komenton për aktet e organizimit të brendshëm të ekzekutivit apo të ministrive. Unë si President i Republikës respektoj Kushtetutën dhe i kam shumë të qarta kompetencat e mia se cilit institucion mund t’i delegojë autoritetin kushtetues për të lidhur marrëveshjet ndërkombëtare në emër të Republikës së Shqipërisë”-deklaroi presidenti Meta”* (“Gazeta Mapo”, 24 janar 2019).

Është e qartë që tekstet e mësipërme i drejtohen publikut të gjerë dhe një jospécialist e ka të vështirë të kuptojë terminologjinë e përdorur në këto tekste dhe si rrjedhojë nuk arrin të informohet për atë çka nënkupton shkruesi. Po t’i hedhim një sy Kodit të Procedurës Civile, do të shohim se ai nuk u drejtohet joprofesionistëve. Gjuha e tij nuk kuptohet lehtë, pasi shumë fjali janë të ngatërruara, janë bërë shumë referime të ndërlikuara dhe termat teknike nuk janë vetëshpjegues. Kjo çon pastaj në vështirësi për zbatimin e ligjit, duke qenë se termat janë të paqartë dhe të hapur për interpretime të ndryshme.

Më poshtë gjendet një listë me disa nga termat më të përdorur në fushën e jurisprudencës në mediet e marra në analizë, së bashku me shpjegimin e tyre.

**Abrogim-** Veprim formal i shfuqizimit të një ligji, akti juridik, ose dispozite tjetër ligjore.

**Akt nënligjor** - Vendim, rregullore, udhëzim i nxjerrë nga organet ekzekutive ose organet lokale për zbatim të ligjit, që karakterizohet normativ dhe është i detyrueshëm për të gjithë.

**Akt normativ** – 1. Akt i nxjerrë nga organet ligjvënëse, ekzekutive ose lokale që është i detyrueshëm për të gjithë. 2. Akt normativ i Këshillit të Ministrave, institucioneve të tjera qendrore ose organeve lokale - Akt i miratuar nga Këshilli i Ministrave, institucionet e tjera qendrore ose organet lokale, në rast nevojë dhe urgjence, i cili e humb fuqinë që nga fillimi në rast se nuk ratifikohet nga Kuvendi brenda një afati të caktuar kohor.

**Aktgjykim detyrues**- Vendim gjyqësor që është i detyrueshëm për t'u zbatuar nga gjykatat e tjera në të ardhmen, si një precedent ligjor.

**Aktgjykim dënues**- Vendim gjyqësor dënues; vendim sipas të cilit refuzohet kërkesa e një personi, organizate, ose pale tjetër në një proces gjyqësor.

**Akuzues (organ)**-Pala që ngre akuzën para organit gjyqësor.

**Aleat** - Ai që lidhet e bashkërendon veprimet me një tjetër për qëllime të njëjta; përkrahës aktiv i dikujt. Aleat besnik (i ngushtë).

**Alimentacion**- Kontribut financiar i caktuar nga gjykata që një person është i detyruar ta paguajë për t'u siguruar që një person tjetër, zakonisht një fëmijë, të ketë të plotësuar nevojat bazë të jetesës.

**Amnisti** - Akt faljeje i nxjerrë nga Presidenti i Republikës për të gjithë personat (ose kategori të caktuara personash) që janë dënuar për vepra penale me vendim gjyqësor të formës së prerë, ose që janë në procedim.

**Ankesë**- Shprehje formale e pakënaqësisë ose mosmiratimit në lidhje me një vendim gjyqësor, ndaj një veprimi të institucioneve të zbatimit të ligjit, ose një situatë tjetër ligjore.

**Antikushtetues**- Kundërkushtetues, vendim ose akt juridik që është në kundërshtim me kushtetutën, që shkelë parimet kushtetuese.

**Apelim**-Të drejtuarit një gjykate më të lartë për të rishikuar vendimin e dhënë nga një gjykatë më e ulët; Ankimim.

**Arsyetim vendimi**-Pjesë e një vendimi gjyqësor ku gjykatat përcaktojnë dhe shpjegojnë bazën dhe arsyet juridike për vendimin e tyre.

**Arrestuar (i, e)**- Personi i cili me vendim të organit kompetent (gjykatës ose policisë) është privuar nga liria.

**Autopsi**- Procedurë mjekësore që realizohet në trupin e një të vdekuri për të zbuluar arsyet e vdekjes ose për të bërë vlerësime të tjera mjekësore.

**Balotazh**- Proces i votimit shtesë kur në votimin e parë asnjëri nga kandidatët nuk merr shumicën e votave të nevojshme për të fituar.

**Bandit**- Person ose grup personash që vepron në kundërshtim me

ligjin, duke u përfshirë në aktivitete kriminale.

**Barazi para ligjit-** Koncept juridik dhe moral që përcakton se çdo individ dhe organizatë duhet të trajtohet me të njëjtin respekt; duhen të kenë të drejtat dhe përgjegjësitë e njëjta para ligjit, pa dallim dhe diskriminim në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, orientimit seksual, besimit, kulturës, ose çdo karakteristikë tjetër personale.

**Bartje e kontratës-** Proces ligjor ku një person ose një kompani i bartë (transferon) të drejtat dhe detyrimet e një kontrate të nënshkruar në tërësi ose në pjesë tek një person tjetër.

**Bastisje-** Veprim i autorizuar nga gjykata kompetente që përfshin kërkimin dhe inspektimin e një vendi, një objekti, apo një personi për të zbuluar dhe siguruar prova të mundshme për një proces gjyqësor.

**Bashkëfajtor-** Person që bashkëpunon me një person tjetër në kryerjen e një vepre penale, që përfshin pjesëmarrjen aktive ose ndihmën në planifikimin, organizimin, ose kryerjen e një veprimi kriminal.

**Burim detyrimi-** Fakte juridike prej të cilave krijohen detyrimet.

**Cenim i përhershëm-** Shkelje në mënyrë të vazhdueshme e një diçkaje ose e një të drejte nga një person i caktuar.

**Cenim-** Veprim me të cilin shkelen interesat ose gjërat e dikujt, shkel diçka që është e paprekshme për dikë, prek diçka a dikë për t'i shkaktuar dëm.

**Çështje e gjykuar-** Rast që është shqyrtuar më parë, për të cilin është nxjerrë vendim nga një gjykatë apo një autoritet tjetër ligjor.

**Çështje juridike-** Situatë, mosmarrëveshje, ose problem që ka të bëjë me aplikimin, interpretimin, ose zbatimin e ligjit.

**Daktiloskopi-** Degë e shkencës së kriminalistikës që ka të bëjë me identifikimin e individëve përmes analizës dhe krahasimit të figurës së vijave papilare në lëkurën e gishtërinjve të duarve, shuplakave dhe të shputave të njeriut.

**Delikuencë-** Veprim a sjellje që shkelë ligjet ose normat shoqërore.

**Dosje kriminale-** Dosje zyrtare ose lëndë në të cilën janë të shënuara të dhëna mbi krimet e kryera dhe kryerësit e tyre.

**Dosje penale-** Të gjitha shkresat e lëndës që lidhën me veprën penale dhe me kryerësin e saj.

**Dyshim i arsyeshëm-** Njohuri për informacionin që do ta bindte një vëzhgues objektiv se një vepër penale ka ndodhur.

**Dyshim i bazuar-** Shkallë e lartë e besueshmërisë që një person ka kryer vepër penale.

**Dhënie e aktgjykimit-** Marrje vendimi; të gjitha veprimet gjyqësore që kryhen që nga momenti kur fillon këshillimi dhe votimi e deri në

momentin kur aktgjykimi bëhet akt juridik.

**E drejta e jetës-** E drejtë themelore e njeriut e garantuar në një varg instrumentesh ndërkombëtare.

**Ekshumim-** Zhvarrosje e kufomës me qëllim kontrolli dhe autopsie (obduksioni), kur ka dyshime se vdekja është pasojë e një akti kriminal.

**Fajde-**Vepër penale kundër pasurisë, e paraparë me dënim në Kodin Penal, që nënkupton pranimin ose kontraktimin për vete apo për personin tjetër një sasi dukshëm jo proporcionale të pasurisë në këmbim të shërbimit për personin tjetër, duke shfrytëzuar gjendjen e rëndë financiare të personit të tillë, gjendjen e rëndë të banimit, varfërisë, papërvojën ose paaftësinë për të gjykuar drejt.

**Falsifikim-**Vepër penale kundër rendit publik dhe veprimeve juridike; krijimi ose prodhimi i paligjshëm i dokumentit, ndryshimi ose përdorimi i dokumentit të falsifikuar; ndryshimi i dokumentit të vërtetë.

**Falsifikues-**Personi i cili kryen vepër penale të falsifikimit, personi që përpilon, ndryshon një dokument ose e përdor dokumentin e falsifikuar me qëllim përfitimi material.

**Gazetë zyrtare** - Botim periodik që është autorizuar të publikojë njoftime publike ose ligjore.

**Gubernur** - Zyrtari më i lartë, që drejton e qeveris një provincë a një departament në disa shtete kapitaliste ose një shtet të veçantë në një federatë shtetesh kapitaliste; zyrtari më i lartë që përfaqëson shtetin sundues e që qeveris në një koloni.

**Gjykatë Kushtetuese** - Gjykata më e lartë në vend kur bëhet fjalë për interpretimin, mbrojtjen dhe zbatimin e kushtetutës.

**Inspektorat** - Organ shtetëror i ngarkuar të shohë punën e ndërmarreve a të institucioneve të caktuara, organ që kontrollon, që jep udhëzime për diçka a që merret me zgjidhjen e diçkaje; zyra e ndërtesa e këtij organi. Inspektorati shtetëror (rrugor, shëndetësor). Inspektorati i sigurimit teknik (i mbrojtjes, i farërave, i futbollit). Inspektoratet e punës. Punonjësit e inspektoratit.

**Institucion** - Organizëm shtetëror a shoqëror, që e zhvillon veprimtarinë e vet në një fushë të caktuar të ekonomisë, të shkencës, të arsimit, të kulturës, të jetës shoqërore, politike etj. Institucion shtetëror (shkencor, parashkollor, shëndetësor, artistik, shoqëror). Institucion ideologjik (politik, ushtarak). Institucion fetar. Institucionet qendrore.

**Kod penal** - Dokument që përmbledh të gjitha, ose një sasi të konsiderueshme të ligjit penal të një juridiksioni të caktuar.

**Kufi ligjor** - Kufizim në madhësinë ose sasinë e diçkaje të lejueshme ose të mundshme.

**Kushtetutë** - Ligji themelor i një shteti, që përcakton rendin politik dhe ekonomik e shoqëror të tij, sistemin e zgjedhjeve, organet e larta dhe lokale të pushtetit shtetëror e të administratës shtetërore, organizimin e mbrojtjes së vendit e të forcave të armatosura, të gjykatave e të prokurorisë si edhe të drejtat e detyrat themelore të shtetasve.

**Ligj** - Normë, rregull që vendoset nga organi më i lartë i pushtetit shtetëror dhe që është e detyrueshme për të gjitha organet shtetërore dhe për të gjithë shtetasit.

**Mbrojtje sociale** - Politika dhe programe të dizajnuara për të mbrojtur njerëzit nga goditjet dhe streset gjatë gjithë jetës së tyre.

**Ndjekje penale** - Akti ose procesi i mbajtjes së një gjykimi kundër një personi që akuzohet për një krim për të parë nëse ai person është fajtor.

**Pandehur (i,e)** - Ai që nxirret përpara gjyqit për faje e veprime të kundërligjshme. **Paraburgim** - Koha nga dita e ndalimit të dikujt që dyshohet për një faj a krim deri kur jepet vendimi nga ana e gjykatës.

### Përfundime

Mediet në Kosovë, ashtu si edhe ato në Shqipëri, përdorin pak a shumë terma të njëjtë që i përkasin fushës së jurisprudencës, që në shumicën e rasteve janë të huazuara nga latinishtja dhe gjuhë të tjera, pra dalin të papërpunuar (të përkthyer ose të përshtatur).

Terminologjia e huaj ka vërshuar në masë të madhe, sidomos në fushat e dijes, ku kuptimet leksikore janë prurje të reja bashkë me elementet që ato emërtojnë. Sot edhe gjuha e jurisprudencës është bërë vatër e lindjes dhe e përdorimit të këtyre termave. Ata janë bërë pjesë e fondit aktiv të shqipes. Si rregull, pasurimi i çdo sistemi terminologjik më së shpeshti kryhet me qëllim të plotësimit të boshllëqeve, pra kur sistemi ka nevojë për një koncept të ri, pasi në rastin e mungesës në sistemin leksikor të gjuhës marrëse të fjalëve që ekzistojnë në një terminologji të huaj, lindë nevoja për të krijuar një term të ri, prandaj, procesi i huazimit të termave është shumë dinamik. Analiza e kryer dëshmon se sot, futja e termave të rinj në sistemin terminologjik është një proces i pakthyeshëm. Pavarësisht fanatizmit të disa studiuesve për "pastërtinë" e gjuhës, duhet pranuar se proceset e vazhdueshme që ndodhin në pasurimin e sistemeve terminologjike janë procese që ndodhin në të gjitha gjuhët e botës, të shoqëruara me një trysni të jashtëzakonshme nga gjuhët si anglishtja, gjermanishtja, frëngjishtja etj.

## Conclusions

The media in Kosovo, as well as in Albania, tend to use more or less the same terms belonging to the field of jurisprudence, which, in most cases, are borrowed from Latin and other languages and appear unprocessed (either directly translated or only partially adapted). Foreign terminology has flooded many domains of knowledge, especially in fields where lexical meanings come as new imports along with the elements they designate. Today, even the language of jurisprudence has become a source of the emergence and usage of such terms. These borrowed terms have become part of the active lexical stock of the Albanian language. As a rule, the enrichment of any terminological system most often occurs to fill lexical gaps—that is, when the system requires a new concept. When a term does not exist in the lexical system of the receiving language but exists in a foreign terminological system, there arises the need to create or borrow a new term. Therefore, the process of term borrowing is highly dynamic.

The analysis conducted confirms that the introduction of new terms into the terminological system is now an irreversible process. Despite the purist attitudes of some scholars toward language “purity,” it must be acknowledged that the continuous processes enriching terminological systems occur in all languages of the world. These processes are accompanied by strong external pressures from dominant languages such as English, German, French, and others.

## Literaturë

- Duro, Agron, *Terminologjia në ligjërimin e specializuar*, në: *Studime Filologjike*, 1997.
- Gashi, Sejdi, *Çështje sociolinguistike të terminologjisë në mediet e Kosovës dhe të Shqipërisë*, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2024.
- Hoxha, Shpresa et.al. *Terminologjia juridike anglisht -shqip në legjislacionin e Kosovës në periudhën 1999-2009*.
- Kasumaj, Sylë, *Fjalor i termave të drejtësisë*, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2019.
- Lloshi, Xhevat, *Stilistika dhe pragmatika*, Tiranë, 1999.
- Thomai, Jani et.al, *Fjalor i gjuhës shqipe*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Lletërisë, Tiranë, 2006.
- Vogel, Friedemann (red), *Legal Linguistics Beyond Borders: Language and Law in a World of Media, Globalisation and Social Conflicts.*:

*Relaunching the International Language and Law Association (ILLA),  
Duncker & Humblot GmbH, 2019.*

## THE LEXICON OF JURISPRUDENCE IN SOME MEDIA OF KOSOVA AND ALBANIA

### *ABSTRACT*

The lexicon of jurisprudence represents a distinct field of language, characterized by a strict system of terms, concepts, and discursive structures that require precision and clearly defined context. In the public sphere, this lexicon is particularly disseminated through the media, which play a key role in bringing legal terminology into public use. This study aims to analyze how the lexicon of jurisprudence is incorporated and used in media discourse in Kosovo and Albania, following a comparative approach to the usage of this specialized vocabulary.

The analysis was carried out based on a selected corpus of articles published in online portals and daily newspapers in Kosovo (such as *Koha Ditore*, *Gazeta Express*, *Klan Kosova*, etc.) and in Albania (“Dita”, “Gazeta shqiptare”, “Sot”, “Telegraf”, “Fjala”, “Liberale”, “Panorama”, etc.). For the sake of balanced representation, approximately 100 articles from each country were analyzed, all published between 2015 and 2023.

**Keywords:** jurisprudential lexicon, Kosovo, Albania, linguistic system, media discourse.

Ilda HOXHA

## **ROLI I STUDIUESVE GJERMANË NË DOKUMENTIMIN E SHQIPES NË SHEK. XX-XXI**

Roli i studiuesve gjermanë në dokumentimin dhe studimin e gjuhës shqipe gjatë shekullit XX dhe XXI ka qenë jashtëzakonisht i rëndësishëm dhe kontribues në mënyrë të qëndrueshme për albanologjinë si një fushë shkencore.

Studiuesit gjermanë të shekujve XX-XXI trashëguan një traditë të fuqishme nga pararendës si Johann Georg von Hahn, Gustav Meyer, Norbert Jokl, Maximilian Lambertz etj. Kjo traditë u zhvillua dhe institucionalizua më tej në universitetet gjermane, sidomos në ato të Vjenës, München-it, Berlinit etj.

Qendrat albanologjike në Gjermani dhe Austri kanë luajtur një rol të rëndësishëm në zhvillimin dhe avancimin e studimeve albanologjike, sidomos në fushat e gjuhësisë, etimologjisë dhe historisë së shqipes. Universitetet dhe institutet e këtyre vendeve, veçanërisht në qytete si Berlin, München, Vjenë, Grac dhe Innsbruck, kanë qenë dhe janë ende qendra kryesore kërkimore për studimet e gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare. Në fushën e etimologjisë, shumë kontribute të rëndësishme janë bërë nga albanologët modernë që kanë përdorur metodat e krahasimit gjuhësor për të ndihmuar në zbërthimin e origjinës dhe evoluimit të fjalëve shqipe. Ata kanë përdorur materiale të shumta historike dhe burime gjuhësore për të zbuluar rrënjët e fjalëve dhe për të analizuar mënyrën se si shqipja ka huazuar nga gjuhë të tjera, si latinishtja, greqishtja, turqishtja, dhe gjuhët sllave, përveç ndikimeve më të hershme indoevropiane.

Një aspekt i rëndësishëm i këtyre studimeve është se shumë nga këta gjuhëtarë të rinj janë ende aktivë në kërkime dhe kontribuojnë vazhdimisht në literaturën shkencore albanologjike. Ata janë pjesë e një tradite të vazhdueshme, që ka filluar me punët e gjuhëtarëve të mëdhenj të shekujve të kaluar dhe që vazhdon të rritet, duke e pasuruar përditë njohurinë tonë mbi gjuhën shqipe dhe lidhjet e saj me gjuhët e tjera.

Mjaft me rëndësi është të përmendim degën e Albanologjisë pranë Universitetit elitar “Ludwig-Maximilian” të Munihut (LMU), e cila përcjell ndërkohë një traditë thuhetse 65-vjeçare në aktivitetin të saj shkencor-universitar. Fillimet e saj i kemi në vitin 1961 me shkrimtarin dhe albanologun shqiptar Martin Camaj, i cili dha kontributin e tij si profesor dhe punonjës shkencor deri në vitin 1990. Më pas vazhdon aktivitetin prof. dr. Wilfried Fiedler në prill 1990 – prill 1998. Vijon në shtator 1998 –

gusht 2000 prof. dr. Rexhep Ismajli me statusin e profesorit honorar. Që nga viti 2000 e deri më sot aty drejton prof. dr. Bardhyl Demiraj. Dega e Albanologjisë është pjesë përbërëse e Institutit të Gjuhësisë Krahasuese-Indoeuropiane si edhe të Albanologjisë (Institut für Vergleichende und Historische Sprachwissenschaft sowie Albanologie) në LMU, duke gëzuar kështu statusin institucional të një qendre shkencore-universitare që përgatit, diplomon dhe doktoron si albanologë të rinj ata studentë e studiues që përzgjedhin ndërkohë albanologjinë si fushë kryesore studimi në degët universitare të fuzionuara: Bachelor of Arts “Gjuhësi e Përgjithshme dhe Indoeuropiane: Albanologji” (Allgemeine und Indogermanische Sprachwissenschaft: Albanologie) dhe Master of Arts “Filologji Ballkanike” (Balkanphilologie).<sup>1</sup>

Në Austri mësimdhënia e gjuhës shqipe ka filluar në gjysmën e dytë të shekullit XIX dhe është zhvilluar nëpër shkolla të larta e privatisht. Lektori i parë i shqipes në këtë Universitet ka qenë Nikolaus Rotta, i cili për herë të parë ka mbajtur një kurs të gjuhës shqipe në semestrin e dimrit të vitit akademik 1944/45, pra pak para përfundimit të luftës. Në semestrin e dimrit 1957/58 Rotta nuk përmendet më dhe me të përfundojnë dhe kurset e gjuhës shqipe.<sup>2</sup> Ai qëndroi 12 vjet aty. Më pas vjen prof. Karl Treimer. Pas 10 viteve në mungesë të një lektori për shqipen, vjen lektori i ri nga Kosova Skënder Gashi. Pas largimit të Dr. Skënder Gashit nga detyra, përgjegjësinë për zhvillimin e kurseve të gjuhës shqipe gjatë semestrit dimëror e mori përsipër Dr. Kurt Gostentschnigg, duke siguruar vazhdimësinë e procesit mësimor. Dr. Ina Arapi, ishte lektorja e fundit, e cila vazhdoi punën deri në verën e vitit 2012. Që atëherë, fatkeqësisht, nuk ka më katedër albanologjie. Shkolla austro-gjermane, krahas shkollës linguistike italiane, ka sjellë një frymë të fuqishme filologjike në Shkodrën e gjysmës së parë të shekullit XX, të cilën nuk ia ka arritur ta lëkundë, si metodë, për gjysmë shekulli asnjëra prej metodave të investuara në gjysmën e dytë të shekullit XX.<sup>3</sup> Një përpjekje për të bërë periodizimin e historisë së albanologjisë e ka bërë prof. dr. Jup Kastrati në veprën e tij “Historia e albanologjisë”, e cila është sprovë e parë në historinë pesëqindvjeçare të shkrimit të saj për të përmbledhur gjithë atë që është e

<sup>1</sup>Bardhyl Demiraj, *Qendra albanologjike në universitetin “Ludwig-Maximilian” të Munihut – një vështrim perspektiv*, Studimet albanistike në vendet ku flitet gjermanisht, Prishtinë, 2017, fq.59.

<sup>2</sup>Miradije Berishaj, Gjovalin Shkurtaj, *Panoramë e studimeve albanologjike dhe e mësimin të shqipes në diasporën shqiptare në Republikën e Austrisë*, Studimet albanistike në vendet ku flitet gjermanisht, Prishtinë, 2017, fq.735.

<sup>3</sup>Begzad Baliu, *Kërkime albanologjike*, Prishtinë, 2010, fq.185.

njohur gjatë këtyre pesë shekujve në fushë të albanologjisë.<sup>4</sup> Ai e ka ndarë në albanologjinë parashkencore (nga Piccolomini, 1473 deri te Hahn, 1853) dhe shkencore (nga Franz Bopp, 1854 deri në vitin 1997). Në pjesën e parë, profesori vlerëson punën dhe rolin e Lajbnicit (1705) dhe të Hahn, ndërsa në periudhën e dytë i ka dhënë një vend të veçantë Gustav Meyer.

Albanologjia në hapësirën gjermanishtfolëse, e themeluar dhe konsoliduar nga figura të shquara si Johann Thunmann, Joseph Ritter von Xylander, Franz Bopp, Georg von Hahn, Gustav Meyer, Norbert Jokl dhe Maximilian Lambertz, dhe e pasuruar gjatë gjysmës së dytë të shekullit XX nga studiues të mirënjohur si Hermann Ölberg, Wilfried Fiedler dhe Oda Buchholz, vijon traditën e saj të lavdishme edhe sot me përfaqësuesit e brezit të ri, të cilët e kanë studiuar shqipen nga anë të ndryshme, të ndër të cilët veçohen emrat e Robert Elsie, një ndër njohësit më të thellë dhe më të përkushtuar të gjuhës, letërsisë dhe kulturës shqiptare, István Schütz, Georg Stadtmüller Claus Haebler, Basil Shaderi e disa të tjerë që vazhduan traditën. Po përmendim disa nga kontributet e këtyre albanologëve.

Claus Haebler (1931-2023) u mor kryesisht me gjuhësinë indoevropiane, por në fillimet e tij, duke njohur shumë mirë gjuhët e vjetra greke dhe latine, rastisi të kontaktojë me arvanitasit e Salaminës, të cilët e kishin ruajtur fort mirë arbërishten në variantin më të moçëm. Claus Haebler më 1965 në Wiesbaden boton monografinë: *Grammatik der Albanischen Mundart von Salamis*. Në studimet e shqipes trajtohet si ndër të parët e aplikimit të metodologjisë strukturaliste në studimet me karakter dialektor, e që më pas vjen e bëhet puna shkencore model për një numër të konsideruar gjuhëtarësh.<sup>5</sup>

Georg Stadtmüller, (1909-1985) një tjetër albanolog gjerman, i cili kontributin e tij për historinë e shqipes e shtriu në një mendim, se djepi qendror i popullsisë shqiptare mund të ketë qenë gjatë kohës romake dhe bizantine vetëm në luginën e Matit. Sipas Martin Camajt, i cili i ka bërë një recension veprës së autorit në fjalë, ky mendim është pranuar nga pjesa më e madhe e dijetarëve, duke shtuar se krahina e Matit mund të merret si epiqendër e popullsisë shqiptare e se fise të po kësaj kombësie, sidomos fise baritore që ishin të shtrenguar të ndiqnin kullotat, jetonin me shumicë dhe jashta kësaj qendre.<sup>6</sup>

Stadmüller i kushton rëndësi çështjes së autoktonisë së shqiptarëve. Camaj

<sup>4</sup> Begzad Baliu, Kërkime albanologjike, Prishtinë, 2010, fq.181.

<sup>5</sup> Imri Badallaj, *Kontributi i Claus Haebler-it mbi të folmet arbërore të Greqisë*, Studimet albanistike në vendet ku flitet gjermanisht, Prishtinë, 2017, fq.262.

<sup>6</sup> Tomor Osmani, *G. Shtadmyller (nga M. Camaj)*, Shëzjat për gjuhën shqipe Shkodër, 2013, fq.200.

e kritikon Stadmüller-in, se e ka tepruar në përdorimin e emrave të vendeve, duke vërtetuar, se, nëse kjo krahinë ishte në të kaluarën e banuar prej kësaj apo asaj kombësie, vetëm se ka një emër të kësaj gjuhe, që për Camajn ishte i padrejtë.<sup>7</sup> Sipas tij, prania e një toponimi latin apo sllav në një vend nuk provon domosdoshmërisht se ky vend ishte që në periudhat më të hershme i banuar nga një popullsi latine apo sllave. Toponimet janë të ndjeshme ndaj ndikimeve historike, politike dhe gjuhësore, të cilat mund të ndryshojnë ose të mbivendosen me kalimin e kohës.

István Schütz (1923-2010) është figura dominuese e albanologjisë hungareze në gjysmën e dytë të shekullit të njëzetë dhe përfaqësuesi më i shquar i kësaj fushe në atë periudhë.

István Schütz ishte i pari që prezantoi gjuhën shqipe për studentët hungarezë dhe për të gjithë të interesuarit që dëshironin ta mësonin atë. Ai zhvilloi një metodë unike të mësimdhënies së shqipes, e cila merrte parasysh dhe respektonte mënyrën e të menduarit dhe stilin e të nxëniet të hungarezëve. Schütz-i i kushtoi 62 vite të jetës së tij studimit dhe mësimdhënies së gjuhës dhe kulturës shqipe, derisa u nda nga jeta më 27 nëntor 2010, në moshën 87-vjeçare. Ai ishte një albanolog autodidakt, i cili e mësoi gjuhën shqipe pa asnjë libër në dispozicion, duke u zhytur njëkohësisht në studimin e kulturës dhe historisë shqiptare. Pavarësisht kushteve të vështira të kohës, Schütz u dallua për këmbënguljen dhe durimin e jashtëzakonshëm në kërkimin shkencor, duke kapërcyer sfida të shumta që i sillte realiteti politik dhe akademik i periudhës. Schütz është hartuesi i “Fjalorit shqip-hungarisht”, një punë shumëvjeçare, me ulje-ngritjet e saj, por gjithmonë i shtyrë nga vullneti dhe këmbëngulja për t’i shkuar deri në fund punës së nisur. Ky Fjalor, shprehej Schütz, duhet të jetë një ndihmë e dobishme për gjithë ata hungarezë të cilët duan të mësojnë shqipen, por nuk gjejnë profesor të gjuhës. Gjithashtu, fjalori duhet të jetë aq i pasur, që t’u përgjigjet edhe kërkesave të ndryshme të një niveli të lartë të përkthyesve letrarë në veprimtarinë e tyre si ndërmjetës të pasurisë letrare dhe të folklorit të shqipes lexuesve hungarezë.<sup>8</sup>

Një ndër përfaqësuesit më të njohur të pjesës së dytë të shek. XX është edhe albanologu gjerman Armin Hetzer.(1941) Ndër veprat më të rëndësishme të Hetzer-it përmendet Fjalori “Shqip-gjermanisht / gjermanisht-shqip”. Ky fjalor është një ndër punët më praktike dhe të vlefshme për studentët, përkthyesit dhe këdo që ka nevojë të ndërveprojë mes këtyre dy gjuhëve. Ai u realizua me shumë kujdes dhe saktësi

<sup>7</sup> Tomor Osmani, *G. Shtadmyller (nga M. Camaj)*, Shënjzat për gjuhën shqipe, Shkodër, 2013, fq.200.

<sup>8</sup> István Schütz, *Fjalori i ri shqip-hungarisht*, Filologji 18, Prishtinë, 2011, fq.12.

shkencore, duke reflektuar pasurinë dhe veçoritë e gjuhës shqipe në përkthim të përpiktë gjerman. Vepër tjetër është libri për mësimin e gjuhës letrare shqipe, i shkruar në bashkëpunim me Zuzana Finger. Ky tekst mësimor u krijua për të ndihmuar të huajt, sidomos gjermanofolësit, të mësonin shqipen standarde. Libri shquhet për metodologjinë e qartë, strukturën didaktike dhe theksin në normën letrare të shqipes. Punimi tjetër: “Nominalisierung und verbale Einbettung in Varietäten des Albanischen” – Në këtë vepër studimore të thelluar, Hetzer analizon dukuritë e substantivimit dhe ndërkaljes së foljeve në varietete të shqipes, duke përfshirë edhe gjuhën letrare të sotme. Ky studim ka rëndësi të veçantë për sintaksën dhe semantikën e shqipes, si dhe për kuptimin e zhvillimit të saj modern. Në tërësi, Hetzer ka lënë pas një trashëgimi të vyer që ndihmon jo vetëm albanologjinë, por edhe përpjekjet për përkthim, mësimdhënie dhe analizë gjuhësore të shqipes në kontekst ndërkombëtar. Po dallojmë disa prej artikujve të tij: "Ortografi e ortoepi. Mbi gjendjen e gjuhës së shkruar shqipe pas Kongresit të Drejtshkrimit më 25.11.1972 në Tiranë", "Si mund të lexohet Fjalorthi i Arnold von Harffit", tre artikuj mbi "Të ashtuquajturin Kodeks të Beratit", një studim mbi "Fjalorin tre gjuhësh të Teodor Kavaliotit", si dhe botimin e përpunuar edhe në gjermanisht të këtij fjalori (shqip, gjermanisht, greqisht, arumunisht).<sup>9</sup>

Robert Elsie, (1950-2017) është një nga emrat më të rëndësishëm të albanologjisë moderne. Studiuesi i albanologjisë me origjinë kanadeze, shkruante në gjermanisht dhe anglisht. Ai veproi pothuajse i vetëm, për dekada me radhë, në një fushë të cilën shumë e konsideronin pa interes: kulturën, historinë dhe letërsinë shqiptare. Ndërsa bota akademike përëndimore shpesh shihte nga qendra të mëdha kulturore, Elsie zgjodhi me vetëdije të zbardhte dhe dokumentonte një kulturë të vogël, të shpërfillur, e cila për të kishte vlera universale. Ai punoi pa mbështetje të madhe akademike, pa ndonjë institucion të fuqishëm prapa, shpesh duke përkthyer dhe botuar me burime personale dhe duke e trajtuar Shqipërinë me seriozitetin që i jepet një kulture të madhe. Ai e zbuloi pasionin e tij për Shqipërinë në fund të viteve 1970, pasi udhëtoi atje me një grup studentësh nga Instituti i Gjuhësisë së Universitetit të Bonit, në një kohë kur vendi ishte ende një tokë e panjohur kulturore për pjesën tjetër të botës. Ai nuk e zgjodhi këtë fushë për lavdi apo përfitim, por sepse pa në të diçka që të tjerët nuk e panë — dhe iu përkushtua asaj me përlulesi, dashuri dhe seriozitet deri në fund të jetës. Nga veprat e tij mund të përmendim:

---

<sup>9</sup> Izer Maksuti, *Rreth kontributit albanologjik të Armin Hetzer*, Albanologjia, 9-10, Tetovë, 2018, fq. 29.

“A Dictionary of Albanian Religion, Mythology, and Folk Culture” (2001) – Një fjalor i plotë me terma nga feja, mitologjia dhe folklori shqiptar; "Albanian Literature: A Short History". Një histori e shkurtër e letërsisë shqiptare, nga fillimet deri në kohët moderne." (2005); Historical dictionary of Albania (2010). Sipas porosisë së tij, ai prehet në malet e Veriut tonë, pranë një kishe në Theth.

Basil Schader (1951) është profesor në Shkollën e lartë pedagogjike të kantonit të Zyrih në Zvicërr, ku ai udhëheq degën “gjeranishtja si gjuhë e dytë”. Ai është anëtar i disa komisioneve lëndore dhe drejtues i projekteve arsimore-shkencore për gjuhën e mërgimtarëve shqiptarë në Zvicërr. Studimet dhe hulumtimet sociolinguistike dhe didaktike të prof. Schader-it janë përqendruar kryesisht te gjuha shqipe në kontakt me gjuhën gjermane dhe dialektet e saj në Zvicrën gjermanofone. “Për disa vjet radhazi ai ka qenë drejtues i projektit kërkimor “Kompetenca gjuhësore, orientimi gjuhësor dhe suksesi shkollor i nxënësve shqiptarë në Zvicërr” dhe, për ta përmbushur sa më mirë atë detyrë, përveç të tjerave, ai iu përvesh punës për të hartuar edhe një studim doktorati kushtuar pikërisht kontaktit e proceseve të ndryshme që nxjerr në dukje dygjuhësia dhe pranëvënia kulturore e shqiptarëve të shpërngulur në Zvicërr”<sup>10</sup>, citon prof. dr. Gjovalin Shkurtaj. Më 1996 boton librin “Shqip! Materiale mësimore për nxënës dhe nxënës shqiptarë dhe për mësimin ndërkulturor”. Brenda secilës temë, tekstet janë të ndara në tri nivele gjuhësore, me synimin për të ofruar materiale të përshtatshme për nxënës me aftësi gjuhësore të ulëta, të mesme dhe të larta. Një pjesë e këtyre teksteve janë të përkthyer. Përveç teksteve në gjuhën shqipe, libri përmban gjithashtu një parashtrësë për gjuhën dhe kulturën shqiptare. Po ashtu, për çdo temë paraqiten propozime didaktike që ilustrojnë mënyrat se si mund të trajtohet tema përkatëse në një qasje të hapur ndaj gjuhëve dhe kulturave të ndryshme të pranishme në klasë. Kjo pjesë e librit i drejtohet kryesisht mësimdhënësve.

Hans-Joachim Lanksch, (1943-2019) përkthyesi gjerman i lirikës shqipe, nxënësi i Martin Camajt, adhuruesi i dialektit të gegërishtes. Hans-Joachim Lanksch lindi në vitin 1943 në Braunschweig (RFGJ) dhe u shpërngul që në rini në Mynih, ku ndoqi studimet në fushat e filologjisë ballkanike, sllavistikës, kulturës popullore dhe albanologjisë. Interesimi i tij i thelluar për gjuhën shqipe, kulturën dhe letërsinë shqiptare erdhi natyrshëm, falë njohjes dhe miqësisë me prof. Martin Camajn, i cili asokohe drejtonte degën e albanologjisë në universitetin elitare “Ludwig-

<sup>10</sup> Gjovalin Shkurtaj, *Albanologu Basil Shader (Schader) dhe studimi i tij rreth kontaktit gjuhësor të shqipes me gjermanishten në diasporën shqiptare në Zvicërr*, Kundrime gjuhësore, Tiranë, 2006, fq.162.

Maximilian“ të Mynihut. Ndahet nga jeta më 20 maj 2019. Lanksch-i ka përkthyer në gjuhën gjermane disa prej shkrimtarëve dhe poetëve më të njohur shqiptarë, përfshirë Martin Camaj, Lasgush Poradeci, Azem Shkreli, Ali Podrimja, Fatos Arapi dhe Visar Zhiti. Ai ka sjellë në gjermanisht edhe autorë të tjerë të rëndësishëm si Frederik Rreshpja, Ridvan Dibra, Mimoza Ahmeti, Agron Tufa, Primo Shllaku, Ledia Dushi etj.

Lanksch shprehte një revoltë të brendshme për mënjanimin e gegërishtes. Po citojmë një mendim të tijin të shoqëruar me nota ironie:” *Nisma për rishikimin e punës së Kongresit të Drejtshkimit, të gjuhës së tashme standarde si dhe për futjen e gegnishtes në shkollat e trevave gegnishtfolëse, simbas gjasave, te shtresat e gjana do të hasë në rezervë se "s'është momenti". Me siguri, s'është momenti me u marrë mu tash me problemin e gjuhës unitare të shqiptarëve. Probleme më urgjente ka me tepricë - në Shqipni, ndër detyrat prioritare të shtëpisë figurojnë p.sh.: lufta kundër krimit të organizuem dhe korrupsionit, reformimi i thellë i sistemit të drejtësisë, zgjidhja e çështjes së drejtës së pronës, përmbushja e standardeve për integrimin euroatlantik (citue nga fjalët e Presidentit të Republikës). Jashtë Shqipnie, jemi tue u marrë me lutjet për paqe dhe me protestat kundër një tufe njerzish që synojnë, me çdo kusht, me shkretue Lindjen e Afërme me versionin e dytë të një lufte aq të çmendun sa dhe kriminele. Momenti, në të vërtetë, nuk është. Kur ka me qenë momenti për shqyrtimin e çështjes së gjuhës shqipe? Atëherë, kur ujku ka me banue me qengjin dhe leopardi ka me u shtri përbrî kecit?”<sup>11</sup>*

Klaus Steinke, një studiues gjerman i njohur për kontributin e tij në albanologji, veçanërisht në dialektologji. Ai flet për përvojën e tij në vitet 1960 kur punonte me Martin Camajn, një ndër figurat më të rëndësishme të albanologjisë në Gjermani. Në një artikull të tijin “herausforderungen für die deutsche albanologie im 21. Jahrhundert”<sup>12</sup> (Sfidat e albanologjisë gjermane në sh. 21), ai shprehet se, kur mësova pak shqipen në Mynih, ishte ende një gjuhë krejtësisht ekzotike dhe ndoshta e njohur vetëm për ballkanologët dhe indoevropianistët. Në kumtesën e tij, Steinke ngre pyetjen, nëse do të ketë një gjuhë të përbashkët standarde për të gjithë shqiptarët (si ajo e formuar në Shqipëri – toskërishtja standarde), apo do të ketë dy norma zyrtare, një për Shqipërinë dhe një për Kosovën, ku në Kosovë të standardizohet gegërishtja?<sup>13</sup> Ai e lidh me Gustav Weigand, një

<sup>11</sup> Hans - Joachim Lanksch, *Gegnishtja po ban gëk*, Phoenix 4-6, Shkodër, 2002, fq.168.

<sup>12</sup> Klaus Steinke *Herausforderungen Für Die Deutsche Albanologie Im 21. Jahrhundert*, Studimet albanistike në vendet ku flitet gjermanisht, Prishtinë, 2017, fq. 41.

<sup>13</sup> Klaus Steinke *Herausforderungen Für Die Deutsche Albanologie Im 21. Jahrhundert*, Studimet albanistike në vendet ku flitet gjermanisht, Prishtinë, 2017, fq. 43.

nga albanologët më të rëndësishëm gjermanë të fillimshkullit XX, i cili nuk u pozicionua hapur në favor të asnjërës nga dy dialektet kryesore të shqipes, gegërishtes dhe toskërishtes, por zgjodhi një formë kompromisi, që mund të shihet si “zgjidhje solomonike”. Në gramatikën e tij shqipe të botuar më 1913, ai përdori gegërishten jugore të Elbasanit, një variant dialektor që ka veçori të përbashkëta me të dy dialektet:

Ky debat është aktual që kur standardi i gjuhës shqipe u themelua më 1972 në Kongresin e Drejtshkrimit në Tiranë, duke u bazuar kryesisht në dialektin toskë. Kosova, megjithëse me shumicë gjeografike dhe demografike gegë, e pranoi këtë normë, për arsye politike dhe për të ruajtur unitetin kombëtar në një kohë të vështirë për shqiptarët jashtë Shqipërisë.

Helmut W. Schaller (1940) është një gjuhëtar dhe albanolog gjerman i njohur për kontributin e tij në fushën e filologjisë ballkanike dhe sllavistike. Ai ka qenë profesor në Universitetin e Marburgut dhe ka publikuar një sërë veprash mbi historinë e gjuhësisë në Evropën Juglindore. “Historia e albanologjisë në Gjermani”, bën një analizë të plotë të studimeve albanologjike të gjuhëtarëve austriakë e gjermanë.

Heiner Eichner (1942-2024), albanolog austriak, në artikullin e tij “Zhvillimi i studimeve albanologjike në kuadrin e gjuhësisë indoevropiane gjermanishtfolëse - një perspektivë autobiografike”, përmbledh kontributet e rëndësishme të gjuhëtarit Gert Klingenschmitt në fushën e albanologjisë historike, sidomos në lidhje me origjinën dhe zhvillimin e gjuhës shqipe brenda familjes së gjuhëve indoevropiane. Autori e vendos Klingenschmitt-in në vazhdimësinë e gjuhëtarëve të mëdhenj si: Gustav Meyer, që provoi përfundimisht përkatësinë e shqipes në familjen indoevropiane apo Holger Pedersen dhe Norbert Jokl, që thelluan studimet krahasimtare. Ky pozicionim është i rëndësishëm, sepse tregon nivelin e ndikimit të punës së tij në albanologjinë moderne.

Eseja “Albanisch und Urindogermanisch” (1981) fokusohet në formacionet e aoristit sigmatik në shqipe — sidomos format me **-shë**, si: *dhashë*, *pashë*. Ai argumenton, se këto forma nuk janë trashëguar nga protoindoevropianishtja, por janë krijime të reja historike, pasi mungojnë në dialektet e vjetra dhe në dokumentet më të hershme. Në vend të tyre, format me **-ova** (si *çova*) janë vazhdues më të besueshëm të aoristit sigmatik indoevropian.

Joachim Matzinger-in e vendos atë në një linjë të qartë akademike e gjenealogjike me albanologët dhe indoevropianistët më të shquar gjermanofolës të gjysmës së dytë të shekullit XX. I afirmuar si studiues me kontribute të rëndësishme në studimin e gjuhës shqipe, veçanërisht të fazave të vjetra të saj. Matzinger-i (1968) e ka shprehur disa herë mendimin

e tij mbi tezën “*Shqiptarët si pasardhësit të ilirëve*”.<sup>14</sup> Këtë tezë, tezën autoktone të shqiptarëve, e shikon në mënyrë kritike. Titulli i plotë: “Der altalbanische Text ‘E Mbsuame e Krështerë’ des Lekë Matrënga vom Jahr 1592”

(“Teksti në gjuhën e vjetër shqipe: *E Mbsuame e Krështerë* e Lekë Matrëngës nga viti 1592”)

Botuar: Dettelbach, 2006

Gjatësia: 306 faqe.

Matzinger-i e trajton tekstin jo thjesht si dokument kulturor apo religjioz, por si material gjuhësor me rëndësi të lartë filologjike. Qasja e tij bazohet në metodat e “Shkollës së Erlangenit”, një rrymë metodologjike në linguistikën historike gjermane që fokusohet në: Rekonstrukcionin e sistemeve fonologjike dhe morfologjike përmes analizës së dokumenteve të shkruara. Përshkrimin sistematik të çdo forme gjuhësore. Qasjen krahasimtare të saktë dhe të disiplinuar ndaj historisë së gjuhës. Matzinger ka botuar gjithashtu shumë gjurmime të detajuara mbi Buzukun. Në vitin e fundit u botua libri i tij me titull:

- “*Die sekundären nominalen Wortbildungsmuster im Altalbanischen bei Gjon Buzuku*” [“Tipet emërore sekundare të fjalëformimit në Shqipen e vjetër të Gjon Buzukut”], Wiesbaden 2016, 593 faqe.<sup>15</sup> Ky botim i Joachim Matzinger-it dhe Stefan Schumacher-it, “Die Verben des Altalbanischen. Belegwörterbuch, Vorgeschichte und Etymologie” (2013), është një nga veprat më voluminoze dhe më të rëndësishme në studimet e shqipes së vjetër, veçanërisht për trajtimin etimologjik. Joachim Matzinger dhe Stefan Schumacher botuan më 2013 “Foljet e shqipes së vjetër. Fjalor dëshmish, parahistori dhe etimologji” një punim kolosal.

Fjalori mbledh çdo folje të dëshmuar në shqipen e vjetër, deri rreth mesit të shekullit XVIII.

Ndër burimet kryesore ishin Pjetër Budi, i cili përfaqëson gegërishten liturgjike e letrare të shek. XVII, Lekë Matrënga dhe Jul Variboba që përfaqësojnë toskërishten (sidomos nga Italia Jugore).

Pjesa më e madhe e vlerësimit historik gjuhësor i përket Schumacher-it. Gjuhëtari austriak Stefan Schumacher lindi në vitin 1963 në Tirol. Studioi në Universitetin e Insbrukut në degën e Gjuhësisë Indoevropiane si dhe në degë të tjera, si ajo e Parahistorisë. Libri përmban, ndër të tjera: një

<sup>14</sup> Heiner Eichner, *Zhvillimi i studimeve albanologjike në kuadrin e gjuhësisë indoevropiane gjermanishtfolëse - një perspektive autobiografike*, Studimet albanistike në vendet ku flitet gjermanisht, Prishtinë, 2017, fq.103.

<sup>15</sup> Heiner Eichner, *Zhvillimi i studimeve albanologjike në kuadrin e gjuhësisë indoevropiane gjermanishtfolëse - një perspektive autobiografike*, Studimet albanistike në vendet ku flitet gjermanisht, Prishtinë, 2017, fq.104.

përshkrim të ri analitik të sistemit foljor të gjuhës shqipe; një trajtim historik të hollësishëm të kategorive gramatikore, si: imperfekti (koha e pakryer), aoristi dhe optativi (mënyra dëshirore); një analizë të thelluar dhe të re të zhvillimit historik të fonologjisë së shqipes; një kapitull të veçantë mbi etimologji të përzgjedhura, ku diskutohen origjina dhe zhvillimi i disa njësive leksikore; gjithashtu, edhe pse libri është shkruar në gjuhën gjermane, ai përfshin udhëzime në gjuhën shqipe për përdorimin praktik të fjalorit.

Wilfried Fiedler (1933-2019) është albanologu më i njohur dhe më i rëndësishëm në hapësirën gjermanishtfolëse dhe vazhdues i traditës së Gustav Meyer-it, Norbert Jokl-it dhe Maximilian Lambertz-it<sup>16</sup>, - sipas Robert Elsie. Në vitin 1959, Wilfried Fiedler u emërua docent i gjuhës shqipe në Universitetin Humboldt të Berlinit, ndërsa nga viti 1968 e në vijim, ushtroi detyrën e bashkëpunëtorit shkencor pranë Institutit të Gjuhësisë në Akademinë e Shkencave të RDGj-së. Deri në vitin 1989, ai drejtoi, së bashku me Dr. Oda Buchholz, Sektorin e Balkanologjisë në këtë institut.

Në të njëjtin vit, 1989, ai u emërua profesor i Albanologjisë në Universitetin e Mynihut, duke pasuar në këtë post prof. Martin Camajn. Në vitin 1991 zgjidhet anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës. Pas daljes në pension në vitin 1998, prof. Fiedler vazhdoi angazhimin e tij akademik si profesor i jashtëm i gjuhës shqipe pranë Universitetit të Jenës, në Institutin për Studime të Evropës Juglindore. Ka bashkëpunuar së bashku me Oda Buchholz në hartimin e “Albanische Grammatik” - “Gramatika e shqipes”, botuar në Leipzig, më 1987.

Le të kujtojmë se veprimtaria studimore e Oda Buchholz – it si gjuhëtare në fushë të studimit të shqipes rrok gati tërë strukturën gramatikore të shqipes së sotme, problemet e funksionimit të gjuhës letrare, e po ashtu edhe të përvijimit të proceseve të formimit të saj a shqyrtimeve në lëmë të leksikologjisë e semantikës me vështrimin kah leksiku shoqëror, etj<sup>17</sup>; Fiedler është edhe bashkëautor i Fjalorit Shqip-Gjermanisht dhe atij Gjermanisht-Shqip (së bashku me O. Buchholz-in dhe G. Urlisch) në vitin 2000. “Sistemi foljor i gjuhës shqipe të Gjon Buzikut (1555)” në vitin 2004 dhe “Formimi i shumësit të gjuhës shqipe” në vitin 2010, janë botime të Akademisë së Shkencave e Arteve të Kosovës. Studimi i tij mbi sistemin foljor në gjuhën e Buzikut përfaqëson një monografi të gjerë me mbi 800

<sup>16</sup> Robert Elsie, <http://www.albanianphotography.net/fiedler/al/index.html>

<sup>17</sup> Remzi Përnaska, Tomorr Plangarica, *Albanische Grammatik e O. Buchholz-it dhe W. Fiedler-it, perlë gramatografie*, Studimet albanistike në vendet ku flitet gjermanisht, Prishtinë, 2017, fq. 370.

faqe, e cila trajton në mënyrë gjithëpërfshirëse gjuhën e këtij autori, me theks të veçantë te sistemi foljor.

Ndërkohë, monografia e tij për shumësin në gjuhën shqipe është rezultat i kërkimeve shumëvjeçare dhe përfaqëson deri më sot studimin më të plotë e më të detajuar të hartuar ndonjëherë mbi këtë temë.

Hans-Jürgen Sasse (1943-2015), i cili fillimisht punoi në Berlin dhe më pas në Mynih, studioi gjuhën dhe kulturën arabe, filologjinë ballkanike dhe gjuhësinë e përgjithshme. Ai mori doktoraturën në studime arabe në vitin 1970 në Mynih. Gjatë viteve 1960, ai zhvilloi edhe hulumtime në terren në Greqi në fshatin Markopulo në Atikën e Veriut. Dialekti i Markopulos në rajonin e Oropusit mbeti një nga burimet kryesore të punës së Sasse-s.<sup>18</sup> Ai bëri regjistrime në fshatin Kaparelli dhe arriti në konkluzionin se këto janë dokumente jashtëzakonisht të vlefshme të një gjuhe që ishte ende e gjallë tek brezi i vjetër në atë kohë. Sasse vazhdon, se informatorët që janë në gjendje të interpretojnë përralla, tradita popullore dhe “tekste” të tjera në gjuhën shqipe të regjistruara në kasete, janë tashmë një fenomen i rrallë në shumicën e fshatrave. Ai bëri një studim dialektor të kësaj të folmeje në sistemin fonetik e fonologjik, morfologjik dhe sintaksor.

Emri Norbert Boretzky (1935) në opinionin shkencor është i njohur në disa fusha: në gjuhësinë e përgjithshme e gjuhësinë historike ku publikimet e tij me kohë zunë vend në literaturën klasike në fushën e diakronisë historike dhe teorike, më vonë në fushën e kontakteve ndërgjuhësore (me përqendrim te gjuhët e Ballkanit), ndërsa në pjesën më të madhe të karrierës iu përkushtua romishtes. Interesimi i Norbert Boretzky për gjuhën shqipe shfaqet që në fazat e hershme të punës së tij shkencore. Në këto studime, shqipja trajtohet kryesisht në kontekstin ballkanik, si në aspektin leksikor, ashtu edhe në atë gramatikor. Ndër projektet më të rëndësishme dhe më të gjera të tij në fushën e albanologjisë është punimi i habilitimit me titull *Der türkische Einfluß auf das Albanische* (“Ndikimi turk në shqipen”), i botuar në dy vëllime. Vëllimi i parë (1975) përqendrohet në analizën fonologjike dhe morfologjike të turqizimeve në shqipe, ndërsa vëllimi i dytë (1976) përfshin një fjalor të detajuar të këtyre huazimeve.<sup>19</sup>

Walter Breu (1949) është një gjuhëtar gjerman i njohur për kontributin e tij në fushat e gjuhësisë ballkanike, të kontaktit gjuhësor dhe të albanologjisë.

<sup>18</sup> Walter Breu, Elvira Glaser, *Hans-Jürgen Sasses Forschungen zum arvanitika*, Studimet albanistike në vendet ku flitet gjermanisht, Prishtinë, 2017, fq.197.

<sup>19</sup> Blertë Ismajli, *Norbert Boretzky si albanolog – Sistemi foljor i shqipes në studimet e tij*, Studimet albanistike në vendet ku flitet gjermanisht, Prishtinë, 2017, fq.431.

Ai ka qenë veçanërisht aktiv në studimin e marrëdhënieve ndërgjuhësore në Ballkan, duke përfshirë gjuhën shqipe, sllavishten dhe gjuhë të tjera të rajonit. Në diskutimin e tij për mënyrën, sheh dhjetë mënyra në shqipen, plus një që përdoret, sipas tij vetëm në disa të folme arbëreshe. Krahas dëftores, urdhërores, dëshirores, habitores, lidhore, ai si mënyrë sheh edhe kushtoren, gjusivin (lejoren) le + lidhore, posibilitoren (mundësoren) mund + lidhore, obligativin (duhet + lidhore), volitivin (dua + lidhore) edhe mënyrën hipotetike (në ardhsha dhe po erdha)<sup>20</sup>.

Kurt Gostentschnigg, studiuesi i albanologjisë nga Vjena e koncepton fushën e albanologjisë jo thjesht si një disiplinë të izoluar, por si një ndërthurje multidisiplinare që përfshin histori, etnografi, arkeologji, sociologji, filozofi, gjeografi dhe fusha të tjera. Ai e sheh albanologjinë si pjesë të një konteksti më të gjerë shkencor dhe politik, ku interesimi dhe kontributi i albanologëve austro-hungarezë nuk mund të kuptohet jashtë rrethanave historike të monarkisë Austro-Hungareze. Sipas tij, veprimtaria e këtyre albanologëve ishte e lidhur ngushtë me interesat politike, ekonomike dhe ushtarake të kësaj fuqie në Ballkan, veçanërisht në përpjekjet e saj për të kundërshtuar zgjerimin e pansllavizmit dhe imperializmit italian në rajon. Ka trajtuar çështjen e etnogjenezës shqiptare nga ana e albanologjisë austro-hungareze.<sup>21</sup> Sipas Gostentschnigg janë shfaqur dy teori kryesore mbi etnogjenezën e shqiptarëve. E para është teoria ilire, e cila mbështet idenë se gjuha shqipe rrjedh nga ilirishtja dhe se shqiptarët janë pasardhës autoktonë të ilirëve. E dyta është teoria trake, që sugjeron se shqipja buron nga trakishtja dhe se paraardhësit e shqiptarëve kanë ardhur në territorin e sotëm nga rajonet e banuara më parë nga trakët. Këto teori përfaqësojnë dy qasje të ndryshme në përpjekjen për të shpjeguar prejardhjen gjuhësore dhe etnike të shqiptarëve në një kontekst të ndikuar nga interesa shkencore, politike dhe ideologjike të kohës.

Kontributet e gjuhëtarit danez Gunnar Svane (1927-2012), studiues i zellshëm i gramatologjisë dhe i filologjisë së gjuhëve sllave, i gjuhësisë ballkanike, zënë një vend më se të meritueshëm dhe që spikat në disa pikëpamje. Botimi i variantit nga Gunnar Svane në vitin 1985, nën kujdesin e Institutit të Studimeve Gjuhësore të Universitetit të Aarhus-it, përfaqëson një vazhdimësi të natyrshme të kërkimeve dhe botimeve të mëparshme mbi gjuhën e Pjetër Budit. Ky botim pasqyron një sërë shkrimesh shkencore me

<sup>20</sup> Bardh Rugova, *Mënyrë dhe modalitet në gjuhën shqipe – kontributi i Walter Breu-it*, Studimet albanistike në vendet ku flitet gjermanisht, Prishtinë, 2017, fq.448.

<sup>21</sup> Kurt Gostentschnigg, *Dimensionit politik i trajtimit të çështjes së etnogjenezës shqiptare nga ana e albanologjisë austro-hungareze*, Studimet albanistike në vendet ku flitet gjermanisht, Prishtinë, 2017, fq. 477.

vlera të veçanta, që trajtojnë çështje të leximit dhe interpretimit të shenjave grafike në tekstet e Budit, si dhe ofrojnë krahasime me elemente nga autorë të tjerë të letërsisë së vjetër shqipe. Këto studime paraprijnë në mënyrë kohezive botimin e sipërpërmendur dhe lidhen ngushtë me realizimin e konkordancave që e pasojnë atë. Një trajtesë e thelluar që synon të sqarojë aspektet e interpretimit fonik dhe elementet bazike të tekstit, duke evidentuar vlerën që mbartin këto vepra për studimet gjuhësore dhe historike, në veçanti në kuadër të ballkanistikës, gjendet në shkrimin me titull *How to Read Budi's "Speculum Confessionis"*, botuar në vitin 1980 në revistën *Studia Albanica*, nr. 1<sup>22</sup>. Gjithashtu, në vitin 1986, Svane përgatiti një transkriptim në ortografi moderne të veprës *Rituale Romanum* (1621) të Budit, së bashku me një konkordancë, nën kujdesin e Institutit për Gjuhësi të Universitetit të Aarhus-it, duke e konsoliduar më tej këtë linjë kërkimi në albanologji.

Studiuesit gjermanishtfolës në fushën e albanologjisë janë karakterizuar historikisht nga një përkushtim i thellë ndaj saktësisë shkencore dhe analizës kritike. Kjo qasje e matur dhe objektive ka kontribuar ndjeshëm në krijimin e një pasqyre më të qartë, më të thelluar dhe më të paanshme të realiteteve shqiptare në sytë e botës akademike.

Albanologët gjermanishtfolës janë përpjekur vazhdimisht të ruajnë një neutralitet shkencor dhe të shmangin instrumentalizimin e dijes për qëllime politike. Në dekadat e fundit, vihet re një rritje e dukshme e interesit për studimet kulturore gjuhësore dhe letërsinë shqipe në hapësirën akademike gjermanishtfolëse. Letërsia shqiptare – klasike dhe bashkëkohore – po përkthehet e analizohet gjithnjë e më shumë dhe diskursi kulturor shqiptar po gjen vend në analizat evropiane. Kjo traditë e pasur e albanologjisë gjermanishtfolëse jo vetëm që nuk është shuar, por po vazhdon dhe rinovohet nga një brez i ri studiuesish. Ata janë aktivë në institucione shkencore dhe universitare në Gjermani, Austri, Zvicër dhe më gjerë, ku vazhdojnë të thellojnë kërkimet në gjuhësi, histori, letërsi, kulturë dhe antropologji shqiptare. Ky brez i ri nuk ndjek vetëm rrugën e klasikëve, por edhe i përshtat qasjet e veta me metodat bashkëkohore digjitale dhe ndërdisiplinare, duke sjellë një perspektivë moderne dhe globale në studimet shqiptare.

#### BIBLIOGRAFI:

- Bardhyl Demiraj, Qendra albanologjike në universitetin "Ludwig-Maximilian" të Munihut – një vështrim perspektiv, Studimet albanistike në vendet ku flitet gjermanisht, Prishtinë, 2017.
- Begzad Baliu, Kërkime albanologjike, Prishtinë, 2010.
- Bleritë Ismajli, Norbert Boretzky si albanolog – Sistemi foljor i shqipes në studimet e

---

<sup>22</sup> Evalda Paci, *Gunnar Svane: kontribute themelore mbi interpretimin tekstor e filologjik të veprës së Pjetër Budit*, Studimet albanistike në vendet ku flitet gjermanisht, Prishtinë, 2017, fq.669.

- tij, Studimet albanistike në vendet ku flitet gjermanisht, Prishtinë, 2017.
- Gjovalin Shkurtaç, Albanologu Basil Shader (Schader) dhe studimi i tij rreth kontaktit gjuhësor të shqipes me gjermanishten në diasporën shqiptare në Zvicër, Kundrime gjuhësore, Tiranë, 2006.
  - Hans-Joachim Lanksch, Gegnishtja po ban gëk, Phoenix 4-6, Shkodër, 2002.
  - Heiner Eichner, Zhvillimi i studimeve albanologjike në kuadrin e gjuhësisë indoevropiane gjermanishtfolëse - një perspektive autobiografike, Studimet albanistike në vendet ku flitet gjermanisht, Prishtinë, 2017.
  - Imri Badallaj, Kontributi i Claus Haebler-it mbi të folmet arbërore të Greqisë, Studimet albanistike në vendet ku flitet gjermanisht, Prishtinë, 2017.
  - István Schütz, Fjalori i ri shqip-hungarisht, Filologji 18, Prishtinë, 2011
  - Izer Maksuti, Rreth kontributit albanologjik të Armin Hetzer, Albanologjia, 9-10, Tetovë, 2018.
  - Klaus Steinke Herausforderungen Für Die Deutsche Albanologie Im 21. Jahrhundert, Studimet albanistike në vendet ku flitet gjermanisht, Prishtinë, 2017.
  - Miradije Berishaj, Gjovalin Shkurtaç, Panoramë e studimeve albanologjike dhe e mësimit të shqipes në diasporën shqiptare në Republikën e Austrisë, *Studimet albanistike në vendet ku flitet gjermanisht*, Prishtinë, 2017.
  - Remzi Përnaska, Tomorr Plangarica, *Albanische Grammatik* e O. Buchholz-it dhe W. Fiedler-it, perlë gramatografike, Studimet albanistike në vendet ku flitet gjermanisht, Prishtinë, 2017
  - Robert Elsie, <http://www.albanianphotography.net/fiedler/al/index.html>
  - Walter Breu, Elvira Glaser, Hans-Jürgen Sasses Forschungen zum arvanitika, Studimet albanistike në vendet ku flitet gjermanisht, Prishtinë, 2017.
  - Tomor Osmani, Shëjzat për gjuhën shqipe, G. Shtadmyller (nga M.Camaj), Shkodër 2013.

#### THE ROLE OF GERMAN SCHOLARS IN DOCUMENTING THE ALBANIAN LANGUAGE IN THE 20TH–21ST CENTURIES

##### ABSTRACT

This paper explores the important contributions of German-speaking scholars to the study and documentation of the Albanian language during the twentieth and twenty-first centuries. Continuing a strong scholarly tradition, these researchers have advanced Albanian studies through work in linguistics, etymology, dialectology, and historical analysis, particularly within major academic centers such as Munich, Vienna, and Berlin. Adopting a descriptive and analytical approach, the study examines the contributions of key scholars and evaluates their impact on the development of Albanology. The findings demonstrate that German-speaking researchers have played a central role in shaping modern Albanian linguistic studies through rigorous methodology and comparative perspectives.

Furthermore, the paper addresses key debates related to language standardization, dialectal variation, and ethnogenesis, highlighting their continued relevance. It concludes that this scholarly tradition remains influential and essential for the ongoing development and international recognition of Albanian studies.

**Keywords:** Albanian language, German scholars, linguistic studies, etymology, dialectology, language documentation.

Ermira ALIJA

## FISHTA PËR TRE POETË BASHKËKOHËS: NDRE MJEDËN, ASDRENIN DHE KOLË THAÇIN

Një pjesë e madhe e shkrimeve kritike të Fishtës i përkasin kritikës letrare, në kuptimin specifik të fjalës, si degë e shkencës për letërsinë. Ato kanë karakter të theksuar analitik e ndoshta, ajo që mund të ndriçohet më tej në këto shkrime është sfondi metafizik i estetikës dhe filozofisë kristiane, nën këndshikimin e asaj që vetë Fishta thoshte: *Kush e kishte mendue se, atëherë, kur laicizmi kujtonte se po këndon kangën e ngadhjimit, do t'u trandte ndër themele të veta?*<sup>1</sup>...

Por ka edhe një pjesë të shkrimeve kritike të Fishtës, që shfaqen në forma të ndryshme recensionelesh<sup>2</sup> për libra artistikë, që mund t'i emërtojmë edhe *shënime për libra*, apo *shënime kritike*.

Megjithëse publicistika e Fishtës rrok një periudhë të gjatë kohore, më shumë se 27 vjet, recensionet apo shënimet për librat nuk janë të shumtë në numër, gjë që arsyetohet me angazhimet dhe jetën e ngarkuar të tij. Nëse shqyrtojmë shënimet e Fishtës për librat dhe autorët shqiptarë, ato janë për:

*Visari Komtaar* të Vinçenc Prennushit

*Bleta Shqiptare* të Thimi Mitkos

*Ëndra e lotë* të Asdrenit

*Juvenilja* të Ndre Mjedjës

*Vjerrsha* të Murad Toptanit, botuar mbas vdekjes (1918) së tij

*Tu tempulli i Mariës* (poemë) e Kolë Thaçit

*Genovefa* (dramë, përkthim) të Luigj Naraçit e Karl Gurakuqit

*Valët e Vjosës* të Nazif Mamaqit, Këngëtori Kombëtar

Nga këto shënime kritike, na u duk me interes të veçonim reagimin e Fishtës për veprat e mirëfillta letrare të autorëve bashkëkohës me të dhe t'u përgjigjemi pyetjeve: Si pozicionohet ai në lidhje me autorët bashkëkohës?

<sup>1</sup> Laicizmi në Perëndim, Hylli i Dritës, Gjergj Fishta, Vepra letrare 9, Enti Botues "Gjergj Fishta"& Bibliotheca Gollettiana, 2004, f. 605.

<sup>2</sup> Hamit Boriçi i quan: *lloje specifike të artikujve letrarë - publicistikë shënime për librat*, apo *shënime kritike* në: Hamit Boriçi, *Llojet e shkrimeve informative dhe analitike të gazetarisë*, Tiranë, 1985, f. 142.

A ka karakteristika të caktuara publicistika reçensionale e Fishtës (nëse mund ta quajmë ashtu)? Cilat janë ato?

Në ribotimin e dy vëllimeve të përmbledhjes së publicistikës së Fishtës, thuhet: *Kur përfundon së lexuari këto dy vëllime, nuk të mbetet fije dyshimi se Fishta-publicist është po aq i madh sa edhe Fishta-poet. Këtë madhësi e shprehin qartë shumë tregues të shkrimeve të tij, të cilët përbëjnë tiparet thelbësore të saj*<sup>3</sup>. Atëherë si shfaqet Fishta në shënimet kritike për veprat e bashkëkohësve të vet? Së pari, a ka shtylla referimi, si bazë e përbashkët vlerësimi? A ndërtojnë ato një stil specifik? Mendojmë se vënia në dukje e këtyre karakteristikave na ndihmon të gjykojmë për qëndrueshmërinë e zhvillimin e llojeve të artikujve publicistiko letrarë në kohën e sotme.

Shënimet kritike që kemi marrë në shqyrtim janë ato që shkruhen për:

**Ëndra e lotë** të Asdrenit, botimi i librit Bukuresht 1912, shkrimi i Fishtës më 1914

**Juvenilja** të Ndre Mjedjës, botimi në Vjenë 1917, shkrimi i Fishtës më 1917

**Tu tempulli i Mariës** (poemë) e Kolë Thaçit, botimi më 1917, shkrimi më 1917

Ajo që vihet re mbas leximit të këtyre shënimeve kritike, është se Fishta ka disa fjalë kyçe që i përmend pothuajse në të gjitha shkrimet, të cilat, siç duket, përbëjnë referenca të rëndësishme për të në vlerësimin e letërsisë. Ato janë:

- mendimet e naltueshme ose ideja e naltë poetike
- gjuha (e pastër, e hijshme)
- ndjesia që reflektohet në krijim (si njomësi, përmallje, atdhedashuri)
- puna me vargun, përpunimi poezisë
- teknika e stili si shkollë, imitim

Mbi bazën e këtyre shtyllave të vlerësimit, të njëjta për të tre autorët, ne kemi ndërtuar një tabelë, për të krahasuar shënimet e Fishtës për secilin autor.

---

<sup>3</sup> Hamit Boriçi dhe Ndue Zef Toma në: Gjergj Fishta, Vepra letrare 9, Enti Botues “Gjergj Fishta” & Bibliotheca Gollettiana, 2004, f 652

<b>Shtylla vlerësimi</b>	<b>Për Thaçin</b>	<b>Për Asdrenin</b>	<b>Për Mjedën</b>
Ideja poetike	<i>Argument i madhnueshëm e fort interesant</i>	<i>Mendime të naltueshme</i>	<i>Shembëlltyrat e gjalla, plot njomësi e gjithmonë të arsyeshme</i>
Gjuha	<i>Fjalë shqipe, të përdorume me vend Libri e begatë shqipen me fjalë të reja e të hijshme</i>	<i>Gjuhë e pastër dhe e hijshme Shfaqet hijshëm dialekti I tosknis</i>	<i>Gjuha e pastër</i>
Puna me vargun; Stili	<i>Autori ka qitë në punë një cenë të palodhshme e një kujdes të posacëm në t'bam të këtij libri E ka zhdrivillue me mjeshtri, në mënyrë që idetë vijnë tuj u zmadhue me shije estetike Ndërlikimi I tepërt i vendit të fjalëve Elokucioni del i ajatë e tepër i kërkue Kuptimi nuk del aq qartë sa duhet Ndërlikimi t' lodh e s'të len me shijue bukurinë Ndërlikimi i ngjan poezisë latine, por nuk ka hije</i>	<i>Me iu vu ma tepër teknikës së vjershave e trajtës së përjashtme të poezisë</i>	<i>Me mjeshhtëri janë ndërtue vjershat e janë lidhë mendimet Stili i naltueshëm, Bukurinë e formës e rreh flladi i poezis Autori këndon mbi lyrë të vet të tingllueshme Autori e ka përshkue sa herë nën limë të mendjes e të teknikës</i>
Ndjesia	<i>Në do vende ka edhe hove poetike të hijshme</i>	<i>Fllad i amel njomsijet e hijeshijet fort të kandshme Thjeshtie...</i>	<i>Pranverë lulesh e bylbylash Natyrë e kërtlnestë e plot jetë Melankoni e kandshme e cila edhe sendeve ma të vogla u jep një interes dhe një randësi të vecantë. Kjo melankoli nuk rrjedh gjithmonë prej zemret, aq sa prej mendjet të autorit, përshkohet nëpër rreze të filozofisë e të poezisë klasike e mandej depërton nëpër fashoje të gjuhës shqipe, Jo aq e përmallshme sa me t'u molisë zemra</i>

Sic shihet nga tabela, pavarësisht disa referencave, të cilave Fishta u

mbështetet në shënimet kritike, përsëri ai nuk u rri atyre strikt. Për shfaqje të ndryshme letrare e ndien të nevojshme të përdorë terma jot ë zakonshëm, bile poetikë, që rrjedhin nga një reagim i thellë emocional dhe intelektual prej njohësi të thellë të letërsisë e procesit të krijimit. Në pikëpamje njerëzore, mund të themi se nuk ka frikë nga bukuria e krijimit. Përkundrazi, ai e ndien letërsinë dhe përpigjet të tregojë burimin e saj, duke përdorur jo thjesht një terminologji specifike, por edhe të funksionalizojë potencialin e vet figurativ si poet.

Nuk është e vështirë të kuptosh nga tabela kompleksitetin mendor dhe emocional që i kanë ngjallur botimet e tri veprave bashkëkohëse Fishtës. Nuk është e vështirë edhe të kuptosh se si ai thellohet në kërkimin e gjetjes së emocionit e të bukurisë.

Në anën tjetër, nëse shohim se si shfaqen karakteristikat e publicistikës letrare të Fishtës tek stili i shënimeve për librat, mbi të tre autorët, vëmë re:

Elemente të stilit	Për Thaçin	Për Asdrenin	Për Mjedën
Karakteri operativ	Botimi i librit: Shkodër 1917, shkrimi i Fishtës më 1917	Botimi i librit Bukuresht 1912, shkrimi i Fishtës më 1914	botimi Vjenë 1917, shkrimi I Fishtës më 1917
Mendimi i thellë dhe profesional	Shih më sipër	Shih më sipër	Shih më sipër
Karakteri informues	Titulli i kritikës është vetë titulli i veprës	Titulli i kritikës është vetë titulli i veprës	Titulli i kritikës është vetë titulli i veprës
Karakteri emotiv	<i>... ka dalë një libër vjershash, shkruar prej zotit Kolë Thaçit, i njoftun n'literatyrë shqyptare</i>	<i>Qe një libër sikush!</i>	<i>Qe një vepër poetike, me të cillën mund të thohet, se përnjimend asht stolisë gjuha e asht rrit pasunia e literaturës shqipe!</i>
Karakteri propogandues	<i>...kjo asht një punë e madhe n'literatyrë e për t'u ndjekun prej shum shqyptarësh...</i>	<i>... libri i Asdrenit asht një shembull qi do ndjekë prej shumë kuj.</i>	<i>Kjo vepër ka me kenë domosdo e nevojshme me u përdorë si tekst ndër shkolla të Shqypnisë</i>
Mosrënie në konformizëm	Shih më sipër për stilin	Shih më sipër për stilin	Shih më sipër për stilin
Stili motivues dhe karakteri militant	<i>Na pat kande me vu roe këto, jo pse</i>	<i>...auktori ka me punue prapë e</i>	<i>Autori mundet me kenë i sigurtë se</i>

	<p><i>duem me thanë qi hymni i z. Thaçi nuk asht i hijshëm, por pse, tuj njoftë cilësitë poetike të tij të zgjedhuna, dëshirojmë qi t'qesë punë ditë e përditë ma mirë, për nam t'Atdheut e t'gjytetit t'vet. Prandej po gëzohena me gjith zemër ... për këtë libër të ri, me të cillin e ka begatë visarin e literatyres shqipe e shpresojm se me atë cenë e kujdes, me të cillin ka shkruet hymnin Tu tempulli i Maries, ka me botue edhe kangë të tjera</i></p>	<p><i>prapë, pa u lodhë, m'Parnas t'Shqypris e se me botime tjera ka me begatë ma tepër pasunin e literatyres shqipe ...</i></p>	<p><i>atdheu ka me ia dijtë për nder mundin qi ka hjekë në përpilim të kësaj vepre</i></p>
--	--	--	--

A e karakterizon stilin e Fishtës, militantizmi? Mendojmë se shtyllat e forta të mendimit shkencor letrar, e shmangin Fishtën nga militantizmi i fortë publicistik. Kur analizon bukurinë e melankolisë së Mjedës, ai nuk e sheh si mangësi animin nga mendimi, të cilin përsëri nuk e sheh si diçka misionare, por fort të brendshëm. Militantizmi i Fishtës ndoshta del në pah atëherë kur çdo përpjekjeje i vë misionin e përparimit të atdheut, por me të nuk abuzohet dhe pavarësisht stilit dinamik e të vrullshëm të të menduarit, Fishta nuk e don *atdhedashurinë llapazane*.

Fishta si kritik shfaq njeriun e gjerë e të madh brenda vetes, që flet jo në emër të egos, por në emër të një misioni të diçkaje të thellë që qëndron në themel të letërsisë, pa anashkaluar përpjekjen e madhe njerëzore për ta mbërritë.

#### LITERATURË:

- Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave Politike dhe Juridike, Hamit Boriçi, LLojet e shkrimeve informative dhe analitike të gazetarisë, Shtypshkronja Mihal Druri, Tiranë 1985
- Hamit Boriçi, Gazetaria dhe publicistika, Shtypshkronja 8 Nëntori, Tiranë 1990

- Gjergj Fishta, *Vepra letrare 9, Enti Botues “Gjergj Fishta”* & Bibliotheca Gollettiana, 2004

**FISHTA ON THREE CONTEMPORARY POETS: NDRE MJEDA,  
ASDRENI, AND KOLË THAÇI**

***ABSTRACT***

This paper examines Gjergj Fishta’s critical stance toward three contemporary Albanian poets—Ndre Mjeda, Asdreni, and Kolë Thaçi—through his critical notes on *Juvenilja*, *Ëndra e lotë*, and *Tu tempulli i Mariës*. Focusing on literary review as a distinct component of his journalistic and critical writing, the study seeks to identify the main criteria of aesthetic evaluation and the nature of Fishta’s critical judgment in relation to contemporary literature. The analysis is grounded in several recurring evaluative principles in his treatment of all three authors, including the elevation of the poetic idea, the quality of language, the expression of feeling, and the technical and stylistic shaping of verse. On this comparative basis, the paper argues that Fishta develops a form of literary criticism grounded in a stable yet flexible framework of reference, one capable of responding to the specific qualities of each work.

At the same time, the analysis of these critical notes reveals several fundamental categories underlying Fishta’s reception of the literary text: the informative function, emotional engagement, motivational impulse, and cultural-national orientation. These categories place his literary reviews beyond the bounds of merely stylistic or descriptive evaluation. In this sense, Fishta’s criticism emerges as an interplay between aesthetic judgment and a clear awareness of literature’s formative role in cultural and national life. Ultimately, the paper concludes that Fishta stands out as a critic of broad aesthetic and intellectual horizons, one who conceives literature both as a high spiritual value and as an important instrument of cultural and national formation.

**Edmond MUÇO****IKONOGRAFIA E ONUFRIT****Hyrje**

Shqipëria gjatë shekujve të mesjetës deri në pushtimin turk, me pak përjashtime bënte pjesë në kuadrin e Perandorisë Bizante. Gjithashtu, duhet mbajtur parasysh se kisha në Shqipëri në pjesën më të madhe të saj ka qenë e rritit lindor.<sup>1</sup>

Thesari artistik i realizuar nga populli shqiptar gjatë mesjetës, sidomos në artin e ikonave dhe atë të miniaturës së dorëshkrimeve, për shkak të rrethanave shumë të vështira të njohura në histori sot paraqitet thellësisht i reduktuar.<sup>2</sup>

Në Shqipëri në fushën e arteve figurative veprat më të vjetra mesjetare që kanë mundur të ruhen deri më sot janë ato të miniaturës së dorëshkrimeve fetare, të cilat fillojnë nga kodet e shekullit IX dhe vazhdojnë në kodet e çdo shekulli.

Në Shqipëri zhvillimin më të madh miniatura e dorëshkrimeve mesjetare e arrin aty nga shekulli XI ose fillimi i shekullit XII me miniaturën e dy kodeve tepër luksoze të Vlorës ku bie në sy një sintetizim i elementeve të stilit Bizantin që sapo kishte arritur formimin e tij të plotë me ato të traditës të artit antik.<sup>3</sup>

Realizmi i miniaturës së nivelit të lartë në Shqipëri përkon në kohë edhe me zhvillimin e gjinive të tjera të arteve si p.sh., pikturën monumentale të shekullit XII të Rubikut, me atë të Shën Marisë (Leskovik), atë të Beratit dhe Korçës.<sup>4</sup>

Piktura e shekullit XIII në Shqipëri, si ajo e ikonave dhe e miniaturës së dorëshkrimeve nuk paraqitet më me atë finesë të theksuar nga ana artistike si ajo e shekullit të mëparshëm.

Kurse ikonat e shekullit XIV të Shqipërisë karakterizohen nga tipare artistike më të përparuara që vërehen në ndërtimin e tyre arritur me anë linjash elegante që evidentojnë bukur format e tyre voluminoze. Në këto

---

<sup>1</sup> Ikona dhe miniatura mesjetare në Shqipëri, shtëpia botuese “8 Nëntori”, Tiranë, 1974, f. 9.

<sup>2</sup> Po aty.

<sup>3</sup> Po aty, f.10.


<sup>4</sup> Theofan Popa, Pikturët Mesjetarë shqiptarë, shtëpia botuese “8 Nëntori”, Tiranë, 1961, f. 42.

ikona të shekullit XIV të Shqipërisë vërehen edhe disa veçori vendase që i bëjnë të ndryshojnë mjaft nga ikonat analoge të vendeve të tjera.

Në këtë periudhë në Shqipëri nuk vazhdoi të zhvillohet më arti i miniaturës së dorëshkrimeve, sepse këto filluan të zëvendësohen me librat e shtypit.<sup>5</sup>

I pari ndër piktorët shqiptarë që u shfaq në këtë periudhë historike, ishte Onufri i neokastrës (Elbasani) me një aktivitet të mirëfilltë si në pikturën murale, ashtu edhe në ikonë. Pas Onufrit vijnë edhe piktorë të tjerë, si: Nikolla, bir i Onufrit, Joani bashkëpunëtorë, të Nikollës në pikturë dhe të tjerë anonimë të cilët kanë zbukuruar me piktura ndërtesa kulturi në zona të ndryshme të Shqipërisë.

Piktura e Onufrit lind e zhvillohet në vazhdim të traditës së artit të madh bizantin, por talenti i fuqishëm i këtij mjeshtri, nën ndikimin e ideve të reja të krijuara nga rrethanat politike të vendit dhe të realizimeve të shkëlqyera të artit perëndimor të kohës ndryshon normat e paradiktuara të pikturës së vjetër bizantine dhe fut elemente të jetës së gjallë. Onufri arrin kështu të krijojë një art të vetin me tipare individuale, një art të përshkruar prej një fryme e prirjeje realiste, që nga ana artistike arrin maja të larta me interes të veçantë.<sup>6</sup>



**Fig.1** Onufri, Ungjillor Llukaj, Skenë nga dyert e bukura shek. XVI, Kisha Vangjelista Berat.



**Fig.2** Onufri, “Shën Maria me krishtin”, shek.XVI, tempera mbi dru .

<sup>5</sup> Theofan Popa, *Piktorët mesjetarë shqiptarë*, shtëpia botuese “8 Nëntori”, Tiranë, 1961, f. 42.

<sup>6</sup> Dhorka Dhamo, *Piktura murale e mesjetës në Shqipëri*, shtëpia botuese “8 Nëntori”, Tiranë, 1974, f. 39.

Stili artistik i Onufrit me përsosjen e tij të lartë influençoi thellësisht dhe u ndoq nga të gjithë piktorët që erdhën më pas nga biri i tij Nikolla e të tjerë. Në Shqipëri u krijua kështu një rrymë artistike e qartë me realizime të bukura, por në rrethana shumë të vështira që pasuan. Kjo rrymë nuk pati mundësi vazhdimi në zhvillim.

Shekulli XVIII në Shqipëri karakterizohet nga një zhvillim mjaft i rëndësishëm ekonomik shoqëror, me rritjen e tregtisë të qyteteve, me ndërtimin e shumë institucioneve të kultit dhe me zbukurimin e tyre me vepra arti të gjinive të ndryshme. Historikisht dihet se në këtë kohë kemi formimin e shtresës së pasur shqiptare dhe një qetësim relativ të vendit.<sup>7</sup>

### Onufri, mjeshtri më i madh i ikonografisë shqiptare

Për piktorin e periudhës pas bizantine Onufriin të dhënat biografike janë të pakta. Edhe ato pak informacione që disponojmë janë mbledhur nga shënimet që kanë lënë në ikonë apo afreske. Si datë e përafërt e lindjes mendohet të jetë viti 1500, ndërsa viti i vdekjes mbahet 1578.

Veprimtarinë e tij artistike e zhvilloi kryesisht në pjesën qendrore të Shqipërisë, ku mesa duket kristianizmi u ruajt gjerë atëherë edhe ndër qytete. Me vepra më në zë të shekullit XVI janë zbukuruar shumë kisha brenda dhe jashtë vendit.



**Fig.3** Onufri, “Shën Johan Pagëzori”, shek.XVI, tempera mbi dru.



**Fig.4** Onufri, “Krishti Pantokrator”, shek XVI, tempera mi dru.

<sup>7</sup> Dhorka Dharmo , Piktura murale e mesjetës në Shqipëri, shtëpia botuese “8 Nëntori”, Tiranë, 1974, f. 44.

Në shekullin XVI, Berati ishte një nga qytetet më të rëndësishme të hapësirës arbërore. Sipas një dekreti sulltanor qytetarët e Beratit ishin të lirë të mbanin besimin e tyre, të ndiqnin zakonet dhe ritualet e tyre.<sup>8</sup> Kështu rasti i Beratit dëshmon një rritje të popullsisë kristiane, ku nga viti 1431 me rreth 175 shtëpi të krishtera dhe në fillim të shekullit XVI numri i tyre shënon 561<sup>9</sup>, duke treguar se mjedisi ekonomik e social ishte i favorshëm për vazhdimësinë e traditës së pikturimit të ikonave të kishave, prania e atelies së Beratit e konfirmon një gjë të tillë.

Onufri në qytetin e Beratit gjeti mjedisin e favorshëm për vazhdimin e traditës së pikturimit të ikonave në kisha. Këtë e konfirmon prania e atelies në këtë qytet.

Krahas ndryshimeve dhe zhvillimeve ekonomike arti ikonografik kishte treguar nivel të lartë e një pjekuri artistike. Studiuesit kanë shkruar për atelien e Beratit dhe për artin e Onufrit që vazhdoi të reflektohet deri tek ikonografët e fundit të shek.XIX.

Në Berat Onufri ka ushtruar një veprimtari të gjerë në pikturën monumentale dhe të kavaletit. Në Shqipëri ikona e Onufrit ruhet vetëm në kalanë e Beratit.<sup>10</sup>

Ikonat e Onufrit janë kompozime shumëngjyrëshe me ngjyra të ndezura. Koloriti më i ndezur i tyre shpjegohet dhe me dëshirën për të theksuar më mirë figurat e tyre shumë të vogla. Këto vepra e paraqesin Onufrin si artist me të gjitha tiparet e tij, si mjeshtër dhe njohës i përsosur i teknikës së pikturimit me tempera.<sup>11</sup>

Onufri ka pikturuar me dashuri edhe njerëzit e thjeshtë të moshuar, të rinj, figura që më pas do t'i ngrinte në lartësinë e tipikes.

Janë pikërisht këto figura që futën në pikturën e tij ndjenjën ngazëllyese, një ndjenjë nga jeta e gjallë reale. Skenat e festave janë si miniatūra të vogla me ngjyra më të forta ku spikat sidomos e kuqja, ajo ngjyrë që ishte e preferuar për Onufrin dhe jo më kot kritika e huaj e ka quajtur e “kuqja e veçantë dhe e paimitueshme e tij”.<sup>12</sup>

Etapa e dytë e rëndësishme e krijimtarisë së Onufrit lidhet me Kosturin (Greqi) ku ai më 23 korrik të vitit 1547 përfundoi pikturën në

<sup>8</sup> Zija Shkodra, *Esnafët në jetën qytetare ballkanike gjatë shekujve XVII-XVIII*, “Studime historike”, nr.1, Tiranë, 1975.

<sup>9</sup> Po aty

<sup>10</sup> *Historia e artit shqiptar Nr.1*. Instituti i Lartë i Arteve, Shtëpia Botuese e Librit Universitar, Tiranë, 1990, f.85.

<sup>11</sup> Po aty

<sup>12</sup> Theofan Papa, piktori i madh shqiptar i shekullit XVI, *Buletin i Universitetit shtetëror të Tiranës, seria e shkencave shoqërore Nr.1, Tiranë, 1955, f. 208.*

kishën e Apostujve. Onufri i dha Kosturit pikturën e tij, por edhe qyteti, me monumentet e shumta dhe traditën e tij e pajisi me njohuri dhe frymëzoi artistin tonë.

Në Neokastër (Elbasan), prej andej ai mori njëra pas tjetrës dy porosi që e futën thellë e më thellë në zonën e Shpatit, ku ai pikturoi në fillim në Shelkan e më pas në kishat e Shën Kollit, Valshit, dhe atë të Shën Premtes (1554).

Elbasani edhe Shpati përbëjnë një nga periudhat më të rëndësishme të Onufrit, pasi atje ai ka lënë dy monumentet e tij më të bukura.<sup>13</sup> Thua jse të gjithë aftësinë e tij krijuese Onufri e ka derdhur në pikturimin e kishave të thjeshta nga pikëpamja arkitekturore dhe kryesisht në zona të thella.<sup>14</sup>

Prirja e Onufrit për të pasuruar ikonografinë e pikturave dhe për t'i dhënë tipare origjinale skemës dekorative të tyre, shprehet në praninë e motiveve ikonografike të pandeshura më parë tek ne.

Onufri synoi që e gjithë piktura e altarit të jetë e lidhur nga një temë e vetme dhe të krijojë në përputhje me arkitekturën e mjedsit, një bërthamë të vetme ideore. Ai vendosi të pikturojë edhe anën e pasme të ikonostasit prej muri, disa motive që i shkonin tematikës së zgjedhur.<sup>15</sup>

I nisur nga këto pozita, Onufri i jep zë rëndësisë së madhe të formulimit të ikonostasit duke trajtuar për herë të parë si një fasadë monumentale në brendësi të tempullit.

Onufri respekton gjithmonë stazhin e jetës, bukurinë dhe çiltërsinë, ndjeshmërinë dhe energjinë e të rinjve, përvojën dhe mençurinë e të moshuarve, autoritetin e fjalës së tyre të prerë dhe të matur.

Çdo kompozim i Onufrit përmbillet në vetvete dhe fare mirë mund të perceptohet si një tablo e veçuar duke na sjellë ndërmend traditën karakteristike paleologe.<sup>16</sup>

Gjatë pikturimit të ikonave, Onufri i dha rëndësi të veçantë individualizimit të tipit pa rënë në tipizime standarde dhe shabllonizime. Në përputhje me situatën dramatike të asaj periudhe historike, ai ka ditur të vëri theksin në botën e brendshme, psikologjinë, duke dhënë në këtë rrugë tërthorazi, pikëllimin e shqiptarit për lirinë e humbur, si dhe revoltën e

<sup>13</sup> Historia e artit shqiptar Nr.1. Instituti i Lartë i Arteve, Shtëpia Botuese e Librit Universitar, Tiranë, 1990, f. 85.

<sup>14</sup> Aleksandër Meksi, Arkitektura e kishave të Shqipërisë, shekulli VII-XV, Tiranë, 2018, f. 34.

<sup>15</sup> Hasan Nallbani, Piktura murale bizantine në vendin tonë, Traditat në arkitekturë dhe art, Monumentet Nr.1, Tiranë, 1980, f.11.

<sup>16</sup> Mustafa Arapi, Punimet konservuese restauruese në kishën e Shën Mëhillit (dorëshkrim në arkivin e Institutit të Monumenteve të Kulturës).

vendosmërinë për të rifituar atë.



**Fig.5** Onufri, “Pagëzimi i Krishtit në lumin Jordan”, rreth 1540.



**Fig.6** Onufri, “Shën Theodor Tironi dhe Shën Teodor Stratilati,” shek.XVI, tempera mbi dru.

Duke analizuar aspektet artistike të krijimtarisë së Onufrit, vërejmë se aty rrezaton arti i shkollës së Kretës dhe Venecias traditë e vjetër e Kostandinopojës. Këto shkolla artistike luajnë një rol të rëndësishëm, por gjithashtu elementet e huazuara nga arti i Rilindjes fiorentine janë prezente në artin ikonografik të tij.<sup>17</sup>

Sipas studiuesve, Onufri ruan ikonografinë bizantine, ai huazon edhe elementët perëndimorë të rilindjes italiane, gjë që reflektohet më pas në korpusin artistik të të gjithë atelies së Beratit gjatë shekujve që do të pasonin, ku arti i Onufrit do të kthehej në model për t’u ndjekur nga ikonografët pasardhës.

<sup>17</sup> Holta Rroçi, Dorina Arapi, Onufri dhe tema ikonografike e trinisë së shenjtë me tri fytyra, Revista periodike kulturore- shkencore, Nr.19, Korçë, 2016, f.140.



**Fig 7** Nikolla i Onufrit  
“Lindja e Krishtit” ,  
shek.XVI



**Fig.8** Onufër Qiprioti, “Deisis”,  
shek.XVII

Në fundin e shekullit XVI, trashëgiminë e Onufrit e vazhdon si piktor ikonograf Nikolla, i cili njihet si djali i tij. Këtë fakt e konstatojmë në një mbishkrim në portën perëndimore brenda kishës “Shën Mërisë Vllaherna” në Berat, kur në vitin 1578 ai shkruan se është Nikolla biri i piktorit Onufri. Siç ishte shpesh, zanati trashëgohej në familje nga pasardhës të mjeshtrit apo edhe nga ndihmësit e tij në atelie.<sup>18</sup>

Kështu Nikolla, biri i Onufrit u kthye në mënyrë natyrale si vazhduesi i stilit piktorik të të atit, i shoqëruar dhe nga ikonografë të tjerë siç ishte edhe Joani.<sup>19</sup>

Nikolla biri Onufrit, është mjeshtri i dytë me rëndësi i shekullit XVI në Shqipëri. Ashtu si dhe Onufri, Nikolla ka pikturuar disa kisha që ndodhen në pjesë të ndryshme të Shqipërisë, si në: Berat, Kurjan të Fierit e në Dhërmi<sup>20</sup>

<sup>18</sup> Ermir Hoxha, Historia e artit në Shqipëri (nga prehistoria tek shekulli XIX), Tiranë: Emal 2020, f.165.

<sup>19</sup> Po aty.

<sup>20</sup> Andrea Llukani, Arti ikonografik në Shqipëri, Tiranë, 2019, f.11.

Ikonat e Nikollës ruhen edhe në Arbanas të Bullgarisë. Figurat artistike që ka krijuar mjeshtri dallohen në shumë drejtime nga ato që krijoi Onufri.

Edhe sistemi dekorativ i tij nuk ishte i huazuar. Ai dallohet për një siluetë të veçantë koloriti të ndezur etj. Nikolla ndryshe nga Onufri nuk ishte aq dramatik dhe i furishëm. Tipat që ai krijoi janë të përpunuar e idealizuar në mënyrë origjinale siç duket në shekullin XVI. Pas rënies së Perandorisë Bizantine, piktura tradicionale në Shqipëri, vijoi të përjetojë një periudhë lulëzimi, duke i lënë më shumë vend veprimtarisë krijuese vendase.

Onufri bashkë me pasardhësit e tij Nikollën (i biri) dhe Onufër Qipriotin përbënin artistët më të shquar të ikonografisë së asaj kohe. Këta artista krijuan tiparet e veçanta në punët e tyre. Ata themeluan një traditë të veçantë, krijuan variante të reja, zgjedhje kompozicionale të traditës bizantine, duke i dhënë ikonografisë vendase një tipar të ri.

Një ndihmesë të madhe dhanë këta artistë në themelimin e shkollës së Beratit, si dhe në përhapjen e kësaj shkolle në jug të Shqipërisë e cila u reflektua në ikonografinë artistike deri në shekullin XIX.

### **Elementi etnografik në pikturën e Onufrit**

Onufri ishte piktori i parë shqiptar që futi elementin etnografik në pikturën e tij, ai shfrytëzoi në mënyrë më të ndërgjegjshme disa tipare të stilit të artit popullor. Në këtë drejtim ai ndoqi traditën tonë shumë të çmuar që u pasurua më tej në shekujt e mëvonshëm, ku ai ka luajtur një rol pozitiv në formimin e një arti me tipare shqiptare.

Elementin etnografik në pikturën e Onufrit e gjejmë në figurat reale dhe në përgjithësi në figurat e barinjve që kanë hyrë në ikonografinë e artit kristian prej legjendave popullore.<sup>21</sup>

Skenat me barinj të piktorëve të shquar të shekullit XVI përgjithësisht kanë karakter publik dhe përshkruhen nga një atmosferë e ngrohtë jetësore. Në këtë drejtim Onufri ndjek traditën e pikturës paraardhëse të shekujve XIII-XIV, me të cilën veprën e tyre e lidhin edhe me një varg elementesh të përbashkëta etnografike.<sup>22</sup>

<sup>21</sup> Dhorka Dhamo, Konferenca Kombëtare e Studimeve Etnografike (28-30 Qershor 1976), f. 493.

<sup>22</sup> Po aty.

Onufri ka pasqyruar jetën e gjallë me elemente krejtësisht origjinale. Në artin popullor të njëjtin objekt nuk e gjen kurrë të përsëritur.

Pasqyrimi i elementeve të veshjes dhe stolive tregon për një njohje të mirë të ambientit etnografik të Shqipërisë së Mesme dhe për një lidhje të ngushtë shpirtërore me të. Këto motive Onufri i riprodhon në veprat e Beratit e pastaj në Kostur të Greqisë e më pas në Shpat të Elbasanit.<sup>23</sup>

Me futjen për herë të parë të elementit etnografik në figurat e shenjtorëve, piktorët e shekullit XVI, thyejnë hermetizimin e kanoneve duke treguar një traditë të tyre shumë shqiptare, vazhdimësinë e së cilës e shikojmë në rritje në pikturën mesjetare të shekullit XVIII-XIX.<sup>24</sup>

Onufri duke pasqyruar prodhimet artizanale popullore ka hyrë në marrëdhënie me jetën e popullit dhe me vlerat e papërsëritshme të artit të tij madhor ka njohur qartësinë e mendimit të krijmtarisë artistike popullore, psikologjinë dhe temperamentin e veçantë të shprehur në ngjyrën, ritmin e vijave, kompozimin e përmbyllur dhe lokalizimin e tij karakteristik.

## PËRFUNDIME

Sipas studimeve që i bëhet veprës së Onufrit, mendohet se fillesat e tij ai i ka pasur në kishat e Beratit për të vijuar në Kostur dhe më pas në Elbasan ku qëndroi më gjatë.

Në Berat shkëlqeu me pikturën murale dhe atë të kavaletit. Ndryshe nga tradita e mëparshme me pikturën e zymtë të kishave, Onufri i dha ngazëllim dhe jetë pikturave të tij dhe pasuroi ikonostasin me ikona të pikturuara me ngjyra të forta. Ngjyra e kuqe Onufrit është më e preferuara e tij ende sot që quhet “e kuqe e veçantë e paimitueshme e Onufrit”.

Onufri në pikturën e tij futi dhe elementë etnografikë, nuk mungojnë as njerëzit e thjeshtë nga jeta reale, si: fshatarë dhe barinj me kërraba dhe me qeleshet e tyre, karakteristike në ambientet e Shqipërisë së mesme.

Ikonografia e Onufrit mbetet një nga veprat më të arrira të pikturës ikonografike bizantine realizuar në territorin shqiptar.

---

<sup>23</sup> Andromaqi Gjergji, Vështrim historik mbi veshjet në Shqipëri , “Etnografia shqiptare”, nr.7 , Tiranë, 1976, f.98.

<sup>24</sup> Po aty

Onufri është mjeshtër i nivelit kombëtar e ballkanik. Ai ka ushtruar një veprimtari të çmuar artistike brenda dhe jashtë vendit të pasur me elemente realiste dhe me frymë origjinale.

## BIBLIOGRAFIA

1. Arapi Mustafa, *Punimet konservuese restauruese në kishën e Shën Mëhillit (Dorëshkrim në arkivin e institutit të Monumenteve të kulturës)*.
2. Bido Agim, *Arti popullor veshje e tekstile*, Instituti i Kulturës Popullore, Tiranë, 1992.
3. Dharmo Dhorka, *Elementi Etnografik në pikturën mesjetare të Onufrit dhe Nikollës*, Konferenca kombëtare e studimeve etnografike (28 qershor 1976).
4. Dharmo Dhorka, *Piktura murale në Shqipëri*, Arti kishtar, Shtëpia botuese “8 Nëntori”, Tiranë, 1974.
5. Dharmo Dhorka, *Studime historike*, Nr.2, Tiranë. 1980, f.15.
6. Figura 1, është marrë në studimin *Ikona dhe Miniatura mesjetare në Shqipëri*, shtëpia botuese “8 Nëntori”, Tiranë, 1974, f. 61.
7. Fig.2-8 janë marrë në botimin Ermir Hoxha, “Historia e Artit në Shqipëri (nga parahistoria tek shek. XIX)”, Emal, Tiranë, 2020, f.168, f.156, f.157, f.166, f.169.
8. Gjergji Andromaq, *Veshjet shqiptare në shekuj*, Instituti i Kulturës Popullore, Tiranë, 2005.
9. Hado Abaz, *Veshjet popullore dhe elementë të tjerë etnografikë në pikturën shqiptare*, Kultura popullore, Nr.1, 2.
10. Hoxha Ermir, *Historia e Artit në Shqipëri (nga prehistoria tek shek. XIX)*.
11. Llukani Andrea, *Arti i ikonografisë në Shqipëri*, Tiranë, 2019.
12. Meksi Aleksandër, *Arkitektura e kishave të Shqipërisë, shekulli VII-XV*, Tiranë, 2018.
13. Meksi Aleksandër, *Kishat e Shqipërisë së Mesme dhe të Veriut, Monumentet 1*, Tiranë, 1986.
14. Nallbani Hasan, *Piktura murale bizantine në vendin tonë, traditat në arkitekturë dhe art. Monumentet, 1*, Tiranë, 1980, f.10-15.

15. Popa Theofan, *Ikona dhe miniatura mesjetare në Shqipëri*, shtëpia botuese “8 Nëntori”, Tiranë, 1974.
16. Popa Theofan, *Mbishkrime të kishave të Shqipërisë*, Instituti i Historisë, Tiranë, 1999.
17. Popa Theofan, *Miniatura dhe piktura në Shqipëri* (shekulli VI-XIV), Arti kishtar, shtëpia botuese “8 Nëntori”, Tiranë, 1974.
18. Popa Theofan, *Piktorët mesjetarë shqiptarë*, shtëpia botuese “8 Nëntori”, Tiranë, 1961.
19. Popa Theofan, *Onufri, piktori i madh shqiptar i shekullit XVI*, Buletini i Universitetit shtetëror të Tiranës, seria shkencat shoqërore, Nr.1, Tiranë, 1955 (f. 208).
20. Roçi Holta, Arapi Dorina, *Onufri dhe tema ikonografike e Trinisë së shenjtë me tri fytyra*, “Tempulli”, revistë periodike kulturore shkencore Nr.19, Korçë, 2016.
21. Shkodra Zija, *Esnafët në jetën qytetare ballkanike gjatë shekujve XVII-XVIII*, “Studime historike”, nr.1, Tiranë, 1975.

## ICONOGRAPHY OF ONUFRI

### ABSTRACT

In this article, I aim to bring the creativity of the greatest master of Albanian iconography Onufri.

In the XVI century, iconography continued to dominate in the field of figurative arts in Albania, which marked its peak.

In this period, many paintings of churches were realized, and icons which today are masterpieces of this field. The XVI century is in the figurative arts the century of Onufri, who created his own style and was the first to make the post-Byzantine turn in Albania.

According to researchers, Onufri exercised his activity in Berat, Kostur and then Elbasan where he stayed longer.

A special role in the formation of Onufri was played by the city of Berat with its centuries-old culture, with the well-known centers of antiquity near Apollonia and Ballsh as well as with the art of mural painting of the thirteenth-fourteenth century.

Onufri's iconography was also accompanied by ethnographic elements.

Master Onufri is exalted before us as a painter of genius talent who mastered the art of painting and artistic culture with rare precision.

***Keywords:*** Onufri, icon, Albania, church, Berat

**Nertila HAXHIJA LJARJA, Zamira SHKRELI**

## **TURIZMI I ERRËT NË SHQIPËRI (RASTI I SHKODRËS) DHE KRAHASIMI ME PRAKTIKAT E EVROPËS LINDORE**

### **Objektivat e kërkimit dhe metodologjia**

Qëllimi kryesor i këtij studimi është të analizojë mënyrën se si zhvillohet turizmi i errët në Shqipëri përmes rastit të Shkodrës dhe të shqyrtojë rolin që kjo formë turizmi mund të luajë në ndërmjetësimin shoqëror të traumës historike të periudhës komuniste. Studimi synon të identifikojë potencialet dhe kufizimet e memorializimit të dhunës totalitare në Shqipëri, duke e vendosur këtë proces në raport krahasues me modelet e konsoliduara të memorializimit në Evropën Lindore, veçanërisht në Auschwitz-Birkenau në Poloni dhe në institucionet memoriale të Pragës, si Burgu i Pankrac dhe Memoriali Heydrich.

Në këtë kuptim, studimi mundohet të kuptojë se si konceptohet dhe ndërtohet memorializimi i traumës historike në Shkodër, çfarë e dallon këtë qasje nga përvojat e konsoliduara ndërkombëtare dhe si ndikon autenticiteti material, struktura edukative dhe narrativa shoqërore në përjetimin emocional dhe intelektual të vizitorëve. Duke u fokusuar te dimensionit i ndërveprimit të vizitorit me hapësirat memoriale, studimi kërkon të zbulojë se në ç' mënyrë mungesa e një politike të institucionalizuar të kujtesës dhe e një sistemi të standardizuar interpretimi historik e orienton përvojën e vizitës drejt një forme më personale dhe subjektive, në kontrast me modelet e Polonisë dhe Republikës Çeke ku memorializimi funksionon si instrument edukativ dhe etik me mesazh universal.

Metodologjia e përdorur në këtë punim mbështetet në një qasje cilësore me karakter krahasues dhe interpretativ. Ajo përfshin analizën e burimeve dokumentare dhe literaturës akademike mbi turizmin e errët, trashëgiminë e vështirë dhe antropologjinë e kujtesës, si dhe studimin e dokumenteve muzeale, raporteve institucionale dhe materialeve historike të lidhura me destinacionet e trajtuara. Përveç analizës teorike, studimi shfrytëzon një qasje të kufizuar etnografike përmes observimit të drejtpërdrejtë të hapësirave memoriale në Shkodër, duke marrë në konsideratë reagimet publike dhe diskursin shoqëror rreth përjetimit të traumës kolektive. Analiza krahasuese ndërmjet rasteve të Shkodrës,

Auschwitz-it dhe memorialeve çekë mbështetet në identifikimin e elementeve të përbashkëta dhe të dallimeve strukturore, duke u fokusuar në dimensione si autenticiteti material i hapësirës, intensiteti emocional i përjetimit, qasja pedagogjike dhe roli shoqëror i memorializimit.

Nëpërmjet kësaj qasjeje metodologjike, studimi synon të kontribuojë në debatin shkencor mbi mënyrat e ndërmjetësimit të traumës historike dhe zhvillimin e turizmit të errët në kontekste post-totalitare, duke propozuar një model të ri të memorializimit organik që mund të shërbejë si referencë akademike dhe praktike për zhvillimin e politikave kulturore dhe të menaxhimit të kujtesës historike në Shqipëri dhe më gjerë.

Turizmi i errët përkufizohet si një formë e veçantë e angazhimit kulturor, përmes së cilës individët vizitojnë hapësira të ngarkuara me trauma historike, dhimbje kolektive dhe ngjarje që kanë prodhuar pasoja të thella shoqërore. Ai nuk përbëhet thjesht nga prezenca fizike në vendet e tragjedisë, por nga përvoja reflektive që synon të ndërtojë kuptim moral, historiografik dhe identitar përmes dialogut me të kaluarën. Në literaturën bashkëkohore, ky fenomen lidhet me mënyrat e shoqërive moderne për të negociuar marrëdhënien me vdekshmërinë dhe memorien kolektive. Sipas Foley dhe Lennon (2000), të cilët e përcaktuan dhe e popullarizuan këtë koncept, turizmi i errët përfshin vizita në hapësira të stigmatizuara historikisht nga konflikte, gjenocide, diktatura dhe përvoja kolektive të dhunës së institucionalizuar.<sup>1</sup> Gjatë afro tre dekadave të fundit, studimet në këtë fushë kanë evoluar, duke eksploruar një spektër të gjerë praktikash – nga vizitat në kampet e spastrimit etnik deri te vendet e katastrofave – dhe duke krijuar një literaturë të pasur mbi tipologjitë, motivimet e vizitorëve, debatet etike dhe strategjitë e menaxhimit.

---

<sup>1</sup> “Lennon dhe Foley ofrojnë një përkufizim të shkurtër të turizmit të errët si një ‘interes turistik për vdekjet, fatkeqësitë dhe mizoritë e kohëve të fundit’ që rrjedh nga një ‘ndryshim themelor në mënyrën se si vdekja, fatkeqësitë dhe mizoritë po trajtohen nga ata që ofrojnë produkte turistike të lidhura’. Teza e tyre është se turizmi i errët është njëkohësisht një aludim i postmodernitetit dhe një konstrukt i praktikave të konsumit postmodern. Për t’i parafrazuar ato, asgjësimi i kohës dhe hapësirës përmes teknologjive globale të komunikimit kontribuon në rritjen e shfaqjeve vizuale të ngjarjeve të errëta. Objektet e turizmit të errët shkaktojnë ankth dhe dyshim për modernitetin dhe pasojat e tij që manifestohen në vizita (të qëllimshme ose të rastësishme), ose, thënë ndryshe, mundësinë për të zhvilluar një produkt turistik. Lennon & Foley, *Dark Tourism: The Attraction of Death and Disaster* (2000), fq.3-11.

[https://www.researchgate.net/publication/238353655\\_Dark\\_tourism\\_the\\_attraction\\_of\\_death\\_and\\_disaster\\_by\\_John\\_Lennon\\_and\\_Malcolm\\_Foley\\_Continuum\\_London\\_and\\_New\\_York\\_2000\\_No\\_of\\_pages\\_184\\_Price\\_1599\\_0-8264-5064-4#fullTextFileContent](https://www.researchgate.net/publication/238353655_Dark_tourism_the_attraction_of_death_and_disaster_by_John_Lennon_and_Malcolm_Foley_Continuum_London_and_New_York_2000_No_of_pages_184_Price_1599_0-8264-5064-4#fullTextFileContent)

Në këtë kontekst global, Shqipëria përbën një rast studimi veçanërisht me rëndësi. E izoluar për gati gjysmëshekulli nën një nga regjimet totalitare më të mbyllura në Evropë, vendi ka trashëguar një peizazh të pasur memorial të përbërë nga burgje, kampe pune, vende ekzekutimesh dhe bunkerë, të cilat përbëjnë një bazë unike për zhvillimin e një turizmi të errët autentik. Megjithatë, ky potencial mbetet kryesisht i pashfrytëzuar dhe i pastrukturuar. Qyteti i Shkodrës, me trashëgiminë e saj të thellë historike dhe institucione si Muzeu “Vendi i Dëshmisë dhe i Kujtesës”, shfaqet si një laborator për studimin e këtij fenomeni në kontekst shqiptar.

Për të pozicionuar përvojën shqiptare brenda diskursit ndërkombëtar, ky artikull ndërton një kuadër krahasues me tre destinacione të njohura botërisht të turizmit të errët: Pragën, me muzeologjinë e saj të sofistikuar të totalitarizmit; Varshavën, ku trashëgimia e Holokaustit dhe e Luftës është e endura në identitetin urban; dhe Auschwitzin, si simboli më universal i këtij lloji turizmi. Nëpërmjet kësaj kornize krahasuese, artikulli synon të nxjerrë në pah veçantitë, sfidat dhe mundësitë e pazbuluara që ofron rasti shqiptar, duke kontribuar në një kuptim më të thellë të mënyrës se si shoqëritë e përballojnë të kaluarën e tyre të vështirë nëpërmjet turizmit.

*“Shpesh argumentohet se shoqëritë moderne i ndajnë të gjallët nga të vdekurit. Vdekja, së bashku me çmendurinë dhe vuajtjen, në shoqërinë moderne është e izoluar, e fshehur, e ndaluar ose e mohuar... Megjithatë, ka shumë kanale përmes të cilave edhe në shoqëritë moderne të gjallët takohen me të vdekurit.”<sup>2</sup>*

Turizmi i errët përfaqëson një fenomen kompleks ku individët ndërveprojnë me vendet e lidhura me vdekjen dhe tragjedinë përmes një rrjeti marrëdhëniesh të ndryshme. Thelbi i këtij fenomeni qëndron në mënyrën se si kujtesa transmetohet ndër breza: nga përvoja direkte e brezit të parë, tek kujtimi emocional i brezit të dytë, dhe deri te lidhjet historike ose gjenealogjike të brezave të mëvonshëm. Ky proces formëson thellësisht mënyrën se si vizitorët i qasen këtyre vendeve – disa e përjetojnë atë si pasardhës me një lidhje personale me tragjedinë, ndërsa të tjerë e shohin si observatorë të largët historik.

Në thelb, turizmi i errët funksionon si një reflektim i marrëdhënieve shoqërore me vdekjen dhe kujtesën kolektive. Ai ofron një perspektivë mbi mënyrat se si shoqëritë përballen me të kaluarën e tyre të vështirë, duke përfshirë përkujdesjen ndaj të ndjerëve, shndërrimin e ngjarjeve tragjike në

---

<sup>2</sup> Walter, Tony. 2009. "Dark Tourism: Mediating Between the Dead and the Living." In *The Darker Side of Travel*, edited by Richard Sharpley & Philip R. Stone. [https://purehost.bath.ac.uk/ws/portalfiles/portal/370536/Walter\\_2009\\_Dark\\_Tourism.pdf](https://purehost.bath.ac.uk/ws/portalfiles/portal/370536/Walter_2009_Dark_Tourism.pdf).

objekte të edukimit publik dhe në forma të kontrolluara argëtuese, si dhe negocimin e vazhdueshëm midis kujtimit dhe harrimit. Çdo destinacion i turizmit të errët përfaqëson një kombinim të veçantë të këtyre elementëve, duke krijuar një peizazh memorial kompleks që vazhdimisht riformëson marrëdhëniet kolektive të shoqërisë me mortalitetin dhe trashëgiminë historike. Ky fenomen tregon jo vetëm perceptimet kulturore dhe etike mbi vdekjen, por edhe mënyrën se si kujtesa e kolektivit strukturohet, transmetohet dhe interpretohet ndër breza.

Turizmi i errët në Shkodër, Republikën Çeke dhe Poloni paraqet një spektër të gjerë përvojash vizitorësh, duke reflektuar thellësisht kontekstet historike dhe shoqërore të secilit vend.

Shtrirja e ndryshme e këtyre përvojave të vizitorëve, nga reflektimi i heshtur në Auschwitz tek autenticiteti i papërpunuar në Shkodër, mund të analizohet në detaj përmes gjashtë faktorëve kryesorë, siç paraqet në mënyrë krahasuese Tabela 1 më poshtë.

<b>Faktor / Vend</b>	<b>Shkodër (Shqipëri)</b>	<b>Pragë (Rep. Çeke)</b>	<b>Varshavë Auschwitz (Poloni)</b>
<b>Intensitet emocional</b>	Mesatar – vizitorët ndihen të shqetësuar, ndonjëherë paqartë për ngjarjet	I moderuar – informacioni edukativ ndihmon për kontroll të emocioneve	I lartë – përjetim dramatik dhe reflektim i heshtur
<b>Struktura edukative</b>	E kufizuar – mungesë materialesh të plota, interpretim i pjesshëm	E detajuar – ekspozita të hollësishme historike, shpjegime të qarta	E fuqishme – guidime të strukturuara, hapësira për reflektim
<b>Autenticiteti / origjinaliteti</b>	I lartë – objekte të paprekura historike si ish-Burgu i Sigurimit	Mesatar – objektet restauruara dhe të adaptuara për edukim	I lartë – struktura origjinale e kampit dhe memorialeve të ruajtura
<b>Ndërveprim me vizitorin</b>	I kufizuar – mungesa e interpretimit edukativ mund të	I strukturuar – vizitorët marrin kuptim dhe informacion të	I fuqishëm – vizitorët përjetojnë lidhje emocionale dhe

Faktor / Vend	Shkodër (Shqipëri)	Pragë (Rep. Çeke)	Varshavë / Auschwitz (Poloni)
	lërë ndjenjë të paplotë	plotë	reflektim
<b>Universaliteti i mesazhit</b>	I pranishëm – simbol i rezistencës dhe përballjes me harresën	I pranishëm – lufta kundër totalitarizmit dhe memorimi i viktimave	I lartë – simbol i çnjerëzimit dhe terrorit sistematik
<b>Qasje në reflektim</b>	E kufizuar – mungesa e hapësirave për reflektim të thellë	E moderuar – ekspozitat ofrojnë kuadër për reflektim dhe diskutim	E lartë – hapësira të kujdesura për heshtje, meditimin dhe reflektim

*Tabela 1: Krahasimi i përvojës së vizitorëve në tre vendet e trajtuara të Turizmit të Errët.<sup>3</sup>*

Siç nxjerr në pah tabela, ndërsa Auschwitz-i ofron një përvojë të lartë të strukturuar emocionale dhe edukative, rasti i Shkodrës dallohet për autenticitetin e lartë historik të vendeve si Ish-Burgu i Sigurimit të Shtetit, megjithëse i shoqëruar me një strukturë edukative të kufizuar dhe mjete të pakta për reflektim të udhëzuar. Ky kontrast thekson natyrën ende në zhvillim dhe organike të memorializimit në Shqipëri, në krahasim me modelin e standardizuar të Evropës Lindore.

Në Poloni, destinacione si Auschwitz-Birkenau krijojnë shpesh një reagim të thellë emocional dhe reflektim të heshtur mbi natyrën njerëzore dhe pasojat e dhunës sistematike. Në kontekstin e Auschwitz-Birkenau-së, vizita e turistëve përbën një dialog të fuqishëm mes emocioneve dhe reflektimit historik. Secili element – të brendshmet personale, objektet e ekspozuara, por edhe arkitektura e kampit – nuk është thjesht një relikte, por një katalizator që nxit një pasqyrë kritike mbi çnjerëzimin dhe strukturat sociale që e mundësuan gjenocidin.

Vizitorët përjetojnë një paradoks: autenticiteti fizik i kampit i jep atyre një ndjenjë realiteti historik, por përmasat e tmerrit janë kaq të mëdha

<sup>3</sup> Përpunim i autorëve bazuar në Light (2017) dhe Hodgkinson (2013).

sa që perceptimi i ngjarjeve mbetet pjesërisht i papërkufizuar. Kjo dyzimi krijon një përvojë komplekse — jo vetëm kujtesë pasive, por një përballje aktive me të kaluarën dhe pyetje ekzistenciale mbi natyrën njerëzore.

Për më tepër, funksioni edukativ i Auschwitz-it shtrihet përtej thjesht shpjegimit të fakteve. Memoriali i kërkon vizitorëve të reflektojnë mortalitetin, të mendojnë mbi përgjegjësitë kolektive dhe mekanizmat parandalues në shoqëritë moderne. Duke qëndruar fizikisht në vendin e tragjedisë, vizitorët nuk marrin pak njohuri abstrakte, por konvertohen në dëshmitarë të asaj që ka qenë — dhe paralajmërim për atë që mund të jetë — duke u bërë pjesë e një laborator social ku e shkuara dhe e tashmja bashkëveprojnë.<sup>4</sup>

Raporti i Muzeut Auschwitz-Birkenau 2023 (dokument i muzeut që tregon rolin e kujtesës pasluftës si themel i identitetit bashkëkohor dhe si muzeu menaxhon vizitorët dhe edukimin) thekson se pavarësisht kohës që kalon, puna për të ruajtur kujtimin fizik të Auschwitz-Birkenau dhe për të edukuar brezat e ardhshëm mbi pasojat e terrorit dhe luftës është më e rëndësishme sesa kurrë, veçanërisht në një kohë kur ideologjitë e urrejtjes po rilindin në mbarë botën.<sup>5</sup>

Ndryshe nga realiteti i ish-kampeve të përqendrimit nazist, si Aushvici, rasti i Shkodrës paraqet një model memorializimi të ndryshëm, të bazuar në trashëgiminë e periudhës komuniste në Shqipëri.

Ndërsa vendet memoriale në Evropën Lindore u hapën për publik në mënyrë të organizuar menjëherë pas Luftës së Dytë Botërore, në Shqipëri procesi i memorializimit të vendeve të lidhura me represionin komunist ka ndodhur në mënyrë më të ngadaltë dhe të decentralizuar. Vende si Ish-Burgu i Sigurimit të Shtetit në Shkodër kanë kaluar nëpër një transformim gradual nga hapësira të braktisura në vende me rëndësi memoriale, duke reflektuar një tranzicion social të pandërprerë drejt përballjes me të kaluarën.

Motivimet e vizitorëve në kontekstin shqiptar tregojnë dallime thelbësore nga modelet e Evropës Lindore. Në Shkodër, vizitat shpesh motivohen nga lidhje personale të drejtpërdrejta me viktimat e regjimit,

<sup>4</sup>Sarah Hodgkinson, “The concentration camp as a site of ‘dark tourism’”, *Témoigner. Entre histoire et mémoire* [Online], 116 | 2013, Online since 01 June 2015, connection on 11 April 2025. URL:

<http://journals.openedition.org/temoigner/272> ; DOI:

<https://doi.org/10.4000/temoigner.272>

<sup>5</sup>

[https://www.auschwitz.org/gfx/auschwitz/userfiles/\\_public/2024\\_news/auschwitz\\_raport\\_2023.pdf](https://www.auschwitz.org/gfx/auschwitz/userfiles/_public/2024_news/auschwitz_raport_2023.pdf)

ndërsa interesi për të kuptuar mekanizmat e shtetit totalitar ndërlidhet ngusht me përgjigjet për të dhënë kuptim historisë së afërt familjare. Ky ndryshim në motivim ndikon direkt në dinamikën e vizitës dhe në pritshmërinë e vizitorëve.

Sfidat e memorializimit në Shkodër ndryshojnë nga ato të Evropës Lindore. Ndërsa vendet e fundit përballen me probleme të ruajtjes së autenticitetit ndaj presioneve të turizmit masiv, Shkodra has në vështirësi të ruajtjes fizike të vendeve, mungesë të burimeve për interpretim profesional dhe vështirësi në integrimin e kujtimit personal në një narrativë historike koherente. Mungesa e një qasjeje të koordinuar ndaj memorializimit e bën këtë proces të varur nga iniciativat lokale dhe të pavarura.

Përvoja e vizitorëve në Shkodër karakterizohet nga një autenticitet i papërpunuar dhe i paformular, në kontrast me përvojën e standardizuar që ofrojnë vendet memoriale në Evropën Lindore. Kjo mungesë e strukturës formale, ndërsa paraqet vështirësi për vizitorët e jashtëm, ofron një rast studimi unik për proceset organike të formimit të kujtesës kolektive.

Në Shkodër, si dhe në shumë vende të tjera të Evropës, ekziston një shqetësim i përbashkët: si të tregohet vuajtja e së kaluarës turistëve pa e kthyer atë thjesht në një atraksion. Megjithatë, në rastin e Shkodrës, kjo çështje bëhet edhe më e ndjeshme. Arsyeja kryesore është se ngjarjet e kohës së diktaturës komuniste kanë ndodhur relativisht kohëve të fundit. Shumë prej njerëzve që i përjetuan ato vuajtje janë ende në jetë, dhe kujtimet e tyre janë ende të gjalla. Kjo e bën të vështirë trajtimin e këtyre vendeve si thjesht destinacione turistike. Përveç kësaj, nuk ka kaluar ende aq shumë kohë sa të krijohet një distancë e mjaftueshme historike për t'i vlerësuar këto ngjarje me objektivitet të plotë.<sup>6</sup>

Si përfundim, rasti i Shkodrës në studimin e turizmit të errët në Shqipëri ofron një perspektivë të rëndësishme krahasuese me praktikën e Evropës Lindore. Modeli i memorializimit organik dhe në zhvillim e shndërron Shkodrën në një laborator natyror për studimin e turizmit të errët në kontekste postdiktatoriale, duke kontribuar në kuptimin më të gjerë të mekanizmave të përballjes me të kaluarën e vështirë përmes turizmit.

Për të kuptuar më thellë rrënjët e këtyre dallimeve në përvojë, Tabela 2 ofron një krahasim sistematik të gjashtë aspekteve kryesore që përcaktojnë karakterin e secilit memorial.

---

<sup>6</sup> Xherardo Nikjari, Pjerin Mirdita, Nertila Haxhia Ljarja, "Zhvillimi i qëndrueshëm i turizmit të errët: perspektiva në Shkodër". Konferencën Shkencore "Sfidat e zhvillimit të turizmit të qëndrueshëm" -CONFTOUR 2025. (në proces botimi).

Tabela 2: Krahasim i aspekteve kryesore të vendeve të Turizmit të Errët<sup>7</sup>.

Aspekti	Shkodër (Shqipëri)	Auschwitz (Poloni)	Pankrac & Heydrich (Republika Çeke)
<b>Konteksti historik</b>	Diktatura komuniste	Holokausti, Gjenocidi nazist	Rezistenca kundër nazistëve
<b>Tipi i memorialit</b>	Burgje, kampe pune, bunkerë	Kamp përqendrimi dhe shfarosjeje	Burg, memorial rezistence
<b>Qasja ndaj turizmit</b>	Organike, e papërpunuar, jo e standardizuar	E standardizuar, edukative, reflektive	E strukturuar, kombinim edukimi dhe emocioni
<b>Motivimet e vizitorëve</b>	Lidhje personale, kërkimi i të kuptuarit të së kaluarës familjare	Reflektim mbi natyrën njerëzore, edukim historik	Edukim, lidhje emocionale me rezistencën
<b>Sfidat</b>	Mungesa e burimeve, ruajtja fizike, mungesa e një narativi koherent	Ruajtja e autenticitetit ndaj turizmit masiv	Balancimi midis edukimit dhe komodifikimit

<sup>7</sup> Përpunim i autorëve bazuar në Light (2017) dhe Hodgkinson (2013).

Aspekti	Shkodër (Shqipëri)	Auschwitz (Poloni)	Pankrac & Heydrich (Republika Çeke)
<b>Roli në shoqëri</b>	Përballje me të kaluarën komuniste	Paralajmërim kundër ideologjive të urrejtjes	Ndërtim i identitetit kombëtar përmes reflektimit

Ky krahasim konfirmon se sfidat kryesore për Shkodrën, të tilla si mungesa e burimeve dhe e një narrativi koherent, janë të ndërlidhura me kontekstin e saj historik të periudhës komuniste dhe procesin e saj memorial organik. Në të kundërt, vendet e Evropës Lindore kanë kaluar tashmë në një fazë menaxhimi të sofistikuar, ku fokusi ka kaluar te ruajtja e autenticitetit përballë turizmit masiv dhe përdorimi i kujtesës për ndërtim të qëndrueshëm identiteti.

Në Republikën Çeke, Burgun e Pankraç dhe Memorialin Heydrich në Pragë mund t'i konsiderojmë si dy vende kyçe që ilustrojnë mënyrën se si turizmi i errët bashkëjeton me trashëgiminë kulturore dhe edukimin historik. Të dyja institucionet ofrojnë një përvojë të strukturuar, ku informacioni historik dhe interpretimi pedagogjik bashkohen me intensitetin emocional të ngjarjeve të së kaluarës, duke krijuar një hapësirë reflektimi dhe ndërveprimi kritik për vizitorët. Burgun e Pankraç e karakterizon historia e tij represive, ku mijëra të burgosur u ekzekutuan për aktivitetet e tyre në rezistencën kundër pushtuesve nazistë. Ruajtja e objekteve origjinale, si dhomat e ekzekutimit dhe gjyqinat, si dhe dokumentacioni i sakrificave individuale, jo vetëm që ruan autenticitetin historik, por ofron gjithashtu një kuptim emocional të dimensionit njerëzor të dhunës shtetërore. Vizitorët janë të ftuar të përballen me realitetin e dhunës, duke përjetuar një përzierje të edukimit historik dhe përkujdesjes morale, ku e kaluara bëhet një udhërrëfyes për reflektim mbi drejtësinë dhe përgjegjësinë njerëzore.<sup>8</sup>

Në mënyrë të ngjashme, Memoriali Heydrich – i vendosur në Kishën e Shën Cirilit dhe Metodit – sjell historinë e një momenti kritik në historinë e Rezistencës Çeke gjatë Luftës së Dytë Botërore. Ekspozitat e tij nuk kufizohen vetëm në paraqitjen e fakteve historike, por përfshijnë elemente

<sup>8</sup> <https://english.radio.cz/inside-story-history-pragues-pankrac-prison-8550930>

vizuale, audio dhe artefakte që nxisin ndërveprimin e vizitorëve me narrativën e rezistencës dhe represionit. Kjo qasje e kombinon edukimin formal me përvojën emocionale, duke i lejuar vizitorët të kuptojnë jo vetëm mekanizmat e dhunës ideologjike, por edhe dimensionin moral të veprimeve individuale dhe kolektive gjatë periudhave totalitare. Në këtë mënyrë, këto institucione nuk janë thjesht vende kujtese; ato shndërrohen në hapësira aktive të përvetësimit të trashëgimisë kulturore, ku historia e dhimbshme e së kaluarës përbëhet me nevojën për edukim dhe përqaftim të vlerave të përgjegjësisë, demokracisë dhe dinjitetit njerëzor.<sup>9</sup>

Burgu i Pankraç dhe Memoriali i Heydrich në Prag shërbejnë si studime rasti ideale për të shqyrtuar ndërlikimet dhe thellësitë e turizmit të errët (*dark tourism*) dhe trashëgimisë së vështirë (*difficult heritage*). Fusha e turizmit të errët ka evoluar nga një fokus i ngushtë tek "vende të lidhura me vdekjen" drejt një kuptimi më të nuancuar të motivimeve, përvojave dhe konteksteve politike që e rrethojnë këtë fenomen.<sup>10</sup>

Në përputhje me këtë kuptim të zgjeruar, të dyja këto vende mund të konceptualizohen si "hapësira reflektive" ku vizitorët angazhohen jo vetëm me fakte historike, por edhe me dimensione emocionale dhe etike të së kaluarës. Në kundërshtim me paragjykimet e hershme që i përshkruanin vizitorët e vendeve "të errëta" si turistë pasivë ose si thjesht të motivuar nga kurioziteti, Light vëren se motivimi kryesor i shumë prej tyre është në fakt një dëshirë për të mësuar, për të kuptuar dhe për t'u lidhur emocionalisht me ngjarjet e kaluara.<sup>11</sup>

Në fakt, vizitorët modernë janë agjentë kritikë që negocojnë dhe krijojnë kuptimin e tyre në këto hapësira. Përvoja e vizitës shpesh përfshin dimensione emocionale komplekse—nga hidhërimi dhe tmerrri te respekti dhe shpresa—dhe mund të ketë një ndikim transformues në individë. Për të analizuar këtë dimension të përvojës së vizitorëve, mund të përdoret teoria e "mediacionit të vdekshmërisë" (*mortality mediation*), e paraqitur nga Stone dhe Sharpley.<sup>12</sup> Këta studiues argumentojnë se turizmi i

<sup>9</sup> <https://prague.eu/en/objevujte/national-monument-to-the-heroes-of-the-heydrich-terror-narodni-pamatnik-hrdinu-heydrichiady>

<sup>10</sup> Light, D. (2017). Progress in dark tourism and thanatourism research: An uneasy relationship with heritage tourism. *Tourism Management*, 61, 275–301. <https://doi.org/10.1016/j.tourman.2017.01.011>, (fq.276).

<sup>11</sup> Light, D. (2017). Progress in dark tourism and thanatourism research: An uneasy relationship with heritage tourism. *Tourism Management*, 61, 275–301. <https://doi.org/10.1016/j.tourman.2017.01.011>, fq. 285-286.

<sup>12</sup> Light, D. (2017). Progress in dark tourism and thanatourism research: An uneasy relationship with heritage tourism. *Tourism Management*, 61, 275–301. <https://doi.org/10.1016/j.tourman.2017.01.011>, fq. 287-289.

errët shërben si një mekanizëm social për të negociuar marrëdhënien me vdekjen në shoqëritë sekulare moderne, duke ofruar mundësi për reflektim të kontrolluar në hapësira të sanksionuara sociale.

Marrë parasysh këto funksione, mund të argumentohet se Burgu i Pankraç dhe Memoriali Heydrich nuk janë thjesht muze; ato shndërrohen në "laboratore të kujtesës". Në këto hapësira, diskutimet abstrakte mbi pushtetin, rezistencën dhe vdekshmërinë njerëzore bëhen të prekshme dhe të përhershme përmes narrativit historik dhe ambientit fizik, një proces që studiuesi Light e lidh me ndërtimin e identitetit kolektiv. Ato mishërojnë një ndërprerje midis turizmit tradicional të trashëgimisë dhe formave më të errëta të turizmit, duke i kërkuar vizitorit të angazhohet jo vetëm me "çfarë ndodhi," por edhe me "çfarë do të thotë kjo për ne sot." Këto vende luajnë një rol kyç në formimin e identitetit kolektiv. Ato shërbejnë si vende ku kujtesa kombëtare rindërtohet dhe negociohet, duke lejuar shoqërinë çeke të përballë pjesët më të errëta të historisë së saj dhe të ndërtojë një të ardhme mbi një kuptim të thellë dhe reflektuar të së kaluarës.<sup>13</sup>

Destinacionet e turizmit të errët në vende të ndryshme të Evropës – si Vendi i Dëshmisë dhe Kujtesës në Shkodër, kampi i Auschwitz-it ose Burgu i Pankrac në Pragë – tregojnë se si historia lokale mund të marrë një dimension universal. Fuqia e këtyre hapësirave qëndron në aftësinë e tyre për ta tejkalar kontekstin gjeografik dhe për t'u shndërruar në mësim të përgjithshme mbi çnjerëzimin, rezistencën dhe dinjitetin njerëzor. Vendi i Dëshmisë dhe Kujtesës në Shkodër përfaqëson qëndresën shpirtërore dhe refuzimin e nënshtrimit; Auschwitz mbetet simboli më i njohur i terrorit sistematik; ndërsa Burgu i Pankrac në Pragë mishëron historinë e rezistencës së heshtur ndaj aparatit totalitar.

Këto vende funksionojnë si forma të "trashëgimisë së pakëndshme" (dissonant heritage), ku dhimbja, trauma dhe represioni nuk paraqiten vetëm si episode historike, por si struktura për të kuptuar rreziqet e ideologjive çnjerëzuese në çdo kohë. Sipas Tunbridge & Ashworth (1996)<sup>14</sup>, trashëgimia e tillë nuk është vetëm ruajtje e mbetjeve fizike, por një proces i vazhdueshëm interpretimi që lidh të kaluarën me nevojat dhe dilemat morale të së tashmes. Prandaj, këto destinacione shndërrohen në hapësira edukative ku vizitorët ballafaqohen me dimensionin etik të së kaluarës dhe me përgjegjësinë për të ardhmen.

<sup>13</sup> Light, D. (2017). Progress in dark tourism and thanatourism research: An uneasy relationship with heritage tourism. *Tourism Management*, 61, 275–301. <https://doi.org/10.1016/j.tourman.2017.01.011>, fq. 294.

<sup>14</sup> Dissonant Heritage: The Management of the Past as a Resource in Conflict By J. E. Tunbridge and G.J. Ashworth. Wiley (Baffins Lane, Chichester PO 19 1UD, UK), 1996.

Siç e kanë treguar studime të tilla si ato të Stone dhe Sharpley (2008) dhe Light (2017), turizmi i errët në këto vende nuk përqendrohet vetëm tek sfidimi i vdekjes personale, por tek sfidimi i kujtesës kolektive dhe identitetit historik. Auschwitz nxit reflektim mbi narrativën evropiane të civilizimit; destinacionet e Çekisë sfidojnë mitin e qëndresës së vazhdueshme kundër pushtuesve; ndërsa Shkodra sfidon harresën dhe negocimin e vazhdueshëm me të kaluarën komuniste. Këto destinacione shërbejnë si pasqyra për shoqëritë përballë tyre, duke i detyruar të përballen me të vërtetën historike dhe të rindërtojnë identitetin kolektiv mbi baza më të ndërgjegjshme dhe autentike.

## BIBLIOGRAFIA

- Ariès, Philippe. 1974. *Western Attitudes toward Death: From the Middle Ages to the Present*. Translated by Patricia M. Ranum. Baltimore: Johns Hopkins University Press.
- Auschwitz-Birkenau State Museum. 2023. "Raport 2023." Accessed April 11, 2025. [https://www.auschwitz.org/gfx/auschwitz/userfiles/\\_public/2024\\_news/auschwitz\\_raport\\_2023.pdf](https://www.auschwitz.org/gfx/auschwitz/userfiles/_public/2024_news/auschwitz_raport_2023.pdf).
- Becker, Ernest. 1973. *The Denial of Death*. New York: Free Press.
- Giddens, Anthony. 1991. *Modernity and Self-Identity: Self and Society in the Late Modern Age*. Stanford, CA: Stanford University Press.
- Gorer, Geoffrey. 1965. *Death, Grief, and Mourning*. Garden City, NY: Doubleday.
- Hodgkinson, Sarah. 2013. "The Concentration Camp as a Site of 'Dark Tourism'." *Témoigner. Entre histoire et mémoire* 116. Accessed April 11, 2025. <http://journals.openedition.org/temoigner/272>. <https://doi.org/10.4000/temoigner.272>.
- Lennon, J. John, and Malcolm Foley. 2000. *Dark Tourism: The Attraction of Death and Disaster*. London: Continuum.
- Light, Duncan. 2017. "Progress in Dark Tourism and Thanatourism Research: An Uneasy Relationship with Heritage Tourism." *Tourism Management* 61: 275–301. <https://doi.org/10.1016/j.tourman.2017.01.011>.
- Nikjari, Xherardo, Pjerin Mirdita, and Nertila Haxhia Ljarja. Në proces botimi 2025. "Zhvillimi i qëndrueshëm i turizmit të errët: perspektiva në Shkodër" [Sustainable Development of Dark Tourism: The

- Perspective in Shkodër]. Konferenca Shkencore "Sfidat e Zhvillimit të Turizmit të Qendrueshëm" - CONF TOUR 2025. Shkodër.
- Prague.eu. n.d. "National Monument to the Heroes of the Heydrich Terror." Accessed April 11, 2025. <https://prague.eu/en/objevujte/national-monument-to-the-heroes-of-the-heydrich-terror-narodni-pamatnik-hrdinu-heydrichiady>.
  - Radio Prague International. 2018. "The Inside Story of the History of Prague's Pankrác Prison." Last modified February 18, 2018. Accessed April 11, 2025. <https://english.radio.cz/inside-story-history-pragues-pankrac-prison-8550930>.
  - Stone, Philip R., and Richard Sharpley. 2008. "Consuming Dark Tourism: A Thanatological Perspective." *Annals of Tourism Research* 35 (2): 574–95. <https://doi.org/10.1016/j.annals.2008.02.003>.
  - Tunbridge, J. E., and G. J. Ashworth. 1996. *Dissonant Heritage: The Management of the Past as a Resource in Conflict*. Chichester, UK: John Wiley & Sons.
  - Walter, Tony. 2009. "Dark Tourism: Mediating Between the Dead and the Living." In *The Darker Side of Travel: The Theory and Practice of Dark Tourism*, edited by Richard Sharpley and Philip R. Stone, 39–55. Bristol, UK: Channel View Publications.

## **DARK TOURISM IN ALBANIA (THE CASE OF SHKODRA) AND A COMPARISON WITH EASTERN EUROPEAN PRACTICES**

### ***ABSTRACT***

This study analyzes the development of dark tourism in Albania, taking the city of Shkodra as a case study and situating it within a comparative framework with established memorialization practices in Poland and the Czech Republic. Drawing on theoretical approaches from memorial tourism, difficult heritage, and the anthropology of memory, the article examines how historical trauma is mediated, the role of material authenticity, and the impact of cultural policies on visitors' experiences. The analysis shows that Shkodra presents a model of organic and still informal memorialization, which differs from the standardized and structured institutions of Auschwitz-Birkenau and Pankrác/Heydrich. The findings highlight the importance of integrating personal and collective narratives into a professional interpretive framework to avoid the fragmentation of memory and the trivialization of trauma.

Ultimately, the article argues that the case of Shkodra may serve as an important laboratory for the study of post-totalitarian memorialization and potentially as a development model for dark tourism destinations in the region.

**Keywords:** Dark tourism; Auschwitz-Birkenau; Pankrác; Heydrich; Shkodra; Collective memory; Post-communist heritage; Memorialization; Cultural tourism.

Anelmo SPAHIJA, Bendis KRAJA

**NË ANËN TJETËR TË ADRIATIKUT: LËVIZJA  
SHOQËRORE DHE POLITIKE NË ITALI NË  
MBËSHTETJE TË TË DREJTAVE KOMBËTARE TË  
POPULLIT SHQIPTAR GJATË LUFTËS SË VLORËS  
(QERSHOR-GUSHT 1920)**

**Konteksti historik: Shqipëria dhe Italia pas përfundimit të Luftës së Parë Botërore. Rënia e iluzioneve të pasluftës dhe kundërvënia e hapur.**

Në përfundim të Luftës së Parë Botërore Shqipëria u gjend me pjesën më të madhe të territorit të saj (Korça dhe hinterlandi i saj mbeteshin nën ushtrinë franceze, serbët vendosën nën kontroll luginën e Drinit të Zi, ndërsa Shkodra ishte nën administrimin ndërkombëtar) nën kontrollin ushtarak të Italisë. Projekti i parë i pavarësisë së vendit nën garancinë e gjashtë Fuqive të Mëdha, i shpallur në korrik 1913 kishte dështuar brenda pak muajsh. Revoltat e brendshme, mungesa e autoritetit të princ Vidit dhe administratës mbretërore, intervencioni i huaj, sidomos Greqisë, por edhe rivaliteti i vazhdueshëm austro-italian, si dhe fillimi i L.P.B. çuan në fundin e çdolloj autoriteti shtetëror, copëtimin e vendit fillimisht mes fraksioneve të ndryshme politike (Esat Pasha, administrimi ndërkombëtar në Shkodër, kryengritësit fundamentalistë të Shqipërisë së Mesme, banda vorio-epirote) e më pas me shndërrimin e tij në atë që historiografia përpara viteve 90' e cilësonte "shesh të luftës imperialiste"<sup>1</sup>, praktikisht me copëtimin e vendit kryesisht mes shteteve ndërluftuese Austrisë, Francës dhe Italisë. Përfundimi i luftës e gjente vendin në një situatë të tillë, ku ndërthureshin pritshmëritë ogurzeza të copëtimit të plotë mes fqinjëve sipas Traktatit të Fshehtë të Londrës dhe shpresës që ngërthenin parimet e vetëvendosjes kombëtare të popujve dhe të denoncimit të diplomacisë së fshehtë, të shpallura nga presidenti Uillson si bazë për vendimet e konferencës së paqes së Parisit.

Pritshmëri të mëdha për pasluftën kishte edhe klasa drejtuese italiane, e cila nën presionin e një minorance aktive intervencioniste, si dhe me

---

<sup>1</sup> Muin Çami, "Shqipëria në marrëdhëniet ndërkombëtare (1914-1918)", Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Tiranë, 1987, 211.

premtimet e Traktatit të Fshehtë të Londrës e kishin përfshirë Italinë në luftë në anën e Antantës<sup>2</sup>. Në këtë marrëveshje të fshehtë me Fuqitë e Antantës, Italia ishte angazhuar të përfshihej në luftë me premtimin për zgjerim pas luftës përveçse në territoret e Austro-Hungarisë (duke përfshirë ato që qarqet nacionaliste i konsideronin “territore irredente” në Trento, Istria, dhe porte të tjera të Dalmacisë), edhe Vlorën, së bashku me protektoratin mbi atë çfarë mbetej nga shteti i copëtuar shqiptar me Serbinë, Malin e Zi dhe Greqinë<sup>3</sup>. Zonën e hinterlandit të Vlorës, Italia e kishte siguruar që në dhjetor 1914, duke përfituar nga dakordësia e heshtur e Fuqive të Medha, të përfshira të luftë me njëra-tjetrën, me synimin gjithashtu që të përfshinin Italinë në bllokun e tyre. Kjo zonë e pushtimit italian ishte zgjeruar pas zbarkimit aleat në Greqi dhe krizës politike greke, pas së cilës ushtria italiane zëvendësoi forcat kostandiniste në zotërimin e territoreve të Shqipërisë së Jugut, përveç kazasë së Korçës që zotërohej nga ushtria franceze. Për të siguruar mbështetjen e popullsisë lokale e të patriotëve shqiptarë, si dhe për t’iu kundërvënë masave që kishin ndërmarrë francezët e austriakët në zonat e tyre të kontrollit, gjenerali Ferrero shpalli me 3 qershor në Gjirokatër, premtimet për pavarësinë e Shqipërisë dhe lejoi ngritjen e flamurit shqiptar<sup>4</sup>. Fundi i luftës dhe tërheqja e ushtrive austriake mundësoi përparimin e mëtejshëm italian në pjesën tjetër të vendit, të parcaktuar më sipër.

Pikërisht nga kjo situatë e re e krijuar pas përfundimit të luftës, buronin prishmëritë e politikës e jashtme italiane. Por synimet italiane në Shqipëri dhe Ballkanin Perëndimor u vendosën në pikëpyetje nga krijimi i Mbretërisë Serbo-Kroato-Sllovene, e cila u kundërvihej synimeve italiane në Dalmaci. Këtyre synimeve iu kundërvunë edhe Franca e Britania, që e shikonin Mbretërinë SKS si kundërpeshë ndaj zgjerimit të ndikimit italian në Mesdhe dhe Ballkanin Perëndimor. Gjithashtu, zgjerimi italian në këto territore nuk aprovohej plotësisht as nga pala amerikane. Presidenti Uillson i shikonte pretendimet italiane për zgjerim në territore me popullsi kroate si në kundërshtim me parimet e vetëvendosjes së kombeve. Gjithashtu, presidenti amerikan refuzoi të njihte traktatet e fshehta të pasluftës, si produkte të diplomacisë së vjetër të paraluftës, të bazuar vetëm në balancën e forcave mes Fuqive të Mëdha, pa marrë parasysh aspiratat e popullsisë lokale. Duke u nisur nga kjo, qeveritë italiane të pasluftës filluan ta përdorin Shqipërinë dhe çështjen shqiptare si “monedhë këmbimi” për

<sup>2</sup> Pierre Milza, “Historia e Italisë”, Dituria, Tiranë, 2012, 750-752.

<sup>3</sup> Paskal Milo, “Politika e Jashtme e Shqipërisë (1912-1939)”, Toena, Tiranë, 2013, 257-258.

<sup>4</sup> Po aty, 279.

pretendimet në Dalmaci, në negociatat me SHBA, Britaninë e Madhe, Francën dhe Mbretërinë SHK në të ashtuquajturën “Çështja e Adriatikut”<sup>5</sup>.

Pikërisht kjo e fundit ndikoi në armiqësimin gjithnjë e më të madh të faktorit politik dhe popullsisë në Shqipëri me Italinë, ushtrinë dhe politikën e saj të jashtme. Fillimisht, deklarata e gjeneralit Ferrero gjatë luftës, e më pas krijimi i qeverisë së Durrësit nën mbrojtjen Italiane, si dhe premtimet për të mbështetur pavarësinë dhe integritetin territorial të Shqipërisë në Konferencën e Paqes, u pritën mirë nga patriotët shqiptarë, e shikonin Italinë si mbrojtësen e vetme të vendit përballë pretendimeve greke dhe dhunimeve të sovranitetit territorial nga ushtria serbe e vendosur në luginën e Drinit të Zi. Mirëpo këto rezultuan vetëm premtime boshe nga ana italiane dhe iluzione që u shuan shpejt për delegatët shqiptarë në Paris. Në korrik 1919 qeveria italiane me synimin parësor për të marrë “territoret irredente” në Dalmaci, vendosi të ndryshojë strategjinë politike dhe të arrijë marrëveshje me Greqinë. Marrëveshja Titoni-Venizelos<sup>6</sup> garantonte njohjen e pretendimeve greke në Azinë e Vogël dhe në Shqipërinë e Jugut, në këmbim të mbështetjes nga pala greke të pretendimeve italiane në Dalmaci dhe në pjesën tjetër të Shqipërisë. Memorandumet e 14 dhjetorit 1919 dhe 9 janarit 1920, të arritura i pari me dakordësinë e Katër Fuqive fituese të luftës (SHBA, Francë, BM, Itali), ndërsa i dyti me një marrëveshje të fshehtë të tre fuqive evropiane pa praninë amerikane, për të rikthyer copëtimin e vendit sipas Traktatit të Fshehtë të Londrës, në këmbim të zgjerimit italian në Dalmaci, e acaroi edhe më tepër faktorin politik dhe patriotët shqiptarë kundër politikës italiane, por edhe asaj evropiane që i ishte rikthyer metodave të vjetra të diplomacisë<sup>7</sup>. Kjo nxiti në Shqipëri mbajtjen e Kuvendit të Lushnjës, dhe marrjen e masave të mëtejshme për unifikimin e vendit nën qeverinë e re të Tiranës, që zëvendësoi kudo qeverinë e Durrësit që kishte qenë e nënshtruar tërësisht ndaj Italisë.

Qeveria e Tiranës arriti të vendoste autoritetin në pjesën më të madhe të vendit. Ushtritë franceze u larguan, ndërsa me Greqinë që ishte e përfshirë në luftë me Turqinë, u arrit marrëveshja e njohjes reciproke të kufijve të vitit 1913 deri në vendimin përfundimtar të Fuqive të Mëdha. Për më tepër, presidenti Uillson refuzoi të njohë memorandumin e 9 janarit, duke penguar copëtimin e plotë të vendit. Ushtria italiane mbajti megjithatë të pushtuar Vlorën me hinterlandin e saj përgjatë Vjosës deri në Tepelenë.

<sup>5</sup> Po aty, 401 - 415.

<sup>6</sup> Art.: Alberto Becherelli, *L'Albania nella politica estera italiana (1913-1920)*, në: *L'Albania Indipendente e le relazioni italo-albanesi (1912-1920)*, Alberto Becherelli & Andrea Carteny (ed.), Roma: Edizioni Nuova Cultura, 2013, 58.

<sup>7</sup> Paskal Milo, 437, 445 - 447.

Për çlirimin e Vlorës, qeveria e Tiranës e kishte të qartë se nuk duhej të priste më tej ndërhyrje të tjera nga faktori ndërkombëtar. Qeveria e Tiranës nuk mund të përfshihej drejtpërdrejt në këtë operacion, që do të konsiderohej agresion i hapur, por organizoi fshehtas popullsinë lokale, e cila në kodrën e Baçallasë, 29 maj mori vendimet për fillimin e kryengritjes dhe dërgimin e ultimatumit për gjeneralin italian Piaçentini, për largimin e garnizoneve italiane. Kryengritja rezultoi një sukses i plotë për shqiptarët, të cilët në fund të qershorit çliruan pjesën më të madhe të territoreve përreth Vlorës, duke përfshirë Kotën, Gjormin, Drashovicën, Vajzën, Llogaranë, Këlcyrën dhe Tepelenën. Vlora u vendos në rrethim të plotë<sup>8</sup>. Disfata e garnizoneve italiane në Shqipëri lidhej me një varg faktorësh që përfshijnë situatën e vështirë të përballjes me popullsinë lokale, me probleme të furnizimit e të veshmbathjes, me përballjen me sëmundjen e malaries, me moralin e ulët të ushtarëve që nuk kishin gjithnjë e më pak motive për t'u përballur në një luftë me popullsinë shqiptare, që i kishin bazat tek situata e vështirë social-ekonomike në Italinë e pasluftës dhe mobilizimi i opinionit publik italian kundër luftës në Shqipëri.

### **Radikalizimi i masave të gjera të popullsisë në Italinë e pasluftës.**

Fundi i Luftës së Parë Botërore, solli për Italinë, ashtu si për pjesën më të madhe të shteteve evropiane, një krizë të thellë ekonomike e shoqërore. Dirigjizmi i periudhës së luftës kur shteti nxiste zhvillimin e industrive të lidhura me luftën mori fund, gjë që çoi mjaft prej tyre drejt deficitit dhe falimentit. Regjimi liberal u përball me rënien e prodhimit bujqësor, sidomos të prodhimit të grurit dhe rritjen me ritme të shpejta të deficitit tregtar. Shpenzimet e luftës kishin detyruar qeveritë italiane marrjen e borxheve të shumta, që në vitin 1920 arritën në 60 milionë lira, katër herë më shumë se më 1914. Të gjitha këto sollën inflacion monetar dhe rritjen marramendëse të çmimeve<sup>9</sup>.

Me hapa të shpejtë u thellua edhe kriza shoqërore. Me qindra e mijëra ushtarë që u kthyen nga fronti, për t'u përballur me pasojat e varfërimit të vazhdueshëm dhe të papunësisë. Industritë e mëdha filluan të ulin pagat dhe të shkurtojnë fuqinë punëtore. Një pjesë e tyre shkuan drejt falimentit. Mjaft prej ushtarëve që vinin nga radhët e fshatarësisë u ishte premtuar përfshirja në frontin e luftës me premtimin e shpërndarjes së tokave të latifondistëve, që vazhdonin të dominonin jetën ekonomike e shoqërore në jug të vendit. Por qeveritë e pasluftës nuk i mbajtën këto premtime. Në

<sup>8</sup> Arben Puto, "Shqipëria Politike", Toena, Tiranë, 2009, 267-269.

<sup>9</sup> Martin Clark, "Modern Italy (1871-1995)", Longman, London & New York, 206-207.

përgjithësi, vihej re në masën e popullsisë zhgënjimi nga lufta, nga një luftë e kushtueshme në jetë njerëzore dhe që kishte prodhuar varfëri e mjerim kudo. Kësaj i shtohej edhe modeli sovjetik, i asaj çfarë po ndodhte në Rusi, ku revolucioni kishte triumfuar, ku punëtorët kishin pushtuar fabrikat, toka u ishte shpërndarë fshatarëve dhe ishin formuar këshillat e punëtorëve, të fshatarëve e të ushtarëve<sup>10</sup>.

Situata politike e pasluftës u karakterizua nga maxhoranca të dobëta liberale, të arritura me mbështetjen demokristiane (PPI-Partito Popolare Italiano). Qeveritë e Orlandos e të Nitit nuk arritën të zhgjidhnin problemet e mprehta ekonomike e shoqërore të vendit. Ato u përballën edhe me disfatën në politikën e jashtme, pasi në Konferencën e Paqes së Parisit nuk arritën të siguronin realizimin e objektivave të dëshiruara për kontrollin e Fiumes dhe të porteve të tjera dalmatine. Kjo ndër të tjera nxiti edhe një valë revolte tek elementë intervencionistë të borgjezisë së vogël dhe lumpenproletariatit, ish-oficerë të klasës së mesme<sup>11</sup> që e shikonin veten të dekluar e të rrethuar me urrejtjen e bashkëpatriotëve të tyre, për shkak se e kishin çuar vendin drejt një lufte me pasoja të tilla. Kjo masë laramane ish-ushtarakësh, ultra-nacionalistësh, sindikalistësh revolucionarë, futuristësh u vendosën nën drejtimin e udhëheqësve si Gabriele D'Annunzio dhe pushtuan qytetin e kontestuar të Fiumes me 12 shtator 1919, duke filluar kështu atë që njihet si “kriza e Fiumes”<sup>12</sup>. Në këtë mënyrë, edhe ngritja e këtyre qarqeve ultra-nacionaliste dhe përpjekja për ta zhvendosur debatin politik të vendit drejt “çështjes nacionale”, drejt “fitores së gjymtuar” në vend të problematikave reale me të cilat përballeshin masat e gjera të popullsisë, ndikoi në radikalizimin e mëtejshëm të këtyre shtresave shoqërore.

Duke filluar nga pranvera e vitit 1919 në të gjithë Italinë shpërthyen manifestimet e punëtorëve e të fshatarëve, që u pritën me plumba nga xhandarmëria. Kjo u pasua në muajt e mëvonshëm me krijimin e një situatë revolucionare në të gjithë vendin. Veprimet u ndërmorën në pjesën më të madhe me mbështetjen e organizatave lokale të PSI, si dhe të sindikatave (CGdL-Confederazione Generale dell' Lavoro). Në PSI (Partito Socialista Italiano) në kongresin e tetorit 1919, një muaj përpara zgjedhjeve të përgjithshme, triumfoi rryma maksimaliste, e cila propagandonte zgjerimin e aktivitetit të partisë përtej rrugës parlamentare, në mbështetje të revoltave

<sup>10</sup> Norberto Bobbio, “Profilo ideologico del Novecento italiano”, Einaudi, Torino, 1986, 136-137.

<sup>11</sup> Pierre Milza, “Historia e Italisë”, Dituria, Tiranë, 2012, 757.

<sup>12</sup> Giovanni Sabbatuci & Vittorio Vidotto (ed.), “Storia d'Italia, 4. Guerre e Fascismo 1914-1943”, Laterza, 1997, 113-114.

popullore. Si rrjedhojë, në zgjedhjet nëntorit, PSI doli si forca më e madhe politike në Itali me 32,3% të votave<sup>13</sup>. Megjithatë maxhoranca u formua sërisht nga koalicioni i liberalëve dhe demokristianëve. Që në muajt e parë në të gjithë vendin shpërthyen grevat, manifestimet dhe përleshjet e masave popullore me karabinierët. Duke filluar nga marsi 1920, punëtorët në veri filluan pushtimin e fabrikave dhe formuan këshillat e punëtorëve. Ata kërkonin rritjen e pagave, kontratat kolektive dhe njohjen e funksioneve vendimmarrëse të këshillave të punëtorëve në fabrika. Ndërkohë, fshatarët filluan të okuponin tokat e latifondistëve dhe kërkonin ndërmarrjen e një reforme agrare. Këto lëvizje përfshinë pothuajse të gjithë vendin. Me qindra greva, manifestime dhe përleshje me forcat e rendit u regjistruan në të gjithë Italinë.

Në një situatë të tillë pothuajse revolucionare, periudhë e njohur si “Dyveçari i Kuq”, gjendej Italia në gjymën e parë të vitit 1920, kur kongresi i Lushnjës dhe më pas qeveria e Tiranës rrëzoi qeverinë e Durrësit të kontrolluar nga italianët, bashkoi vendin dhe filloi të mbështesë shpërthimin e kryengritjes në jug për çlirimin e Vlorës. Duke patur një situatë të tillë të acaruar të brendshme, qeveria Nitti e pati mjaft të vështirë të ndërmerre një luftë të hapur për mbrojtjen e protektoratit të Shqipëri. Megjithatë, përballë dështimeve në politikën e jashtme dhe krizës së Fiumes, ku bandat proto-fashiste e nacionaliste kontrollonin qytetin, qeveria italiane vendosi të mos tërhiqej për çështjen e Vlorës dhe të mbronte deri në fund pushtimin e Vlorës dhe hinterlandit.

Ndaj kësaj politike reagues faktorë të shumë politikë e shoqërorë të lidhur me të majtën italiane, duke përfshirë PSI me të gjitha rrymat e saj, sindikatën e përgjithme të punëtorëve CGdL, Shtëpitë e Punës në provinca, këshillat e punëtorëve, si dhe vetë ushtarët e mobilizuar për t’u dërguar për të luftuar në Shqipëri. Aksioni politik kundër dërgimit të ushtarëve italianë në luftë u zhvillua në disa forma duke përfshirë reagimin në parlament të deputetëve socialistë, reagimin në të përditshmen kryesore të PSI “Avanti” dhe në të përditshme të tjera, deri në radikalizimin e plotë me kryengritjen e ushtarëve dhe organizimin e manifestimeve e demonstratave për të penguar dërgimin e ushtarëve dhe furnizimeve drejt Shqipërisë.

#### **Aksioni parlamentar dhe i shtypit. Rënia e qeverisë Nitti**

PSI gëzonte në raport me socialdemokracitë e tjera evropiane prestigjin e refuzimit të LPB që në fillimet e saj (ndryshe nga partitë franceze e gjermane e austriake që kishin formuluar pretekste të ndryshme

<sup>13</sup> Giovanni Sabbatuci & Vittorio Vidotto (ed.), “*Storia d’Italia, 4. Guerre e Fascismo 1914-1943*”, Laterza, 1997, 115-117.

ideologjike për të mbështetur përfshirjen e shteteve të tyre në luftë). PSI kishte përdorur formulën “*ne aderire, në sabotare*”<sup>14</sup> (“as pjesëmarrje, as sabotim”). Që me përfundimin e luftës në retorikën e PSI merr rëndësi të vaçantë gjithnjë e më shumë ndër të tjera antimilitarizmi, kundërshtimi kundër asaj që shikohej si vazhdimësi e politikës imperialiste e kolonialiste të paraluftës nga regjimi liberal, dhe mbështetja për të drejtat e vetëvendosjes së kombeve. Këto parime justifikuan edhe zgjerimin dhe rritjen politike të partisë në Italinë e pasluftës, në një shoqëri të zhgënjyer nga lufta dhe në nevojë për reforma shoqërore. Pavarësisht rrymave të brendshme që përfshkonin partinë<sup>15</sup>, në rastin e shpërthimit të kryengritjes së Vlorës dhe kryengritjes së ushtarëve, PSI u gjend e bashkuar në mbështetjen e kësaj kauze.

Në arkivin e “Avanti” ka me dhjetëra artikuj e njoftime në lidhje me luftën e Vlorës, kundërshtimin e saj dhe mbrojtjen e të drejtave të popullit shqiptar për kryengritjen. Duhet thënë se në këtë periudhë të fillimviteve 20’ “Avanti” ishte ndër gazetat më të lexuara në Itali, në një kohë që shtypi përbëntë mjetin e vetëm të informacionit për opinionin publik. Me 8 qershor grupi parlamentar socialist paraqiti përpara Dhomës së Deputetëve kërkesën për çmobilizimin e ushtrisë. Me 11 qershor qeveria Nitti, përballë bllokimit të vendit nga grevat e manifestimet, si dhe rrethimit të ushtrisë në Shqipëri, jep dorëheqjen. Në vend të tij formohet kabineti i ri qeveritar me në krye liberalin e vjetër Xhovani Xhioliti. Me 13 qershor faqet e “Avanti” hapen me kryetitullin “*Nuk duam pushtime ushtarake në Shqipëri*”<sup>16</sup>. Pothuajse e gjithë fleta hapëse i dedikohet luftës që po bëhej në Shqipëri. Denoncohet lufta imperialiste dhe përpjekja e qeverisë për të mbajtur nën

<sup>14</sup> Martin Clark, 198.

<sup>15</sup> Rryma reformiste synonte që në betejën politike të partisë të mbizotëronë rruga parlamentare, ndërsa grevat dhe manifestimet të ishin të përkohshme e të shërbenin për arritjen e një marrëveshje të favorshme për punëtorët me qeverinë dhe industrinë e madhe. Reformistët kishin shumicën në grupin parlamentar dhe kryesinë e CGdT. Ata përfaqësoheshin nga intelektualë themelues të partisë si Filipo Turati, Treves etj. Rryma që arriti të bëhej mbizotëruese në parti, pas kongresit të tetorit 1919 ishte rryma maksimaliste e drejtuar nga drejtori i “Avanti” Mentore Xhiaçinto Serrati. Maksimalistët pavarësisht se e mbështesnin aksionin e grupit parlamentar, deklarorin se ai ishte i pamjaftueshëm. Maksimalistët mbështesnin aksionin e masave, grevat dhe manifestimet, që duhej të vazhdonin deri në rënien e qeverive liberale dhe ardhjen në pushtet të PSI. Ato ishin të ndikuar edhe nga ngjarjet revolucionare në Rusi. Shiko: Spencer di Scala, “*Italian Socialism, between politics and history*”, University of Massachusetts Press, 1996, 48-49; Giovanni Sabbatuci & Vittorio Vidotto (ed.), 117-118.

<sup>16</sup> “Avanti”, Anno XXIV-Nr. 140, 13 giugno 1920, fl.1. “*Non vogliamo conquiste militari in Albania!*”

zgjedhë popujt e tjerë. I bëhet thirrje të gjithë strukturave të partisë, grupit parlamentar (numerikisht ishte grupi më i madh parlamentar) dhe krerëve të sindikatave, punëtorëve dhe ushtarëve të thirrur që të zhvillojnë një aksion të fortë kundër luftës dhe dërgimit të ushtarëve: “*Populli italian nuk do t’ia dijë më për aventurat e luftërave. Për asnjë arsye dhe për asnjëlloj çmimi. Në qoftë se trupat italiane nuk janë të dëshirueshme në Vlorë, le të largohen sepse nuk është shtëpia e tyre*”<sup>17</sup>. Denoncohen gjithashtu edhe thirrjet e fundit të intervencionistëve të vjetër e të rinj (mbështetës të qeverisë, danuncianë, fashistë, futuristë) për të mbrojtur interesat strategjike në Vlorë. Vihet në dukje se tashmë italianët nuk do të mashtroheshin për herë të dytë, siç kishte ndodhur në pranverën e vitit 1915. Një rëndësi e tillë i kushtohet jo rastësisht ngjarjeve në Shqipëri, duke patur parasysh edhe atë çfarë kishte ndodhur në Trieste një ditë më parë.

Me 11 qershor në Trieste shpërtheu ajo që njihet si Revolta e Arditëve, e mbështetur nga Dhomat e Punës, punëtorët dhe shtypi socialist. Arditët refuzuan të zbatonin urdhrin e grumbullimit në kazerma dhe nisjes për në Vlorë. Brenda pak orësh u formua një kortezh i madh me mijëra gra e punëtorë e me ushtarët në krye, i cili filloi demonstratën përpara kazermës së qytetit, ku nuk vonuan të nisnin përleshjet me forcat e rendit, gjatë të cilave pati edhe viktime në radhët e rebelëve. Vetëm ndërhyrja e drejtpërdrejtë e komandës ushtarake pas mesnatës, kishte vendosur edhe njëherë rendin, dhe kishte arritur të dërgonte drejt Vlorës, vetëm një pjesë të vogël të ushtarëve<sup>18</sup>.

Këto ngjarje, që ishin treguese të gatishmërisë së përgjithshme shoqërore për t’iu përgjigjur pozitivisht thirrjes së opozitës dhe ushtarëve kryengritës, nxitën intensifikimin e aksionit politik. Me 15 qershor kryesia e PSI dhe CGdL i bënte thirrje klasës punëtore italiane që pengonte me çdo mënyrë nisjen e ushtarëve për në front. Në të gjithë vendin Shtëpitë e Punës do të zhvillonin takime për të organizuar aksionin politik për t’i bërë ballë me çdo mënyrë “*rrezikut të përhapjes së konflikteve të përgjakshme, që përfaqësojnë shkelje kriminale ndaj qytetërimit dhe të drejtës së popujve për të zotëruar fatet e tyre*”<sup>19</sup>. Në faqet e “Avantit” tashmë hyhet më thellë në bërjen të njohur për publikun të çështjes shqiptare. Në “*Shkaqet e revoltës shqiptare*” trajtohen kërkesat e shqiptarëve për zgjerimin e prerogativave administrative, refuzimin italian dhe burgosjen e patriotëve shqiptarë, e më në fund ultimatumit e dërguar komandës italiane. Njoftohet

<sup>17</sup> Po aty, fl.1

<sup>18</sup> Po aty, fl.1. “*Conflitti a Trieste*”

<sup>19</sup> “Avanti”, Anno XXIV-Nr. 143, 15 giugno 1920, fl.1. “*Ancona è sempre contro le avventure di guerra*”.

fillimi i luftimeve dhe hedhja në erë e urave në Tepelenë e Himarë nga ana e shqiptarëve. Në artikullin “*Gjendja katastrofike e ushtrisë*” denoncohet mënyra se si agjencia zyrtare Stefani njoftonte publikun për gjendjen e ushtrisë dhe mundohej të fshihte situatën reale në front dhe vështirësitë e ushtrarëve të thjeshtë italianë. Agjencia Stefani akuzohej se përfitonte nga mungesa e informacionit të publikut të gjerë italian, për të zvogëluar tërheqjen e ushtarëve italianë dhe përparimin e kryengritësve në kodrat përreth Vlorës. Po kështu, denoncohen edhe lajmet e rreme që gazetaret proqeveritare kishin dhënë për situatën ushtarake në Tepelenë, e cila ishte rrethuar dhe dorëzuar nga uria. Asnjë prej këtyre gazetave nuk fliste për rënien rob të të gjithë regjimentit 71 në duart e kryengritësve shqiptarë. Artikulli njoftonte se brigada “Pulja” kishte “shpërndarë të vdekurit e vet që kur zbarkoi me 30 gusht 1918<sup>20</sup>”. Së fundi, në “Avant:i botohet edhe njoftimi mbi vrasjen e Esat Pashës në Paris në hotel Kontinental nga “një student i pedagogjisë”, Avni Rustemi. Pasi jepen informacionet e përgjithshme mbi ngjarjen, në fund paraqitet qëndrimi i redaksisë së përditshmes socialiste: “*Esat Pasha ka qenë gjithmonë një instrument i Antantës. Ai e vendoste gjithnjë Shqipërinë në ankand, duke patur edhe shpresën që të bëhej mbret. Le të kujtojmë nderimet gati mbretërore që iu bënë në Romë kur erdhi këtu si agjent i Italisë. Më vonë ndodhi prishja e marrëdhënieve. Pastaj Esati shkoi në Paris, më shumë për të bërë interesat e tij se sa ato të vendit të vet*”<sup>21</sup>.

E njëjta polemikë kundër luftës vazhdon edhe pas formimit të qeverisë së re të Xhovani Xhollitit. Qeverisë i kërkohet që të largohet nga ato që konsiderohen “*aventurat e rrezikshme të luftës në Libi e Shqipëri*”<sup>22</sup> ndërkohë që përballet me problematikat e pafundme të brendshme. Një vështrim më i thelluar jepet mbi arsyet e rebelimit të popullit shqiptar, duke e vënë theksin tek aspiratat e drejta nacionale të patriotëve shqiptarë dhe politikës së gabuar të ndjekur nga qeveria italiane. Vihet në dukje kontradikta mes deklaratave të luftës e bërë nga autoritetet italiane në Shqipëri në qershor 1917, me pazaret e bëra pas luftës në Konferencën e Paqes për copëtimin e vendit (marrëveshjet Titoni - Venizelo, memorandumet e dhjetorit dhe janarit). Një përgjegjësi të veçantë kishte edhe komanda ushtarake me politikën që kishte ndjekur në Shqipëri, duke refuzuar dorëzimin e administratës civile për qeverinë e Durrësit dhe

<sup>20</sup> “Avanti”, Anno XXIV-Nr. 143, 15 giugno 1920, fl.1. “*La disastrosa situazione militare*”.

<sup>21</sup> “Avanti”, Anno XXIV-Nr. 143, 15 giugno 1920, fl.1. “*Essad Pascia ucciso da un studente albanese*”.

<sup>22</sup> “Avanti”, Anno XXIV-Nr. 145, 18 giugno 1920, fl.1. “*Due avventure pericolose di guerra: Libia e Albania*”.

përpjekjet për të ruajtur me çdo kusht kontrollin ushtarak në vend, gjë që kishte bërë që patriotët shqiptarë të humbisnin plotësisht besimin tek Italia dhe të shkonin drejt rebelimit dhe rrëzimit të qeverisë së Durrësit. “Gjeneralët tanë, nga Kadorna tek Piaçentini, janë shkatërrimi i Italisë, sidomos kur bëjnë politikë”<sup>23</sup>. Politika e refuzimit të çdo negociate me qeverinë e Tiranës, vendosja e represionit ushtarak në Vlorë, e arrestimeve në masë, djegia e shtëpive të atyre që kishin kaluar në mbështetje të qeverisë së Tiranës, si rasti i ish-prefektit Kasëm Qafëzezi, kishte çuar në rebelimin e shqiptarëve, dhe suksesin e mëtejshëm të kryengritjes. Në kushte të tilla, ishte absurde që qeveria kërkonte të dërgonte sërish bijtë e italianëve të vdisnin në malet e Shqipërisë. Në të njëjtën ditë, në “Avanti” u botua edhe një artikull i presidentit të Federatës shqiptare të Bostonit, Kriston Kirka, i cili kërkon bashkimin e popullit italian në përpjekjet e popullit shqiptar për vetëvendosje kombëtare.

Çështja e luftës dhe çështja shqiptare gjen mbështetje gjatë këtyre ditëve edhe në sektorët anarko-sindikalistë<sup>24</sup>, që nuk kishin përfaqësim parlamentar, por kishin ndikim jo të vogël në lëvizjen punëtore dhe në selitë e sindikatave. Qëndrimet e tyre shfaqen në faqet e të përditshmes “Umanita Nova”. Në artikullin “Lufta në Shqipëri”, denoncohet, me një retorikë mjaft radikale politika e jashtme imperialiste e shtetit italian ndaj Shqipërisë, që gjatë LPB e deri në pranverën e vitit 1920. Denoncohen gjithashtu edhe grupet e interesit që i kishin shtyrë qeveritë italiane drejt pushtimit të Shqipërisë. Kërkohet nga populli italian që të refuzojë luftën: “Populli italian, nuk mund dhe nuk do të jetë pjesëmarrës në krimin që po ndërmerret (nga qeveria. aut). T’i lëshohet Shqipëria shqiptarëve. Flitet për protektorat italian. Por të gjithë e dinë se ‘mbrojtja’ e ofruar nga një Shtet nënkupton shtypjen...Edhe pushtimi i vetëm portit të Vlorës, do t’i hiqte

<sup>23</sup> Po aty, fl. I. “Perche si e ribellato il popolo albanese”.

<sup>24</sup> Anarko-sindikalistët ishin grupime të së majtës jashtëparlamentare, të cilët në aksionin e tyre politik i jepnin rëndësi ekskluzive formave të aksionit voluntarist revolucionar, refuzonin pjesëmarrjen në insitucionet përfaqësuese, dhe mohonin rëndësinë e përdorimit të “makinerisë” së shtetit si një fazë e ndërmjetme mes kapitalizmit dhe socializmit, duke nënvizuar rreziqet e krijimit të një regjimi të ri autoritar, siç kishte ndodhur në Rusi. Anarko-sindikalistët gjenin mbështetje në sektorë të ngushtë të punëtorisë, kryesisht të fshatit dhe në elementë të izoluar intelektualë të provincës. Ata kishin themeluar Bashkimin Anarkist Italian dhe kishin si personalitet kryesor revolucionarin e vjeter anarkist Erriko Malatesta. Pavarësisht se nuk kishin influencën e socialistëve luajtën një rol të rëndësishëm në kundërvënien ndaj instalimit të regjimit fashist. Art.: Giampietro Berti, “Il programma anarchico”, në: “L’Unione Anarchica Italiana. Tra rivoluzione europea e reazione fascista 1919–1926. Pisa: Biblioteca Franco Serantini, 2006”, 29-39

*Shqipërisë daljen më të mirë tregtare*<sup>25</sup>.

Dështimet e mëtejshme në Shqipëri e diskredituan më tej qeverinë italiane dhe përpjekjet e saj për mobilizimin ushtarak. Çështja e Shqipërisë u ngrit vazhdimisht në Dhomën e Deputetëve nga grupi parlamentar socialist. Opinioni publik (përveç minorancave aktive intervencioniste që ishin të përqendruara në çështjen e Fiumes) ishte tejet i radikalizuar tashmë kundër luftës. Me 24 qershor u mor vendimi që të ndërmerreshin të gjithë masat e mundshme në bashkëpunim më Konfederatën e Përgjithshme të Punës për parandalimin e përfshirjes së vendit në luftë<sup>26</sup>. Kjo lidhej me përpjekjet që po bënte qeveria dhe komanda ushtarake që të mobilizonte ushtarë dhe të grumbullonte furnizimet nga portet e Ankonës e të Brindizit. Pas dorëzimit të Tepelenës, komanda ushtarake ishte e gatshme të sakrifikohej më tej përmbajtjen e Vlorës me çdo kusht. Prandaj Shtëpitë e Punës dhe strukturat e partisë dhe të shtypit opozitar u angazhuan për të organizuar popullsitë lokale që të mbështeste ushtarët që kundërshtonin dërgimin në Shqipëri. Në të njëjtën ditë, “Avanti” satirizon qarqet intervencioniste dhe nacionaliste, që kishin premtuar “parajsën shqiptare” si shpërblim për gjakun e derdhur në luftë nga ushtarët italianë. Ky premtim tregon dekadencën e tyre morale, si dhe dritëshkurtësinë në nënvlerësimin e faktorëve ndërkombëtarë dhe të lëvizjes kombëtare në Shqipëri. Ushtria nuk kishte ç’të bënte më në Shqipëri, përveçse t’i jepte fund luftimeve dhe të largohej nga Vlora. Së fundi, nga faqet e “Avanti” lëshohej thirrja që u bë motoja e aksionit politik të ditëve të mëvonshme “*Via da Valona*”<sup>27</sup>.

### **Revolta e bersaljerëve të Ankonës dhe rebelimi i Brindizit**

Në ditët në vijim kundërshtimi i luftës mori trajta gjithnjë e më radikale. Me 25 qershor bersaljerët e regjimentit 11 filluan përpjekjet për t’u organizuar për të mos zbatuar urdhrat për t’u nisur për në Vlorë me piroskafin “Magiar”. Për të siguruar një mbështetje masive të revoltës, u vendosën në kontakt me seksionet socialiste, anarkiste, republikane, si dhe me Dhomat e Punës, të cilat kishin mundësinë të mobilizonin klasën punëtore të kantierëve dhe industrive përreth, si dhe popullsinë civile. Në mesnatë, bersaljerët u futën në kazermën Villarey, komandatin dhe morën në kontroll kazermën. Njëkohësisht u shpërndanë armatime edhe për popullsinë. Të nesëmen kazerma buçiste nga koret “*In Albania non si va!*” (“Nuk nisemi për Shqipëri” përkth. konvencional). Komanda ushtarake e

<sup>25</sup> “Umanita Nova”, Anno I, N. 94, 17 giugno 1920, fl. 1. “*La guerra in Albania*”.

<sup>26</sup> “Avanti”, Anno XXIV-Nr. 151, 25 giugno 1920, fl. 1. “*Il Gruppo socialista alla reccisa opposizione*”.

<sup>27</sup> Po aty, fl.1. “*Il paradiso albanese*”.

Ankonës vendosi të dërgonte ushtrinë, e cila rrethoi kazermën dhe mori urdhër ta godiste me artileri deri sa të rebeluarit të dorëzoheshin. Por urdhrat nuk u zbatuan sërish, pasi një pjesë e bersaljerëve u solidarizuan dhe u bashkuan me kazermën e revoltuar. Përballë agresionit ushtarak, u angazhua mobilizimi popullor. Organizatat sindikaliste Shtëpitë e Punës në marrëveshje se seksionet opozitare (socialiste, republikane, anarkiste) shpallën grevën e përgjithshme në Ankona. Në të gjithë industrinë dhe kantieret e portit u ndalua puna. Në rrugët e qytetit filluan manifestimet dhe thirrjet për largimin e ushtrisë. Megjithatë edhe përballë presionit popullor, komanda ushtarake e vazhdoi rrethimin. Nga ana tjetër përpjekjet e kazermës për të çarë rrethimin e për t'u lidhur me Shtëpinë e Punës, që organizonte kryengritjen popullore nuk rezultuan të suksesshme. Në mesditë u arrit marrëveshja për dorëzimin e kazermës dhe të armëve, me kusht largimin e bersaljerëve dhe lirimin e tyre nga detyrimi për t'u dërguar në Shqipëri. Përballë përpjekjeve për të shpërndarë manifestuesit, e gjithë Ankona kaloi në kryengritje. Luftimet mes kryengritësve dhe forcave qeveritare vazhduan deri në pasditen e datës 27 qershor.

Ngjarjet e Ankonës u pasqyruan gjerësisht në faqet e “Avantit”<sup>28</sup>. Përveç kësaj, me 29 qershor PSI dhe CGdL lëshuan thirrjen për punëtorët dhe ushtarët që të vazhdonin rezistencën kundër luftës në Shqipëri: “Punëtorë, Ushtarë! Qëndroni të gatshëm për çdo zhvillim. Shtrëngoni dorën me vëllazëri. Çdo përpjekje për ekspedita të reja, vazhdimin i operacioneve ushtarake në Shqipëri, apo shpërthimi i reaksionit me qëllim hakmarrjeje për ngjarjet në Ankona ose në pjesë të tjera të Italisë, le t'ju gjejë të përgatitur për urdhrat që, në raste të tilla, do të dimë t'ju japim.”<sup>29</sup>. Qeveria e Xhollitit gjendej kështu sërish përballë rrezikut të revolucionit. Lëvizja kundër luftës u përhap me përmasa më paqësore, edhe në pjesë të tjera të Italisë, si në qytetet e Markeve (Maçerata, Pezaro, Fano), në Romanja (Çezena, Forli). Greva të përgjithshme u shpallën edhe në Romë, Milano, Torino e Parma, duke zgjatur tri ditë, deri më 29 qershor.

Ndërkohë në Brindizi, një nga portet kryesore të grumbullimit të ushtarëve për në Shqipëri, u krijua një situatë e ngjashme me atë të Ankonës. Pikërisht ngjarjet e Brindizit do t'i vinin kapakun çështjes së

<sup>28</sup> “Avanti”, Anno XXIV-Nr. 151, 27 giugno 1920, fl.1: “*I bersaglieri di Ancona si amutinano per non partire in Albania*”; “Avanti”, Anno XXIV-Nr. 151, 27 giugno 1920, fl.1: “*Il paese e i soldati non vogliono avventure di guerra: La rivolta di Ancona e l'azione parlamentare dei socialisti costringono il governo a dichiarare che non invia truppe in Albania*”.

<sup>29</sup> Po aty, 27 giugno 1920. “*Il manifesto del Partito Socialista e della Confederazione del Lavoro al proletariato italiano*”.

dërgimit të trupave të tjera në Shqipëri. Me 29 qershor 1920 arditë u sollën nga Palermo në Brindizi për t'u transportuar përmes piroskafit "Molfetta" drejt Vlorës. 40 prej tyre hipën në bord ndërsa 80 të tjerët refuzuan. Kësaj iu bashkua edhe masa popullore prezente e cila filloi të lëshonte thirrje kundër nisjes së djemve në luftë: "*Vigliacchi! Venduti! Scendete! ...Abbasso la guerra!*" ("Të poshtë, të shitur, zbrisni. Poshtë lufta!"). Në burimet e shtypit të kohës përmendet punëtorja Teodora Nuzzo që kishte hipur në skaletën e piroskafit duke i nxitur arditët që t'u rezistonin urdhrave e të mos niseshin. Nga këtu filloi një betejë në port mes arditëve të rebeluar dhe atyre që kishin vendosur të niseshin. Këtyre të fundit iu bashkuan edhe forcat e rendit, karabinieria dhe përforcimet e ushtrisë. Me arditët e rebeluar u bashkuan edhe një pjesë e popullsisë së qytetit. Mofeta u nis pas mesnate për të Vlorë me vetëm 40 arditë, ndërsa luftimet vazhduan në qytet. Pjesa më e madhe e arditëve të rebeluar u shpërndanë, ndërkohë në qytet pasuan represionet dhe arrestimet ndaj kryengritësve, që ishin kryesisht punëtorë, sindikalistë dhe aktivistë të forcave opozitare (socialistë, republikanë, anarko-sindikalistë)<sup>30</sup>.

### **Aksioni parlamentar dhe tërheqja e qeverisë italiane**

Lëvizjet e tre ditëve të fundit, të zhvilluara në formën e revoltave të ushtarëve, manifestimeve popullore e grevave punëtore u shoqëruan edhe me një aksion të fortë politik të forcave parlamentare socialiste në Dhomën e Deputetëve. Qeveria Xholiti, nga ana tjetër u detyrua të ndërmerre hapa mbrapa, gjithnjë duke u përpjekur të shpëtonte atë çfarë mund të shpëtohej, duke u munduar të realizonte një tërheqje gjithsesi të kujdesshme nga pozicionet e saj. Përballë ngjarjeve të Ankonës, Xhovani Xholiti deklaroi se qeveria do të hiqte dorë nga ideja e protektoratit italian për Shqipëri. Mirëpo për sa i përket Vlorës, ai paraqiti argumentin se ushtarët italianë ishin sulmuar nga shqiptarët dhe ishin të detyruar të mbroheshin. Vlora kishte një rëndësi strategjike në Adriatik për Italinë, ndërkohë që një shtet i pavarur shqiptar "në gjendje anarkie", sipas Xholitit nuk do të ishte i aftë ta mbronte përballë një agresioni të shteteve fqinje. Kryeministri italian deklaroi se nuk do të dërgoheshin më trupa në Vlorë, megjithatë lufta do të vazhdonte.

Me 27 qershor grupi parlamentar socialist, kërkoi vendosjen në rendin e ditës çështjen e largimit të trupave italiane nga Vlora. Në kërkesën e deputetit Maffi, të mbështetur nga deputetët e tjerë Mateoti, Bianchi,

<sup>30</sup> Donato Peccerillo, Da Brindisi ad Ancona e Trieste, la rivolta degli Arditi, <https://www.patriaindipendente.it/longform/da-brindisi-ad-ancona-e-trieste-la-rivolta-degli-arditi/>

Rivella, Vella vinte në dukje kontradiktën e deklaratave të qeverisë për njohjen e pavarësisë së Shqipërisë dhe dërgimin atje të trupave pushtuese. Dallohej gjithashtu edhe ndërhyrja e Xhuzepe Modiljanit, i cili theksoi se nuk duhen dërguar më ushtarë në Shqipëri. Ai denoncoi justifikimet e komandës ushtarake dhe ministrin të Luftës Ivanoe Bonomit që ushtarët e dërguar ishin “vullnetarë”, ndërkohë që më pas për çudi këto “vullnetarë”, kur dërgoheshin në front rebeloheshin. Ai hodhi poshtë pretendimet imperialiste të nacionalistëve se përmes pushtimit shpërndaheshin të mirat e civilizimit dhe gjoja ndihmoheshin drejt zhvillimit popujt e prapambetur. Ai jepte rastin e Libisë, e cila në vend të qytetërimit, ishte ekspozuar përballë rrënimin dhe shfrytëzimit kolonial. Prandaj, deklarata e qeverisë italiane për njohjen e pavarësisë dhe mosdërgimin e trupave të tjerë ishte e pamjaftueshme. Duhej largimi i plotë nga Vlora: *“Shqiptarët janë të pjekur për pavarësinë e tyre, në mënyrën e tyre, ashtu siç ata e kuptojnë atë: nuk ka asnjë arsye që ju të sillni në Shqipëri një qytetërim tjetër. Dhe më lejoni që, si socialist, të shpreh të gjitha rezervat e mia ndaj kësaj mbeturine të ideologjisë së ‘misionit civilizues’, të cilin ju e pretendoni ndaj Shqipërisë. Ja pse unë shpall qartësisht pakënaqësinë time për njoftimin që shtyn evakuimin e Vlorës.”*<sup>31</sup> Konstantino Lazari, kryetar i grupit parlamentar socialist e konsideroi një fitorë të rëndësishme frenimin e dërgimit të trupave të tjera në Vlorë. Ai deklaroi mbështetjen e plotë për lëvizjen kundër luftës, dhe bashkimin e protestave të punëtorëve me ato të ushtarëve deri në fillimin e negociatave për largimin e ushtarëve italianë nga Shqipëria, duke e mbyllur: *“E përsërisim dhe lartësojmë më tej thirrjen: Jashtë nga Vlora!”*<sup>32</sup>

Qeveria italiane, përballë rebelimeve në porte të grevave në të gjithë vendin, si dhe përballë aksionit parlamentar të opozitës, deklaroi se nuk do të dërgoheshin ushtarë të tjerë italianë. Megjithatë, qeveria arriti të siguronte shumicën parlamentare (duke u mbështetur tek grupimet liberale e demokristiane si dhe deputetët e ekstremit të djathtë), që ushtria italiane të vazhdonte të qëndronte në Vlorën e rrethuar nga shqiptarët. Mocioni i opozitës u mposht me 248 vota kundër largimit përfundimtar dhe 108 pro. Megjithatë, Xholiti deklaroi hapjen e negociatave me qeverinë Shqiptare, që do të drejtoheshin nga baroni Alioti, për të arritur një marrëveshje që do t'i jepte fund luftës në Vlorë.

Në ditët e para të muajit korrik pati përpjekje të tjera për të dërguar

<sup>31</sup> Ruggero Giacomini, *“La rivolta dei bersaglieri e le Giornate Rosse: I moti di Ancona dell'estate 1920 e l'Indipendenza dell'Albania”*, Consiglio Reggionale delle Marche, Ancona, 2010, 258.

<sup>32</sup> Po aty, 260.

“vullnetarë” drejt Vlorës, përpjekje që u denoncuan vazhdimisht në Dhomën e Deputetëve<sup>33</sup>. Gjatë këtyre ditëve u denoncuan edhe arrestimet e ndërmarra nga autoritetet lokale ndaj pjesëmarrësve në ngjarjet e ndodhura në fundin e qershorit<sup>34</sup>. Vlora mbeti e rrethuar. Qeveria shqiptare refuzoi çdo kompromis që nuk përfshinte dorëzimin e Vlorës Shqipërisë. Ndërkohë grevat e manifestimet punëtore, si dhe okupimet e tokave nga fshatarët vazhdonin në të gjithë vendin. Të gjitha këto çuan drejt përfundimit të negociatave për tërheqjen e trupave italiane nga Vlora, që u finalizuan me Protokollin e Tiranës (2 gusht 1920).

## **PËRFUNDIME**

Lufta e Vlorës dhe mposhtja e garnizoneve italiane në Shqipëri nga kryengritësit shqiptarë me armatime sigurisht më modeste se ushtria italiane, e cila ishte ndër fuqitë fituese të LPB, shkaktoi jo vetëm impaktin kombëtar të entuziazmit patriotik për bashkimin e vendit, por edhe impaktin ndërkombëtar, të lidhur me disfatën e ushtrisë italiane. Pikërisht një sukses i tillë i palës shqiptare shpjegohet jo vetëm me angazhimin mbarëkombëtar e patriotik për çlirimin e Vlorës, por gjithashtu edhe me faktorë të brendshëm objektivë dhe subjektivë që lidhen me vetë dinamikat e brendshme të Italisë.

Ndër faktorët objektivë përfshihet gjendja ekonomike e Italisë pas përfundimit të LPB, si dhe pamundësinë e qeverisë për të mbajtur më tej të angazhuar një ushtri që pas pesë vitesh në gjendje mobilizimi, nuk e kishte më tej entuziazmin për të luftuar, për më tepër në territore koloniale dhe popullsi të huaja, në kushte gjithnjë e më të përkeqësuar të furnizimeve.

Ndërsa faktorët subjektivë me karakter shoqëror e politik që vepruan në favor të çështjes shqiptare ishin lëvizja punëtore që kishte nisur në Itali, mobilizimi i sindikatave, i intelektualëve dhe faktorit kryesor politik opozitar ndaj qeverisë së Xholitit, që ishte Partia Socialiste Italiane, së bashku me organizatat republikane dhe anarko-sindikaliste. Pikërisht këto lëvizje të brendshme që ishin të pranishme në Itali, nxitën një frymë të përgjithshme anti-militaste, anti-koloniale, si dhe solidaritetin me luftën patriotike të shqiptarëve për bashkimin e vendit, duke penguar mobilizimin, duke denoncuar qeveritë Niti e Xholiti, si dhe duke organizuar greva e manifestime kundër luftës, duke dhënë kështu një kontribut të rëndësishëm në luftën çlirimtare të popullit shqiptar në Vlorë.

---

<sup>33</sup> Po aty, 262-263.

<sup>34</sup> “Avanti”, Anno XXIV-Nr. 160, 6 luglio 1920, fl.1. “*Gli eçidi di Ancona*”.

Tërësia e këtyre faktorëve mundësoi ndërmarrjen e aksioneve politike që u shfaqën në forma të ndryshme. Ato u shfaqën në terrenin e betejës sociale si pjesë e lëvizjes punëtore, në organizimin e CGdl dhe Shtëpive të Punës dhe në kundërshtimin e drejtpërdrejtë të reparteve të bersaljerëve e të arditëve në portet kryesore të vendit, si: Trieste, Ankona, Brindizi dhe qytetet e tjera italiane në shenjë solidariteti. Grupimet opozitare të selive lokale të socialistëve, republikanëve e anarko-sindikaliste u shfaqën në mbështetje të këtyre lëvizjeve. Së dyti, aksioni politik u shfaq në faqet e shtypit socialist dhe atij anarko-sindikalist, në një epokë në të cilën shtypi i përditshëm zinte pjesën kryesore të informimit të opinionit publik. Të përditshmet “Umanita nova” dhe kryesisht “Avanti” shfaqën kritikën dhe kundërshtimin ndaj politikave të qeverive Niti e Xhioliti, denoncuan qarqet nacionaliste e fashiste që mbështesnin vazhdimimin e luftës, si dhe mbështetën luftën e popullit shqiptar për Vlorën. Së treti, grupi parlamentar socialist, i drejtuar nga personalitete, si: Modiljani, Laxari, Mateoti etj., udhëhoqi aksionin parlamentar, fillimisht kundër qeverisë Niti deri në dorëheqjen e saj, më pas kundër qeverisë Xhioliti, duke këmbëngulur vazhdimisht dhe ngritur çështje në seancat parlamentare për tërheqjen e trupave italiane nga Shqipëria, duke vlerësuar njëkohësisht si të drejtë luftën e popullit shqiptar të drejtat e tij kombëtare.

Së fundi, duhet theksuar fakti se Lufta e Vlorës përfshihet ndër luftërat çlirimtare të cilat ndërthurin konceptin gramshian të “dy fronteve të rezistencës”: atë të lëvizjes për çlirim apo bashkim kombëtar të popujve të shtypur dhe atë të lëvizjes masive shoqërore e politike që lind në vetë shoqërinë e shtetit që mban regjimin e pushtimit. Kjo e fundit, ndërthur gjithashtu në vetvete rezistencën kundër rekrutimit ushtarak dhe politikës imperialiste me përpjekjet për demokraci dhe drejtësi shoqërore. Pikërisht këto dy fronte të rezistencës në të dyja brigjet e Adriatikut detyruan qeverinë italiane të pranonte tërheqjen nga Vlora dhe të nënshkruante Protokollin e Tiranës me qeverinë shqiptare.

## BIBLIOGRAFIA

### Monografi

- Arben Puto, “*Shqipëria Politike*”, Toena, Tiranë, 2009.
- Giovanni Sabbatuci & Vittorio Vidotto (ed.), “*Storia d’Italia, 4. Guerre e Fascismo 1914-1943*”, Laterza, 1997.
- Martin Clark, “*Modern Italy (1871-1995)*”, Longman, London & New York.
- Muin Çami, “*Shqipëria në marrëdhëniet ndërkombëtare (1914-1918)*”,

Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Tiranë, 1987.

- Norberto Bobbio, “*Profilo ideologico del Novecento italiano*”, Einaudi, Torino, 1986.
- Paskal Milo, “*Politika e Jashtme e Shqipërisë (1912-1939)*”, Toena, Tiranë, 2013.
- Pierre Milza, “*Historia e Italisë*”, Dituria, Tiranë, 2012.
- Ruggero Giacomini, “*La rivolta dei bersaglieri e le Giornate Rosse: I moti di Ancona dell’estate 1920 e l’Indipendenza dell’Albania*”, Consiglio Regionale delle Marche, Ancona, 2010.
- Spencer di Scala, “*Italian Socialism, between politics and history*”, University of Massachusetts Press, 1996.

### Artikuj

- Art. Donato Peccerillo, *Da Brindisi ad Ancona e Trieste, la rivolta degli Arditi*, <https://www.patriaindipendente.it/longform/da-brindisi-ad-ancona-e-trieste-la-rivolta-degli-arditi/>
- Art. Giampietro Berti, “*Il programma anarchico*”, në: “L’Unione Anarchica Italiana. Tra rivoluzione europea e reazione fascista 1919–1926. Pisa: Biblioteca Franco Serantini, 2006”, 29-39
- Art.: Alberto Becherelli, “*L’Albania nella politica estera italiana (1913-1920)*”, në: “L’Albania Indipendente e le relazioni italo-albanesi (1912-1920)”, Alberto Becherelli & Andrea Carteny (ed.), Edizioni Nuova Cultura, Roma, 2013

### Shtypi

- “Avanti”, Anno XXIV-Nr. 140, 13 giugno 1920.
- “Avanti”, Anno XXIV-Nr. 143, 15 giugno 1920.
- “Avanti”, Anno XXIV-Nr. 145, 18 giugno 1920.
- “Avanti”, Anno XXIV-Nr. 151, 25 giugno 1920.
- “Avanti”, Anno XXIV-Nr. 151, 27 giugno 1920.
- “Avanti”, Anno XXIV-Nr. 160, 6 luglio 1920.
- “Umanita Nova”, Anno I, N. 94, 17 giugno 1920.

**ON THE OTHER SIDE OF THE ADRIATIC: SOCIAL AND  
POLITICAL MOBILIZATION IN ITALY IN SUPPORT OF THE  
NATIONAL RIGHTS OF THE ALBANIAN PEOPLE DURING THE  
VLORA WAR (JUNE–AUGUST 1920)**

***ABSTRACT***

The War of Vlora of June–August 1920, in which Albanian insurgents confronted the Italian military garrison in southern Albania, resonated powerfully across both parts of the Adriatic. While the Italian government of Giovanni Giolitti initially sought to preserve a strategic foothold in Vlora, the socialist press, labor organizations, and a significant segment of Italian public opinion mobilized against this military adventure. The socialist daily *Avanti!* became a central platform for denouncing the occupation, framing the Albanian struggle as both a fight for national self-determination and a mirror of Italian workers' own opposition to imperialist wars. Strikes, protests, and even mutinies—most notably the Ancona uprising in June 1920—demonstrated the refusal of soldiers and workers to support a campaign perceived as unjust and costly. This paper explores the political and social dynamics within Italy that intersected with the Vlora conflict, highlighting how the Biennio Rosso (1919–1920) created a fertile environment for anti-militarist mobilization. Drawing on socialist writings, parliamentary debates, and labor movement resolutions, it argues that Italian socialists framed the “Valona question” not only as an episode of foreign policy but as a test of Italy's postwar democracy and the internationalist commitments of the working class. Ultimately, the convergence of Albanian armed resistance and Italian social opposition contributed to the withdrawal of Italian forces in August 1920. This paper illustrates how trans-Adriatic interactions shaped both Albania's national consolidation and Italy's contested path between liberalism, socialism, and emerging fascism.

**Ilirjana Kaceli (DEMIRLIKA)  
Cavid QAZIMOV**

## **VLERËSIMET E ORIENTALISTËVE RUSË MBI VEPRËN E MUSTAFA KOÇI BEUT**

### **Hyrje**

Në historinë e gjatë të Perandorisë Osmane, një vend të veçantë zënë personalitetet me origjinë shqiptare që shërbyen në drejtimin dhe administrimin e shtetit. Sipas burimeve të shumta historike, mbi tridhjetë e tre kryeministra (sadrzemë) apo vezirë të mëdhenj kanë qenë me prejardhje shqiptare, duke kontribuar në periudha të ndryshme të zhvillimit dhe fuqizimit të Perandorisë<sup>1</sup>. Këta burra shteti, shpesh të formuar në kuadër të sistemit të devshirmesë, u shquan për aftësitë e tyre ushtarake, administrative dhe politike.

Shqiptarët që pranuan fenë islame u bënë një ndër shtyllat më të forta të aparatit osman, duke u ngjitur në poste të larta të administratës dhe të ushtrisë. Shumë prej tyre shërbyen si komandantë, guvernatorë, nëpunës të lartë, kadinj, imamë, diplomatë, madje edhe si vezirë apo kryeministra, duke drejtuar me kompetencë oborret e sulltanëve dhe institucionet qendrore të shtetit.

Në këtë kuadër spikat figura e Mustafa Koçi Beut, një autor dhe mendimtar politik i shekullit XVII me origjinë shqiptare nga zona e Korçës, i njohur për traktatet e tij mbi krizën e institucioneve osmane dhe nevojën për reforma. Veprat e tij përfaqësojnë një ndër shembujt më të artikuluar të mendimit kritik brenda administratës osmane, duke reflektuar përpjekjet për rikthimin e parimeve tradicionale të rendit shtetëror si përgjigje ndaj dekadencës administrative dhe ushtarake të kohës.

Fokusi kryesor i këtij studimi është analiza e vlerësimeve dhe interpretimeve të orientalistëve rusë mbi figurën dhe veprën e Mustafa Koçi Beut. Studimet e këtyre autorëve përfaqësojnë një kontribut të rëndësishëm në historiografinë e mendimit politik osman, duke ofruar perspektiva kritike mbi rolin e Koci Beut si teoricien i reformës dhe si dëshmitar i krizave strukturore të Perandorisë. Përmes këtyre vlerësimeve synohet të kuptohet më qartë ndikimi i tij në traditën reformuese osmane dhe rëndësia

---

<sup>1</sup> Abdülkadir, Özcan “*Türk siyasi ve kültürel hayatında Arnavut asıllı sadrazamlar*”, botuar në revistën: Rumeli Kültürü, İstanbul, Sonbahar, 2002, sayı 3, f.30.

e mendimit të tij në zhvillimin e ideve politike të kohës.

Ky studim mbështetet në një qasje historiko-analitike dhe krahasuese, duke u bazuar kryesisht në analizën e burimeve dytësore, veçanërisht studimeve të orientalistëve rusë që janë marrë me veprën e Mustafa Koçi Beut. Metoda konsiston në shqyrtimin kritik të interpretimeve të tyre, krahasimin e qëndrimeve të ndryshme dhe vendosjen e tyre në kontekstin e historiografisë osmane dhe ballkanike. Në këtë mënyrë, synohet të nxirren në pah veçoritë e perceptimit rus mbi reformizmin osman dhe rolin e elitës shqiptare brenda tij.

### 1. Mustafa Koçi Beu – Reformatori shqiptar i Perandorisë Osmane

Mustafa Koçi Beu përfaqëson një nga figurat më të spikatura me origjinë shqiptare që arritën të zënë pozita të larta në administratën e Perandorisë Osmane gjatë shekullit XVII. Sipas burimeve historike, ai lindi në fshatin Mborje të Korçës<sup>2</sup>. Edhe pse emri i tij i vërtetë ishte Mustafa, në shumë dokumente osmane dhe kronika të kohës ai përmendet me nofkat “Koxha”, “Koçi” apo “Kuçi”, që mendohet të kenë prejardhje nga fjala shqipe “kuqe”, me kuptimin “i kuq”.

Sipas studiuesve të huaj dhe osmanologëve<sup>3</sup>, Mustafa Koçi Beu u rekrutua që në moshë të vogël përmes sistemit *Devshirme*, dhe më pas u arsimua në Medresenë e njohur Enderun<sup>4</sup>, institucion elitar që përgatiste administratorët dhe funksionarët e lartë të Perandorisë. Zgjuarsia, disiplina dhe guximi e bënë të shquhej që në fillimet e karrierës së tij, duke u ngjitur shpejt në hierarkinë shtetërore gjatë sundimit të Sulltan Ahmetit I (1603–1617).

Me kalimin e viteve, Koçi Beu fitoi përvojë të gjerë në administratë dhe u emërua në poste të rëndësishme këshillimore gjatë sundimit të Sulltan Muratit IV (1623–1640). Ai shërbeu si *Has Odabaşı*, një post kyç në organizimin e pallatit perandorak, dhe më pas si këshilltar personal i Sulltanit, me titullin “*Sırdaş*”, që do të thotë “mbajtësi i sekreteve”. Burimet osmane përmendin se Koçi Beu shoqëroi Sulltan Muratin IV edhe gjatë fushatës së pushtimit të Bagdadit<sup>5</sup> (1638), një nga ekspeditat më të rëndësishme të periudhës.

<sup>2</sup> Petrika Thëngjilli, *Historia e Perandorisë Osmane*, SHBLU, Tiranë: 1997, f.148.

<sup>3</sup> Mehmed Süreyya, *Sicill-i Osmani*. c. 3. Istanbul: 1996, s. 891.

<sup>4</sup> Erkan Tamtürk, *Koçi Bey Risalesi* (Kitap İncelemesi), *Journal of Academic Projection (JAP)*, 2024, 9 (1), f. 86.

<sup>5</sup> İhsan Cora, *Yönetim Ve Organizasyon Bilimi Açısından Koçi Bey Risalelerinin Analizi: Tarihsel Bir Araştırma*, *İstanbul Ticaret Üniversitesi Sosyal Bilimler Dergisi* Yıl:15 Sayı:29 Bahar 2016/2 s.221-244.

Në një kohë kur Perandoria Osmane po përballej me shenja të qarta të rënies dhe dobësimit të sistemit feudal-ushtarak, sulltanët e shekullit XVII, veçanërisht Murati IV dhe Ibrahim I, u përpoqën të ndalonin përkeqësimin e strukturës shtetërore<sup>6</sup>. Për këtë arsye, ata kërkuan nga këshilltarët e tyre më të afërt që të analizonin gjendjen e sistemit dhe të propozonin masa reformuese. Në këtë kuadër, Mustafa Koçi Beu, i njohur për mendimin e tij kritik dhe vizionin reformativ, hartoi dy traktate politike të njohura me emrin “*Risale*”, të cilat përbëjnë një ndër dokumentet më të rëndësishme të mendimit politik osman. Traktati i parë iu paraqit Sulltan Muratit IV në vitin 1631, dhe përmbante 22 letra ku autori trajtonte me guxim shkaqet e degjenerimit të sistemit dhe propozonte rrugët e reformimit të tij. Sulltan Murati IV siç dihet, kishte ardhur në moshë shumë të re në pushtet dhe fillimisht kishte qenë nën ndikimin e nënës së tij sulltaneshës Kosem. Por shumë shpejt ai do të çlirohej nga ky ndikim dhe do të vendoste autoritetin e tij<sup>7</sup>.

Murati IV, i njohur për autoritarizmin dhe përpjekjet për rikthimin e disiplinës në shtet, vlerësoi këshillat e Koçi Beut dhe zbatoi masa të ashpra kundër korrupsionit e abuzimeve në administratë. Ai ndaloi përdorimin e alkoolit dhe duhanit dhe urdhëroi ekzekutimin e atyre që shkelin ligjet e shtetit, duke u përpjekur të rikthente autoritetin dhe moralin publik. Një nga idetë themelore të Koçi Beut, që u bë parim për reformën e Muratit IV, ishte se “*institucionet tradicionale osmane zotëronin ende një epërsi të madhe ndaj çdo modeli perëndimor*”<sup>8</sup>, dhe se forcimi i rendit të brendshëm ishte çelësi i mbijetesës së perandorisë.

Pas vdekjes së Muratit IV në vitin 1640, në fron u ngjit Sulltan Ibrahim I (1640–1648), i njohur me nofkën “Deli”, i cili, ndonëse vuante nga çrregullime mendore, kërkoi gjithashtu ndihmën e Koçi Beut për të hartuar një raport të ri reformash<sup>9</sup>.

Koçi Beu i ka paraqitur Sulltan Ibrahimit gjithsej 17 raporte (layiha). Vërehet menjëherë se gjuha e tij është mjaft e thjeshtë. Megjithëse sulltani kishte një natyrë të shqetësuar dhe të paduruar, Koçi Beu, me mënyrën e tij të qasjes, arriti të fitojë besimin e tij. Përveç kësaj, ai i jepte sulltanit këshilla edhe për çështjet më themelore, në mënyrë që të kompensonte mungesat e tij në drejtimin e shtetit.

<sup>6</sup> P. Thëngjilli, *Historia e Perandorisë Osmane ...*, f.149.

<sup>7</sup> Mehmed Maksudoglu, *Historia osmane dhe institucionet*, (trans: E. Meidani) botimet “Alsar”, Tiranë: 2017, f.315.

<sup>8</sup> St. Shaw, *Historia e Perandorisë Osmane dhe e Turqisë Moderne*, Vëllimi I, Jehona study center, Tiranë 2006, f.240.

<sup>9</sup> Zuhuri Danişman, *vep e cituar*, f.2.

Temat e trajtuara në këto raporte përfshinin kryesisht rregullat e sjelljes në pallat, organizimin shtetëror, përgatitjet për fushata ushtarake, mënyrën se si duhej të sillej dhe të fliste sulltani, detyrat e agallarëve të pallatit, si duhej t'u përgjigjej letrave zyrtare, cilët persona meritonin lavdërime dhe cilat fjalë duhej të përdorte për t'i shprehur ato. Të gjitha këto ishin çështje tepër të thjeshta në përmbajtje<sup>10</sup>. Megjithatë, ana pozitive e kësaj, është se falë këtyre raporteve është arritur të fitohet njohuri mbi shumë çështje që lidhen me administratën shtetërore osmane.

Sipas dëshmive të Mehmet Tahirit nga Bursa, Koçi Beu i shërbeu Sulltan Ibrahimit I deri në vitin 1648, kur ky i fundit u rrëzua nga fronti. Pas kësaj periudhe, reformatori shqiptar u tërhoq nga jeta politike, u largua nga Stambolli dhe u kthye në vendlindjen e tij, në Korçë.

Sipas burimeve lokale, Mustafa Koçi Beu ndërroi jetë rreth vitit 1650 dhe u varros në fshatin Plasë, në rrugën që lidh Korçën me Manastirin<sup>11</sup>, në një tokë vakëf që vetë ai kishte dhuruar më parë<sup>12</sup>.

Figura e Mustafa Koçi Beut mbetet një ndër më të ndriturat e mendimit politik osman të shekullit XVII – një shqiptar që me erudicionin dhe guximin e tij intelektual ndikoi në përpjekjet për reformë dhe rigjallërim të një perandorie gjigante në prag të rënies së saj.

## 2. Traktatet politike (Risale) të Mustafa Koçi Beut

Në periudhën e shërbimit të tij si këshilltar pranë Sulltan Muratit IV dhe më pas Sulltan Ibrahimit I, Mustafa Koçi Beu u ngarkua me hartimin e dy *Risaleve*, apo traktateve politike, që trajtonin shkaqet e përkeqësimit të Perandorisë Osmane dhe propozonin rrugët për shpëtimin dhe ringritjen e saj<sup>13</sup>. Këto vepra përbëjnë ndër burimet më të rëndësishme të historisë së qeverisjes osmane të shekullit XVII, si dhe dokumente themelore të mendimit politik e administrativ të kohës<sup>14</sup>.

Në këto traktate, Koçi Beu e nënshtroi Perandorinë në një formë “autopsie” të hollësishme, duke analizuar shkaqet e rënies dhe duke paraqitur propozime konkrete për reformim. Ai argumenton se përçarjet, korrupsioni dhe prishja e rendit tradicional osman kishin çuar në dobësimin e shtetit. Në një nga pasazhet më të njohura, ai shkruante: “*Shteti nuk rronte dot me zullume.*”

<sup>10</sup> Ceyhan, N. (2021). *Koçi Bey'in IV. Murat'a ve I. İbrahim'e Sunduğu Risalelerin Farklılıkları ve Karşılaştırması*. ATEBE Dergisi 5(1), 13-14.

<sup>11</sup> Mehmet Tahir, Bursalı. *Osmanlı Müellifleri*, Cilt 3, İstanbul: Yaylacık Matbaası, 1975, f. 80.

<sup>12</sup> Bursalı Mehmet, *po aty*, f.80.

<sup>13</sup> Mustafa Koçi Beu, *Risale* (1631), arkivi i Sarajevë të Topkapësë, dorëshkrimi nr. 1323.

<sup>14</sup> Disa autorë Risaleit i quajnë Traktate, të tjerë raporte dhe memorandumë.

Më tej theksonte se “*Ky shtet është aq i madh, sa, nëse ndreqet, nuk do të ketë frikë nga zhdukja. Ka burime të pasura natyrore, miniera ari, argjendi e bakri; edhe njerëzit e tij janë të fortë si metalet që nxjerr toka. Në viset shqiptare ka burra viganë që një vlen sa dhjetë, pesëmbëdhjetë shpata; trima me fletë si shqiponja dhe si sokolë.*”<sup>15</sup>

Në raportet e tij, Koçi Beu analizon me kujdes degradimin e sistemit administrativ, ushtarak, ekonomik dhe financiar, duke denoncuar hapur korrupsionin, ryshfetin dhe shitjen e posteve shtetërore<sup>16</sup>. Ai kritikon ashpër rritjen e burokracisë dhe centralizimin e tepruar të pushtetit, duke theksuar se “*Në çdo administrim mund të jepet një vendim i gabuar; por më e rrezikshme se gabimi është mungesa e mekanizmave që ta korrigojnë atë*”. Mirëpo, ajo që përbën rëndësinë këtu nuk është vendimi i gabuar, por “*mosekzistenca e mekanizmave që do të rregullonin këto vendime*”<sup>17</sup>.

#### a. Risaleja e Parë

Risalenë ose Traktatin e Parë Koçi Beu e hartoi në vitin 1631 dhe ia paraqiti Sulltan Murat IV<sup>18</sup>. Veçoria kryesore e këtij traktati është se ai është i pari në llojin e tij për shtetin e Perandorisë Osmane dhe një ndër burimet më mirëpërshkruese të historisë të këtij shekulli<sup>19</sup>. Karakteristikat kryesore të këtij traktati tregojnë që ai kishte një stil letrar me detaje të hollësishme dhe përbëhet nga 22 pjesë të shkruara në gjuhën osmane, me një stil të qartë, të detajuar dhe me ton udhëzues. Në këtë vepër, Koçi Beu paraqet një sërë parimesh e masash reformuese:

1. *Rikthimi i rendit tradicional* – Respektimi i ligjit të Sheriatit dhe parimeve themelore të shtetit osman.<sup>20</sup>
2. *Pavarësia e institucioneve fetare* – Veziriazami, kadiaskerët dhe myftiu duhet të jenë figura të ndershme e të përgatitura, të zgjedhura nga radhët e dijetarëve.
3. *Reformimi i sistemit të Timarit* – Tokat t’u jepen ushtarakëve besnikë dhe banorëve vendas, jo spekulatorëve; përmes tyre të rikthehet disiplina ushtarake.<sup>21</sup>

5- *Konfiskimi i pasurive të përfituara në mënyrë të padrejtë*, përfshirë

<sup>15</sup> Necip Alpan, Nasip Kaçi, *Shqiptarët në Perandorinë Osmane*, Albin, Tiranë: 1997, f.57.

<sup>16</sup> Ceyhan, N. (2021). *Koçi Bey'in IV. Murat'a ve I. İbrahim'e Sunduğu Risalelerin Farklılıkları ve Karşılaştırması*. ATEBE Dergisi 5(1), 13.

<sup>17</sup> *Civilizimi Osman (Politikë, Ekonomi, Art)*, Përgaditi: Coşkun Çakır, trans. A. Qefalia, Logos, Tiranë: 2014, f.284.

<sup>18</sup> Ali Fuad Gökçe, *Osmanlı Klasik Döneminde İdari Reform Hareketleri: Koçi Bey Risalesi*, Yasama Dergisi, sayı 14, 2010, s.59-78.

<sup>19</sup> Behar Kaceli, *Reformatori i Madh i perandorisë osmane, Koçi Beu*, Koha Islame, 22 shkurt 2019.

<sup>20</sup> Omer Dinçer, *Çağdaş yönetim düşüncesi açısından Koçi bey Risaleleri*, Marmara Üniversitesi İktisadi ve İdari Bilimler Fakültesi Dergisi, cilt VII, sayı 1-2, İstanbul: 1990, s.353.

<sup>21</sup> Zuhuri Danişman, *Koçi Bey Risalesi*, Kültür ve Turizm Bakanlığı Yayınları, Ankara: 1985, s.26.

ulufet dhe vakëfet e ngritura në kundërshtim me ligjin.

6- *Menaxhimi i drejtë i vakëfeve dhe pasurive të jetimëve*, pa përzierje me arkën e shtetit.

7- *Reformimi i administratës* – Nëpunësit të jenë të përgatitur në shkollat osmane dhe të përzgjidhen mbi bazën e meritës.

8- *Lehtësimi i barrës fiskale* – Heqja e taksave të padrejta dhe mbrojtja e popullsisë fshatare.

9- *Krijimi i një ushtrie të vogël, të disiplinuar dhe të besuar*, që do të shmangte shpërdorimet e jeniçerëve.<sup>22</sup>

Në analizën e tij, Koçi Beu përshkruan një tablo të zymtë të realitetit: spahinj të demoralizuar, timare në duart e joushtarakëve, ryshfet të përhapur dhe fshatarësi të varfëruar. Si rrugëdalje, ai propozon rikthimin e sistemit të disiplinës së epokës së Sulltan Sulejmanit të Madhërishëm, kur rendi dhe drejtësia ishin themel i shtetit.

Masat e ndërmarra nën ndikimin e këtij traktati, si regjistrimi i timareve dhe rregullimi i shpërndarjes së tyre, dhanë disa rezultate të përkohshme, por nuk arritën të ndalonin procesin e *privatizimit të pronave shtetërore* dhe përqendrimin e pasurive në duart e institucioneve fetare dhe aristokracisë<sup>23</sup>. Administrata e vakëfeve i jepte ato me qira. Nga këto qira edhe vetë sulltani përvetësoi një pjesë të të ardhurave.

#### **b. Risaleja e Dytë**

Pas vdekjes së Muratit IV dhe ardhjes në pushtet të Sulltan Ibrahimit I (1640–1648), Koçi Beu përgatiti një raport të dytë, të quajtur “*Kanunname*” të hartuar në vitin 1640. Ky traktat, gjendet i ruajtur edhe sot në arkivin e Sarajeve të Topkapisë (nr. 1323), përbëhet nga 17 pjesë dhe mendohet të jetë me shkrimin origjinal të autorit. Ndryshe nga risaleja e parë, që merrej me organizimin e përgjithshëm shtetëror, raporti i dytë fokusohet në reformat e brendshme të pallatit sulltanor, përzgjedhjen e njerëzve të afërt me sulltanin, disiplinën e oborrit dhe mënyrën e komunikimit administrativ. Ai ruan të njëjtin ton udhëzues dhe racional, duke kërkuar kthimin e meritokracisë, disiplinës dhe moralit në qeverisje. Traktati i dytë, shquhet për gjuhën e qartë dhe stilin udhëzues, duke u bërë një ndër raportet e para politike në historinë osmane. Kjo vepër paraqet një panoramë të qartë të jetës sociale në atë kohë, duke filluar nga qendra e gjer në pikat më të largëta të Perandorisë. Ai përshkruan me detaje jetën sociale, ekonomike dhe politike të shekullit XVII, duke ofruar një pasqyrë të qartë

<sup>22</sup> Kunt, Metin (2009) *Türkiye Tarihi*, Cem yayınevi, İstanbul, p. 30.

<sup>23</sup> Petrika Thëngjilli, *Historia e Perandorisë Osmane*, ShBLU, Tiranë: 1997, f.149.

të problemeve të perandorisë<sup>24</sup>. Në të përshkruhen të gjitha problemet që shqetësojnë perandorinë si ato: administrative, ekonomike, sociale etj<sup>25</sup>.

Vlerësimet akademike për Koçi Beun filluan qysh në shekullin XIX, nisin me studimin e orientalistit austriak Joseph von Hammer-Purgstall, i cili e prezantoi atë si “Montesquieun osman”.<sup>26</sup> Krahasimi është domethënës, pasi, ashtu si filozofi francez Montesquieu,<sup>27</sup> Koçi Beu kërkonte ndarjen e pushteteve dhe vendosjen e ligjit mbi arbitraritetin e individëve.<sup>28</sup>

Në Perandorinë Osmane, studimi i parë i plotë për *Risale*t u botua nga Ebuzziya Tefvik në vitin 1895, ndërsa përkthimi modern nga gjuha osmane në turqisht u realizua nga Zuhuri Danişman në vitin 1985.<sup>29</sup>

Më vonë, studiuesi Yılmaz Kurt zhvilloi kërkime të reja mbi tekstet e Koçi Beut, duke ndriçuar aspektet reformuese të mendimit të tij politik<sup>30</sup>. Për studiuesit bashkëkohorë, Mustafa Koçi Beu mbetet pararendës i ideve për ndarjen e pushtetit dhe luftën kundër korrupsionit në një perandori që po përballej me krizë strukturore.<sup>31</sup> Vepra e tij është një dëshmi e qartë se reflektimi politik dhe vetëkritika administrative kishin zë të fuqishëm në traditën osmane shumë përpara Iluminizmit evropian.<sup>32</sup>

### 3. Mustafa Koçi Beu në orientalizmin rus

Ndër studiuesit orientalistë që janë marrë me historinë e Perandorisë Osmane, një vend të veçantë zënë ata që kanë hedhur dritë mbi personalitete të shquara që ndikuan në zhvillimin shoqëror, politik dhe administrativ të kësaj perandorie. Brenda këtij kuadri, figura e Mustafa Koçi Beut ka tërhequr vëmendjen e veçantë të studiuesve rusë, të cilët e kanë trajtuar atë jo vetëm si një reformator të mendimit politik osman, por edhe si një pasqyrë të gjendjes së brendshme të shtetit në një periudhë

<sup>24</sup> Yılmaz Kurt, “Koçi Bey ve Risalesi Üzerine Yeni Bulgular,” *Türk Kültürü İncelemeleri Dergisi* 5. (1993): s. 33–56.

<sup>25</sup> Ebuzziya Tefvik, *Koçi Bey Risalesi* (Stamboll: Ebuzziya Matbaası, 1895).

<sup>26</sup> Joseph von Hammer-Purgstall, *Geschichte des Osmanischen Reiches* (Pesth: C.A. Hartleben, 1827), vol. 5, p. 254–257.

<sup>27</sup> Charles de Montesquieu, *De l'Esprit des Lois* (Paris: Librairie Garnier, 1748).

<sup>28</sup> Serif Mardin, *The Genesis of Young Ottoman Thought: A Study in the Modernization of Turkish Political Ideas* (Princeton: Princeton University Press, 1962), p. 45–49.

<sup>29</sup> Zuhuri Danişman, *Koçi Bey Risalesi (Osmanlı Devleti'nin Gerileme Sebepleri)* (Ankara: Kültür ve Turizm Bakanlığı Yayınları, 1985).

<sup>30</sup> Yılmaz Kurt, “Koçi Bey ve Risalesi Üzerine Yeni Bulgular,” *Türk Kültürü İncelemeleri Dergisi* 5 (1993): 40–42.

<sup>31</sup> Hamilton A. Gibb dhe Harold Bowen, *Islamic Society and the West*, vol. I (London: Oxford University Press, 1950), p. 297–299.

<sup>32</sup> Fikret Adanır, “Reform and Change in the Ottoman Empire: Koçi Bey and the Crisis of the 17th Century,” *Turkish Historical Review* 3, nr. 2 (2012): p.168

krize. Studimet akademike kushtuar Mustafa Koçi Beut nga orientalistët rusë mund të ndahen në tri periudha kryesore, secila me qasje dhe perspektiva të ndryshme kërkimore. Këto periudha reflektojnë jo vetëm zhvillimin e mendimit shkencor rus mbi historinë osmane, por edhe ndryshimet ideologjike e metodologjike që kanë shoqëruar kërkimet historike nga koha e Perandorisë Ruse deri në epokën sovjetike dhe pas saj. Në këtë mënyrë, përmes këtyre studimeve, Mustafa Koçi Beu nuk shihet më vetëm si autor i “Risaleve” të tij të njohura, por si një dëshmitar i gjallë i krizave të shekullit XVII dhe një interpretues i thellë i shkaqeve të rënies së disiplinës dhe moralit shtetëror në administratën osmane. Ai bëhet kështu një figurë përmes së cilës mund të kuptohet evolucioni i ideve politike dhe mendimit kritik në një nga periudhat më të trazuara të historisë osmane.

#### a. *Studimet Akademike për Mustafa Koçi Beun në Rusinë Cariste*

Në Rusinë cariste, studimet akademike për figurën e Mustafa Koçi Beut morën jetë për herë të parë falë punës së orientalistit të njohur Vasili Dimitrievich Smirnov<sup>33</sup>, i cili mund të konsiderohet si themeluesi i traditës shkencore ruse mbi analizën e mendimit politik osman.<sup>34</sup> Smirnov, i lindur në vitin 1846 në fshatin Biryuchya Kosa të rrethit Astrakhan, vinte nga një familje e thjeshtë, bir i një prifti që ndërroi jetë herët, por kjo nuk e pengoi të vijonte një rrugëtim arsimor e intelektual mbresëlënës. Pas përfundimit të Seminarit të Astrakhanit dhe më pas të Seminarit Teologjik të Perm-it, ai u pranua në Akademinë Teologjike të Shën Petersburgut, përpara se të transferohej në Fakultetin e Gjuhëve Lindore të po këtij universiteti — një vend që do ta formësonte përfundimisht si njohës të thellë të gjuhëve dhe kulturave orientale.<sup>35</sup>

Në vitin 1873, Smirnov mbrojti tezën e tij të doktoraturës me titullin “*Qasjet e Koçi Beut të Gümülcine dhe të shkrimtarëve osmanë të shekullit XVII ndaj temës së rënies politike të Turqisë*”, e cila u botua po atë vit si monografi në Shën Petersburg.<sup>36</sup> Kjo vepër, e përbërë nga një parathënie, shtatëmbëdhjetë kapituj dhe një përfundim, përbën një nga trajtimet më të hershme e më të plota të figurës dhe mendimit politik të Mustafa Koçi Beut.

<sup>33</sup> İhsan Çomak, *Vasili Dimitriyevç Smirnov (1846-1922)*, Uluslararası Sosyal Araştırmalar Dergisi, Cilt 5, sayı 21, Bahar 2012, s.279.

<sup>34</sup> Vasili D. Smirnov, *Ocherki po istorii Osmanskoi Imperii* [Studime mbi historinë e Perandorisë Osmane] (St. Petersburg: Tipografiya Imperatorskoy Akademii Nauk, 1873), 4–5.

<sup>35</sup> Smirnov Василий Дмитриевич, Большая Советская Энциклопедия (под ред. А. М. Прохоров-3-е изд) Москва, Советская энциклопедия, 1969

<sup>36</sup> Vasili D. Smirnov, *Kochi Bey iz Gümülcine i osmanskie pisateli XVII veka o politicheskom upadke Turtsii* [Koçi Beu i Gümülcinës dhe shkrimtarët osmanë të shek. XVII mbi rënien politike të Turqisë] (St. Petersburg: Imperial University Press, 1873), 10–12.

Në këtë monografi, Smirnov paraqet një vështrim gjithëpërfshirës mbi jetën dhe veprimtarinë e Koçi Beut, duke analizuar me kujdes traktatet e tij politike, të njohura si Risale. Një element dallues i qasjes së tij,<sup>37</sup> është pohimi se Koçi Beu ishte me origjinë turke dhe jo shqiptare, siç mendojnë shumica e studiuesve të tjerë, duke pretenduar se ai ishte nga Komotini (Gümülcine) në Trakinë Perëndimore, e jo nga Korça.<sup>38</sup> Ky mendim mbetet unik në literaturën shkencore, pasi asnjë autor tjetër nuk e ka ndarë këtë qëndrim me Smirnovin.

Përtej analizës biografike, Smirnov zhvilloi një vlerësim të thellë kritik të kontributit të Koçi Beut në mendimin politik osman. Ai e konsideroi Mustafa Koçi Beun si një nga mendimtarët e parë reformatorë, që guxuan të identifikonin me qartësi shkaqet e dobësimit të shtetit osman dhe të propozonin masa për përmirësimin e tij.<sup>39</sup> Sipas tij, Koçi Beu u përpoq të ndalonte shpërbërjen politike dhe ekonomike të perandorisë, duke i paraqitur dy risale— për Sulltan Muratin IV dhe Sulltan Ibrahimin I, të cilat përmbanin një analizë të mprehtë të situatës dhe rekomandime për reformë administrative.<sup>6</sup>

Megjithatë, Smirnov vlerëson se këto traktate, ndonëse me vlerë historike dhe teorike të jashtëzakonshme, nuk përmbanin zgjidhje radikale apo afatgjata për problemet e Perandorisë Osmane. Ai argumenton se Koçi Beu nuk i mori parasysh ndryshimet globale që po ndodhnin në ekonominë dhe politikën botërore të shekullit XVII, duke u përqendruar në një reformë brenda kornizës tradicionale osmane.<sup>7</sup> Për këtë arsye, Smirnov e cilëson veprën e tij si “Projektligjin e Reformës së Brendshme”, që përmban rekomandime të rëndësishme, por që mbeten të kufizuara në vizionin e një administrate të centralizuar dhe konservatore.<sup>40</sup>

Në përfundim, studimet e Vasili D. Smirnovit jo vetëm që vendosën bazat e orientalistikes ruse mbi mendimin politik osman, por edhe i dhanë figurës së Mustafa Koçi Beut një dimension të ri, atë të një analisti të ndërgjegjshëm të krizës shtetërore, i cili përmes penës së tij kërkoi të ringjallte frymën e disiplinës dhe të moralit në administratën osmane.<sup>9</sup>

<sup>37</sup> Кочи-бей Гёмюрджинский (Гёрюджели Мустафа Кочи-бей), Корзинка Кукунор. Москва, Советская Энциклопедия, 1953, s. 173

<sup>38</sup> Vasili D. Smirnov, *Kochi Bey iz Gümülcine i osmanskie pisateli XVII veka o politicheskom upadke Turtsii* [Koçi Beu i Gümülcinës dhe shkrimtarët osmanë të shek. XVII mbi rënien politike të Turqisë] (St. Petersburg: Imperial University Press, 1873), 45–47.

<sup>39</sup> Vasili D. Smirnov, *Kochi Bey iz Gümülcine i osmanskie pisateli XVII veka o politicheskom upadke Turtsii* [Koçi Beu i Gümülcinës dhe shkrimtarët osmanë të shek. XVII mbi rënien politike të Turqisë] (St. Petersburg: Imperial University Press, 1873), 45–47.

<sup>40</sup> Cavid Qasimov, XVI-XVII. Yüzyıl Osmanlı İslahat Lahiyaları, İlmi Araştırmalar Dergisi, sy. 22, 2006, s. 230-233;

**b. Studimet Akademike për Mustafa Koçi Beun në Bashkimin Sovjetik**  
Në periudhën e Bashkimit Sovjetik, studimet akademike mbi Mustafa Koçi Beun morën një zhvillim të veçantë falë punës së studiueses dhe orientalistes së njohur Anna Stepanovna Tveritina, e cila konsiderohet një nga figurat më të rëndësishme të shkollës sovjetike të orientalistikës osmane.<sup>41</sup>

Anna Tveritina lindi në vitin 1910 në Kuntsevo, një vendbanim pranë Moskës. Babai i saj, një mjeshër në ushtrinë cariste, ndërroi jetë në vitin 1911, dhe pas kësaj familja u zhvendos në fshatin Gusevka të rrethit Kirsanovsky. Pas përfundimit të luftës civile ruse, familja e saj u transferua fillimisht në Kutaisi, më pas në Baku, ku ajo përfitoi një formim të gjerë kulturor e gjuhësor. Në vitin 1928, me vendim të Komisarariatit Popullor të Arsimit, Tveritina u dërgua të studionte në Fakultetin Lindor të Universitetit Shtetëror të Leningradit (sot Universiteti i Shën Petersburgut).

Pas diplomimit në vitin 1932, ajo nisi punën si kërkuese shkencore në Institutin e Studimeve Orientale të Akademisë së Shkencave të BRSS, ku vijoi edhe studimet e doktoraturës. Në vitin 1939, ajo mbrojti me sukses disertacionin me titull *“Rebelimi i Karayazıcı Deli Hasanit në Turqi”*, një studim që u vlerësua për thellësinë e analizës mbi strukturat sociale dhe ushtarake osmane të shekullit XVI.<sup>42</sup>

Edhe pse humbi pjesëtarë të familjes gjatë Rrethimit të Leningradit në Luftën e Dytë Botërore, Tveritina vazhdoi kërkimet e saj me përkushtim të jashtëzakonshëm.

Në dekadat që pasuan, ajo botoi një sërë artikujsh dhe monografish mbi çështje të ndryshme politike dhe ekonomike të Perandorisë Osmane. Por ndër veprat e saj, më e rëndësishmja për historinë e mendimit politik osman është artikulli *“Traktati i dytë i Koçi Beut”*, botuar në vëllimin VI të *Revistës së Shënimeve Shkencore të Institutit Oriental të Akademisë së Shkencave të Bashkimit Sovjetik* në vitin 1953. Ky artikull prej 56 faqesh paraqet një analizë të detajuar të krizës politike dhe ekonomike që tronditi Perandorinë Osmane në shekujt XVI–XVII, duke ndjekur një qasje tipike marksiste për strukturat e pushtetit dhe raportet e klasave.

Tveritina thekson se Mustafa Koçi Beu ishte ndër të parët që e kuptoi rënien e rendit shtetëror osman dhe kërkoi reforma për ta shpëtuar. Në artikullin e saj, ajo argumenton se Koçi Beu, duke i paraqitur Risalen e

<sup>41</sup> Anna S. Tveritina, *“Vtoroe sochinenie Kochi-Bei”* [Traktati i dytë i Koçi Beut], në *Uchenye Zapiski Instituta Vostokovedeniya AN SSSR*, vëll. 6 (Moskë: Akademiya Nauk SSSR, 1953), p.3–5.

<sup>42</sup> Tveritina, *Türkiye’de Karayazıcı Deli Hasan İsyani, 1593-1603*, TTK, İstanbul Aya kitap 2006. (*Revolta e Karayazıcı Deli Hasanit në Turqi*)i perkthyer ne gjuhen turke (disertacion doktorature, Instituti i Studimeve Orientale, Moskë, 1939), p. 12–14.

parë Sulltan Muratit IV, u bë një figurë kyçe në oborrin osman. Pas vdekjes së këtij sulltani, kur në fron u ngjiti Sulltan Ibrahim I, i cili vuante nga paqëndrueshmëri mendore dhe dobësi administrative, Koçi Beu hartoi Risalen e dytë për t'i ofruar udhëzime të qarta mbi mënyrën e drejtimit të shtetit.<sup>43</sup>

Sipas Tveritinovës, kjo Risale e dytë dallon nga e para jo vetëm për tonin më udhëzues e praktik, por edhe për stilin më të qartë e të thjeshtë, të përshtatur me nivelin e kuptimit të sulltanit të ri.<sup>9</sup> Ajo vëren se në këtë traktat, Koçi Beu demonstroi aftësinë për të analizuar sistematikisht keqfunksionimet e administratës osmane, duke u përqendruar në korrupsionin, nepotizmin dhe humbjen e disiplinës ushtarake.<sup>44</sup>

Në përfundim, Anna Tveritina interpreton mendimin e Mustafa Koçi Beut në kuadrin e metodologjisë marksiste historike, duke e parë si një reflektim të krizës së strukturave feudale në prag të transformimeve moderne të Perandorisë Osmane.<sup>45</sup> Ajo arriti në përfundimin se traktatet e Koçi Beut përfaqësojnë një formë të hershme të vetëdijes politike reformuese në Lindje, e cila, ndonëse e kufizuar nga realiteti osman, ruan një vlerë të jashtëzakonshme për historinë e ideve politike.<sup>46</sup>

## KONKLUZIONE

Mustafa Koçi Beu përfaqëson një figurë tranzicioni ndërmjet periudhës klasike dhe asaj moderne të mendimit politik osman. Ai ishte një diagnostikues i saktë i sëmundjeve të shtetit dhe një vizionar reformator që e kuptoi se shkaqet e rënies së perandorisë nuk ishin të jashtme, por të brendshme. Traktatet e tij mbeten një burim themelor për historinë e ideve politike dhe dëshmi i qartë i faktit se mendimi administrativ osman kishte në gjirin e tij individë me vizion modern dhe kritik. Përmes veprës së tij, Mustafa Koçi Beu lë një trashëgimi të çmuar, që i flet jo vetëm historisë osmane, por edhe kuptimit bashkëkohor të reformës, meritës dhe qeverisjes etike. Krahas vlerësimit nga osmanologët perëndimorë, Orientalistët rusë e kanë parë figurën e Koçi Beut jo vetëm si mendimtar osman, por edhe si fenomen ballkanik, duke vënë në dukje origjinën e tij shqiptare dhe kontributin e tij në përhapjen e kulturës administrative osmane në rajon. Në analizat e tyre, studiuesit rusë e kanë trajtuar Koçi Beun si një reformator me bazë morale dhe filozofike, që kuptonte se stabiliteti i

---

<sup>43</sup> Ibid., 20–24.

<sup>44</sup> Ibid., 32–34.

<sup>45</sup> Ibid., 45–47.

<sup>46</sup> Ibid., 55–56.

perandorisë nuk mund të mbështetë vetëm në forcën ushtarake, por në ndërtimin e një rendi të drejtë dhe të qëndrueshëm shoqëror. Kjo qasje e orientalizmit rus është me vlerë, sepse nxjerr në pah universalitetin e mendimit të Koçi Beut përtej kufijve etnikë apo fetarë. Si rrjedhojë, studimet akademike mbi Mustafa Koçi Beun në orientalizmin rus kanë një histori më shumë se 150 vjeçare. Në kuadër të vitit të sipërpërmendur, studimet më gjithëpërfshirëse për Mustafa Koçi Beun u bënë nga Vasili Dimitrievich Smirnov dhe Anna Stepanovna Tveritina. Më tej, situata e Traktateve të shkruara nga Mustafa Koçi Beu u përmendën pjesërisht në kuadër të studimit të krizave politike dhe ekonomike që ndodhën në Perandorinë Osmane në shekujt XVI-XVII. Në këtë drejtim, Mustafa Koçi Beut, i cili kishte një vend jashtëzakonisht të rëndësishëm në mjedisin politik osman në shekullin e 17-të, iu kushtua rëndësi nga orientalistët rusë dhe për të u kryen studime akademike. Këto studime vazhdojnë edhe sot në institucione të ndryshme akademike të Federatës Ruse.

## BIBLIOGRAFIA

- Adanır, Fikret. “Reform and Change in the Ottoman Empire: Koçi Bey and the Crisis of the 17th Century,” *Turkish Historical Review* 3, no. 2 (2012): p.168.
- Alpan, Necip, Kaçi, Nasip *Shqiptarët në Perandorinë Osmane*, Albin, Tirane: 1997, f.57.
- Bursalı. Mehmet Tahir. *Osmanlı Müellifleri*, Cilt 3, İstanbul: Yayıncılık Matbaası, 1975, f. 80.
- Ceyhan, Neyla. (2021). *Koçi Bey'in IV. Murat'a ve I. İbrahim'e Sunduğu Risalelerin Farklılıkları ve Karşılaştırması*. ATEBE Dergisi 5(1), 13-14.
- Charles de Montesquieu, *De l'Esprit des Lois* (Paris: Librairie Garnier, 1748).
- Cora, İhsan. *Yönetim Ve Organizasyon Bilimi Açısından Koçi Bey Risalelerinin Analizi: Tarihsel Bir Araştırma*, İstanbul Ticaret Üniversitesi Sosyal Bilimler Dergisi Yıl:15 Sayı:29 Bahar 2016/2, s.221-244.
- Çakır, Coşkun. *Civilizimi Osman (Politikë, Ekonomi, Art)*, Përgaditi: trans. A. Qefalia, Logos, Tiranë: 2014, f.284.
- Çomak, İhsan. Vasili Dimitriyevç Smirnov (1846-1922), *Uluslararası Sosyal Araştırmalar Dergisi*, Cilt 5, sayı 21, Bahar 2012, s.279.
- Danişman, Zuhuri. *Koçi Bey Risalesi (Osmanlı Devleti'nin Gerileme Sebepleri)* (Ankara: Kültür ve Turizm Bakanlığı Yayınları, 1985).
- Dinçer, Omer. *Çağdaş yönetim düşüncesi açısından Koçi bey Risaleleri*, Marmara Üniversitesi İktisadi ve İdari Bilimler Fakültesi Dergisi, cilt VII, sayı 1-2, İstanbul: 1990, s.353.
- Ebuzziya Tevfik. *Koçi Bey Risalesi* (Stamboll: Ebuzziya Matbaası, 1895).

- Gibb Hamilton, Bowen, Harold. *Islamic Society and the West*, vol. I (London: Oxford University Press, 1950), S. 297–299.
- Gökçe, Ali Fuad. “Osmanlı Klasik Döneminde İdari Reform Hareketleri: Koçi Bey Risalesi”, *Yasama Dergisi*, sayı 14, 2010, s.59-78.
- Kaçeli, Behar. *Reformatori i madh i Perandorisë Osmane, Koçi Beu*, Koha Islame, 22 shkurt 2019.
- Kunt, Metin, Akşin, Sina. *Türkiye Tarihi*, Cem yayınevi, İstanbul: 209, p. 30.
- Kurt, Yılmaz. “Koçi Bey ve Risalesi Üzerine Yeni Bulgular,” *Türk Kültürü İncelemeleri Dergisi* 5 (1993): s. 33–56.
- Maksudoğlu, Mehmed *Historia Osmane dhe institucionet*, (trans: E. Meidani) botimet “Alsar”, Tiranë: 2017, f.315.
- Mardin, Şerif *The Genesis of Young Ottoman Thought: A Study in the Modernization of Turkish Political Ideas* (Princeton: Princeton University Press, 1962), p. 45–49.
- Mustafa Koçi Beu, *Risale* (1631), arkivi i Sarajeve të Topkapësë, dorëshkrimi nr. 1323.
- Özcan, Abdülkadir. “Türk siyasi ve kulturel hayatında Arnavut asıllı sadrazamlar”, botuar në revistën: Rumeli Kültürü, İstanbul, Sonbahar 2002, sayı 3, p. 30.
- Purgstall, Joseph von Hammer. *Geschichte des Osmanischen Reiches* (Pesth: C.A. Hartleben, 1827), vol. 5, 254–257.
- Qasimov, Cavid. XVI-XVII. Yüzyıl Osmanlı İslahat Lahiyaları, *İlmi Araştırmalar Dergisi*, sy. 22, 2006, s. 230-233.
- Shaw, Stendford. *Historia e Perandorisë Osmane dhe e Turqisë Moderne*, Vëllimi I, Jehona study center, Tiranë: 2006.
- Smirnov, Vasili D. *Kochi Bey iz Gümülcine i osmanskie pisateli XVII veka o politicheskom upadke Turtsii* [Koçi Beu i Gümülcinës dhe shkrimtarët osmanë të shek. XVII mbi rënien politike të Turqisë] (St. Petersburg: Imperial University Press, 1873).
- Smirnov, Vasili D. *Kochi Bey iz Gümülcine i osmanskie pisateli XVII veka o politicheskom upadke Turtsii* [Koçi Beu i Gümülcinës dhe shkrimtarët osmanë të shek. XVII mbi rënien politike të Turqisë] (St. Petersburg: Imperial University Press, 1873), 45–47.
- Süreyya, Mehmed. *Sicill-i Osmani*. c. 3. İstanbul: 1996.
- Tamtürk Erkan. *Koçi Bey Risalesi* (Kitap İncelemesi), *Journal of Academic Projection (JAP)*, 2024, 9 (1), s. 85-90.
- Thëngjilli, Petrika *Historia e Perandorisë Osmane*, SHBLU, Tiranë: 1997, f.148.
- Tveritinova, “Vtoroe sochinenie Kochi-Bei” [Traktati i dytë i Koçi Beut], në *Uchenye Zapiski Instituta Vostokovedeniya AN SSSR*, vëll. 6 (Moskë: Akademiya Nauk SSSR, 1953).

- Tveritinova, Anna S. *Türkiye'de Karayazıcı Deli Hasan İsyanı, 1593-1603*, ТТК, Istanbul Aya kitap, 2006. (*Revolta e Karayazıcı Deli Hasanit në Turqi* përkthyer në gjuhën turke (disertacion doktrature, Instituti i Studimeve Orientale, Moskë, 1939).
- Кочи-бей Гёмюрджинский (Гёрюджели Мустафа Кочи-бей), Корзинка Кукунор. Москва, Советская Энциклопедия, 1953, s. 173. • Kochi-bey Gomyurdzhinskiy (Goryudzheli Mustafa Kochi-bey), Korzinka Kukunor. Moskva, Sovetskaya Entsiklopediya, 1953, s. 173.
- Смирнов Василий Дмитриевич, Большая Советская Энциклопедия (под ред. А. М. Прохоров-3-е изд) Москва, Советская энциклопедия, 1969 (Smirnov Vasily Dmitrievich, Enciklopedia e Madhe Sovjetike (redaktuar nga A. M. Prokhorov - botimi i 3-të) Moskë, Enciklopedia Sovjetike, 1969)

## MUSTAFA KOÇI BEY WORK THROUGH THE LENS OF RUSSIAN ORIENTALISM

### ABSTRACT

Mustafa Koçi Bey was an Ottoman citizen of Albanian origin. He had held various positions in the sultan's court since the reign of Sultan Ahmet I. He continued his duty during the reign of the two sultans Murat IV and Ibrahim I.

His most important work, which made him famous, was the drafting of two treaties called Risalet. Through them he tried to find a solution to the difficult economic and political situation of the Ottoman Empire. The treaties made the author a very famous person in Europe and the East during the XIX-XX centuries.

Academic studies were conducted on these treaties by the most important orientalists of the world. In this paper, the author's work will also be evaluated by scholars of oriental studies of different periods in Russia. They have been carried out by the studies of the Orientalists of Tsarist Russia and later of the Orientalists of the Soviet Union, who tried to understand the essence and ideas that Mustafa Koçi Bey had expressed in his treaties. This paper, in the first part, will analyze the life and work of this author, and in the second part, there will be provided some evaluations of Russian orientalists on his treaties and his figure.

**Keywords:** Mustafa Koçi Bey, Treaty, Russian Orientalism, Soviet Orientalism.

Migena SALIHI, Nertila HAXHIA LJARJA

## PRIJËSI I MADH I QËNDRESËS KOMBËTARE SHQIPTARE, AZEM GALICA

Azemi u rrit me një ndjenjë të thellë urrejtjeje ndaj pushtuesve të cilët shkatërruan vendin e tij, jetën e tij dhe të familjes së tij. Me gjithë varfërinë dhe vështirësitë, Azemi u rrit me një vendosmëri të palëkundur për të luftuar kundër pushtuesve.

Pas vrasjes së babait dhe djegies së shtëpisë së tij nga forcat turke në vitin 1906, Azemi u bashkua me betejat kundër sunduesve osmanë, të udhëhequra nga figura të njohura si Isa Buletini dhe Idriz Seferi në Grykën e Kaçanikut dhe Carralevës. Lufta e tij vazhdoi kundër pushtuesve të rinj sllavë që nga viti 1912 deri më 1924, duke vdekur në fushë të betejës.

Që në moshë të re Azem Galica mori pjesë në beteja të përgjakshme, duke penguar marshimin e pushtuesve serbë në Kosovë. Mijëra luftëtarë nga i gjithë vendi ranë për këtë qëllim. Pavarësisht trimërisë dhe vullnetit të shqiptarëve për të mbrojtur vendin, mungesa e armëve dhe municioneve i la ata të pafuqishëm përballë pushtuesve.

Pas pushtimit të Kosovës nga serbo-malazezët, filloi një fushatë e egër shfarosëse kundër shqiptarëve, veçanërisht në vitet 1913-1914, ku dhuna arriti kulmin. U themelua një pushtet ushtarak policor që aplikoi një politikë të dhunshme ndaj popullsisë shqiptare dhe një program asimilues për të zhdukur etninë shqiptare në Kosovë. Kjo përfshinte masakrën e mijëra shqiptarëve, shkatërrimin e pronave dhe institucioneve fetare, si dhe serbizimin me forcë të emrave dhe mbiemrave nën kërcënimin e armëve. U ndalua gjuha, traditat dhe veshja kombëtare, shqiptarët u kthyen me dhunë në fenë sllavo-ortodokse. Terrori dhe torturat nga xhandarmëria dhe ushtria serbo-malazeze arritën kulmin në Rrafsh të Dukagjinit, ku ata që refuzonin kthimin në sllavo-ortodoks dhe ndryshimin e identitetit kombëtar torturoheshin dhe vriteshin në mënyrë barbare “*Ndërroni fenë e kombësinë ose pranoni vdekjen*”<sup>1</sup>. Vendosja e administratës civile të pushtuesit serb në përputhje me dekretin “Mbi rregullimin e krahinave të çliruara”<sup>2</sup> që

<sup>1</sup> Ajet Haxhiu, *Shota dhe Azem Galica* (Tiranë: Shtëpia Botuese "8 Nëntori", 1982), 27.

<sup>2</sup> “*Në dhjetorin e vitit 1912, mbreti serb kishte shpallur një dekret personal, nëpërmjet të të cilit e vinte tërë këtë rajon nën sundimin ushtarak; nga shqiptarët kërkohet që ose t'i dorëzonin të gjitha armët, ose do të konsideroheshin si armiq, të cilët do të ndiqeshin.*”

mbështetej te “Ligji mbi bashkimin e Serbisë së Vjetër Mbretërisë Serbe dhe qeverisjes së saj”, u shoqërua me 2 veprime mjaft të rënda për popullsinë shqiptare; çarmatosja e popullsisë dhe regjistrimi i saj.<sup>3</sup> Këto veprime ishin pjesë e një terrori të egër shtetëror mbi popullsinë shqiptare, e cila iu përgjigj me një luftë të rezistencës (në fakt pa lidhje të brendshme dhe pa qendër drejtuese) ndaj pushtimit serb nëpërmjet veprimeve individuale apo formimit të çetave në zona të ndryshme të vendit. “... rezistenca kishte vazhduar në disa vise. Në verën e vitit 1913, grupe të vogla kryengritësish shqiptarë të njohur si kaçakë (kaçakë), ishin aktivizuar në rajonin e Pejës e në atë të Gjakovës. Çdo formë e rezistencës dënohej me ashpërsinë më të madhe”.<sup>4</sup>

Për shkak të vuajtjeve të rënda, shpërthyen kryengritje të njëpasnjëshme kudo, veçanërisht në rajonin e Drenicës. Në pranverën e vitit 1913, vëllai i Shotës, Dani, u vra në një luftim të ashpër në fshatin Mikushnicë, dhe Azem Bejta u burgos. Ai u dërgua në kampin e Runikut (fshat afër Radishevës), ku familjarët e të burgosurve sulmuan kampin për t'i liruar nga torturat çnjerëzore. Azem Bejta arriti të arratisesh, por u plagos dhe u kap në Malet e Drenicës.

Pas arrestimit, Azem Galica dhe dy vëllezërit e tij të mëdhenj u dërguan në burgun e sigurisë së lartë në Pozharevc të Serbisë, ku u mbajtën nën kushte të rënda për të shmangur arratisjen, por edhe nga aty ai arrin të arratiset e të kthehet mes shumë vështirësish në Drenicë. Me të arritur në vendlindje, Azem Bejta formoi çetat çlirimtare dhe filloi eliminimin e ushtarëve serbë dhe spiunëve shqipfolës që gjatë dy viteve të mungesës së çetave kryengritëse kishin bashkëpunuar me pushtuesin serb pa frikë ndëshkimi.

---

*Në gushtin e vitit 1913, u shpall një dekretligj tjetër për "rajonet e çliruara" që bazohej në një ligj të vitit 1885 për "likuidimin e banditëve": ky ligj lejonte syrgjynosjen e fshatrave të tëra; në të kishte nene kundër tubimit të më shumë se pesë vetave në mbrëmje dhe njëherësh ishte kundër çdo forme të "propagandës kundër shtetit". Një dekret tjetër, edhe më drakonian për "sigurimin publik" doli në shtator, në të cilin thuhej se ai që do t'i bënte rezistencë pushtetit, do të dënohej me pesë vjet pune të rëndë, ndërsa "vendimet e policisë... ishin provë e mjaftueshme për krim- in e bërë"; dhe ai i cili shpallej nga policia si kriminel, në qoftë se nuk dorëzohej brenda dhjetë ditësh, mund të vritej nga çdo nëpunës shtetëror- civil apo ushtarak.”. Noel Malcolm, *Kosova: Një histori e shkurtër* (Prishtinë: Koha; Tiranë: Shtëpia e Librit, 2001), 268.*

<sup>3</sup> Jusuf Buxhovi, *Kosova: Nga Konferenca e Londrës deri te protektorati ndërkombëtar* (Prishtinë: “Faik Konica”; Houston: “Jalifat Publishing”, 2013), 119–23.

<sup>4</sup> Noel Malcolm, *Kosova: Një histori e shkurtër* (Prishtinë: Koha; Tiranë: Shtëpia e Librit, 2001), 268.

Gjatë shtegtimeve luftarake, para burgosjes së tij, Azemi njohu Shotën, me të cilën u martua pas arratisjes nga burgu në vitin 1915. Martesa e tyre u bë pa ndonjë dasmë apo shpenzime, por me disa krisje pushkësh që simbolizonin bashkimin e tyre dhe të armëve të lirisë kundër armikut të përbashkët. Lufta dhe përpjekjet heroike të tyre vazhduan pa pushim deri në vdekjen e Azemit.

Në fund të vitit 1915 dhe fillimin e vitit 1916, vendin e forcave pushtuese serbo-malazeze që kapitulluan para ushtrisë Austro-Hungareze, e zënë ato austro-hungareze dhe bullgare. Pavarësisht largimit të tyre, Kosova u nda përsëri në dy pjesë, njëra nën kontrollin e Austro-Hungarisë dhe tjetra nën kontrollin bullgar. Në zonat nën kontrollin Austro-Hungarez, shqiptarët fituan disa të drejta kombëtare, përfshirë hapjen e shkollave shqipe dhe vendosjen e administratës vendore deri te shpallja e një autonomie të brendshme, të cilat ishin të ndaluara gjatë pushtimit serbo-malazez. Në këtë periudhë Beogradi do të përpiqet që të gjejë aleatë mes shqiptarëve, "... *ndër të cilët edhe Azem Bejtën dhe të tjerë, të cilët bashkë me çetnikët serbë do të luftojnë praninë austro-hungareze në Kosovë...*"<sup>5</sup>. Kryçetniku serb Kosta Peçanaç<sup>6</sup> "*kishte hyrë në bisedime edhe me Azem Bejtën, kaçakun më të njohur shqiptar, i cili ishte përfshirë në një luftë*

<sup>5</sup> Jusuf Buxhovi, *Kosova: Nga Konferenca e Londrës deri te protektorati ndërkombëtar* (Prishtinë: "Faik Konica"; Houston: "Jalifat Publishing", 2013), 124, 133–37.

<sup>6</sup> Kush ishte Kosta Millovanoviq "Peqanci": Kosta Millovanoviq, i njohur si "Peqanci," lindi në vitin 1879 në Deçan dhe u rrit në Gurakoc të Burimit (Istogut). Në vitin 1892, u transferua në Serbi dhe, në moshën 21-vjeçare, u thirr për të kryer shërbimin ushtarak. Në fund të shekullit të 19-të dhe fillim të shekullit të 20-të, u aktivizua në grupet çetnike serbe, të cilat kryenin sulme diversante dhe vrasje të figurave shqiptare në rajonet e Kumanovës, Shkupit dhe trojeve të tjera shqiptare. Në vitin 1904, u emërua "Vojvodë" i çetnikëve. Gjatë Luftës së Parë Ballkanike, Millovanoviq luftoi kundër shqiptarëve në Merdare dhe Kumanovë, duke ndihmuar në pushtimin e Rrafshit të Dukagjinit. Pas fillimit të Luftës së Parë Botërore, ai u transferua në frontin e Selanikut, ku arriti gradën e togerit. Pas humbjes së luftës nga Serbia, ai udhëhoqi një divizion të ushtrisë serbe në tërheqje përmes Shqipërisë dhe Malit të Zi drejt bregdetit Adriatik, duke përdorur njohuritë e tij të gjuhës dhe mentalitetit shqiptar. Në vitin 1916, ai shkoi në rajonin e Toplicës për të ndihmuar në organizimin e rezistencës kundër ushtrisë bullgare, por përfundoi duke sabotuar luftën e udhëheqësit lokal, Kosta Vojinoviq. Pas humbjes së shumicës së betejave dhe të ushtarëve të tij, ai u largua nga rajoni në vitin 1917. Pas formimit të mbretërisë serbo-kroato-slllovene më 1 Dhjetor 1918, ai u angazhua në shuarjen e kryengritjeve shqiptare në Kosovë deri më 1923. Millovanoviq u kthye në Kosovë pas Luftës së Parë Botërore, ku mori pjesë në shuarjen e kryengritjeve shqiptare dhe në ripushtimin e Kosovës nga Serbia. Kthimi i Millovanoviq në Kosovë nxiti një rezistencë të madhe nga shqiptarët, të udhëhequr nga Azem Bejta, i cili organizoi kryengritje të fuqishme kundër pushtuesit serb.

*kundër forcave të Boshtit. Ata ishin takuar në verën e vitit 1918 diku në katundin Pridvoricë të Kollashinit të Ibrit, në shtëpinë e Olimpie Bozhovqit. Ishte biseduar rreth "luftës së përbashkët" kundër "pushtuesve". Bisedat do të vazhdonin edhe në katundin Varage, gjë që ato dhe veprimet e ngjashme, që kishin filluar prej më shumë se një viti, nuk do të mbeteshin të pavërejtura dhe pa reagimin e Austro- Hungarezëve, të cilët do ta shpallin armik Azemin dhe kaçakët e tij, me të cilët do të hyjnë në disa luftime, që për pasojë do të kenë edhe masat represive ndaj jatakëve të tij në disa pjesë të Drenicës, të cilat "për arsye sigurie" do të kenë për pasojë edhe deportimin e disa Shqiptarëve në Austri.*

*Armiqësia me austro-hungarezët dhe bashkëpunimi me çetnikët e Kosta Peçancit do të vazhdojë deri në fund në dobi të Serbëve.”<sup>7</sup>*

Gjatë vitit 1916 Azemi me shokë organizuan shumë sulme e prita ndaj xhandarmërisë armike. Në zonat nën sundimin bullgar, shqiptarët nuk gëzonin asnjë të drejtë, duke çuar në konfrontime të shpeshta midis Azem Bejtës, Shaban Polluzhës dhe pushtuesve austro-bullgarë. Drenica e luftëtarëve të Azem e Shote Galicës ishte e ndarë mes 2 pushtuesve, por lufta e tyre kaloi kufijtë e Drenicës duke kaluar edhe në Mitrovicë dhe Vuçiternë. “Çetat dhe grupet e Drenicës në zhvillimin e tyre filluan të kishin të qartë konceptin e manovrimit: luftë me lëvizje e me zhvendosje të largëta, kalime herë në zonën austriake, herë në atë bullgare, veprime të çetës herë në grupe, herë të gjithë bashkë, organizim pritash dhe goditje në befasi etj.”<sup>8</sup>

Në dimrin 1916-1917 çeta e Azemit u nda në grupe si pasojë e sulmeve të forcave armike, ndërsa Azemi, Shota dhe Ademi (vëllai i vogël) u strehuan në Obrij të Drenicës bashkë me familjarët e mbetur të Azemit. Në fundin e marsit të vitit 1917 forcat pushtuese austro-hungareze dhe bullgare rrethuan Azemin, 4 kundër dhjetëra xhandarëve. I bënë thirrje që të dorëzohej, por ai nuk u dorëzua dhe pas shumë përpjekjeve arriti të largohej në pyllin e Obrijes i plagosur.

Gjendja e rëndë nën pushtimin bullgar dhe përpjekjet e Austro-Hungarisë për çarmatosjen e kryengritësve, detyruan Azem Bejtën të bashkohej me udhëheqësin e çetave të Drenicës veriore, Shaqir Smaka<sup>9</sup>, në

<sup>7</sup> Jusuf Buxhovi, *Kosova: Nga Konferenca e Londrës deri te protektorati ndërkombëtar* (Prishtinë: “Faik Konica”; Houston: “Jalifat Publishing”, 2013), 136; Noel Malcolm, *Kosova: Një histori e shkurtër* (Prishtinë: Koha; Tiranë: Shtëpia e Librit, 2001), 273.

<sup>8</sup> Ajet Haxhiu, *Shota dhe Azem Galica* (Tiranë: Shtëpia Botuese “8 Nëntori”, 1982), 42.

<sup>9</sup> “Gjendja e rëndë posaçërisht e krijuar në Drenicë nga mesi i vitit 1916 nga presioni intensifikuar detyroi individë dhe grupe të fshatarëve të arratisen në male për të luftuar

vitin 1917. Pas rrethimit dhe vrasjes së Shaqir Smakës nga xhandarmëria austro-hungareze, në luftën e Bajës<sup>10</sup>, Azem Bejta, në moshën 28-vjeçare, u emërua udhëheqës i çetave të luftëtarëve kryengritës në të gjithë Drenicën. *“Udhëheqësi kaçak më i madh e më i famshëm ishte Azem Bejta (1889-1924), i cili e mbajti Drenicën e tij, zonën qendrore të Kosovës në kryengritje të vazhdueshme gjatë fillimit të viteve 1920. Bejta dhe e shoqja Shota... ishin udhëheqësit e një lëvizjeje të fuqishme që në fund të vitit 1918 komandonin të vetëm rreth 2 mijë luftëtarë dhe 100 mijë përkrahës”*<sup>11</sup>.

Me afrimin e përfundimit të Luftës së Parë Botërore dhe tërheqjen e Austro-Hungarisë, Serbia filloi përgatitjet për ripushtimin e Kosovës. Në tetor 1918, luftëtarët e Azem Bejtës, pasi çliruan Drenicën dhe Istogun, kapën rreth 1000 ushtarë austro-hungarezë dhe çliruan edhe Pejën, ku ngritën Flamurin Kombëtar Shqiptar. Azemi dhe luftëtarët e tij u përshëndetën nga banorët e Pejës dhe më pas dorëzuan robërit të forcat franceze në Mitrovicë. Megjithatë, forcat franceze tradhtuan shqiptarët duke hapur rrugën për ushtrinë serbe, e cila vijoi me ripushtimin e Kosovës dhe masakrimin e shqiptarëve. Kështu, gëzimi i lirisë për shqiptarët ishte i shkurtër dhe ndodhi një tjetër tradhti e madhe ndaj tyre.

Me të hyrë në Kosovë ushtria serbe kërkoi që Azemi dhe luftëtarët e tij të dorëzonin armët meqë lufta kishte mbaruar, por ata nuk pranuan. Me dredhi dhe me premtime komandantët ushtarakë serbë u munduan ta joshnin Azemin, por koha e marrëveshjeve kishte kaluar dhe ai *“... iu përgjigj prerë komandantëve armiq se, po të mos largoheshin nga Kosova,*

---

*kundër tyre si zgjidhje e vetme çështjes së tyre të rëndë. Raste të arratisurve ka pasur në Drenicë, sidomos në veriperëndim të saj, siç ishte çeta e Shaqir Smakës, të fshatit Kastriot, komuna Runik.*

*Shaqir Smaka që në ditët e para të okupimit austro-hungarez filloi të përgaditte popullin për kryengritje të armatosur. Çeta e tij, gjithnjë zgjerohej me luftëtarë të rinj nga fshatrat e komunës së Runikut, ndërsa në fshatin Galicë, Azem Bejta, gjithashtu, formoi çetën e vet.*

*Këto dy çeta të Drenicës në koordinim në mes veti vepronin në likuidimin e stacioneve të xhandarmërisë dhe bënë mbikëqyrjen e kontrollit të aksit rrugor Mitrovicë - Pejë. Mirëpo, nga fillimi i tetorit 1918 trupat e ushtrisë frënge dhe serbe marshonin në drejtim të Kosovës dhe aty nga mesi i këtij muaji ata edhe ia arrijnë ta pushtojnë Kosovën. Njëherit forcat frënge me pjesëmarrjen e çetave shqiptare hyjnë në Mitrovicë më 12 tetor 1918 dhe më 13 hyjnë edhe në Drenicë. Kështu u zhduk gjendja e rëndë trivjeçare nën pushtimin e Austro-Hungarisë.”* Nezir Çitaku, Drenica në shekuj, Asociacioni Ulqini, Ulqin, 2007, fq.200.

<sup>10</sup> Ajet Haxhiu, *Shota dhe Azem Galica* (Tiranë: Shtëpia Botuese “8 Nëntori”, 1982), 51–54.

<sup>11</sup> Miranda Vickers, *Midis serbëve dhe shqiptarëve: Një histori e Kosovës* (Tiranë: Botimet Toena, 2004), 132.

do të rifillonte menjëherë luftën kundër ushtrisë serbe.”<sup>12</sup> Terrori dhe dhuna shtetërore me mjete policore dhe ushtarake e pushtimit të ri serb u rivendos në Kosovë egërsisht, duke filluar edhe aksionin për çarmatosjen me dhunë të popullsisë. Në emër të gjoja vendosjes së rendit dhe ligjit duheshin luftuar “bandat kriminale”, siç quheshin kaçakët që vazhdonin veprimtarinë e tyre në mbarë Kosovën.<sup>13</sup> “Nga kjo gjendje e krijuar shumë qytetarë të Mitrovicës, për t’iu ikur masakrimeve dhe burgosjeve nga pushtuesi serb, iknin për në Sarajevë, Travnik e Banjallukë, ndërsa pjesa tjetër nga rrethi i Drenicës i bashkëngjiten çetave të Azem Galicës.”<sup>14</sup> Gjithashtu pas ripushtimit të Kosovës filloi dhe zbatimi i programit të kolonializmit, që u shpreh me dekretin e shkurtit të vitit 1919 “Masat paraprake për Reformën agrare”.<sup>15</sup>

Por tashmë me pranimin e Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve, ajo do të njihete vendimet e Konferencës së Paqes së Parisit dhe do të ratifikonte marrëveshjet me shtete fqinje, duke pranuar Kosovën si pjesë përbërëse të Mbretërisë Serbo-Kroate-Slllovene. Si rrjellojë Lëvizja Kaçake<sup>16</sup> duke qenë

<sup>12</sup> Ajet Haxhiu, *Shota dhe Azem Galica* (Tiranë: Shtëpia Botuese “8 Nëntori”, 1982), 63.

<sup>13</sup> Jusuf Buxhovi, *Kosova: Nga Konferenca e Londrës deri te protektorati ndërkombëtar* (Prishtinë: “Faik Konica”; Houston: “Jalifat Publishing”, 2013), 124, 140.

<sup>14</sup> Nezir Çitaku, *Drenica në shekuj* (Ulqin: Asociacioni Ulqini, 2007), 203.

<sup>15</sup> “Dekreti për “Masat paraprake për Reformën agrare” në shkurtin e vitit 1919, shpallte shturjen e pronave të mëdha dhe nacionalizimin e pyjeve, përfshinte edhe klauzolën për dhurimin e tokave ushtarëve dhe vullnetarëve serbë; një dekret tjetër i dhjetorit, përcaktonte si “vullnetarë”, të gjithë ata të cilët kishin hyrë në ushtrinë serbe me vullnetin e tyre para 18 nëntorit të vitit 1918, dhe u jepte atyre të drejtën që të kërkonin pesë hektarë toke pune. Dy vjet më pas, një dekret tjetër, shtonte kategorinë tjetër të kolonistëve potencialë, siç ishin luftëtarët vullnetarë në luftërat ballkanike dhe anëtarët e organizatave çet-nike (të cilët kishin të drejtë të merrnin si dhuratë dhjetë hektarë tokë në Kosovë ose në Maqedoni). Ndërkohë, “Dekreti për kolonizimin e trojeve të reja jugore” në shtatorin e vitit 1920, përcaktonte llojin e tokës që mund t’u dhurohej këtyre kolonistëve. Këto ishin toka të lira në pronësinë shtetërore, toka të përbashkëta që nuk punoheshin, toka private që nuk punoheshin ose kishin mbetur të djerra dhe tërë toka e konfiskuar në bazë të “masave paraprake” të shkurtit të vitit 1919. Sipas ligjit të vitit 1931 (i cili në të vërtetë ishte ligji i parë i plotë mbi kolonizimin, krahasuar me “dekretligjet” apo me të ashtuquajtura masat “paraprake” ose “të përkohshme”), toka e atyre që kishin marrë pjesë në kryengritje të kaçakëve, mund të konfiskohej dhe të kolonizohej tashti; në të vërtetë, konfiskime të këtilla ishin bërë tashmë me vite të tëra, duke i shpallur tokat e tilla thjesht si “të djerra.”” Noel Malcolm, *Kosova: Një histori e shkurtër* (Prishtinë: Koha; Tiranë: Shtëpia e Librit, 2001), 291.

<sup>16</sup> Lëvizja kaçake në Kosovë në periudhën 1918-1928 është një lëvizje masive popullore, e mbështetur në traditat dhe historinë e luftës së popullit shqiptar për lirinë kombëtare. Kjo lëvizje vazhdoi dhe thelloi luftën shekullore të popullit shqiptar kundër pushtuesve të huaj. Karakterizohet si një luftë e grupuar, organizuar në formën e çetave, e cila kishte

e jashtëligjshme për Beogradin, kështu do të ishte edhe për Shqipërinë e cila kishte të drejtë të trajtonte veç të drejtat dhe liritë e pakicave shqiptare tashmë jashtë kufijve të saj<sup>17</sup> dhe jo çështjen e bashkimit kombëtar që

si qëllim kundërshtimin e sundimit serbomadh dhe mbrojtjen e identitetit kombëtar shqiptar në kushte të reja pas vitit 1912. Gjatë 10 viteve të saj të ekzistencës, nga tetori i vitit 1918 deri në vitin 1928, Lëvizja Nacionalçlirimtare ka kaluar nëpër faza të ndryshme zhvillimi dhe ka përjetuar batica dhe zbatice, që janë shprehje e kushteve politike dhe ndërveprimeve ndërkombëtare të asaj kohe. Në periudhën nga viti 1918 deri në vitin 1928, lëvizja kaçake në Kosovë kaloi nëpër katër faza kryesore:

1. **Faza e parë (1918-1919):** Fillon me rezistencat lokale të çetave kundër vendosjes së pushtetit serbomadh. Pushteti ushtarako-policor u përball me kundërshtimin e çetave shqiptare në një rezistencë lokale. Kjo fazë karakterizohet nga rezistenca lokale kundër vendosjes së pushtetit serb dhe ndryshon gradualisht në një rezistencë më të përgjithshme kundër autoritetit serbomadh.
2. **Faza e dytë (1919-1921):** Përshkruhet si një lëvizje e përgjithshme popullore në prill-maj të vitit 1919, ku fillon kryengritja e përgjithshme. Në këtë periudhë, Lëvizja bëhet më e organizuar dhe ndikon në gjithë territorin e Kosovës. Kryengritjet më të rëndësishme të kësaj periudhe përfshijnë ato në Rrafshin e Dukagjinit dhe Llapushë. Intensiteti i luftimeve rritet, por përfundon me shtypjen e forcave serbe dhe çetnike.
3. **Faza e tretë (1923-1924):** Kjo fazë karakterizohet nga formimi i zonave të lira si Zona e lirë e Drenicës e Azem Bejtës dhe Zona e lirë në Dumnicë-Zagori e Mehmet Konjuhut. Ndërkohë, zhvillohen bisedime diplomatike midis Lëvizjes dhe organeve shtetërore serbe. Ndikimi i lëvizjes në opinionin publik dhe autonominë e zonave të lira është i dukshëm.
4. **Faza e katërt (1924-1928):** Përfshin dobësimin gradual të lëvizjes pas shkatërrimit të zonave të lira, vrasjen e liderëve si Azem Bejta dhe të tjerëve, dhe luftën e vazhdueshme me çeta të vogla kundër autoriteteve serbe. Lëvizja përpiket të mbijetojë dhe të koordinojë veprimtarinë me emigrantët politikë dhe aktivistët në vend, duke luajtur një rol në luftën politike dhe diplomatike për të mbrojtur të drejtat e shqiptarëve në Jugosllavi.

Ky periudhë shënon një fazë të rëndësishme në historinë e Kosovës, ku lëvizja kaçake luftoi për autonomi dhe liri kombëtare kundër pushtetit serb.

<sup>17</sup> "Qëndrimi zyrtar jugosllav kishte një sërë dykuptimshmëri. Nga njëra anë, përpiquej t'u shmangej obligimeve të përgjithshme të Traktatit për Mbrojtjen e Pakicave të vitit 1919, duke pretenduar se në Kosovë nuk kishte të ashtuquajtur pakicë kombëtare shqiptare. Në një deklaratë të paraqitur nga delegacioni jugosllav në Lidhjen e Kombeve, më 1929, si përgjigje ndaj kritikave shqiptare, thuhej qartë: "Qëndrimi ynë ka qenë gjithmonë se në rajonet tona të jugut, që janë bërë pjesë përbërëse e shtetit tonë, ose i janë aneksuar mbretërisë sonë para 1 janarit 1919, nuk ka pakica kombëtare. Ky qëndrim yni është ende fjala jonë e fundit rreth njohjes së pakicave në Serbinë Jugore". Nga ana tjetër, sipas regjistrimit jugosllav të vitit 1921, shifra e folësve të shqipes në mbarë Jugosllavinë, ishte 439.657 ndër të cilët 288.900 ndodheshin në Kosovë. Këto shifra, megjithatë, konsideroheshin si të pasigurta, jo vetëm nga përfaqësues shqiptarë, por edhe nga vëzhgues të huaj: eksperti italian për Shqipërinë, Antonio aldaçi, bie fjala, mendonte se në Jugosllavi, më 1920, kishte

përbënte thelbin e lëvizjes nacionalçlirimtare të popullsisë shqiptare të Kosovës.

Në vitin 1918, më datë 1 maj, në ilegalitet të plotë u themelua komiteti “Mbrotjtja Kombëtare e Kosovës”, i cili më 7 nëntor, u vendos përfundimisht në Shkodër, nga figurat e shquara atdhetare, si: Bajram Curri, Hoxha Kadri Prishtina, Sali Nivica, Niman Ferizi, Hasan Prishtina, Bedri Pejani, Qamil Bala, Sali Rama, Hafiz Ismet Dibra etj. Qëllimi kryesor i kësaj organizate politike kombëtare ishte mbrotjtja e shtetit të pavarur shqiptar, për demokratizimin e tij, për çlirimin e Kosovës dhe të viseve të tjera shqiptare dhe për bashkimin e tyre me Shqipërinë. Sipas udhëzimeve të këtij Komiteti<sup>18</sup> çetat e Azem Galicës tre muajt e fundit të vitit 1918 dhe gjatë vitit 1919 do të organizojnë dhe do të drejtojnë kryengritjen në krahinat e Kosovës. Më 24 prill 1919 u bë thirrja: “*Vllazën ... koha asht tepër me randësi. S’kemi asnjë minutë për të kapërcye në gjumë...*”<sup>19</sup> Menjëherë luftëtarët kryengritës të bashkuar në Rrafshin e Dukagjinit u rreshtuan përballë forcave serbe<sup>20</sup>. Me kryengritësit u bashkua

---

*700.000 shqiptarë, kurse më 1931 gjeografi rumun Nikola Pop, ka shkruar se kishte 800.000 shqiptarë. Sikur regjistruerit jugosllavë të popullatës të kishin gjetur edhe 67.000 shqipfolës të tjerë, atëherë shqiptarët do të radhiteshin si minoriteti i dytë më i madh gjuhësor në vend, pas sllovenëve, duke e kapërcyer edhe numrin e gjermanëve (505.790) dhe të hungarezëve (467.658)8. Si qe e mundur që autoritetet jugosllave të regjistronin qindra-mijëra shqiptarë dhe në të njëjtën kohë të pohonin se nuk ekzistonte një pakicë kombëtare në Kosovë e Maqedoni? Përgjigjia kësaj enigme është se ata nuk i konsideronin folësit e shqipes si shqiptarë në kuptimin etnik apo kombëtar: ata ishin vetëm serbë shqipfolës Noel Malcolm, Kosova: Një histori e shkurtër (Prishtinë: Koha; Tiranë: Shtëpia e Librit, 2001), 279.*

<sup>18</sup> “Ç’është e vërteta, Komiteti i Kosovës pjesën më të madhe të energjisë së tij ia kushtoi përkrahjes, deri në një shkallë edhe udhëheqjes së Lëvizjes kaçake brenda Kosovës. Në fillim të vitit 1919, ky komitet për- gatiti një varg rregullash të përgjithshme të lëvizjes, duke filluar me këto dy pika: “1: asnjë kryengritës nuk bën të lëndojë serbët vendës, por vetëm ata të cilët rrokin armët kundër shqiptarëve. 2: asnjë kryengritës nuk bën të djegë ndonjë shtëpi apo të rrënojë ndonjë kishë”. Ai po ashtu i bëri një kushtrim popullatës që të fillonte kryengritjen e përgjithshme, më 6 maj.” Noel Malcolm, Kosova: Një histori e shkurtër (Prishtinë: Koha; Tiranë: Shtëpia e Librit, 2001), 285.

<sup>19</sup> Ajet Haxhiu, *Shota dhe Azem Galica* (Tiranë: Shtëpia Botuese “8 Nëntori”, 1982), 75.

<sup>20</sup> “Me forcat kryengritëse të bashkuara mbi Rrafshin e Dukagjinit ishin grupet e çetat e këtyre krahinave:

1. Grupi i Rahovecit, i drejtuar nga patriotët Sadik Rama (i Gjyrxhevikut), Ramadan Shabani i Kijevës dhe Met Imeri.
2. Grupi i Drenicës, i drejtuar nga patriotët Azem Galica, Shotë Galica, Mursel Ahmeti i Prekazit, Sadik Lutani i Turicëfcit dhe Fazli Berani i Klinës.
3. Grupi i Pejës dhe i Istogut, i drejtuar nga patriotët Ram Alia i Istogut, Halit Ahmeti

mbarë populli i Drenicës dhe i Rrafshit të Dukagjinit (rreth 10 000 kryengritës aktiv). Kryengritja u përhap gjatë muajit maj në mbarë Rrafshin e Dukagjinit dhe u çliruan fshatrat mes Rahovecit, Drenicës, Pejës dhe Istogut. Por kryengritësit ishin me mungesa të mëdha në armatime përballë forcave serbe me armatime moderne dhe më të mëdha në numër, duke bërë që pas disa luftimeve zona e çliruar nga kryengritësit të ngushtohet në rajonin e Rahovecit dhe Gjyrrxhevikut të Madh.<sup>21</sup>

Palët u ulën në bisedime ku me gjithë kërcënimet dhe mashtrimet e përfaqësuesve të qeverisë së Beogradit, Azem Bejta, Sadik Rama etj. vendosën të vazhdonin luftën. U çlirua qyteti i Rahovecit me një luftë të përgjakshme me në krye Azem Galicën dhe Sadik Ramën. Por kundërsulmi i Beogradit me përforcime të mëdha në numër dhe armatime në dhjetëditëshin e parë të qershorit dogji Rahovecin dhe goditi rëndë kryengritësit që pas disa ditësh, rreth 300-350 vetë, u tërhoqën në Shqipëri. Ajo që ndodhi pas kësaj kryengritje ishte valë shkatërruese djegjesh, masakrimesh, plaçkitjesh që pësoi gjithë kjo zonë nga forcat serbe.

Në korrik të vitit 1919 Azemi me bashkëpunëtorët e tij do të kthehej përsëri në Kosovë për të vazhduar veprimtarinë e tij, duke bashkëvepruar me çetat e tjera për vazhdimin e qëndresës me luftë dhe duke i bërë thirrje popullit për të mos u larguar nga vendi. *“Ndalimi i gjuhës shqipe dhe mohimi i ekzistencës së shqiptarëve si pakicë kombëtare nuk ishin forma e vetme e presionit mbi shqiptarët e Kosovës. Ekzistonte edhe një program i gjerë i kolonizimit, i vendosjes së folësve të sllavishtes në viset e banuara me shqiptarë... Rrjedhimisht, paralelisht me procesin e kolonizimit, po zhvilloheshin edhe forma të ndryshme të padrejtësive, siç ishte konfiskimi i tokës së fshatarëve shqiptarë, që, me sa duket, kishte si qëllim që të nxiste tendencën e shpërnguljeve të shqiptarëve në Shqipëri ose në Turqi. Ndaj të gjitha këtyre persekutimeve, shqiptarët mund të përgjigjeshin në mënyra të ndryshme, legale dhe jolegale, duke filluar nga veprimtaria politike e sipërpërmendur, veprimtaria ilegale, deri në rebelim.”*<sup>22</sup>

Ndërsa nga ana tjetër qeveria serbe krahas dhunës e terrorit, përdorte edhe mashtrimet duke bërë premtime (edhe me elementë shqiptarë) që

---

*i Suhogërellës dhe Hasan Rexha i Shushicës.*

4. *Grupi i Prizrenit dhe i Gjakovës, i drejtuar nga patrioti Abaz Ostrazubi dhe Zefi i Vogël.*” Ajet Haxhiu, *Shota dhe Azem Galica* (Tiranë: Shtëpia Botuese “8 Nëntori”, 1982), 77.

<sup>21</sup> Ajet Haxhiu, *Shota dhe Azem Galica* (Tiranë: Shtëpia Botuese “8 Nëntori”, 1982), 77-79.

<sup>22</sup> Noel Malcolm, *Kosova: Një histori e shkurtër* (Prishtinë: Koha; Tiranë: Shtëpia e Librit, 2001), 280.

kryetarët e çetave e dinin që nuk do t'i realizonte kurrë. Megjithatë kjo solli një klimë të vështirë për kryengritësit, sepse nëpërmjet kësaj politike disa njerëz u frikësuan, disa të tjerë, spiunë, tradhtarë, kolonë serbë e malazezë u organizuan kundër tyre. Si rrjedhojë Azem Galica me Mehmet Konjuhini e disa krerë të tjerë u detyruan të fillonin bisedimet me qeveritarët serbë në tetor të vitit 1919. Kërkesat e Azem Galicës (të njohura si “8 pikat e Azem Galicës”) ndaj inspektorit të përgjithshëm të administratës së Beogradit, Mihajll Ceroviq, ishin: *“...të njihet e drejta e popullit shqiptar të Kosovës për t'u bashkuar me Shqipërinë; të ndalohen menjëherë vrasjet, djegiet dhe plaçkitjet kundër shqiptarëve; të ndalohet grabitja e tokave të shqiptarëve, ardhja e kolonëve serbë e malazezë dhe dëbimi i shqiptarëve jashtë vendit; të ndalohen operacionet ndëshkuese të ushtrisë kundër shqiptarëve nën pretekstin e marrjes së armëve dhe ndjekjes së çetave; të lejohet hapja e shkollave shqipe; gjuha shqipe të jetë gjuhë zyrtare dhe nëpunësit e huaj të zëvendësohen me nëpunës shqiptarë; të ndalohet burgosja e internimi i familjeve të luftëtarëve të çetave dhe të atyre që i përkrahin çetat; të ndalohet ndjekja e çetave shqiptare dhe të gjithë ata që ndiqen të mbrohen nga çetat.”*<sup>23</sup> Nga ky takim nuk u arrit asgjë, kështu që luftimet vazhduan me shumë sulme të çetave kryengritëse në disa zona të Kosovës.

Gjatë vitit 1920 kryengritësit vazhdojnë luftën e tyre çlirimtare në Llap, Gollak, Vuçiternë, Drenicë, Istog etj., duke pasur gjithmonë mbështetjen e popullsisë vendase, përballë xhandarmërisë, bandave çetnike, batalioneve dhe artilerisë serbe. Po për fatet e Kosovës në këtë periudhë ndikoj fuqimisht gjendja në Shqipëri.

Pas Luftës së Parë Botërore, Shqipëria e njohur si "parisiene" nuk ndryshonte shumë nga Shqipëria "londineze" për sa i përket kufijve shtetërorë, me disa ndryshime të vogla territoriale në veri. Ndërsa nuk kishte garancitë e fuqive të mëdha, Shqipëria kishte "mandatin" italian, që e lidhte me interesat italiane dhe ato britaniko-amerikane, duke e mbrojtur nga rreziku jugosllav dhe duke u përkujdesur për çështjen e Kosovës.

Megjithatë, çështja e Kosovës dhe Lëvizja Irredentiste krijonin tensione të brendshme dhe të jashtme për Shqipërinë. Elita politike shqiptare përpiquej të përfshinte një pjesë të energjisë së Lëvizjes Irredentiste në strukturat qeverisëse për të forcuar shtetin shqiptar dhe për t'u kujdesur për Kosovën.

Pragmatizmi patriotik u bë një drejtim i përgjithshëm politik që çoi shqiptarët e Kosovës të luftonin për Princ Vidin dhe të ndihmonin në

<sup>23</sup> Ajet Haxhiu, *Shota dhe Azem Galica* (Tiranë: Shtëpia Botuese “8 Nëntori”, 1982), 92-93.

ndërtimin e shtetit shqiptar. Kjo ndihmë u vërejt sidomos gjatë Konferencës së Paqes në Paris dhe Kongresit Kombëtar të Lushnjës në janar 1920. Liderët e Komitetit "Mbrojtja Kombëtare e Kosovës", si Hoxhë Kadri Prishtina, Hasan Prishtina dhe Bajram Curri, luajtën rol kyç në këto ngjarje, duke ndihmuar në përgatitjen e kongresit dhe në përbërjen e qeverisë së Sulejman Delvinës.

Në fillim të viteve 1920, Qeveria e Tiranës arriti disa suksese të rëndësishme drejt rikthimit të sovranitetit të shtetit shqiptar. Një nga këto ishte marrja e qytetit të Shkodrës nga trupat franceze më 12 mars 1920 dhe shpallja e vendimit të Bashkisë së Shkodrës për t'iu bashkuar qeverisë kombëtare të Tiranës. Këto ngjarje ishin ngushtësisht të lidhura me veprimtarinë dhe rolin e Komitetit "Mbrojtja Kombëtare e Kosovës" në Shkodër, ku figura të rëndësishme si Hoxha Kadriu dhe Ahmet Zogu kishin mbështetjen e mijëra militantëve të gatshëm për të luftuar për Shqipërinë.

Forcat e Komitetit, të drejtuara kryesisht nga Bajram Curri, mbetën besnike ndaj qeverisë së Sulejman Delvinës dhe Ahmet Zogut, duke vepruar në raste emergjente për të mbrojtur sigurinë e brishtë të shtetit shqiptar. Jugosllavët përdornin Lëvizjen Kaçake të Kosovës për të destabilizuar Shqipërinë dhe justifikonin praninë e forcave të tyre ushtarake në pjesë të Shqipërisë Veriore.

Pas çlirimit të Vlorës dhe largimit të trupave italiane, qeveria shqiptare përballej me sfida të mëdha për të fituar përkrahjen ndërkombëtare. Në gusht të vitit 1920, qeveria e Tiranës u detyrua të pengojë zbarkimin e armëve për lëvizjen e armatosur në Kosovë, një veprim që tregonte fërkimet midis Lëvizjes Irredentiste dhe shtetit shqiptar. Në të njëjtën kohë, qeveria e Iljaz Vrionit, pasuesi i Delvinës, iu afrua britanikëve, të cilët ndihmuar në pranimin e Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve.

Në këto rrethana, kompromisi ishte i domosdoshëm. Lëvizja Irredentiste, e udhëhequr nga figura të njohura si Hasan Prishtina, duhej të përdorej për nevojat e shtetit. Megjithatë, pas vetëm shtatë ditësh si kryeministër, Hasan Prishtina u detyrua të japë dorëheqje, duke treguar vështirësitë e bashkëpunimit midis Lëvizjes Irredentiste dhe shtetit shqiptar. Ahmet Zogu mori fuqinë në dorë, duke vendosur rregullat e politikës shqiptare për vitet e ardhshme.

Në përpjekjet e tyre për të mbrojtur interesat e shtetit, qeveritë shqiptare të kohës u detyruan të heqin dorë nga koncepti për një shtet të bashkuar shqiptar dhe të përqendrohen në stabilizimin e brendshëm. Kjo qasje solli ndërlikime të mëdha politike dhe tragjike për Shqipërinë dhe Kosovën në vitet që pasuan.

Në pranverën e vitit 1920, forcat kaçake u përqendruan në rajonin e Qyqavicës. Çeta e Azem Galicës, e cila kishte arritur në 200 luftëtarë, ishte aktive në Kosovë dhe më gjerë. Për t'u koordinuar më mirë, çeta u nda në dy grupe. Gjatë një përlëshjeje me xhandarmërinë serbe në fshatin Tërdevc, luftëtarët e Azemit arritën të thyenin forcat serbe, duke shkaktuar viktime.

Në verën e vitit 1920, Beqir Rexha, një tjetër prijës kaçak, ishte në fshatin Rakinicë, ku xhandarmëria serbe kreu një sulm, duke rrënuar shumicën e shtëpive dhe vrarë shumë banorë. Lëvizja kaçake vepronte në të gjithë rajonin e banuar me shqiptarë, duke përfshirë edhe territoret e Podujevës dhe Karadakut. Përpjekjet serbe për të shtypur këtë lëvizje shpesh përfshinin hakmarrje ndaj familjeve të kaçakëve.

Në janar të vitit 1921, autoritetet serbe internuan shumë familje të kaçakëve, por aktiviteti i tyre vazhdoi në Drenicë dhe Podrimë. Në vitin 1921, Azem Bejta dhe çeta e tij zhvilluan negociata me autoritetet serbe, por nuk u arrit asnjë marrëveshje përfundimtare. Lëvizja kaçake vazhdoi të mbetet aktive, edhe pse serbët ndërmorën masa ushtarake dhe politike për ta shtypur atë.

Aktiviteti i Azem Galicës, Bajram Currit, Hasan Prishtinës dhe kryengritësve të tjerë detyroi forcat serbe të pranonin një marrëveshje për krijimin, në vitin 1921, të një zone të lirë për shqiptarët nën pushtim, e quajtur "Zona neutrale e Junikut". Ajo përfshinte fshatrat: Junik, Mulliq, Batushë, Brovinë, Ponoshec, Bobaj, Boks, Popoc, Shishman dhe Kosharje<sup>24</sup>. Kjo zonë gjatë viteve 1921-1923 ishte vatra e organizimeve të çetave kryengritëse të malësive verilindore të shtetit shqiptar dhe të Kosovës, që në vjeshtë të vitit 1922 numëronte rreth 2000 vetë, mes tyre dhe e çetës së Azemit dhe Shote Galicës.<sup>25</sup>

Në këtë zonë në fund të dhjetorit 1922 krerët e çetave u organizuan për një sulm kundër qeveritarëve të prefekturës së Kosovës (Kukësit) dhe pastaj të kalonin në krahinat e tjera shqiptare. Por dikush informoi për datën e sulmit, kështu që në një takim mes Hasan Prishtinës, Azem Galicës, Hysni Currit dhe Sadik Ramës u vendos që sulmi të bëhej më përpara. Kryengritësit liruuan Tropojën, Hasin, rrethuan Krumën dhe arritën deri në brigjet e Drinit. Por shpejt arritën forcat ushtarake dhe në përplasjet që u zhvilluan ata lanë shumë të vrarë.<sup>26</sup>

Megjithatë, kjo zonë u suprimua në shkurt të vitit 1923 nga ushtritë e Shqipërisë dhe Jugosllavisë (sipas kujtimeve të Hajriz Demakut, ajo iu

<sup>24</sup> Nezir Çitaku, *Drenica në shekuj* (Ulqin: Asociacioni Ulqini, 2007), 226.

<sup>25</sup> Ajet Haxhiu, *Shota dhe Azem Galica* (Tiranë: Shtëpia Botuese "8 Nëntori", 1982), 190.

<sup>26</sup> Ajet Haxhiu, *Shota dhe Azem Galica* (Tiranë: Shtëpia Botuese "8 Nëntori", 1982), 191-194.

dorëzua Serbisë me nënshkrimin e Cana Beg Kryeziut, përfaqësues i Shqipërisë<sup>27</sup>). Pas kësaj, çetat kaçake u detyruan të kthehen në territoret e tyre, ku veprimi i tyre u bë më i vështirë.

Më 27 janar 1923, ushtria shqiptare, e komanduar nga major Prenk Jaku, hyri pa vështirësi në "Zonën Neutrale" dhe pas disa luftimeve, çetat kaçake dhe prijësit e tyre u larguan nga Juniku. Ushtria shqiptare qëndroi në këtë zonë deri më 21 shkurt 1923, kur ushtria e Mbretërisë Serbe-Kroate-Slllovene hyri në këtë pjesë me mandatin e dhënë nga Konferenca e Paqes në Paris. Aksioni ushtarak jugosllav ndaj popullatës shqiptare ishte i ashpër dhe në përputhje me logjikën e luftës kundër irredentistëve, ndërsa disa burime sugjerojnë se edhe forcat shqiptare morën pjesë në operacion.

Zogu kërkoi nga Beogradi që, në këmbim të Junikut, të likuidoheshin forcat separatiste të Markagjonit që përbënin rrezik për shtetin shqiptar. Shuarja e "Zonës Neutrale" dhe futja e saj nën pushtimin e Beogradit ndau përfundimisht Lëvizjen Irredentiste. Pjesa brenda kufirit shqiptar u integrua në politikën e brendshme shqiptare, ndërsa pjesa në Kosovë dhe territoret shqiptare nën Jugosllavi vazhdoi rezistencën e armatosur për disa vite, por gjithnjë me humbje.

Azem Bejta dhe çetat e tij e kuptonin se Shqipëria ua kishte kthyer shpinën për interesat e veta, ndërsa Beogradi përpiqej t'i kapitulojë ose t'i shfarosë. Eliminimi i Lëvizjes së Rezistencës Kombëtare Shqiptare në Kosovë do të realizohej duke ndryshuar strukturën etnike në dëm të shqiptarëve dhe në dobi të serbëve përmes kolonizimit dhe shpërnguljes. Në modelin e "Zonës Neutrale" të Junikut, Beogradi vendosi të përqendronte kaçakët në Drenicë, ku ata do të mbikëqyreshin dhe veprimet e tyre do të kufizoheshin.

Në qershor 1923, bisedimet e Beogradit me Azem Bejtën dhe prijësit e tjerë të kaçakëve rezultuan në krijimin e "Zonës së Lirë" në Prekaz, ku Azemi dhe çeta e tij do të mbeteshin të armatosur dhe të lirë brenda një territori të caktuar, popullsia e zonës lirohej nga detyrimet shtetërore, dhe organet shtetërore nuk do të dërgonin xhandarmëri apo ushtri në këtë zonë. Kjo zonë u njoh me emrin "Arbania e vogël" dhe përfshinte gati të gjithë fshatrat e komunës së Prekazit dhe gjatë dimrit të vitit 1923 e deri në verën e vitit 1924 përfshinte fshatrat Galicë, Mikushnicë dhe Lybavec.<sup>28</sup> Megjithatë, këto marrëveshje gojore dhe "besat" e ndërsjella nuk zgjatën shumë, pasi Beogradi kishte interesa që prijësit e kaçakëve të mos gëzonin

<sup>27</sup><https://www.radiokosovaelire.com/gani-qarri-azem-bejte-galica-jeta-dhe-veprimtaria-e-tij-luftarake-1889-1924-2/>

<sup>28</sup> Ajet Haxhiu, *Shota dhe Azem Galica* (Tiranë: Shtëpia Botuese "8 Nëntori", 1982), 212.

mbrojtje të përhershme.

Në korrik 1924, regjimi i Beogradit asgjësoi "Zonën e Lirë" të Prekazit dhe simbolin e lëvizjes kaçake, Azem Bejtën, i cili ra heroikisht në luftë me forcat e shumta ushtarake dhe policore të Beogradit (rreth 1200 ushtarë), të cilat natën e 14 korrikut me artileri të rëndë rrethuan "Zonën e lirë të Drenicës". Kryengritësit që kishin shpëtuar nga ky sulm, bashkë me Azem Galicën e plagosur arritën të dalin nga rrethimi drejt malit të Qyqavicës. Çetës së Azem Galicës i bashkohen edhe çeta e Vushtrisë dhe pas 6 ditësh rrethimi u drejtuan për në Shqipëri. Gjatë rrugës së vështirë mes fshatrave Gllarevë e Përçevë, më 25-26 korrik Azemi vdes nga plagët e marra. Për të mos u marrë vesh vdekja e tij kufoma u hodh në një humnerë në shpellën e Qukut, ku qëndroj për gjysmëshekulli. Pas vdekjes së Azem Bejtës, çeta e tij çlirimtare u udhëhoq nga Shote Galica deri në sëmundjen e saj, duke vazhduar edhe 2 vjet të tjera Lëvizjen Kaçake në Drenicë.<sup>29</sup>

Kjo ngjarje shënoi një pikë kthese në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare, ndërsa Ahmet Zogu, pas kthimit të pushtetit në dhjetor 1924, filloi qërimin e hesapeve me liderët e Lëvizjes së Irredentiste edhe në Shqipëri, duke mbyllur tragjikisht kapitullin e Komitetit "Mbrojtja Kombëtare e Kosovës" dhe Lëvizjes Kaçake.

Përtej këtyre zhvillimeve politike, kaçakët u përballën me një përgjigje të rreptë nga autoritetet jugosllave dhe serbe. Masakrat e fshatrave dhe përpjekjet për të eliminuar grupet kaçake shënuan një periudhë të vështirë për popullsinë vendase, sidomos në zonat e prekura si Dubnica, ku shumë civilë humbën jetën në represionin serb.

Pas vitit 1924, një amnisti dhe marrëdhëniet e përmirësuara me Beogradin bënë që lëvizja e kaçakëve të dobësohej, por kujtesa e rezistencës së tyre për një bashkim kombëtar mbeti e fortë në kujtesën popullore shqiptare. Kjo periudhë ishte kritike për shpërqendrimin e lëvizjes së kaçakëve dhe për formimin e një stabiliteti të përkohshëm në rajon.

Në përfundim, Azem Galica mbetet një simbol i fuqishëm i rezistencës shqiptare kundër pushtuesve të huaj. Rritja e tij në një ambient të mbushur me urrejtje ndaj pushtuesve, angazhimi i tij i vendosur për liri, formuan jetën dhe karakterin e tij luftarak.

Pavarësisht kushteve të vështira, mungesës së armëve dhe brutalitetit të forcave pushtuese, ai arriti të mobilizojë mijëra luftëtarë dhe të mbajë

<sup>29</sup> Nezir Çitaku, *Drenica në shekuj* (Ulqin: Asociacioni Ulqini, 2007), 228.

Jusuf Buxhovi, *Kosova: Nga Konferenca e Londrës deri te protektorati ndërkombëtar* (Prishtinë: "Faik Konica"; Houston: "Jalifat Publishing", 2013), 174.

gjallë frymën e qëndresës në Drenicë dhe më gjerë. Komiteti "Mbrojtja Kombëtare e Kosovës" dhe kryengritjet e organizuara prej tij për të çliruar Kosovën nga pushtuesit serbë dhe për të bashkuar atë me Shqipërinë, janë dëshmi të përkushtimit të tij për lirinë dhe pavarësinë shqiptare.

Megjithatë, përpjekjet e Azemit dhe luftëtarëve të tij u përballën me sfida të mëdha, përfshirë tradhtinë e forcave të huaja, mungesën e mbështetjes ndërkombëtare dhe represionin e vazhdueshëm nga regjimet serbe. Pavarësisht vdekjes së tij në betejë, Azem Galica dhe lëvizja e tij kaçake vazhduan të frymëzojnë breza të tërë shqiptarësh, duke mbajtur gjallë kujtesën dhe ndjenjën e rezistencës ndaj çdo forme të shtypjes dhe pushtimit.

Azemi jetoi dhe vdiq si një hero, dhe historia e tij është një testament i fortë i rezistencës, trimërisë dhe dashurisë për lirinë e popullit të tij. Ai mbetet një figurë e rëndësishme dhe e nderuar në historinë shqiptare, një shembull për të gjithë ata që luftojnë për drejtësi dhe liri.

## **BIBLIOGRAFIA:**

- Buxhovi, Jusuf. *Kosova: Nga Konferenca e Londrës deri te protektorati ndërkombëtar*. Prishtinë: "Faik Konica"; Houston: "Jalifat Publishing", 2013.
- Çitaku, Nezir. *Drenica në shekuj*. Ulqin: Asociacioni Ulqini, 2007.
- Haxhiu, Ajet. *Shota dhe Azem Galica*. Tiranë: Shtëpia Botuese "8 Nëntori", 1982.
- Malcolm, Noel. *Kosova: Një histori e shkurtër*. Prishtinë: Koha; Tiranë: Shtëpia e Librit, 2001.
- Vickers, Miranda. *Midis serbëve dhe shqiptarëve: Një histori e Kosovës*. Tiranë: Botimet Toena, 2004.
- Radio Kosova e Lirë. "Gani Qarri: Azem Bejta Galica, jeta dhe veprimtaria e tij luftarake (1889-1924)." <https://www.radiokosovaelire.com/gani-qarri-azem-bejte-galica-jeta-dhe-veprimtaria-e-tij-luftarake-1889-1924-2/>.

## **THE GREAT LEADER OF ALBANIAN NATIONAL RESISTANCE, AZEM GALICA**

### ***ABSTRACT***

Azem Galica was a prominent figure of the Albanian national liberation movement in the early 20th century. He became widely known

for his courage and determination in the struggle against the Austro-Hungarian and Bulgarian occupiers, as well as the anti-popular Serbian and Montenegrin regimes, becoming a symbol of resistance and national independence for many Albanians. His activity included organizing the *kaçak* movement, leading combat battalions, and protecting the local population, demonstrating remarkable tactical and strategic abilities in confronting occupying forces. The legacy of Azem Galica holds particular importance for national identity. He continues to be honored as a national hero for his decisive contribution to the struggle for the freedom and independence of the Albanian people.

The object of the study on the patriotic activity of Azem Galica includes a broad analysis and evaluation of his actions within the historical, political, and social context of the time, aiming to provide a deeper understanding of his role and contribution to the resistance against Serbian and Montenegrin occupation.

The aim of this paper on the patriotic activity of Azem Galica is to examine and analyze his impact and essential role in the Albanian independence movement at the beginning of the 20th century.

The methodology used in this study includes a multidisciplinary and analytical approach to understand and assess his contribution to Albanian national history. This methodology seeks to provide a thorough and well-documented understanding of his patriotic activity, including historical research and analysis of the historical context and his legacy within national history.

**Keywords:** *kaçak* movement, armed band (*çetë*), neutral zone, occupation, uprising.

## JETA SHKENCORE

### - Konferenca shkencore “*Leksikografia shpjeguese shqipe e viteve '30–'40 të shek. XX*”

Më 18 tetor 2024 u zhvillua konferenca shkencore “*Leksikografia shpjeguese shqipe e viteve '30–'40 të shek. XX*”, e cila u organizua në bashkëpunim mes Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Departamentit të Gjuhësisë dhe Qendrës së Studimeve Albanologjike të Universitetit të Shkodrës “*Luigj Gurakuqi*”. Konferenca trajtoi zhvillimin e leksikografisë shpjeguese shqipe në periudhën ndërmjet dy luftërave botërore, duke vënë në pah rolin e dijetarëve të Veriut dhe kontributin e tyre në zhvillimin e leksikografisë shkencore bashkëkohore. Punimet analizuan botimet, prurjet teorike dhe qasjet e leksikografëve të kohës, të cilat ndërtuan themelet e leksikografisë institucionale pas Luftës së Dytë Botërore.

Konferenca u hap nga prof. as. dr. Orjeta Baja – Drejtuese e Departamentit të Gjuhësisë. Fjalët përshëndetëse u mbajtën nga prof. dr. Blerita Dragusha – Zëvendësrektore e Universitetit të Shkodrës dhe akad. Valter Memisha – Drejtor i Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë.

Në fjalët e tyre, u evidentuan disa nga sfidat dhe arritjet e leksikografisë shpjeguese shqipe gjatë viteve '30–'40 të shek. XX, si dhe u vu në dukje fakti që dijetarë të trevës së Veriut luajtën një rol kyç në zhvillimet leksikografike të gjuhës sonë, duke i cilësuar ata si prijatarë.

Kumtesat e mbajtura në këtë tubim shkencor analizuan punën e asaj periudhe dhe vlerësuan trashëgiminë e saj në kontekstin e sotëm, duke u ndalur në prurjet leksikografike të N. Gazullit, P. Tases, L. Nosit, A. Sirdanit; në botime të lëndës leksikore nga dijetarë të tjerë, si M. Kruja, K. Gurakuqi e A. Xhuvani; si dhe në probleme teorike të parashtruara nga studiues të kohës, si F. Konica e L. Gurakuqi – duke përgatitur kështu truallin për leksikografinë shkencore njëgjuhëshe institucionale të pas Luftës së Dytë Botërore.

### - Seminari “*Shkodra në shekuj*”

Seminari “*Shkodra në shekuj*” u zhvillua më 12–13 dhjetor 2024. Përmes këtij seminari u synua të krijohet një platformë ndërdisiplinore për të diskutuar dhe eksploruar trashëgiminë kulturore të rajonit të Shkodrës dhe Veriut të Shqipërisë. Seminari synoi të krijonte një platformë ndërdisiplinore mbi historinë dhe trashëgiminë kulturore të Shkodrës, duke trajtuar rolin e institucioneve fetare, arsimore dhe të shtypit të hershëm në

formësimin e identitetit kombëtar. Me pjesëmarrjen e rreth 70 kumtuesve nga hapësira shqiptare dhe rajoni, aktiviteti afërmoi rëndësinë e bashkëpunimit akademik dhe të ruajtjes së trashëgimisë shkodrane.

Qëllimi kryesor i këtij seminari ishte të ofronte një analizë gjithëpërfshirëse mbi rolin e këtij rajoni në formësimin e identitetit kombëtar dhe ndikimin e tij në zhvillimin ekonomik, shoqëror, turistik dhe kulturor.

Në këtë kuadër, seminari përfshiu sesione të veçanta mbi rolet e institucioneve fetare e arsimore në Shkodër, kontributin e shtypit të hershëm shkodran, si dhe të figurave françeskane e laike në ndërtimin e mendimit kombëtar.

Kumtuan rreth 70 kumtues të ftuar nga të gjitha trevat shqiptare, Mali i Zi, Kosova, Maqedonia e Veriut etj. Aktiviteti u konceptua si një urë bashkëpunimi mes studiuesve të Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, Qendrës së Studimeve Albanologjike, si dhe institucioneve kulturore e muzeale të qytetit, duke nxitur diskutime mbi mënyrat bashkëkohore të ruajtjes dhe promovimit të trashëgimisë së pasur shkodrane.

- **Aktiviteti shkencor “Xhubleta – pasaportë e identitetit kulturor kombëtar”**

Në shkurt 2025, në Guci, u zhvillua aktiviteti shkencor “Xhubleta – pasaportë e identitetit kulturor kombëtar”, një bashkëpunim midis Departamentit të Historisë së Universitetit tonë dhe Qendrës për Ruajtjen dhe Zhvillimin e Kulturës së Pakicave në Mal të Zi (Podgoricë). Aktiviteti vlerësoi xhubletën si simbol të trashëgimisë kombëtare dhe si element identitar i mbrojtur. U trajtuan aspektet kulturore, historike dhe etnografike të saj në bashkëpunim me institucionet kulturore të Malit të Zi.

- **Konferenca në nderim të figurës së studiuesit dhe të albanologut të shquar Francesco Altimari**

Konferenca u zhvillua më 21 mars 2025 dhe iu kushtua kontributit shkencor të profesor Francesco Altimari, një nga figurat më të spikatura të albanologjisë bashkëkohore, dhe kishte për qëllim të vlerësonte e të thellonte studimin mbi punën e tij të shquar në fushën e gjuhës dhe kulturës arbëreshe, si dhe rolin e tij të rëndësishëm në studimet albanologjike. Konferenca për nder të profesor Francesco Altimari vlerësoi kontributet e tij në studimet arbëreshe, gjuhësi, leksikografi dhe filologji. Ajo theksoi rolin e tij në ndërkombëtarizimin e studimeve shqiptare dhe në ndërtimin e urave akademike ndërmjet Shqipërisë dhe Italisë.

Si një shkencëtar i përkushtuar, profesor Altimari ka qenë gjithnjë një mbrojtës dhe promovues i zellshëm i trashëgimisë kulturore arbëreshe, duke krijuar një urë të fortë midis Shqipërisë dhe komunitetit

arbëresh të Italisë.

Figura e tij shkëlqen jo vetëm për kontributet shkencore në fushën e gjuhësisë, filologjisë dhe leksikografisë, por edhe për përpjekjet e pareshtura në ruajtjen dhe zhvillimin e identitetit arbëresh dhe lidhjeve historike e kulturore mes dy popujve.

Nëpërmjet punimeve të tij, profesor Altimari ka pasuruar dhe thelluar studimet mbi dialektet e rralla arbëreshe, duke kontribuar gjithashtu në përkthimin dhe përhapjen e veprave të autorëve shqiptarë e arbëreshë në arenën ndërkombëtare.

Ky aktivitet shërbeu si një manifestim shkencor dhe simbolik i mirënjohjes për një personalitet që i ka dhënë një dimension të ri bashkëpunimit akademik ndërmjet Italisë dhe Shqipërisë.

- **Konferenca “*Treva e Veriut: Visaret e traditave dhe kujtesa që ndriçon historinë*”**

Kjo konferencë zhvilloi punimet në maj 2025. Përmes këtij aktiviteti u synua të hidhej dritë mbi pasuritë e pandashme kulturore, gjuhësore dhe letrare të Veriut të Shqipërisë, duke u fokusuar në rolin e këtij rajoni në ndërtimin e identitetit kombëtar shqiptar. Ky rajon ka qenë gjithmonë një burim i pashtershëm traditash, dokesh dhe krijimtarië popullore, duke dhënë një kontribut të vlefshëm në ruajtjen e gjuhës dhe të shpirtit shqiptar ndër shekuj.

Konferenca u fokusua në trashëgiminë kulturore, shpirtërore dhe gjuhësore të Veriut të Shqipërisë, duke theksuar rolin e trevës në ruajtjen e identitetit kombëtar. Me rreth 50 kumtesa nga studiues të rajonit dhe jashtë tij, aktiviteti solli analiza të thelluara mbi dialektet, figurat letrare dhe ndikimet kulturore. Konferenca eksploroj mënyrat bashkëkohore të ruajtjes, transmetimit dhe promovimit të këtyre pasurive, duke analizuar sfidat dhe mundësitë që sjell globalizimi dhe teknologjia e re.

Nëpërmjet referimeve të studiuesve të fushave të etnologjisë, letërsisë, historisë dhe antropologjisë, u ndërtua një tablo e plotë mbi trashëgiminë e pasur të Veriut si nyje identitare dhe kulturore e kombit shqiptar. Temat e trajtuara përfshinë çështje që kanë të bëjnë me ruajtjen e dialekteve, rolin e figurave të letërsisë veriore, si dhe me ndikimin e kulturës së këtij rajoni në mendimin evropian, duke vendosur theksin mbi trashëgiminë shpirtërore si një kujtesë që ndriçon historinë dhe identitetin kombëtar.

Përmes prezantimeve shkencore dhe analizave të thelluara, kjo konferencë siguroi një platformë reflektimi e shkëmbimi idesh, duke afirmuar rëndësinë e trashëgimisë kulturore të Veriut në një botë gjithnjë e më të globalizuar.

Prezantimet u kumtuuan nga studiues të ftuar nga Maqedonia e Veriut, Mali i

Zi, Kosova dhe Italia.

Spikatën me prezantimet e tyre edhe doktorantët në aktivitetin e titulluar “Dita e doktorantit”.

- **Simpoziumi “Kufiri i shpresës dhe i vdekjes në vitet 1944–1991. Shkodra përballë së kaluarës”**

Në gusht 2025, në Bibliotekën e Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi” u zhvillua simpoziumi “Kufiri i shpresës dhe i vdekjes në vitet 1944–1991. Shkodra përballë së kaluarës”, një bashkëpunim me Autoritetin për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit dhe Bashkinë Shkodër. Simpoziumi analizoi kufirin verior gjatë periudhës komuniste si hapësirë tragjesh dhe shpresash. Ai solli dëshmi historike dhe qasje studimore mbi arratisjet, represionin dhe memorien e kësaj periudhe të errët në Shkodër dhe në Shqipëri.

- **Konferenca Shkencore Ndërkombëtare: “Transformime dhe ndikime: Shqipëria Veriore (1879–1918) dhe impakti i fuqive evropiane” - 18 tetor 2024**

Në bashkëpunim me Konsullatën e Austrisë në Shkodër, Departamenti i Historisë organizoi Konferencën shkencore ndërkombëtare “Transformime dhe ndikime: Shqipëria Veriore (1879–1918) dhe impakti i fuqive evropiane”, më 18 tetor 2024.

Konferenca trajtoi proceset politike, diplomatike dhe shoqërore që ndikuan Shqipërinë Veriore në fund-shekullin XIX dhe fillim-shekullin XX, me theks në politikën e Fuqive të Mëdha evropiane dhe rolin e Shkodrës në këto zhvillime.

- **Projekti “Edukimi është çelësi i zhvillimit”**

Projekti kombinoi vizita studimore, takime akademike dhe bashkëpunime ndërkombëtare, duke theksuar rëndësinë e ndërveprimit shkencor dhe të promovimit të trashëgimisë kulturore në nivel evropian, veçanërisht me komunitetet arbëreshe.

Në kuadër të projektit “Edukimi është çelësi i zhvillimit”, një grup studentësh dhe pedagogësh vizitoi nëntë qytete me rëndësi historike dhe turistike, ku u theksua lidhja midis trashëgimisë antike, mesjetare dhe moderne. Gjatë kësaj periudhe u realizuan edhe takime akademike dhe miqësore në Universitetin e Salentos. Pati edhe takime me komunitetin arbëresh.

- **Projekte kërkimore dhe riorganizime akademike**

Departamenti i Historisë zhvilloi projekte kërkimore në fushat e arkivistikës, muzeologjisë, turizmit kulturor dhe turizmit të errët. Riorganizimi i programit “Histori dhe trashëgimi kulturore” në partneritet me Universitetin e Salentos krijoi bazën për një program të përbashkët

Bachelor në “Trashëgimi Kulturorë”.

- Në bashkëpunim me Konsullatën e Austrisë në Shkodër, Departamenti i Historisë organizoi Konferencën Shkencore Ndërkombëtare: “Transformime dhe ndikime: Shqipëria Veriore (1879 – 1918) dhe impakti i Fuqive Evropiane”; 18 tetor 2024, në Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi”.
- Realizimi i dy projekteve: “Interpretimi i historisë përmes njohjes me arkivat dhe muzeumet” dhe “Turizmi i errët, përvoja e vendeve të Evropës Lindore (Çeki, Poloni)”.
- Riororganizim i programit “Histori dhe trashëgimi kulturorë” në programin e përbashkët Bachelor në “Trashëgimi Kulturorë” në Universitetin “Luigj Gurakuqi” të Shkodrës me Universitetin e Salentos, Itali.

#### - **Konferenca studentore e Gjeografisë**

Në maj të vitit 2025 zhvilloi punimet Konferenca studentore, ku studentët prezantuan punime kërkimore dhe projekte aplikative në fushën e gjeografisë dhe të planifikimit hapësinor. Aktiviteti synoi nxitjen e mendimit kritik, përmirësimin e aftësive prezantuese dhe integrimin e studimit teorik me kërkimin shkencor. Kjo konferencë ofroi platformë për paraqitjen e kërkimeve dhe projekteve aplikative në gjeografi dhe planifikim hapësinor, duke nxitur mendimin kritik dhe kompetencat akademike të studentëve.

#### - **Workshop tematik me guida dhe operatorë turistikë**

Në prill 2025 u organizua një workshop, i cili synonte përmirësimin e kurrikulës së kursit profesional “Udhërrëfyes turistikë dhe menaxhues të itinerareve turistike”si dhe rritjen e bashkëpunimit ndërmjet qendrave akademike dhe industrisë turistike, duke adresuar praktikat bashkëkohore të menaxhimit të itinerareve. Workshop tematik me guida dhe operatorë turistikë, i organizuar me qëllim përmirësimin e kurrikulës.

#### - **Konferenca shkencore “Fрати i kujtesës” (me rastin e 100-vjetorit të lindjes së At Zef Pllumit, O.F.M.)**

Më 26 tetor 2024, u zhvillua konferenca shkencore “Fрати i kujtesës” (me rastin e 100-vjetorit të lindjes së At Zef Pllumit, O.F.M.). Veprimtaria u organizua në bashkëpunim mes Provincës Françeskane Shqiptare dhe Fakultetit të Shkencave Shoqërore të Universitetit “Luigj Gurakuqi” Konferenca vlerësoi kujtesën historike dhe veprën letrare të At Zef Pllumit si dëshmi të rëndësishme për periudhën e komunizmit dhe për kulturën françeskane shqiptare.

Studiues të fushave të ndryshme (gjuhësi, letërsi, histori) trajtuan aspekte të jetës dhe veprës së At Zef Pllumit, duke nxjerrë në pah jo vetëm dëshmitë

reale të një prej personazheve që provoi vuajtjet në kalvarin e burgjeve të komunizmit, por edhe vlerat gjuhësore e letrare të shkrimevetë tij.

Në 26 kumtesat e mbajtura në këtë konferencë u theksua se vepra e Át Zef Pllumit mbetet monumentale dhe vijon të jetë një sfidë për shoqërinë shqiptare, për historinë e saj pas Luftës së Dytë Botërore dhe për vlerat e besimit dhe ato humane në përgjithësi.

- **Konferenca shkencore “Në përkujtim të dy Françeskanëve të mëdhenj: Át Bernardin Palaj, O.F.M. dhe Át Justin Rrota, O.F.M.”**

Më 8 mars 2025, u zhvillua konferenca shkencore “Në përkujtim të dy Françeskanëve të mëdhenj: Át Bernardin Palaj, O.F.M. dhe Át Justin Rrota, O.F.M.”. Konferenca nderoi dy figurat madhore të kulturës françeskane, duke analizuar jetën, veprën dhe kontributet e tyre në albanologji, gjuhësi dhe letërsi. Veprimtaria u organizua në bashkëpunim mes Provincës Françeskane Shqiptare, Departamentit të Gjuhësisë dhe Departamentit të Letërsisë të Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”.

Në konferencë u mbajtën 30 kumtesa, në tri seanca paralele, të cilat nxitën reflektimin mbi personalitetet shkencore të Át Bernardin Palajt e Át Justin Rrotës.

Të pranishmit njohën më mirë këta dy personalitete, karakteret, jetën, veprimtarinë, kontributet dhe, në mënyrë të veçantë, tiparet gjuhësore e letrare të krijimtarisë së tyre.

- **Aktivitet akademik me studentë francezë nga Université de Haute-Alsace, Francë**

Më 16 maj 2025, Departamenti i Gjuhësisë në Fakultetin e Shkencave Shoqërore të Universitetit të Shkodrës zhvilloi një aktivitet të veçantë akademik me pjesëmarrjen e një grupi studentësh francezë nga Université de Haute-Alsace (Francë), të ardhur në Shkodër në kuadër të programit Erasmus+ MIC Albanie. Ky aktivitet ndërkombëtar u fokusua në huazimet frënge në gjuhën shqipe dhe në ndërveprimin e studentëve shqiptarë e francezë, duke forcuar dialogun ndërkulturor dhe ndërkombëtarizimin e studimeve gjuhësore.

Studentët u pritën nga dekani i FSHSH, prof. dr. Artan Haxhi dhe nga drejtuesja e Departamentit të Gjuhësisë, prof. as. dr. Orjeta Baja. Pas fjalëve përshëndetëse, prof. Baja mbajti për studentët vizitorë një leksion të hapur me temë: “*Emprunts français dans la langue albanaise*”, duke analizuar ndikimin e frëngjishtes në shqipe përmes huazimeve leksikore.

Në fund të ligjëratës, u zhvillua një punë praktike ndërvepruese me studentët e huaj dhe ata të programit të studimit “Gjuhë-Letërsi” të USH, ku u mbajt një leksion i hapur lidhur me fjalët e huazuara nga frëngjishtja në shqip. Diskutimet ishin frymëzuese dhe nxorën në pah rolin e gjuhëve në

ndërtimin e dialogut ndërkulturor.

Ky aktivitet i shërben forcimit të misionit të përbashkët për një arsim më të hapur, bashkëpunues dhe ndërkombëtar.

- **Workshop: “Përtej fjalëve: Strategji për parandalimin e dhunës verbale”**

Më 29 maj 2025, Departamenti i Gjuhësisë zhvilloi workshop-in ndërdisiplinor me temë: “Përtej fjalëve: Strategji për parandalimin e dhunës verbale”. Aktiviteti, i ideuar nga pedagogia Rezearta Murati, kishte si qëllim të nxisë reflektimin mbi një nga fenomenet më të zakonshme dhe më pak të dukshme të jetës së përditshme: dhunën verbale. Workshop-i trajtoi dhunën verbale në perspektivë gjuhësore, psikologjike, juridike dhe mediatike. Ai nënvizoi rolin e gjuhës në ndërtimin e një komunikimi të shëndetshëm në shoqëri dhe sensibilizoi mbi strategjitë për parandalimin e saj. Me pjesëmarrjen e gjerë të studentëve dhe nxënësve të shkollave të mesme, ky aktivitet solli një qasje ndërdisiplinore, duke përfshirë ekspertë të gjuhësisë, psikologjisë, komunikimit dhe së drejtës.

Veprimtaria u hap nga dr. Rezearta Murati, e cila theksoi rëndësinë e gjuhës si mjet që mund të ndërtojë ose të dëmtojë, dhe nevojën për të ndërtuar një kulturë komunikimi të respektueshëm në të gjitha nivelet e shoqërisë.

Fjalët përshëndetëse u mbajtën nga: prof. dr. Blerta Dragusha – Zëvendësrektore e Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi” dhe prof. as. dr. Orjeta Baja – Drejtuese e Departamentit të Gjuhësisë.

Kontributet akademike përfshinë:

– Dr. Merita Hysa (*Aspektet gjuhësore të dhunës verbale në komunikimin ndërpersonal*); Dr. Isida Hoxha (*Dhuna verbale në media: sfidat dhe strategjitë për parandalimin*); Dr. Arben Hoti (*Ndikimi i faktorëve psikologjikë në dhunën verbale*); Prof. as. dr. Florian Bjanku (*Roli i ligjit dhe kuadri ligjor për parandalimin e dhunës verbale*).

Prezantimet u zhvilluan si një diskutim i hapur me pjesëmarrësit, ku u ndanë eksperiencat, reflektimet dhe ide konkrete për ndërhyrje në situata të dhunës verbale në shkolla, media dhe jetën e përditshme.

Pjesëmarrja në workshop ishte mbresëlënëse, me rreth 120 pjesëmarrës, mes tyre studentë nga programet e Gjuhë-Letërsisë, Psikologjisë, Punës Sociale, Arsimit Fillor, Arsimit Parashkollor dhe Infermierisë, si dhe nxënës nga të gjitha shkollat e mesme të qytetit, publike dhe private. Aktiviteti u përmbyll me një mesazh të qartë: *Fjalët nuk janë të pafajshme – ato ndërtojnë ose lëndojnë. Është detyra jonë të zgjedhim fjalët që ndërtojnë.*

Në tërësinë e tyre, këto aktivitete përbëjnë boshtin themelor të jetës shkencore të Qendrës së Studimeve Albanologjike për vitin akademik 2024–2025, duke dëshmuar përkushtimin e saj në ruajtjen, studimin dhe

promovimin e trashëgimisë shqiptare në dritën e standardeve bashkëkohore të kërkimit shkencor dhe të ndërveprimit ndërkombëtar.

### Nekrologji



#### **PROF. DR. FATBARDHA HOXHA (FISHTA) (1947–2025)**

Më 22 nëntor 2025 u nda nga jeta prof. dr. Fatbardha Hoxha (Fishta), pedagoge e nderuar dhe një ndër figurat më të spikatura të Departamentit të Letërsisë në Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi”. E lindur në Shkodër, në vitin 1947, prof. dr. Fatbardha Hoxha e nisi karrierën e saj akademike në vitin 1969 si pedagoge në Universitetin e Shkodrës, institucion ku

kontribuoi për disa dekada në mësimdhënie, kërkim shkencor dhe drejtim akademik. Në vitin 1989 fitoi gradën *Kandidat i Shkencave Filologjike*, ndërsa në vitin 1994 gradën *Doktor*, me temën “*Haki Stërmilli, jeta dhe vepra*”. Titullin “*Profesor i asociuar*” e fitoi më 28 maj 1999 dhe titullin “*Profesor*”, më 31 maj 2004.

Gjatë veprimtarisë së saj akademike ka ushtruar funksione të rëndësishme drejtuese, ndër të cilat: kryeredaktore e revistës “Buletin shkencor” (seria e shkencave shoqërore), drejtuese e Departamentit të Letërsisë (1990–1993; 2000–2003) dhe më pas të Qendrës së Studimeve Albanologjike të Universitetit të Shkodrës (2013–2016), duke kontribuar në zhvillimin institucional dhe shkencor të këtyre strukturave. Gjatë dekadave të angazhimit në universitet, prof. Hoxha u veçua për profesionalizmin, integritetin dhe përkushtimin e saj në mësimdhënie dhe kërkim shkencor. Kolegët dhe ish-studentët e saj ndër vite, do ta kujtojnë me nderim prof. Bardhën për cilësitë e saj të vyera akademike dhe njerëzore. Fusha e saj kryesore e kërkimit ishte letërsia shqipe, veçanërisht letërsia e traditës dhe interpretimi kritik i autorëve kanonikë. Ajo mori pjesë në konferenca dhe simpoziume shkencore kombëtare e ndërkombëtare dhe botoi një numër të konsiderueshëm studimesh, monografish dhe tekstesh universitare.

Ndër veprat e saj më përfaqësuese janë:

*Letërsi shqiptare* (bashkautor, 1990);

*Haki Stërmilli* (1997);

*Ernest Koliqi, kritik dhe studiues* (2001);

*Fjala jonë, autorë dhe vepra të traditës* (2001);

*Rrjedhë të letërsisë së traditës* (2003);

*Qemal Draçini* (2003);

*Letërsi e hershme shqiptare* (2004);

*Shkodra, vlera tingëlluese* (bashkautor, 2012) dhe *Letërsi e interpretuar* (2013) etj.

Kontributi i prof. dr. Fatbardha Hoxhës në studimet letrare shqiptare dhe në formimin universitar mbetet një referencë e rëndësishme për kërkimin shkencor dhe për trashëgiminë akademike të Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”.

## **BOTIME**

Gjatë këtij viti doli nga shtypi vepra:

“*Krestomaci e albanologjisë*” II, me autor prof. dr. Artan Haxhi, botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Tiranë, 2025. Redaktor: prof. dr. Tefë Topalli. Recensentë: prof. dr. (akademik) Gjovalin Shkurtaç dhe prof. dr. Valter Memishaj. ISBN 9789928809964 (v.2) 537 fq.



**ISSN 2221 – 6855**

*Doli nga shtypi prill, 2026 – tirazhi 120 kopje – Formati 176 x 250 mm. Shtypur  
në shtypshkronjën e Universitetit të Shkodrës  
“Luigj Gurakuqi”*